

Shoqëria Ujësjetës-Kanalizime Tiranë  
Përgatitur nga:

# PLANI I BIZNESIT 2017-2021

SHOQËRIA UJËSJETËS-KANALIZIME TIRANË



## FJALA

Plani i Biznesit i Shoqërisë Ujësjeles-kanalizime Tiranë 2017-2021 është hartuar nga grupi i punës i përbërë nga profesionistë nga Shoqëria Ujësjeles-kanalizime Tiranë me mbështetje teknike të ekspertëve të sektorit ujësjeles-kanalizime nga Projekti i USAID-it për Planifikimin dhe Qeverisjen Vendore.

Gjatë procesit të hartimit të Planit të Biznesit u bë një shqyrtim tërësor i kushteve aktuale të shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizime, si për ish zonën e shërbimit të Shoqërisë para reformës territoriale ashtu edhe për ish komunat që iu bashkëngjiten Bashkisë së re Tiranë dhe për zonën e zgjeruar të shërbimit ujësjeles-kanalizime.

Për zbatimin e këtij Plani Biznesi do të nevojitet angazhimi i çdo punonjësi të Shoqërisë dhe përkushtimi i plotë i Këshillit Administrativ dhe sigursht edhe mbështetja e Bashkisë Tiranë, pronarit të ligjshëm të Shoqërisë ujësjeles-kanalizime.

Unë besoj se mendimi dhe kontributi i çdo anëtarit të stafit tonë ka qenë jashtëzakonisht i rëndësishëm për përgatitjen e këtij plani biznesi dhe për angazhimi i tyre në vënien në zbatim të këtij plani do të sigurojë suksesin e vazhdueshëm të Shoqërisë, si për sa i përket përmirësimit të operacioneve ashtu edhe në ofrimin e shërbimeve më të mira për të gjithë klientët tanë dhe për Bashkinë e Tiranës.

**Redi Molla**

Drejtor  
Shoqëria Ujësjeles-Kanalizime Tiranë

1. PREZANTIM I PËRGJITHSHËM I SHOQËRISË UJËSJELLES-KANALIZIME


1.1 Informacion i përgjithshëm

Gjatë periudhës së përgatitjes së këtij Planit Biznesi, Bashkia e re Tiranë ka qenë në procesin e ri-organizimit të Shoqërisë Ujësjetës-Kanalizime (UK Tiranë) në përgjigje të Reformës Administrative-Territoriale dhe në përputhje edhe me reformat e sektorit të ujit. Reforma administrative, e miratuar në vitin 2015, ishte një vendim i madh i politikës për shkritjen e njësisve të qeverisjes vendore nga 371 bashki dhe komuna që ishin më parë, secila me organet e veta administrative të qeverisjes, në 61 bashki që mbulojnë të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Për të siguruar se nuk ka "tragumentim të shërbimeve" brenda një bashkie, nga reformat në sektorin e ujit u vendos se do të ketë vetëm një Shoqëri që i shërben një bashkie.

Para Reformës Administrative-Territoriale, Shoqëria Ujësjetës-Kanalizime Tiranë siguronte shërbimin me pakicë ujësjetës-kanalizime për konsumatorët e saj të regjistruar brenda kufijve administrativë të Bashkisë Tiranë si dhe për ish komunitat Baldushk, Bërzhitë, Dajt, Farkë, Kashar, Kërrabë, Petrelë, Shëngjergj, Vaqar dhe Zall Herr, të cilat përbënin zonën e saj të licencuar të shërbimit.

UK Tiranë i shërbenet zonës së "gjelbër" që tregohet në Figurën 1-1. Sipas reformës territoriale, Bashkia e re Tiranë ka shtuar në zonën e saj të shërbimit edhe ish komunitat Zall Bashkë, Ndroq dhe Pezë, të cilat u ofronin një nivel të caktuar shërbimi ujësjetësi banorëve të tyre si shërbim komune. Nga ana tjetër, Shoqërisë UK Tiranë i janë larguar nga zona e shërbimit ish Komuna Paskuqan, e cila është tashmë pjesë e Bashkisë Kamëz, dhe ish komunitat Bërkuilë dhe Pezë që tani janë pjesë e Bashkisë së re Vorë, e cila ka Shoqërinë vet ujësjetës-kanalizime.

Figure 1-1  
Zona e re e shërbimit e UK Tiranë SHA



Që në fillim të vitit 2017, Bashkia e Tiranës, nëpërmjet Këshillit Bashkiak të saj, miratoi një Statut të ri për UK Tiranë. Në këtë mënyrë, UK Tiranë do të ndajë zyrtarisht aksionet përkatëse të pronësisë që Bashkia Tiranë dhe Bashkitë Vorë dhe Kamëz kishin tek ish

Tabela 1-1

Të dhënat dhe treguesit e performancës për vitin bazë - 2016

Të dhënat dhe treguesit e performancës	UK Tiranë	Ish komunat	Mesatare
Popullsia në zonën e shërbimit	697,300	135,002	832,302
Mbuhlmi me Shërbim Ujësullës i Popullsisë	91.7%	50.4%	85.0%
Mbuhlmi me shërbim kanalizimësh	85.9%	37.6%	78.1%
Numri i Lidhjeve të Regjistruara të Ujit:			
Familjarë	177,708	18,903	196,611
Biznese private	29,311	1,303	30,614
Institucione buxhetore	586	48	634
Klientë të vegantë	27	0	27
Furra Buke	204	0	204
Lidhje me matës (% e lidhjeve totale)	79.3%	35.8%	75%
Vëllimi vjetor i ujit të faturuar (m <sup>3</sup> )	28,652,338	2,767,557	31,419,895
Vëllimi vjetor i ujit të prodhuar (m <sup>3</sup> )	98,357,724	8,491,881	106,849,605
Përqindja e ujit pa të ardhura	67.6%	67.4%	67.6%
Norma aktuale e arkëtimeve (% e arkëtimeve të faturave në vitin aktual)	80.8%	64.9%	79.9%
Norma e arkëtimeve të faturave të prapambetura (% e arkëtimeve të faturave të prapambetura)	13.3%	n/a	13.3%
Mbuhlmi i Kostos Direkte të Operimit me të Ardhura	n/a	n/a	160.2%
Mbuhlmi i Kostos Direkte të Operimit me Arkëtime	n/a	n/a	128.0%
Mbuhlmi i Kostos Totale të Operimit me të Ardhura	n/a	n/a	94.0%
Mbuhlmi i Kostos Totale të Operimit me Arkëtime	n/a	n/a	75.1%
Stat për 1,000 lidhje (ujësullës + kanalizime)	n/a	n/a	2.62

Struktura aktuale e tarifës së UK Tiranë përbëhet nga kombinimi i tarifës fikse (lekë për lidhje/muaj) dhe tarifës variabël (lekë për metër kub ujë të konsumuar) bazuar në tarifën e miratuar nga Enti Regullator i Ujit. Ish Komunat janë faturuar me të njëjtat tarifa si UK Tiranë që nga fillimi i vitit 2016. Tabela 1-2 jep një përmbledhje të të gjitha tarifave të aplikuar në vitin 2016.

Tabela 1-2

Struktura e tarifës për shërbimin ujësullës-kanalizime

Kategoria	Tiranë *	Komunat
TARIFA AFORFE E UJIT (Lekë/Lidhje/Muaj)		
Familjarë	100	100
Institucione buxhetore	100	100
Biznese private	100	100
Klientë të vegantë	100	100
Furra Buke	100	100
HEC-Lanabregas	100	n/a

\* Në fuqi që nga 22 dhjetor 2011

**2. DEKLARATA E VIZIONIT DHE MISIONIT**

Shoqëria Ujësjetës-Kanalizime Tirane ka përcaktuar deklaratën e saj të Vizionit dhe Misionit si më poshtë:

**VIZIONI**

Të jemi ofruesi më i mirë i shërbimit të qëndrueshëm ujësjetës në Shqipëri nëpërmjet angazhimit tonë tek njerëzit, risitë, klientët, komunitet dhe mjedis.

**MISIONI**

- Të ofrojmë furnizim me ujë të qëndrueshëm, të sigurt dhe të pandërprerë, për të gjithë klientët ekzistues dhe të rinj në zonën e re të shërbimit të Bashkisë Tirane në përputhje me legjislativonin në fuqi.
- Të sigurojmë grumbullimin, trajtimin dhe largimin cilësor të ujërave të ndotura për të mbrojtur shëndetin publik dhe në përputhje me rregulloret kombëtare për mjedisin.
- Të sigurojmë një mjedis të sigurt, të përshtatshëm dhe të mirë ku nxitet komunikimi, bashkëpunimi, trajnimi dhe kompensimi për arritjet individuale të stafit.
- Të përmirësojmë vazhdimisht performancën për të siguruar qëndrueshmëri financiare dhe për të qenë në gjendje të mbulojmë nevojat për investime të reja dhe rinovime të asetëve në kohën e duhur.

**VLERAT**

Përtej deklaratave të Vizionit dhe Misionit, Shoqëria Ujësjetës-Kanalizime Tirane është e angazhuar ndaj vlerave të mëposhtme të Shoqërisë në kryerjen e detyrave të saj:

**Fokusi tek klienti:** Do të angazhohemi të kemi në fokus të parë interesin më të mirë të konsumatorëve tanë dhe të kujdesemi për besimin që ata na japin.

**Shërbimi:** Do të ofrojmë shërbim të shpejtë dhe të qëndrueshëm për konsumatorët tanë aktualë dhe të rinj dhe stafit ynë do të përpiqet vazhdimisht të bëjë më të mirën për ta.

**Përmirësimi i punonjësve:** Jemi të angazhuar të krijojmë dhe ruajmë një mjedis të sigurt punë për punonjësit tanë; të nxitim dhe përmirësojmë zhvillimin personal të secilit punonjës në mënyrë të atillë që punonjësit tanë të jenë më të mirët që mund të ketë sektori i ujit.

**Integriteti:** Do të jemi të hapur, të ndershëm dhe të paanshëm me konsumatorët dhe punonjësit tanë; dhe do të njihemi si Shoqëria që bën atë për të cilën jep fjalën.

ujë për popullsinë që shtohet, edhe kur kushtet dhe cilësia e shërbimit nuk ishin aty ku Shqëria do të donte të ishin. Por kjo ishte dhe dhe nuk është sot, sot është fillimi i një të nesërmeje shumë më të mirë.

Edhe pse duhet të rritet mbulimi me shërbim, Bashkia e re Tiranë mund të krenohet për mbulimin me shërbim prej 85% të banorëve të shërbyer nga sistemi formal i furnizimit me ujë dhe 78% e popullsisë e shërbyer me lidhje në kanalizime.

Edhe pse Shqëria po ofron shërbimin e furnizimit me ujë në mënyrë të vazhdueshme, ndonëse me ndërprerje, për pjesën më të madhe të zonës së shërbimit ajo e siguron këtë shërbim me një kosto të lartë për shkak të faktit se Shqëria ka një përqindje të lartë të ujit pa të ardhura. Uji pa të ardhura është uji që prodhohet dhe dërgohet në sistem, por që nuk i faturonhet konsumatorit dhe shpesh emërtohet si ujë i humbur. Në rastin e Tiranës, ky ujë llogaritet të jetë 67.6% ose pak më shumë se 2/3 e ujit humbet. Kjo situatë duhet të përmirësohet dhe përmirësimi duhet të jetë i konsiderueshëm.

Gjatë disa viteve të fundit, Shqëria ka qenë e përqendruar për t'u bërë një ndërmarje me vetëqëndrueshmëri financiare dhe në këtë drejtim ajo sot mbulon plotësisht kostot e saj operacionale dhe të mirëmbajtjes si dhe është në gjendje të gjenerojë edhe të ardhura shtesë për të financuar disa prej projekteve shumë të nevojshme të investimeve kapitale për një sistem të vjetër dhe ende në zgjerim. Megjithatë, Shqëria vazhdon ende të sfidohet nga disa konsumatorë që nuk paguajnë në kohën e duhur faturat e ujit, duke bërë që Shqëria të ketë një normë prej vetëm 79.9% të arkëtimit të faturave dhe kjo duhet të përmirësohet për të bërë të mundur sigurimin e fondëve me qëllim përmirësues dhe nevojave kryesore për investime kapitale, nëse Tiranë dëshiron të ketë një shërbim të nivelit ndërkombëtar.

### 3.3 Fokusi 5-Vjeçar për gëshjet prioritare të përmirësimit të performancës

Gjatë leximit të këtij plani biznesi, është e rëndësishme të kuptohet se edhe pse ky plan është për një periudhë 5-vjeçare, që është i pranueshëm për planifikim financiar dhe për përmirësim të matshme të performancës, ai nuk është kursyer por e vë theksin kryesor në investimet që do t'i shërbejnë Tiranës për brezat e ardhshëm. Megjithatë, gëshja sot lidhet me përmirësimet e dukeshme të performancës për të vazhduar të fitohet mbështetja e konsumatorëve të Shqërisë, të cilët nga ana e tyre duhet të kuptojnë pse duhet të rriten tarifat me kallimin e kohës dhe se pagesa e plotë dhe brenda afatit e faturës së ujit ka shumë rëndësi në ofrimin e shërbimeve të qëndrueshme dhe të sigurt. Këto gëshje prioritare specifike të përmirësimit të performancës që duhet të zgjidhen deri në 2021 janë si më poshtë:

- Rritja e mbulimit me shërbimin e furnizimit me ujë të popullsisë në Tiranë nga 85% në 95.3% dhe mbulimin me shërbim kanalizimesh nga 78.1% në 83.5%
- Një shumë e konsiderueshme e investimeve kapitale për të arritur këtë Objektiv Strategjik është shtrirja dhe përmirësimi i shërbimeve të ujësjellës-kanalizimeve në zonat rurale të largëta, në ish komunat që përbejnë një pjesë të konsiderueshme të Bashkisë së re të Tiranës. Objektivat në këtë plan biznesi nuk janë një pikë përfundimtare, por një hap i parë i madh për të vazhduar me shtrirjen e shërbimit dhe për të sjellë uniformitet të shërbimit cilësor, pavarësisht se ku jeton konsumatori brenda Bashkisë së Tiranës.
- Arritja e shërbimit të pandërprerë, të vazhdueshëm dhe me presion të furnizimit me ujë (24/7) në pjesën më të madhe të zonës së shërbimit të furnizimit me ujë të Tiranës.

Një qytet nuk mund të quhet kryeqytet i vërtetë nëse nuk siguron furnizim të vazhdueshëm e të pandërprerë me ujë të pijshëm në shtëpitë dhe objektet e biznesit

## 4. ANALIZA DHE PARASHIKIMI I KËRKESËS PËR UJË

## 4.1 Përmbledhje e përgjithshme

Shoqëria ujësjellës-kanalizime e Tiranës u krijuar në 1939 pas përfundimit të sistemit të parë të ujësjellësit. Uji merret nga Lumi i Tiranës, kalonte përmes një impianti të trajtimit të ujit dhe furnizonte qendren e re të asaj kohe të Tiranës, që përbëhej kryesisht nga ndërtesa qeveritare. Detyrat e Shoqërisë së ujësjellësit ishte të administrojë implantin e trajtimit dhe të furnizonte rrjetin e shpërndarjes së asaj kohe.

Gjatë viteve që pasuan, popullsia e Tiranës u rrit në mënyrë të qëndrueshme dhe po kështu u rrit edhe kërkesa për burime të reja të ujit, duke përfshirë Selltën në 1951, Shën Mërinë në 1964 dhe Bovillën në 1974. Në vitin 1999 u vendos të ndërtohej diga e Bovillës për të krijuar një liqen me ujë për të furnizuar implantin e sapondueruar të trajtimit të ujit me kapacitet depozitimi dhe furnizimi prej 100 milion m<sup>3</sup>.

Mënxhimi i kërkesës për ujë nga UK Tiranë ka qenë gjithmonë një çështje prioritare, duke qenë se sistemi i ujësjellësit është më i madh dhe ka kompleksitetin më të madh teknik të çdo sistemi që përfshin të gjithë komponentet që mund të gjenden në një sistem ujësjellës-kanalizime. Analiza e hollësishme e kërkesës aktuale dhe të parashikuar të ujit, si dhe reduktimi i parashikuar i ujit të pa të ardhurave prezantohen në këtë pjesë të Planit të Biznesit.

## 4.2 Sistemi i furnizimit me ujë në Shoqërinë ekzistuese UK Tiranë

Zona aktuale e shërbimit e Shoqërisë UK Tiranë furnizohet nga tre (3) lloje burime të ndryshme uji; burime natyrore që zakonisht vijnë nga malet, puse dhe stacione pompimi, ujëra sipërfaqësore dhe impante të trajtimit të ujit të pishëm. Në Tabelën 4 jepet një paraqitje statistikore të emrave, llojeve dhe kapaciteteve të të gjitha burimeve ujore.

Tabela 4-1

Karakteristikat e burimeve të ujit të UK Tiranë

Lloji	Emri	Sasia maks. (l/sek)	Sasia min. (l/sek)	Niveli (m. mbi niv.det)
Burime	Sellta	1,000	230	1,150
	Shën Mëria	640	450	750
	Boville e Vjetër	420	140	282
Puse	Pishinat	120	80	96
	Laknas	160	80	56
	Bërxiull	200	150	48
	Pema	40	35	91
	Buka	50	40	90
	Coca-Cola	25	20	71
	Çokollata	60	40	95
	Implanti i trajtimit të ujit të pishëm Boville	1,800	1,800	206

UK Tiranë ka një varietet të gjërë të tubacione të transmetimit me gjatësi dhe materiale të ndryshme. Këto tubacione transmetimi shërbejnë për të çuar ujin nga burimet, të cilat, siç u përmend më sipër, mund të jenë burime uji, puse, diga apo impante të trajtimit të ujit tek rezervuarët e ujit që ndodhen kryesisht në pikat hyrëse të pjesës urbane të Bashkisë Tiranë. Gjithashtu gjenden tubacione transmetimit që përdoren për të shpërndarë ujin nga një rezervuar tek tjetri. Në Tabelën 4-2 jepet një pamje e detajuar e gjëndjes së tipareve të ndryshme të tubacioneve për sa i përket karakteristikave, materialit, diamëtrit dhe gjatësisë.

Pas fazës përfundimtare të trajtimit, që është filtrimi, uji kalon në rezervuarin e impiantit, me kapacitet 30,000 m<sup>3</sup>. Nga aty, uji shpërndahet me dy tubacione kryesore transmetimi, një që sjell ujë direkt në sistemin e furnizimit të Tiranës dhe tjetri në rezervuarin e Kinostudios.

Impianti i Trajtit të Ujit të Bovillës ka një kapacitet prodhimi deri në 1,800 l/sek ujë të pijshëm për të furnizuar Bashkinë e Tiranës. Uji rrjedh me gravitet nga diga e Bovillës, në lartësinë 275 m mbi nivelin e detit, përmes një tubi çeliku me diametër DN900mm dhe gjatësi 10 km, drejt impiantit të trajtimit të ujit që ndodhet në Babrru, në lartësinë 217 m mbi nivelin e detit. Cilësia e ujit që shkon në impiantin e trajtimit konsiderohet e kategorisë A1 sipas standardëve të BE-së, kështu që proceset që duhen për të shndërruar këtë ujë në të pijshëm janë koagulimi-flokulimi, filtrimi dhe dezinfektimi. Dezinfektimi arrihet duke futur kimikate të tilla si acidi klorhidrik, hipokloriti i natrumit, polikloridi i aluminit, etj., në doza të përcaktuara në momentin kur uji hyn në fazën e parë të procesit të trajtimit.

**4.2.1 Impianti i Trajtit të Ujit të Pijshëm Bovillë**

Materiali i tubit	Rrjeti në qytet (metra)	Rrjeti në fshat (metra)	Totali (metra)
"Xingato"	324,977	272,635	597,612
Gizë	240,166	2,300	242,466
Çelik	218,486	142,530	361,016
PE	282,883	180,879	463,762
Çelik i galvanizuar	25,512	0	25,512
Milks	174,432	0	174,432
Eternit (Cimento Fibër)	0	3,879	3,879
Argjilë	0	771	771
<b>Totali</b>	<b>1,266,456</b>	<b>602,994</b>	<b>1,869,450</b>

**Tabela 4-4**  
Materialët dhe gjatësia e rrjetit të shpërndarjes së ujit në UK Tiranë

Rrjeti i furnizimit me ujë i UK Tiranë, që fillon nga rezervuarët e ndryshëm dhe përfundon me lidhjen tek konsumatorët, përbëhet nga dy lloje: rrjeti i hapur dhe rrjeti unazor. Në shumicën dermuese në Tiranë, sistemi është rrjeti i hapur dhe vetëm në disa zona të vogla mund të gjendet një rrjet unazor. Kuptohet që ka shumë probleme gjatë orëve të pikut të kërkesës për furnizim me rrjetin e hapur. Rrjeti i përgjithshëm i shpërndarjes së ujit është i përbërë nga 1.8 milion metra tubacione. Ky rrjet ka tuba që datojnë që nga viti 1940 si dhe tuba të rinj të instaluar në vitin 2015. Tubat e këtyj rrjeti janë me materiale të shumëllojshme sig

Yzberisht 1	1,000	148
Yzberisht 2	400	N/A
Yzberisht	4,000	N/A
Misto Mame	1,000	209.9
Pishinat	400	93.1
Gurore Dajt	1,000	446.76
Shkoze	100	226.12
Ligeni i Thatë	1,000	N/A
Kopshiti Botanik	400	136



koniderueshëm kolektorësh të kanalizimeve në Tiranë, të cilët janë ende të bllokuar për shkak të ndërtimeve të reja të ndërtuara mbi to pa respektuar rregullat standarde teknike të ndërtimit.

Aktualisht, të gjitha kanalizimet shkakohen të patrajtuar në pikat e shkakimit të përmendura më sipër. Në vitin 1997, Banka Japoneze për Bashkëpunimin Ndërkombëtar financiar i studiimit për të trajtuar shërbimin e kanalizimeve në Tiranë dhe në 2014 nisi projektimi, i pasuar nga ndërtimi i një impianti për trajtimin e ujërave të ndotur që i shërben Bashkisë së Tiranës. Ky implant ndodhet në ish Komunën Kashar dhe pritet të vihet në punë në fillim të vitit 2019.

#### 4.3.1 Implanti i Trajtit të Ujërave të Ndotur Tiranë

Ndërtimi i Implantit të Trajtit të Ujërave të Ndotur Tiranë, që po zbatohet nga JICA, përbëhet nga dy faza, si më poshtë:

- **Faza e parë:** kjo fazë fokusohet në përmirësimin e shërbimit të kanalizimeve në pjesët urbane të Bashkisë Tiranë dhe ish komunën Kashar që do të shërbejë një sipërfaqe prej 2,343 ha dhe përfshin ndërtimin e implantit të trajtimit të ujërave të ndotura, tubacioneve të shkakimit, kanalizimeve kryesore dhe degëve të tyre. Këto objekte pritet të plotësojnë nevojat e 335,880 njerëzve dhe do të vihen në punë në fund të vitit 2018. Rrjedhja mesatare në kohë të thatë e këtij impianti do të jetë 75,843 m<sup>3</sup>/ditë dhe projektimi për rrjedhën maksimale është 94,046 m<sup>3</sup>/ditë.
- **Faza e dytë:** Në këtë fazë, studimi i fizibilitetit sugjeron investime në objekte të tjera kanalizimesh në të gjithë bashkinë me qëllim përmirësimin e shërbimit dhe përmirësimit të nevojave të 830,320 banorë deri në vitin 2022.

#### 4.4 Metodologjia për përcaktimin e kërkesës për ujë

Si pjesë e këtij Plani Biznesi është ndërtuar një Fletë Logaritme për të mbështetur llogaritjet që duhen për të përcaktuar kërkesën për ujë. Kjo Fletë Logaritmeje i bashkëngjitet Planit të Biznesit si Shtojca B.

Metodologjia e përdorur në këtë Plan Biznesi për përcaktimin e kërkesës për ujë mbështetet në përcaktimin e një kërkesë për frymë për popullsinë e shërbyer që lidhet me të dhënat në dispozicion për popullatën e shërbyer. Kërkesa e llogaritur dhe e parashikuar vëllimore për frymë, sig zbatohet në këtë metodologji, nuk është nevoja aktuale për konsum e një individ, por vlera që reflekton nevojën totale të konsumit të ujit në zonën e shërbimit, pjesëtuar me numrin e personave të furnizuar faktikisht.

#### 4.4.1 Popullsia në zonën e shërbimit dhe popullsia e shërbyer

Hapi i parë në parashikimin e kërkesës për ujë është të përcaktohet popullsia "totale" dhe ajo e "shërbyer" brenda zonës së shërbimit të UK Tiranë, si dhe "kërkesa për ujë për frymë në ditë", duke qenë se këto janë dy variabël e vetëm që do të përdoren për zbatimin e kësaj metodologjie.

Drejtuesit e UK Tiranës kanë marrë parasysh dy burime kryesore për të dhënat e popullsisë në zonën e shërbimit, që janë: regjistri civil në ish NJQV-të përkatëse në zonën e shërbimit dhe të dhënat nga INSTAT. Përfaqësja e marrë për të synuar vlerësimin e saktë të "popullsisë së shërbyer" lidhet me marrjen parasysh të të dhënave të konsumatorëve aktualë të Shqipërisë.

Popullsia në zonën e shërbimit të Shqipërisë ekzistuese UK Tiranë që u vendos për t'u përdorur nga drejtuesit e Shqipërisë është 697,300 banorë, ndërsa për ish komunat është

**Tabela 4-8**  
**Kategoria e Lidhjeve të Ujit**

Kategoria	Përqindja
% nga lidhjet e peregjistruara	93%
% lidhje në rrjetet e reja	7%

Drejtuesit e Shoqërisë janë treguar qëllimisht të rezervuar në parashikimet e popullsisë, duke qenë se kjo vlerë, së bashku me vlerat e shifëve të supozuara të ujit për frymë, përcaktojnë edhe shifët e parashikuara të ujit, gjë që ndikon drejtpërdrejtë në llogaritjen e të ardhurave të Shoqërisë në parashikimin e buxhetit.

Një tjetër analizë e rëndësishme që do të ndikojë në vendimet për investimet është numri i lidhjeve me ujëmatës. Fija e këtyre të dhënave në modelin e rietës së llogaritjes mundëson një llogaritje të përqindjes së lidhjeve me ujëmatës, siç tregohet në Tabelën 4-9.

**Tabela 4-9**  
**Lidhjet me Ujëmatës sipas Kategorisë së Konsumatorëve**  
**Viti Bazë 2016**

Kategoria e klientit	Totali i lidhjeve	Lidhjet me ujëmatës	% e lidhjeve me ujëmatës
Familjare	196,611	147,626	75%
Ente private	30,614	29,336	96%
Institucione buxhetore	634	577	91%
Klientë të vegantë	27	27	100%
Furrat e bukës	204	204	100%

Shoqëria është e angazhuar për të bërë investimet e nevojshme për rritjen e përqindjes së lidhjeve me ujëmatës në pesë vitet e Planit të Biznesit, në mënyrë që të rrisë lidhjet me ujëmatës në zonën e re të shërbimit të UK Tiranës nga 75% në 2016 në 97% për konsumatorët familjare në fund të vitit 2021 dhe në 100% lidhje me ujëmatës për entet private dhe institucionet buxhetore deri në fund të vitit 2018.

Zbatimi i një sistemi efektiv dhe gjithëpërfshirës për matjen e konsumit në të gjithë zonën e re të shërbimit të UK Tiranës, që përfshin instalimin e ujëmatësve për të gjithë konsumatorët në zonën e shërbimit, do të përmirësojë besueshmërinë si dhe bazën e të dhënave ekzistuese të konsumatorëve në drejtim të eliminimit të lidhjeve paligjshme dhe të peregjistruara. Përveç kësaj, instalimi i ujëmatësve të mëdhenj të ujit në pikat kryesore të "daljes" në puse, stacionet e pompimit të ujit dhe në rezervuarë dhe vënien në funksion të sistemit SCADA do të krijojë mundësi për të bërë një bilanc të saktë të ujit në këto sisteme dhe për të menaxhuar më mirë kërkesën për ujë në zonën e re të shërbimit të UK Tiranës.

Me këto objektiva të përcaktuara, Modeli i Planit të Biznesit në Shtojcën B llogarit numrin e ujëmatësve që duhet të instaloohen gdo vit sipas kategorisë së konsumatorit. Kjo llogaritje aktualisht krijon një nevojë për një total prej 77,401 ujëmatës familjare për të bërë dhe instaluar, plus 2,289 matës për ente private, dhe 105 matës për institucionet buxhetore, brenda periudhës pesë-vjeçare të Planit të Biznesit, duke filluar me tremujorin e tretë të vitit 2017. Instalimi i ujëmatësve për entet private dhe institucionet buxhetore, sig e kërkon ligji, duhet të paguhet nga konsumatorët përkatës në këto kategori, gjatë kohës së instalimit.

Tabela 4-10 parashikon në total 77,401 ujëmatës familjare për të instaluar me qëllim

Furrat e bukës	0.16	0.0	124.2
Kërkesa mesatare	129.8	107.5	124.2

Në trajtimin e gështjes së kërkesës për ujë, ku kryesisht sistemit i mungojnë ujëmatësit, është po aq e saktë të merrën parasysh normat e kërkesës për frymë të cilat pasqyrojnë përdorimin e ujit në vende të ngjashme me Shqipërinë. Tabela 4-12 jep normat e kërkesës për frymë, sipas llojit të konsumatorit, që mund të gjenden në vende të ngjashme me Shqipërinë.

Tabela 4-12

## Normat e Aplikueshme në Shqipëri

Mesaret sipas kategorisë së konsumatorit	Normat e aplikueshme në Shqipëri (l/ftd)
Familjarë	80-110
Ente Private / Industri	15-25
Institucion buxhetore	5-10
Totali	100-145

Duke trajtuar parashikimet e shijës së ujit, drejtuesit e Shqipërisë vendosën për normat e shijës për frymë (litra për frymë në ditë) për çdo kategori konsumatori (familjarë, ente private, institucione buxhetore, klientë të vegantë dhe furrat e bukës) për secilin nga pesë vitet e Planit të Biznesit, për të reflektuar një vlerë të shijëve për frymë në ditë sipas kategorisë së konsumatorit siç tregohet në Tabelën 4-13, që bazohet në normat që janë të aplikueshme në Shqipëri, të evidentuara në Tabelën 4-12.

Gjatë përcaktimit të normave të parashikuara të kërkesës për ujë për periudhën 2017-2021, drejtuesit e Shqipërisë morën parasysh rritjen e parashikuar në mbullimin me shërbim të 95.3% të popullsisë në zonën e shërbimit dhe që lidhjet familjare me ujëmatës do të rriten në 97% deri në fund të vitit 2021.

Shifjet ekzistuese të ujit për kategori të tjera të konsumatorëve për Shqipërinë ekzistuese UK Tiranë dhe ish komunat, e shprehur në litra për frymë në ditë janë: Entet private 13.2 litra/frymë/ditë, Institucionet Buxhetore 7.6 litra/frymë/ditë, Klientët e Vegantë 1 litra/frymë/ditë dhe Furrat e Bukës 0.1 litra/frymë/ditë. Mendohet se këto kategori do të nisin të afrohen normave të kërkesës për ujë sic tregohet në Tabelën 4-13.

Tabela 4-13

## Shifjet e Parashikuara të Ujit (litra/frymë/ditë)

Mesaret sipas kategorisë së konsumatorit	2017	2018	2019	2020	2021
Mes. familjare me dhe pa ujëmatës	103.1	102.8	99.1	95.3	92.6
Familjarë me ujëmatës	89.1	89.2	89.5	90.0	90.5
Familjarë pa ujëmatës	148.8	150.0	150.0	150.0	150.0
Ente Private	13.3	13.2	13.2	13.2	13.2
Institucione buxhetore	7.6	7.6	7.6	7.6	7.6
Klientët e vegantë	1.0	1.1	1.1	1.1	1.1
Furrat e bukës	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1
Kërkesa mesatare	125.2	124.8	121.1	117.2	114.5

**Tabela 4-15**  
Ujja e Parashikuar në Ujin e Prodhuar dhe Ujin Pa të Ardhura (në m3/d)

Përshkrimi	2016	2017	2018	2019	2020	2021
Shifje me pakicë	86,082	88,753	90,661	89,952	88,774	88,515
Shifje me shumicë	8,765	10,244	13,584	13,584	13,584	13,584
<b>Totali i shifjes së ujit</b>	<b>94,847</b>	<b>98,997</b>	<b>104,245</b>	<b>103,536</b>	<b>102,358</b>	<b>102,099</b>
Prodhimi i ujit	292,739	265,348	243,112	212,581	187,216	153,632
Uji i biere	0	17,500	17,500	17,500	17,500	16,533
<b>Totali i ujit që në sistem</b>	<b>292,739</b>	<b>282,848</b>	<b>260,612</b>	<b>230,081</b>	<b>204,716</b>	<b>170,165</b>
Uji pa të ardhura	197,892	183,851	156,367	126,544	102,358	68,066
<b>% e ujit pa të ardhura</b>	<b>67.6%</b>	<b>65.0%</b>	<b>60.0%</b>	<b>55.0%</b>	<b>50.0%</b>	<b>40.0%</b>

**4.5 Lidhjet e regjistruara të kanalizimeve**

Aktualisht UK Tirane ekzistues i shërben 85.9% të popullsisë me shërbime kanalizimi, që përfqeson 166,324 lidhje familjare të kanalizimeve. Ish komunat i shërbëjnë 37.6% të popullsisë me shërbime kanalizimesh, që përfqeson 14,105 lidhje familjare me kanalizime. Mbulimi agregat me shërbimin me kanalizime për UK Tiranën e re është 78.1%.

Një objektiv strategjik i UK Tiranës është rritja e mbulimit me shërbim kanalizimesh nga 78.1% në vitin bazë në 83.5% në fund të vitit 2021. Drejtuesit e UK Tiranës kanë parashikuar lidhjet e reja të kanalizimeve të nevojshme për secilin kategori konsumatorësh sig tregohet më poshtë në Tabelën 4-16.

**Tabela 4-16**  
Kategoria e Lidhjeve të Kanalizimeve

Kategoria e konsumatorëve	2017	2018	2019	2020	2021
Totali i lidhjeve të regjistruara të kanalizimeve	212,321	215,494	222,143	229,032	237,126
Lidhje familjare të kanalizimeve	180,618	182,495	187,528	192,721	199,034
% e mbulimit me kanalizime të familjarëve	78.7%	80.1%	81.1%	82.1%	83.5%
Nr. i lidhjeve të reja familjare të kanalizimeve	1,757	3,465	5,033	5,193	6,313
Lidhjet e enteve private	30,834	32,126	33,732	35,419	37,190
Lidhjet e institucioneve buxhetore	638	642	652	661	671
Klientët e vegantë	27	27	27	27	27
Furrat e bukës	204	204	204	204	204

100% të detyrimeve të saj të mëparshme deri në 2019 dhe të nisë të kontribuojë në fondet rezervë të kapitalit nga rezultatit financiar vjetor pozitiv, duke synuar të grumbullojë rezervave kapitale gjatë viteve 2017-2021 në shumën 7.3 miliardë lekë.

- Arrija e shërbimit pa ndërprerje me presion të vazhdueshëm të furnizimit me ujë (24/7) në ish zonën e shërbimit të UK Tiranë deri në 2021, kështu që nuk do të ketë nevojë për depozitat në familjet dhe në ndërtesat e banimit për të siguruar furnizim të mjaftueshëm me ujë gjatë ditës dhe natës.

<p>Arritja e qëndrueshmërisë financiare duke mundësuar mbullimin e kostove totale (kostot vjetore) deri në fund të 2017 dhe vazhdimi i përmirësimit të performancës financiare të Shogërisë në mënyrë të atillë që Shogëria të mbulojë 100% të detyrimeve të saj të mëparshme deri në 2019 dhe të nisë të kontribuojë në fondet rezervë të kapitalit nga rezultati financiar vjetor pozitiv.</p>	<p>Arritja e shërbimit pa ndërprerje me presion të vazhdueshëm të furnizimit me ujë (24/7) në ish zonën e shërbimit të UK Tiranë deri në 2021.</p>
<p>Arritja e qëndrueshmërisë financiare do të zbatohen veprimet e kombinuara të cilat konsistojnë në rritjen e shifëve të ujit, reduktim i kostove të operimit dhe mirëmbajtjes, dhe rritje të normës së arkëtimit mbi faturimet. Njëkohësisht me këto përmirësime, UK Tiranë do të propozojë një rritje të vazhdueshme si për tarifën fikse, tarifën variabël të shërbimit të furnizimit me ujë dhe për tarifën e kanalizimeve, të cilat do të ndihmojnë për të llogaritur kontributin në fondet rezervë të kapitalit.</p>	<p>Arritja e furnizimit me ujë të pandërprerë do të jetë një funksion i faktorëve të ndryshëm ku përfshihen matja e të gjithë sistemit, instalimi, zbatimi dhe monitorimi i sistemit SCADA, rritja e sasisë së ujit të furnizuar në sistem dhe rinovimi i vazhdueshëm i rjetit të furnizimit me ujë.</p>

Gjatë periudhës së këtij plani biznesi, Shqipëria ka planifikuar të zëvendësojë një pjesë të matësve ekzistues familjare, të cilat mund të mos funksionojnë ose nuk mund të kallibrohen. Numri i jetor i matësve, që do të duhet të zëvendësohet, parashikohet të jetë në nivelin e 3% të totalit të lidhjeve me matës të familjeve në vitin përkatës. Ky veprim do të kërkojë një investim prej afro 69.9 milionë lekë dhe do të financohet nga fondet e veta të Shqipërisë.

#### b. Investime të reja kapitale

Me qëllim që konsumatorëve t'u jepet një mjet për të kontrolluar konsumimin e tyre, UK Tiranë planifikon të vazhdojë zbatimin e programit të instalimit të ujëmatësve të konsumatorëve (për të gjitha kategoritë e konsumatorëve) në zonat urbane dhe rurale. Ky investim llogaritet të kushtojë rreth 332 milionë lekë dhe do të financohet nga fondet e veta të Shqipërisë.

Për të përmirësuar saktësinë e matës për kategorinë e konsumatorëve 'ente private', drejtuesit e Shqipërisë kanë vendosur të instalojë tek të gjithë klientët e kësaj kategorie matës SMART. Ky investim do të zbatohet gjatë periudhës pesëvjeçare të planit të biznesit duke synuar që 100% e enteve private të jenë të pajisura me matës SMART deri në fund të vitit 2021. Kostoja totale e këtij investimi parashikohet të jetë në nivelin e 572.3 milionë lekëve dhe do të financohet nga të ardhurat e veta të Shqipërisë. Duke marrë parasysh se kostoja e instalimit për këta matës është rreth 120 euro/lidhje, drejtuesit kanë vendosur të mos e faturojnë direkt koston e matësit, por ta përfshijnë atë si një pagesë shtesë për shlyerjen e ketyre matësve SMART në faturën mujore të klientëve përkatës.

Për të siguruar zbatimin e saktë të investimeve të mësipërme, Shqipëria ka në plan të blejë makinë dhe pajisje të reja që në total kushtojnë 137.8 milionë lekë.

Për t'u përqendruar në menaxhimin e kërkesës për ujë dhe për të projektuar dhe zbatuar një procedurë rutine për bilancin e ujit, Shqipëria planifikon të investojë në matjen e të gjithë sistemit në zonat urbane dhe rurale, përfshirë prodhimin, depot, matës zonal dhe instalimin e programit SCADA. Ky investim llogaritet të kërkojë rreth 952 milionë lekë dhe do të financohet nga hua tregtare që Shqipëria ka në plan të marrë në të ardhmen.

Hartimi i një Master Plani për UK Tiranë dhe zbatimin e programit GIS do të ndihmojë Shqipërinë në planifikimin dhe zbatimin e investimeve të saj të ardhshme. Ky investim llogaritet të shkojë në 70 milionë lekë dhe do të financohet nga hua tregtare që do të merren në të ardhmen. Hartimi i Master Planit dhe instalimi i sistemit GIS parashikohet të përfundojë në fund të vitit 2018.

Duke pasur parasysh se një sasi e madhe e ujit pa të ardhura është rezultat i numrit të madh të lidhjeve të paligjshme në linjat e transmetimit të Bovillës, Shën Mërisë dhe Selitës, drejtuesit e Shqipërisë kanë deklaruar se zhvendosja e ketyre linjave të transmetimit është më se e nevojshme në zonën e populluar (informale) ku kalojnë këto linja. Vlerësohet se në total fondet e nevojshme për të përfunduar këtë investim janë rreth 2.7 miliardë lekë dhe do të financohen nga hua tregtare që do të marrë në të ardhmen Shqipëria.

#### 7.1.2 Investime kapitale për rritjen e mbullimit dhe përmirësimin e shërbimit të furnizimit me ujë

Për të punuar në drejtim të rritjes së mbullimit me shërbim ujësjellësi në të gjithë zonën e saj të shërbimit, UK Tiranë do të kryejë studime dhe projekte dhe do të lidhë kontrata për të rritur mbullimin e shërbimit nga 85.0% në 2016 në 95.3% të popullsisë në zonën e shërbimit deri në fund të vitit 2021. Pjesa kryesore e këtij përmirësimi në mbullimin me shërbim parashikohet të vijë si rezultat i identifikimit dhe legalizimit të lidhjeve të paligjshme si dhe i

Pershkrim	Kosto Totale					Kosto Vjetore '000 Lekë
	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021	
Shpenzime Kapitale me Fondet e Kompanise	2,552,597	100,000	100,000	1,000,000	1,100,000	
Shpenzime Kapitale me Grantet e Kredite	1,000,000	1,000,000	1,000,000	1,000,000	1,100,000	
Shpenzime per Riparime dhe Zevendesime Kapitale	901,277	93,216	212,624	257,298	326,797	
Riparime & Zevendesime Kapitale (Makina, Pajise, Nderresa e tj.)	831,937	80,769	198,813	242,043	310,313	
Zevendesim i Ufemesave Jo-funksionale	69,890	12,447	13,812	15,255	16,483	
Investime te Reja Kapitale	3,870,850	699,865	688,955	1,077,833	874,680	
Makinat dhe Pajise	137,850	137,850				
Instalim Ufemes Mekanik te nji Familjare	315,798	55,360	40,860	74,225	78,516	
Instalim Ufemes Mekanik te nji Privat-Buxhlore	16,279	14,808				
Instalim Ufemes SMART Eme Private	572,332	33,633	83,123	146,559	140,910	
Lidhje te reja ur ne sistemin shpendarës ekszistues	351,316	126,716	94,650	46,265	39,635	
Mderrimi i Sistemeve te reja ur nga nderrimi i sistemeve te reja	104,025	36,403	28,497	13,929	11,933	
Mderrimi i Sistemeve te reja/Lidhje te reja KUZ	1,196,775	96,619	190,551	276,790	285,619	
Limja e re e Transistorit nga ITU Borelle deri ne Ydersthi - KMY	1,088,000	88,475	250,000	520,000	318,000	
Konsulence per Zbatim e Programit te Investimeve Kapitale (Projektim, Tenderim)	88,475					
Shpenzime Kapitale me Grantet e Kredite	7,325,273	854,354	882,170	1,390,457	2,131,977	
Shpenzimet per Rinovime Kapitale	10,339,000	589,000	2,437,500	2,437,500	2,437,500	
Rinovim i Fqjete te Ufemesesit / Ø 90	5,250,000		1,312,500	1,312,500	1,312,500	
Rinovim i Fqjete te Kanazime / Ø 500	4,500,000		1,125,000	1,125,000	1,125,000	
Rikonceptim i vend-burimit Shen Mena	589,000					
Investime te Reja Kapitale	5,918,000	30,000	2,118,000	2,330,000	930,000	
Sistem i Furnizimit me Uje Terezimit me Uje Terezimit per UKT & GIS	952,000	238,000	238,000	238,000	238,000	
Pergjithje e Masterplanit per UKT & GIS	70,000	30,000	40,000			
Mderrimi i By-Pass-eve ne Linjat Kryesore te Transmetimit Borelle, Shen Mena & Sella	2,720,000		1,000,000	1,300,000	420,000	
Shtrimi i Impjantit te Borelles	680,000		340,000			
Rikualifikim i Linjes se Transmetimit te Shen Menses	680,000		500,000			
Shifryzimi i Vendburimit te Gurit te Bardhe	816,000		180,000			
Non totali 2	16,257,000	619,000	4,655,500	4,767,500	272,000	
Totali	23,582,273	1,473,354	5,437,670	6,157,957	5,499,477	
Ekuivalenti ne Euro	173,399,070				5,013,816	

7.2 Fondet rezerve per investimet kapitale

UK Tirane synon te permiresoje performancen e saj financiare ne menyre qe te mund te nise rinovimin e kapitalit, riparimin dhe zevendesimin e kapitalit, dhe investime te reja kapitale. Ne baze te ketij Plani Biznesi, UK Tirane ka perqarkuar kontributet vjetore qe do te behen per fondin e ri rezervë kapital gjate periudhes se planifikuar, nga rezultati financiar pozitiv vjetor. Keto kontribute do te monitorohen dhe raportohen me miratimin e Keshillit Mbikqyres. Kontributet e planifikuara ne fondin e ri rezervë kapitale paraqiten ne Tabelen 7-2.

Tabela 7-2 Kontributet Vjetore te Fondeve Kapitale (ne '000 Leka)

Fonde Kapitale	2017	2018	2019	2020	2021	Total
Rinovim Kapitali	252,597	100,000	100,000	1,000,000	1,100,000	2,552,597
Riparime dhe Zevendesime Kapitale	11,893	93,216	212,624	257,298	326,797	901,827
Investime te Reja Kapitale	589,865	688,955	1,077,833	874,680	639,518	3,870,850
Totali	854,354	882,170	1,390,457	2,131,977	2,066,315	7,325,273



efiçencës së stafit të barabartë me 2.62 për 1000 lldhje (furnizimi me ujë dhe kanalizime), e cila konsiderohet si një raport i moderuar, kur krahasohet me Shqipëri të ngjashme ujësjellës-kanalizime që veprojnë në rajon.

Drejtuesit e Shogërisë UK Tiranë janë të angazhuar për të analizuar dhe ristrukturuar organizigramën aktuale të stafit me qëllim përmirësimitin e treguesit të efiçasitetit të stafit dhe po shqyrtojnë ndryshime të mëtejshme strukturore për të maksimizuar funksionalitetin e stafit mbështetës dhe stafit zbatues, si dhe për të përmirësuar direktivat e reja të vendosura në statutin e ri të kompanisë.

**Tabela 8-1**  
**Personeli sipas pozicionit (2016)**

Numri i personelit	Pozicioni
1	Drejtor i Përgjithshëm (Administrator)
2	Drejtor Teknik/Ekonomik
4	Kordinator/Asistente DP/Keshilltar
4	Drejtor Departamenti: Sherb. Mbeshit, Task Force, Menaxh të Shitjes, Ekonomik
3	Drejtor Departamenti: Prodhimi & Shperndarja, Inxhinierik, Drejtoria Rajonale
12	Drejtor: BNJ, Juridik, Audit, Task Force, Faturim-Arketim, Njesite 1-6
5	Drejtor: Teknik, Njye Boville, Operacionale, Prodhimi, Shperndarja
49	Pergjegjes: Prodhimi Inxhinierik, Monitorim/Ligjor dhe Prokurimi/BNJ/Faturimi dhe Arketimi
22	Pergjegjes: Prodhimi, Transmetimi dhe Depot, Shperndarja
8	Pergjegjes: Rrjeti i Kanalizimeve Urbane-Rurale
89	Specialist: GIS, Projektimi, Bilanci Uj/Kontabiliteti
149	Specialist: Laborant/Jurist/Prokurimi/BNJ/IT/MP/Magaznier
229	Punetor: Fatures/Arketar/Sanitare
527	Punetor: Prodhimi, Transmetimi dhe Depot, Shperndarja
46	Punetor: Rrjeti i Kanalizimeve Urbane-Rurale
1,150	Numri total i personelit
438,980	Numri total i lldhjeve ujësjellës-kanalizime
2.62	Staff/1000 lldhje

## 8.2 Struktura e propozuar organizative dhe personeli

Nga pikëpamja e menaxhimit të biznesit, drejtuesit e UK Tiranë kanë zgjedhur të ruajnë strukturën e saj të mëparshme organizative, bazuar në Statutin e Shoqërisë të miratuar së fundi. Nga pikëpamja e qeverisjes, UK Tiranë do të vazhdojë të funksionojë me një sistem me dy nivele, me një Këshill Mbikëqyrës që emëron dhe mbikëqyr Drejtorin e Përgjithshëm të Shoqërisë.

Në kohën e përgatitjes së këtij Plani të Biznesit, Drejtuesit e Lartë të Shoqërisë UK Tiranë kryen një vlerësim të ndryshimeve organizative dhe të personelit me të cilat shoqëria do të përballë gjatë pesë viteve të ardhshme.

Më poshtë jepet një përmbledhje e disa ndryshimeve të vogla në nivelin e stafit si rezultat i vendimeve që janë marrë gjatë kohës së përgatitjes së këtij plani biznesi:

- **Reduktimi i stafit bazuar në riorganizimin e zonës së shërbimit:** sig u shpjegua Tiranë duke qenë se në bazë të Reformës Administrative-Territoriale dhe Reformës së Sektorit të Ujit do të jetë nën përgjegjësinë e Bashkisë Vore. Prandaj, në fund të 2017, 43 punonjës të UK Tiranë do të transferohen tek Shoqëria U Vore
- **Implantet e trajtimit të ujërave të ndotura:** Impianti i i trajtimit të ujërave të përdorura pritet do të dorëzohet tek UK Tiranë në fillim të vitit 2019. Do të krijohet një Departament i ri për Kanalizimet dhe Ujërat e Përdorura për t'u marrë me shërbimin e mbledhjes dhe trajtimit të ujërave të përdorura. Stafit i ri që pritet të shtohet Shoqërisë për funksionimin e ITUP vlerësohet të jetë rreth 50 punonjës.

Drejtuesit e lartë UK Tiranë janë angazhuar të ndjekin objektivat e programit të certifikimit me testim, i rekomanduar nga qeveria gendrore, nën drejtimin e Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, me qëllim rritjen e aftësisë profesionale dhe performancës operationale të personelit që punojë në Shoqëri me anë të kërkesave dhe procedurave të certifikimit me testim.

Drejtuesit kanë evidentuar edhe disa fusha për përmirësime të mëtejshme organizative, të prezantuar si më poshtë, të cilat do të analizohen dhe shqyrtohen gjatë përditësimit tjetër të planit të biznesit.

- Drejtuesit e lartë do të vazhdojnë të shqyrtojnë dhe përmirësojnë funksionalitetin e Organizrarnes së Shoqërisë duke përshtatur më mirë stafin mbështetës dhe atë zbatues. Kjo do të ndikojë në disa njësi dhe seksione që mund të kenë nevojë për ristrukturim sig është Departamenti i Kujdesit për Klientin, si dhe Departamenti i Task Forës, që do të përfshihen nën Funksionin (Drejtorin) Tregtar.
- Shqyrtim i mëtejshëm i hierarkisë së kontrollit Raporti optimal i "raportimit të drejtëpërdrejtë tek përgjegjësi" ndryshon nga njëra industri në tjetër. Megjithatë, pranohet në përgjithësi se pozicione të tilla si zv. drejtori të kenë të pakten 2-3 raportime të drejtëpërdrejtë. Drejtuesit e lartë të UK Tiranë do të shqyrtojnë riklasifikimin e mundshëm të çdo pozicioni të stafit që kanë një numër raportimesh të drejtëpërdrejtë të lartë apo të ulët, për t'u siguruar që këto pozicione i shërbejnë më mirë strukturës organizative.

- Konsolidimi i burimeve mbështetëse (stafi): numri i stafit administrativ (sekretariatë dhe nëpunësit) në Shoqëri duhet të shqyrtohet edhe më tej. Drejtuesit e lartë duhet të shohin mundësinë e një grupi të centralizuar sekretarie/administrimi, i cili bazuar edhe në përmirësimet teknologjike do të ofrojë mbështetje për të gjitha njësitë e tjera. Në këtë mënyrë, do të shmanget mbivendosja e funksioneve (veçanërisht në Njësitë Zonale dhe Drejtorinë Rajonale).

Tabela 8-2  
Personeli sipas pozicionit (2021)

Numri i personelit	Pozicioni
1	Drejtor i Përgjithshëm (Administrator)
2	Drejtor Teknik/Ekonomik
5	Kordinator/Asistente DP/Keshilltar
4	Drejtor Departamenti: (Sherb. Mbeshk, Task Force, Menaxh te Shites, Ekonomik)
4	Drejtor Departamenti: (Prodhimi & Shperdarja, Inxhinierik, Drejtoria Rajonale, Sherbimi i Kanalizimeve dhe Ujërave të Përdorura)
4	Drejtor: (BNJ, Juridik, Audit, Task Force, Faturim-Arketim, Njësiti 1-6)
8	Drejtor: (Teknik, Njësje Boville, Operacionale, Prodhimi, Shperdarja, Kanalizime, Trajtimi i Ujërave të Përdorura)
58	Pergjegjes: Projektime Inxhinierik/ Monitorimi/Ligjor dhe Prokurimi/BNJ/Faturimi dhe Arketimi
21	Pergjegjes: Prodhimi/ Transmetimi dhe Depot/ Shperdarja
9	Pergjegjes: Rrjeti i Kanalizimeve Urbane-Rurale/Operimi i ITUP
28	Specialist: GIS, Projektime, Bilanci Uj/Kontabiliteti
223	Specialist: Laborant/Jurist/Prokurimi/BNJ/IT/MP/Magaziniert/ITUP
226	Punetor: Faturues/Arketar/Sanitare
515	Punetor: Prodhimi, Transmetimi dhe Depot, Shperdarja
42	Punetor: Rrjeti i Kanalizimeve Urbane-Rurale
1,227	Totali i stafit
499,884	Numri total i lidhjeve (ujësjellës + kanalizime)
2.45	Stafit/1000 lidhje

Në fund të Planit të Biznesit (Shtojca B) jepet një fletë pune e detjuar mbi analizën e stafit.

Gjatë vitit bazë, UK Tiranë ka pasur kosto për pagën e 1.3-të në nivelin e 4.1% të kostove mujore të pagës së personelit. Drejtuesit e Shoqërisë kanë planifikuar ta rrisin këtë nivel kostojë të pagës së 13-të deri në 8.4% të pagës mujore për periudhën e mbetur këtij plani biznesi dhe kjo pagë do t'u jepet punonjësve në fund të gdo vitit gjatë periudhës 2017-2021.

UK Tiranë ka bërë disa shpenzime për trajtimin e personelit në vitin bazë (kryesisht kosto që lidhen me ushqimin e punonjësve, për shkak të inspektimi brenda të gjithë zonës së shërbimit të Shoqërisë). Drejtuesit e Shoqërisë kanë planifikuar të bëjnë shpenzime të tilla edhe për periudhën e parashikuar në nivelin e 5,000 lekë/muaj/punonjës, që është e barabartë me 1.5% të pagës bazë vjetore për periudhën e mbetur të Planit të Biznesit.

Së fundi, në vitin bazë, UK Tiranë ka kryer shërbimin e Këshillit Mbikëqyrës në nivelin e 0.4% të pagës bazë vjetore. Duke qenë UK Tiranë ka vendosur të mbajë dy nivele administrimi (Këshilli Mbikëqyrës – Drejtor i Përgjithshëm), kjo kosto shërbimi do të jetë në të njëjtin nivel për periudhën e mbetur të planit të biznesit.

## 9.2 Kosto të tjera të personelit

Kategoria "Kosto të tjera të personelit" përfshin koston e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, si dhe koston e trajnimit. Pagesat për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore që përbejnë koston për Shoqërinë sipas ligjit, janë 16.7% (1.5% për sigurime shoqërore e 1.7 për ato shëndetësore) të Pagesë Bazë. Edhe pse pritet që kjo kosto të jetë e pandryshueshme për gjithë periudhën e Planit të Biznesit 2017-2021, zëri i koston për sigurime shoqërore e shëndetësore do të rritet për shkak të rritjes së numrit të stafit në 2017.

Shoqëria ka pasur kosto trajnimi në nivelin e 13.5% të pagës bazë vjetore në vitin bazë dhe drejtuesit kanë planifikuar t'i ulin këto kosto në nivelin 11.5% në vitet e ardhshme.

## 9.3 Shërbime të kontraktuara

Kategoria "Shërbime të kontraktuara" konsiston kryesisht në kontratat që Shoqëria ka me firma private apo individë, si për shërbimin e rojeve dhe shërbime të tjera të kontraktuara, siç është mirëmbajtja e sistemit të faturimit arkëtim, ekspertit kontabël që kryen kontrollin financiar vjetor të fundvitit dhe shërbime të tjera profesionale.

UK Tiranë parashikon të ketë një rritje të konsiderueshme në vitin 2017 të kostove për shërbimin sigurisë, duke qenë se Shoqëria ka nën administrimin e saj depot e ujit nga ish-komunat, të cilat gjithashtu kanë nevojë për ruajtje. Ky zë i koston është buxhetuar të jetë në të njëjtin nivel për pjesën tjetër të periudhës së Planit të Biznesit 2018-2021.

Në vitin bazë, UK Tiranë ka pasur kosto në lidhje me shërbimet e tjera të kontraktuara, kryesisht nga shërbimet e ekspertizës financiare. Drejtuesit e Shoqërisë kanë planifikuar vazhdojnë të kenë këto kosto me një rritje të parashikuar vjetore prej 2% për vitet 2017-2021, e cila përfaqëson negociimin e parashikuar të çmimit dhe kontratës për këto shërbime.

9.4 Shpenzime të konsumeshme

Zëri "Shpenzime të konsumeshme" përfshin shpenzimet rutinë të konsumit të përgjithshëm dhe pasqyron kosto për mirëmbajtjen dhe bazën materiale, kimikate, energji elektrike për pompat (ujësjellës dhe kanalizime), transportin, shpenzimet administrative, taksat, fushatat për marrëdhëniet me publikun dhe zëra të tjere të lidhur me to.

Një zë shumë i rëndësishëm që futet në këtë kategori është shpenzimi për Mirëmbajtjen dhe Materialët (pjesë rezervë për zëvendësim, vegla punë, materiale të tjera të konsumeshme që lidhen me operimin dhe mirëmbajtjen). Kjo kategori kostosh përfaqëson 7% të kostove operative në 2016, ndërsa për 2017-2021 do të zbatohet një normë rritjeje vjetore prej 2%.

ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare që lidhen me sektorin e ujit, ky zë i kostos do të jetë në të njëjtin nivel gjatë periudhës së planit të biznesit.

Në parashikimin e buxhetit për kostot e zyrave dhe administratës (pajisje kompjuterike, letër, boje printeri, shpenzime zyre, telefon, etj.), drejtuesit e Shoqërisë kanë parashikuar një rritje vjetore prej 2% për vitet 2017-2021, duke reflektuar ndryshimet e pritshme të gëmit për pesë vitet e ardhshme.

UK Tiranë ka pasur kosto për qiratë të cilat lidhen me marrjen me qira të zyrave të shërbimit për zonën urbane. Drejtuesit kanë parashikuar që këto kosto të jenë të njëjta për periudhën e planit të biznesit 2017-2021.

Zëri i kostos së shpenzimeve të postës dhe komunikacionit përfshin tarifat e korrierit për dërgimin e faturave të konsumatorëve si dhe faturat e telefonit të zyrave. Duke filluar nga viti 2017, do të ngrihet një qendër telefonie (call center) në drejtorinë e Kujdesit të Klientit për të mbledhur ankesat e konsumatorëve nëpërmjet një numri "falas" për qytetarët. Kjo është arsyeja që në këtë zë të kostos do të ketë një rritje të konsiderueshme në vitin 2017 dhe më pas një rritje vjetore prej 2% për vitet 2018-2021, duke reflektuar ndryshimet e pritshme të gëmimeve gjatë viteve të ardhshme.

Zëri i shpenzimeve për Marrëdhëniet me Publikun është llogaritur në bazë të një strategjie që synon të mbështesë dhe promovojë shërbimet e UK Tiranë tek publiku dhe të prezantojë objektivat dhe synimet kryesore të Shoqërisë. Duke pasur parasysh faktin se në Vitin Bazë kostot për Fushatë e Marrëdhënive me Publikun ishin afërsisht 25 lekë/lidhje/vit dhe duke marrë në konsideratë edhe rëndësinë që ka ky zë për një Shoqëri ujësjellës-kanalizime në madhësinë e UK Tiranë (më e madhja në Shqipëri), drejtuesit e Shoqërisë kanë parashikuar një rritje të kostove të Marrëdhënive me Publikun duke buxhetuar një shpenzim prej 167 lekë/lidhje/vit për periudhën 2017-2021.

Kostot për taksat kanë të bëjnë me tarifat rregullatore për ndryshimin e tarifave dhe licencimin që i paguhet ERRU-së si dhe taksat vendore. Duke qenë se Shoqëria parashikon dy ndryshime tariffash në vitet 2018 dhe 2020, tarifa rregullatore do të rritet gjatë këtyre dy viteve të periudhës së planit të biznesit. Ky zë kostojë pritet të ketë një rritje vjetore prej 4% gjatë viteve 2019 dhe 2020.

Në koston për Komisionet Bankare përfshihen shumat e paguara për transferat bankare të urdhërara nga UK Tiranë dhe tarifat e disbursimit të kredisë. Duke filluar nga viti 2017, drejtuesit kanë parashikuar ta rrisin këtë zë me 25% për shkak të rritjes së pritshme të komisioneve të transferave bankare dhe do të vazhdojnë në të njëjtin nivel për periudhën e këtij Plani të Biznesit.

Gjobat dhe penalitetet përfshijnë një detyrim kontraktual të papaguar nga Shoqëria. Gjatë vitit bazë, UK Tiranë ka pasur një padë gjyqësore ku paditësi kërkon shumën e papaguar përfshirë këtë edhe interesin mbi këtë shumë. Kjo është arsyeja pse drejtuesit kanë parashikuar që zëri i gjobave të jetë 1% e kostove operative për vitin 2017.

Kategoria e fundit nën kategorinë Shpenzime është zëri "Shpenzime të Tjera", që përfshin shumat të vogla që paguhen për shpenzime të ndryshme, të cilat nuk janë të kategorizuara më sipër. Drejtuesit e Shoqërisë UK Tiranë kanë vendosur që kjo kategori të ketë një rritje të konsiderueshme për vitin 2017 dhe pritet të ketë një rritje vjetore prej 2% për periudhën 2018-2021.

Për sa i përket huave italiane, gjatë viteve të kaluara Shogëria ka paguar vetëm interesin e huave por jo principlin. Për shkak të kësaj situatë, Shogëria ka akumuluar një "shumë të papaguar" të huave në vlerën 1 miliardë lekë gjatë periudhës 2005-2016. Sig u përmend edhe më sipër, kjo shumë e papaguar huash është kryesisht shuma e principlit.

Drejtuësit kanë parashikuar të hyjnë në një proces negociatash me Qeverinë Qendrore për një mundësi për shuarjen (fshirjen) e pagesave të prapambetura të huave si dhe shlyerjen e huase në të ardhmen (principlin) që lidhet me këtë marrëveshje huaje.

Kompania ka parashikuar financimin e shpenzimeve kapitale ku përfshihen Rinovimi i Kapitalit për asetet nëntokësore; Riparimi dhe Zëvendësimi i kapitalit për asetet e paluajtshme dhe të luajtshme mbitorësore; dhe Investimet e Reja kapitale. Kuptohet që fondet për Rinovimin e Kapitalit dhe Riparimin e Zëvendësimin e Kapitalit nuk bazohen në ndonjë llogari të arsyeshme të amortizimit ose programi të përcaktuar për menaxhimin e asetëve, por thjesht pasqyrojnë një qëndrim të drejtuesve të Shogërisë se është e rëndësishme të fillohet të merren në shqyrtim shpenzime të tilla si pjesë e strukturës për mbullimin e përgjithshëm të kostove.

Për sa i përket shpenzimeve për Rinovim Kapitali, të cilat kanë të bëjnë me zëvendësimin e asetëve nëntokësore (kryesisht tubacionet për ujësjellësin dhe kanalizimet), janë parashikuar nga drejtuësit e UK Tiranë shumat që jepen në Tabelën 10-2 për secilin nga vitet e Planit të Biznesit.

Tabela 10-2

Shpenzimet për Rinovim Kapitali (Lekë)

Viti	Shuma (lekë)
2017	252,596,630
2018	100,000,000
2019	100,000,000
2020	1,000,000,000
2021	1,100,000,000

Shpenzimet për Riparime dhe Zëvendësimë kapitali, që lidhen me riparime apo zëvendësimë të mëdha të pajisjeve, makinerive dhe programeve, janë buxhetuar nga drejtuësit e Shogërisë dhe jepen në tabelën 10-3 për secilin vit të këtij Planit Biznesi.

Tabela 10-3

Fondi rezervë për Riparime e Zëvendësimë të Kapitalit (Lek)

Viti	Shuma (lekë)
2017	11,892,793
2018	93,215,787
2019	212,624,115
2020	257,297,561
2021	326,796,905

Shpenzimet për Investime të Reja Kapitale, që lidhen kryesisht me rritjen e nivelit të matësve për konsumatorët dhe shtrirjen e rrjetëve për të rritur mbullimin me shërbim ujësjellës-kanalizime, janë buxhetuar nga drejtuësit e Shogërisë dhe jepen në tabelën 10-4 për secilin vit të këtij Planit Biznesi.

Volumetrike, e cila paraqitet në Tabelën 10-6. Eshë e rëndësishme të theksohet se nivelet dhe struktura e tarifave të llogaritura në këtë Plan Biznesi kanë për qëllim që të ofrojnë një përmbledhje, tarifë nominale për çdo kategori konsumatorësh që do të përmbushë nevojat për të ardhura bazuar në shifrat e parashikuar dhe normën e arkëtimit. Shogëria do të kryejë një studim të plotë mbi tarifat dhe do të marrë në konsideratë politikat dhe strategjitë e tarifave. Këto tarifa do të duhet të derghohen pranë Entit Regullator të Ujit për miratim, përpara se të zbatohen nga UK Tiranë.

Në lidhje me zonat e reja (ish komunitat Zall Bastar, Ndroq dhe Pezë), të cilat i janë shtuar zonës së re të shërbimit të UK Tiranë pas reformës territoriale, Shogëria do të vazhdojë të faturojë konsumatorët duke përdorur të njëjtin nivel tarifash të cilat aplikoheshin nga Shogëria ekzistuese UK Tiranë. Zbatimi i tarifave aktuale është bazuar në vendimin e Këshillit Mbikëqyrës dhe mbetet në fuqi derisa të paraqitet një kërkesë formale për ndryshimin e tarifave pranë Entit Regullator të Ujit për miratim përfundimtar. Në disa prej faturohen vetëm për shërbimin e furnizimit me ujë. Deri në fillim të vitit 2018, drejtuesit e Shogërisë kanë parashikuar të aplikojnë një strukturë të miratuar të unifikuar tarifash për të gjithë klientët e saj në zonën e re të shërbimit.

Në bazë të kësaj strukture tarifash, për të gjithë klientët e regjistruar me konsum me apo pa matës do të aplikohet një tarifë fikse mujore. Aplikimi i kësaj tarifë, që shpesh referohet si "tarifa e gatishmërisë për të shërbyer" po bëhet gjithnjë e më e zakonshme në sektorin e ujit në Shqipëri. Kjo tarifë propozohet të ketë një rritje për të gjitha kategoritë e konsumatorëve duke filluar nga viti 2018.


Tarifat volumetrike për shërbimet ujësjellës-kanalizime të parashikuara në Planin e Biznesit Jepen në Tabelën 10-6 dhe përfaqësojnë "tarifën e konsumit" sipas kategorive të konsumatorëve.

Drejtuesit e Shogërisë UK Tiranë kanë planifikuar një rritje vjetore të tarifës volumetrike të shërbimit të furnizimit me ujë për të gjitha kategoritë e konsumatorëve për vitet 2018 dhe 2020. Kjo tarifë parashtohet të jetë në të njëjtin nivel për të gjithë periudhën e mbetur të planit të biznesit.

Duke filluar që nga viti 2017, drejtuesit e UK Tiranë kanë planifikuar të vendosin një tarifë fikse mujore për të gjitha entet private, klientët e vegantë dhe furrat e bukës ku do të instalohehen matës SMART. E njëjta tarifë mujore do të aplikohet për të gjitha këto lloje ku do të instalohehen matës i ri gjatë periudhës së Planit të Biznesit (2018-2021). Kjo tarifë fikse për çdo lloje do të jetë në nivelin e 450 lekë/lidhje/muaj dhe do të përdoren për të shlyer kostot totale të instalimit të ujëmatësve.

Në Tabelën 10-6 jepen tarifat e propozuara për shërbimet ujësjellës-kanalizime për periudhën e planifikimit 2017-2021.

**Grafiku 10-1**  
 Norma aktuale e Arkëtimit, Të Ardhurat Totale aktuale dhe Arkëtimit Totale aktuale sipas parashikimit në Planin e Biznesit



Gjatë periudhës së Planit të Biznesit, UK Tirane ka parashikuar të përdorë të ardhurat e saj nga qarkullimi i vlerave monetare, në sajë të performancës së mirë financiare, për të paguar të gjitha detyrimet e prapambetura nga vitet e kaluara. Sipas këtij parashikimi, Shogëria do të jetë në gjendje të shlyejë të gjitha detyrimet e prapambetura nga fundi i vitit 2019.

Ashtu siç tregohet në pjesën e fundit të Tabelës 10-7, Shogëria UK Tirane ka marrë në konsideratë edhe efektin e të ardhurave nga shërbimet e tjera (ku përfshihen, shërbime të ndryshme profesionale që Shogëria mund të ofrojë për palët e treta, kryesisht lidhje për klientë të rinj, tarifa për lehe për ndërtimin e ndërtesave të reja, etj.).


Një tjetër zë i rëndësishëm i të ardhurave është dividenti nga pronësia e HEC Lanabregasit, që parashikohet të ketë një rritje të konsiderueshme në 2017 dhe të vazhdojë në të njëjtin nivel për pjesën e mbetur të periudhës së Planit të Biznesit.

Zëri i fundit i të ardhurave është "arkëtimit nga faturat e prapambetura". Bazuar në strategjinë e Shogërisë për arkëtimin e planifikuar, është parashikuar nga Shogëria rritja e normës së arkëtimit të faturave të prapambetura nga 13.3% në vitin bazë 2016 në 80% deri në vitin 2021.



Rezultati i parashikuar Financiar dhe Hendeku Akumulativë Financiar i UK Tirane, gjate perudhes se Planit te Biznesit, jane paraqitur ne Grafikon 10-2. Sig mund te vihet re nga Grafiku, UK Tirane ka parashikuar te vazhdoje te ketë një rezultat pozitiv dhe te permiresohet çdo vit, ne menyre qe te filloje te reduktojë borxhin e akumuluar nga vitet e mëparshme deri ne fund te 2019.

**Grafiku 10-2**  
Rezultati Financiar Vjetor i parashikuar dhe Hendeku Financiar Akumulativ i UK Tirane Sha



Ndikimi i strukturës së propozuar të tarifave fikse dhe volumetrike në një familje individuale, jepet në Tabelën 10-8, ku paraqitet vlera e faturës për shërbimin ujësjellës-kanalizime për Klientët Familjarë me numër të ndryshëm anëtarësh. Këto fatura mujore, të parashikuara, janë llogaritur duke përfshirë TVSH-në.

**Tabela 10-8**  
Vlera e parashikuar e faturës mujore për ujin dhe kanalizimet (në Lekë, përfshirë TVSH)

Madhesia e familjes	2017	2018	2019	2020	2021
Familje me një Person	328	518	598	771	760
Familje me dy Persona	536	795	955	1,183	1,160
Familje me tre Persona	744	1,073	1,313	1,594	1,560
Familje mesatare me katër Persona	952	1,350	1,670	2,006	1,960

**PROGRAMI I PËRMIRËSIMIT TË PERFORMANCËS  
SHOQËRIA UJËSJELLES-KANALIZIME TIRANË**

**I. Veprim specifik**

Rritja e mbulimit me shërbimin e furnizimit me ujë:

**II. Objektivi Strategjik i Trajtuar**

Rritja e mbulimit me shërbimin e furnizimit me ujë në të gjithë zonën e re të shërbimit të UK Tiranës, si agregat nga 85% në vitin 2016 në 95.3% deri në fund të vitit 2021.

**III. Përshkrimi i veprimit**

1. Përgatitja e studimeve të detajuara të fizibilitetit, projektive dhe dokumenteve të tenderit për zgjerimin e rrjetit të furnizimit me ujë në zonat e pashërbyera.
2. Tenderimi dhe zbatimi i zgjerimeve të planifikuara të rrjetit të furnizimit me ujë në zonat e pashërbyera të zonës së shërbimit të Shoqërisë.
3. Bashkërendimi i veprimeve 1 dhe 2 sa më sipër me aratet për instalimin e ujmatësve të konsumatorëve dhe me kryerjen e verifikimit të konsumatorëve sipas planit të veprimit.
4. Kryerja e kontrollave në terren dhe transferimi i saktë i të dhënave në bazën e të dhënave të klientëve të UK Tiranës.
5. Identifikimi i të gjitha lldhjeve të përgjishme, të përgjishmëzuar brenda zonës së re të shërbimit të UK Tiranë, legalizimi i këtyre lldhjeve nëpërmjet nënshkrimit të marrëveshjes së shërbimit të klientit, futja e këtyre konsumatorëve në bazën e të dhënave dhe faturimi për shërbimin e ofruar.

**IV. Plani i Veprimeve dhe Afatet Kohore**

Plani i veprimit	2017	2018	2019	2020	2021
Përgatitja e studimeve të detajuara, projektive dhe dokumenteve të tenderit					
Tenderimi dhe zbatimi i ndërtimit të shtrirjes së sistemit					
Lidhje të reja në rrjetet ekzistuese					
Kryerja e kontrollave në terren					

**V. Kapitulli i Nevojshëm**

Përshkrimi	Njësia	Sasia	Kosto për njësi (‘000)	Kosto totale (‘000)	2017	2018	2019	2020	2021
Përgatitja e studimeve të detajuara, projektive dhe dokumenteve të tenderit	LS		88,475	88,475					
Lidhje të reja në rrjetin ekzistues shërbim									
Shtrirja e rrjetit ujësjellës për të ritur mbulimin me shërbim		50	104,025	36,403	28,497	13,929	11,933	13,262	
Nr		35,132	10	351,316	126,716	94,650	46,265	39,635	44,050
<b>Totali</b>				<b>543,816</b>	<b>251,594</b>	<b>123,147</b>	<b>60,194</b>	<b>51,569</b>	<b>57,313</b>

**PROGRAMI I PËRMIRËSIMIT TË PERFORMANCËS  
SHOQËRIA UJËSJELLËS-KANALIZIME TIRANË**

**I. Veprim specifik**

Rritja e mbulimit me shërbimin e kanalizimeve.

**II. Objektivi Strategjik i Trajtuar**

Rritja e mbulimit me shërbimin e kanalizimeve në të gjithë zonën e re të shërbimit të UK Tiranës, si agregat nga 78.1% në vitin 2016 në 83.5% deri në fund të vitit 2021.

**III. Përshkrimi i veprimit**

1. Përgatitja e studimeve të detajuara të fizibilitetit, projektiveve dhe dokumenteve të tendërimit për zgjerimin e rrjetit kanalizimeve në zonat e pashërbyera.
2. Tenderimi dhe zbatimi i zgjerimeve të planifikuara të rrjetit të furnizimit me ujë në zonat e pashërbyera të zonës së shërbimit të Shoqërisë.
3. Bashkërendimi i veprimeve 1 dhe 2 sa më sipër me afatet për instalimin e ujëmatësve të konsumatorëve dhe me kryerjen e verifikimit të konsumatorëve sipas planit të veprimit.
4. Përmirësimi i bazës së të dhënave të klientëve të UK Tiranës për të reflektuar lidhjet e reja me kanalizimet dhe për të faturuar për shërbimin e ofruar.

**IV. Planit i Veprimeve dhe Afatet Kohore**

Planit i veprimit					
2017	2018	2019	2020	2021	
					Përgatitja e studimeve të detajuara, projektiveve dhe dokumenteve të tenderit
					Tenderimi dhe zbatimi i ndërimit të shtrirjes së sistemit
					Lidhje të reja në rrjetet ekzistuese
					Kryerja e kontrollëve në terren

**V. Kapitali i Nevojshëm**

Përshkrimi	Njësia	Sasia	Kosto për njësi (000)	Kosto totale (000)	Lek ('000)			Totali
					2017	2018	2019	
Shtirja e rrjetit/sistemit të kanalizimeve për të rritur mbulimin me shërbim	Nr.	21,760	55	1,196,775	96,619	190,551	276,790	285,619
				1,196,775	96,619	190,551	276,790	285,619
								347,194
								347,194

**PROGRAMI I PËRMIRËSIMIT TË PERFORMANCËS  
SHOQËRIA UJESJELLES-KANALIZIME TIRANË**

- I. **Veprimi specifik**  
 Reduktimi i ujit pa të ardhura.
- II. **Objekti i Strategjik i Trajtuar**  
 Rduktimi i ujit pa të ardhura, si mesatare, në të gjithë zonën e re të shërbimit të Shoqërisë, nga 65% në vitin 2017 në 40% deri në vitin 2021 duke rehabilituar rreth 100 km<sup>2</sup> të rrjetit të ujësjellësit, duke instaluar ujëmatës (97% deri në 2021), dhe duke shndërruar lidhjet e pajisjeshme në konsumatorë të regjistruar që krijojnë të ardhura për Shoqërinë.

**III. Përshkrimi i veprimit**

**Përshkrimi i veprimit për zvogëlimin e humbjeve administrative**

1. Instalimi dhe zëvendësimi i ujëmatësve familjare.

2. Instalimi i programit SCADA dhe matës së konsumit në të gjithë sistemin, programin GIS si dhe hartimi i një masterplanit që do ta ndihmojë Shoqërinë të analizojë më saktë bilancin e ujit dhe investimet e parashikuara për të ardhmen.
3. Kryerja e kontrollave të rregullta për saktësinë e ujëmatësve të konsumatorëve dhe identifikimin e ujëmatësve që nuk punojnë për shkak të prishjes së pasojë e demtimit të qëllimshëm dhe marrjen e masave për zëvendësimin e tyre.

4. Identifikimi i të gjitha lidhjeve të pajisjeshme, të parregjistruara brenda zonës së re të shërbimit të UK Tiranës, legalizimi i këtyre lidhjeve nëpërmjet firmosjes të kontratës së shërbimit të ndërmjet konsumatorit dhe Shoqërisë, futja e këtyre konsumatorëve në bazën e të dhënave dhe fatumit i tyre për shërbimin e ofruar.
5. Instalimi i ujëmatësve të ujit për të gjitha entet private dhe institucionet buxhetore që nuk kanë ujëmatës, bazuar në rregulloren e përcaktuar në Udhëzimin Nr. 293, date 10.05.2010.

6. Zëvendësimi i të gjithë ujëmatës mekanik për entet private, me ujëmatës "SMART" deri në 2021.

7. Përmirësimi i praktikave operative dhe tregtare për të mundësuar kryerjen e analizave rutinë të bilancit të ujit me qëllim vlerësimin dhe trajtimin e të gjithë komponentëve të ujit pa të ardhura.

**Përshkrimi i veprimit për zvogëlimin e humbjeve teknike**

1. Hartimi dhe zbatimi i një programi inspektiv të rregullta rutinë në terren në sistemet e furnizimit me ujë dhe regjistrimi i riparimeve i rrjedhjeve të dukshme të evidencuara në sistem, sa më shpejt që të jetë e mundur, për të minimizuar humbjet nga rrjedhjet.

2. Përcaktimi i tubacioneve që kanë nevojë të riparohen apo zëvendësohen.
3. Blerja e makinerive dhe pajisjeve të reja që do të jenë të nevojshme për mirëmbajtjen e rrjetit të furnizimit me ujë.

4. Ndërtimi i bapaseve për të gjitha linjat e transmisionit me qëllim uljen e numrit të lidhjeve të pajisjeshme që bëhen në këto tubacione.

Fundi i vitit	% me Ujëmatës
2017	77%
2018	78%
2019	84%
2020	91%
2021	97%

**V. Kapitall i Nevojshëm**

Nuk ka nevojë për investime kapitale për të zbatuar këtë plan veprimi. Të gjitha aksionet e këtij plani veprimi do të financohen nga buxheti i operimit dhe mirëmbajtjes së Shogërisë.

**VI. Tregues të matshëm në përmirësimin e performancës**

UK Tiranë ka përcaktuar këto objektiva të ndërmjetme për arritjen e objektivit të normës në arkëtimin e faturave:

Norma e Arkëtimeve të Faturore të Prapambetura	Norma e Arkëtimin	Fundi i Vitit
30.0%	90.0%	2017
40.0%	91.0%	2018
60.0%	92.0%	2019
70.0%	92.0%	2020
80.0%	92.0%	2021

HEC Lanabregas	0	0	0	0	0
Tarife specifike për shlyerjen e matësve					
Ente private/kliente të vegantë/furrat e bukës	450	450	450	450	450
Tarifa e furnizimit me ujë me shumicë (Leke/m <sup>3</sup> )	12	15	15	15	15

**IV. Plani i detyrave dhe treguesit kryesorë**

Veprimi	2017					2018					2019					2020					2021				
Përfundimi i projektit të Rikonceptimit të Vënd-burimit të Shën Mërisë																									
Aplikimi i një tarife mujore fikse për ujëmatësit e instaluar SMART																									
Rritja e tarifave fikse dhe variable																									

**V. Kapitall i Nevojshëm**

Plani i Veprimit	Njësia	Sasia	Totali i kostos (000'Leke)	Leke ('000)					
				2017	2018	2019	2020	2021	
Përfundimi i projektit të Rikonceptimit të Vënd-burimit të Shën Mërisë	LS	1	589,000	589,000	0	0	0	0	0
<b>Totali</b>			<b>589,000</b>	<b>589,000</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>

**VI. Tregues të matshëm në përmirësimin e performancës**

Shoqëria ka përcaktuar treguesit e mëposhtëm për përmirësimin e performancës financiare dhe për kontributet e jetore për rezervat kapitale.

**Kontributet e jetore për Fondet e Kapitalit (në Leke)**

Fondi rezervë i kapitalit	2017	2018	2019	2020	2021	Total
Rinovim kapitali	252,597	100,000	100,000	1,000,000	1,100,000	2,552,597
Riparim dhe zëvendësim kapitali	11,893	93,216	212,624	257,298	326,797	901,827
Investime të reja kapitale	589,865	688,955	1,077,833	874,680	639,518	3,870,850
<b>Totali</b>	<b>854,354</b>	<b>882,170</b>	<b>1,390,457</b>	<b>2,131,977</b>	<b>2,066,315</b>	<b>7,325,273</b>

Plani i Veprimit	Njësi <sup>a</sup>	Sasia	Kosto Totale (000'Lek)	2017	2018	2019	2020	2021
				Lekë ('000)				
Zgjerimi i impiantit të trajtimit të ujit Bovillë	LS	1	680,000		340,000	340,000		
Riprojektimi i burimit të ujit të Shën Mërisë	LS	1	680,000		500,000	180,000		
Linja e re e Transmisionit nga ITU Bovillë deri ne Yzberisht - KMY	LS	1	1,088,000		250,000	520,000	318,000	
<b>Totali</b>			<b>2,448,000</b>		<b>1,090,000</b>	<b>1,040,000</b>	<b>318,000</b>	

**V. Aplikimi i kapitalit**

Shpenzimet e tjera kapitale që nevojiten për të arritur këtë synim në lidhje me investimet në pajisjen me ujëmatës është trajtuar tek plani i veprimit i objektivit të reduktimit të ujit pa të ardhura. Aksionet në këtë plan veprimi janë të gjitha të natyres administrative ose operationale dhe mirëmbajtjeje.

**VI. Tregues të matshëm në përmirësimin e performancës**

Duke qenë se objektivit strategjik varet nga një sërë veprimesh të ndryshme teknike dhe administrative nga UK Tirane, dhe nga ndryshimet në sjelljen e konsumatorëve, është e vështirë të parashikohet me saktësi se furnizimi me ujë 24 orë me presion do të arrihet deri në vitin 2021. Ka të ngjarë që kjo të arrihet në disa zona furnizimi me ujë para se të arrihet në zona të tjera të shërbimit.

Përvoja tregon se kjo duhet të arrihet si fillim në një zonë të shërbimit një herë dhe kur konsumatorët të shohin se furnizimi me ujë është i vazhdueshëm dhe i besueshëm, atëherë ata do të jenë të gatshëm të heqin depozitat nga tarracat e pallateve.



Fleta e Punës – Analiza e Staffit

Nr.	Kategoria	Viti Baze 2016		Viti 2017		Viti 2018		Viti 2019		Viti 2020		Viti 2021	
		Nr.	Kosto Vjetore	Nr.	Kosto Vjetore	Nr.	Kosto Vjetore	Nr.	Kosto Vjetore	Nr.	Kosto Vjetore	Nr.	Kosto Vjetore
		Paga Baze Mujore		Paga Baze Mujore		Paga Baze Mujore		Paga Baze Mujore		Paga Baze Mujore		Paga Baze Mujore	
1	Administrator i Përgjithshëm	1	130,000	1	130,000	1	132,500	1	132,600	1	135,252	1	135,252
2	Drejtori Teknik/Drejtori Ekonomik	2	111,500	2	111,500	2	113,200	2	115,730	2	116,005	2	116,005
3	Konduktor/Asistenti DP/Keshilltar	4	83,000	3,994,000	5	83,000	4,990,000	5	84,550	5	86,353	5	86,353
4	Drejtor Departament: Shërb. Mbesht. Task Force, Menaxh. te Shites, Ekonomik	4	100,000	4,800,000	4	100,000	4,800,000	4	102,000	4	104,000	4	104,000
5	Drejtor BNU, Juridik, Audit, Task Force, Fatum-Akademik, Njesite 1-5	12	83,750	12,050,000	12	84,042	12,102,000	11	85,723	11	87,437	11	87,437
6	Drejtor Departament: Prodhimi & Shpërndarja, Inxhinierik, Drejtoria Rajonale	3	100,000	3,600,000	3	100,000	3,600,000	3	102,000	3	104,000	3	104,000
7	Drejtor Teknik, Njye Boshlle, Operacionale, Prodhimi, Shpërndarja	5	81,700	4,902,000	6	83,000	5,976,000	6	84,550	6	86,353	6	86,353
8	Drejtor Departament: Rrjeti i Kanalizimeve & Menaxh. i TUP	0	0	0	0	0	0	0	1	104,000	1	104,000	
9	Drejtor Rrjet Kanalizime, Menaxh. i TUP	0	0	0	0	0	0	2	85,000	2	86,700	2	86,700
10	Përgjegjës Projektim Inxhinierik, Monitorim/Ligjor dhe Prokurim/BNJ/Faturimi dhe Arketimi	49	71,735	42,180,000	59	68,939	48,840,000	58	70,553	58	71,770	58	71,770
11	Përgjegjës Prodhimi, Transmetimi dhe Depot, Shpërndarja	22	59,355	15,690,834	22	61,344	16,194,634	21	62,571	21	63,822	21	63,822
12	Përgjegjës Rrjeti i Kanalizimeve Urbane-Ruraler/funksionimi e TUP	8	59,598	5,734,000	8	61,313	5,885,000	7	62,539	9	63,790	9	63,790
13	Specialist GIS, Projektim, Bilanci Uljkonshilltar	99	56,640	60,492,000	101	57,035	69,126,000	98	58,175	98	59,339	98	59,339
14	Specialist Laborant/Jurist/Prokurim/BNJ/MP/Kazazhier/TUP	149	55,872	99,900,000	181	54,077	117,456,000	178	55,159	178	56,282	178	56,282
15	Punëtor, Fatumes/Aktalet/Santare	229	35,059	96,450,012	234	35,476	99,618,000	226	36,168	226	36,910	226	36,910
16	Punëtor, Prodhimi, Transmetimi dhe Depot, Shpërndarja	527	34,732	219,648,000	535	36,753	235,956,000	515	37,488	515	38,238	515	38,238
17	Punëtor Rrjeti i Kanalizimeve Urbane-Rurale	46	31,696	17,456,000	47	32,240	18,522,000	42	33,497	42	34,167	42	34,167
		Kosto Totale Personeli ne Viti (Leji)		1,160		1,220		1,177		1,227		1,227	
		% Vjetore e nritjes se koston se Punes		7.9%		0.1%		5.4%		2.0%		0.0%	
		N. Indihjeve (U+K)		451,572		462,592		475,893		489,219		499,884	
		Punoqies/1000 lichte		2,52		2,54		2,88		2,46		2,45	
		438,990		451,572		462,592		475,893		489,219		499,884	

Nr.	Indeksimi i Pagave	2017		2018		2019		2020		2021	
		Nr.	Kosto Vjetore	Nr.	Kosto Vjetore	Nr.	Kosto Vjetore	Nr.	Kosto Vjetore	Nr.	Kosto Vjetore
1	Administrator i Përgjithshëm	1	130,000	1	132,500	1	132,600	1	135,252	1	135,252
2	Drejtor Teknik/Drejtori Ekonomik	2	111,500	2	113,200	2	115,730	2	116,005	2	116,005
3	Konduktor/Asistenti DP/Keshilltar	4	83,000	5	83,000	5	84,550	5	86,353	5	86,353
4	Drejtor Departament: Shërb. Mbesht. Task Force, Menaxh. te Shites, Ekonomik	4	100,000	4	100,000	4	102,000	4	104,000	4	104,000
5	Drejtor BNU, Juridik, Audit, Task Force, Fatum-Akademik, Njesite 1-5	12	83,750	12	84,042	11	85,723	11	87,437	11	87,437
6	Drejtor Departament: Prodhimi & Shpërndarja, Inxhinierik, Drejtoria Rajonale	3	100,000	3	100,000	3	102,000	3	104,000	3	104,000
7	Drejtor Teknik, Njye Boshlle, Operacionale, Prodhimi, Shpërndarja	5	81,700	6	83,000	6	84,550	6	86,353	6	86,353
8	Drejtor Departament: Rrjeti i Kanalizimeve & Menaxh. i TUP	0	0	0	0	1	104,000	1	104,000	1	104,000
9	Drejtor Rrjet Kanalizime, Menaxh. i TUP	0	0	0	0	2	85,000	2	86,700	2	86,700
10	Përgjegjës Projektim Inxhinierik, Monitorim/Ligjor dhe Prokurim/BNJ/Faturimi dhe Arketimi	49	71,735	59	68,939	58	70,553	58	71,770	58	71,770
11	Përgjegjës Prodhimi, Transmetimi dhe Depot, Shpërndarja	22	59,355	22	61,344	21	62,571	21	63,822	21	63,822
12	Përgjegjës Rrjeti i Kanalizimeve Urbane-Ruraler/funksionimi e TUP	8	59,598	8	61,313	7	62,539	9	63,790	9	63,790
13	Specialist GIS, Projektim, Bilanci Uljkonshilltar	99	56,640	101	57,035	98	58,175	98	59,339	98	59,339
14	Specialist Laborant/Jurist/Prokurim/BNJ/MP/Kazazhier/TUP	149	55,872	181	54,077	178	55,159	178	56,282	178	56,282
15	Punëtor, Fatumes/Aktalet/Santare	229	35,059	234	35,476	226	36,168	226	36,910	226	36,910
16	Punëtor, Prodhimi, Transmetimi dhe Depot, Shpërndarja	527	34,732	535	36,753	515	37,488	515	38,238	515	38,238
17	Punëtor Rrjeti i Kanalizimeve Urbane-Rurale	46	31,696	47	32,240	42	33,497	42	34,167	42	34,167



**Fieta e Punës – Marrëveshjet e Kredive**

Pershkrimi	Detyrime nga periudha te mepareshme (LEK)	Viti Baze 2016 (LEK)	Viti 2017 (LEK)	Viti 2018 (LEK)	Viti 2019 (LEK)	Viti 2020 (LEK)	Viti 2021 (LEK)
<b>Kredite Ekzistuese</b>							
Pagesat e Interesit	4,694,831	8,749,459	7,895,855	7,042,250	6,188,646	5,335,042	4,481,438
Pagesat e Principalit	597,523,992	85,360,422	85,360,422	85,360,422	85,360,422	85,360,422	85,360,422
<b>Totali i Pagesave per Kredine Italiane 95/007</b>	<b>602,218,823</b>	<b>94,109,880</b>	<b>93,256,276</b>	<b>92,402,672</b>	<b>91,549,068</b>	<b>90,695,463</b>	<b>89,841,859</b>
Pagesat e Interesit	10,861,617	5,170,135	4,665,731	4,161,328	3,656,925	3,152,521	2,648,118
Pagesat e Principalit	378,302,517	50,440,336	50,440,336	50,440,336	50,440,336	53,592,857	53,088,454
<b>Totali i Pagesave per Kredine Italiane 94/006</b>	<b>389,164,134</b>	<b>55,610,470</b>	<b>55,106,067</b>	<b>54,601,664</b>	<b>54,097,260</b>	<b>56,745,378</b>	<b>55,736,572</b>
Pagesat e Interesit	6,847,483	11,297,682	11,297,682	14,937,626	18,577,564	18,577,564	18,577,564
Pagesat e Principalit	-	0	0	0	0	0	0
<b>Totali i Pagesave per Kredine Italiane 99/004</b>	<b>6,847,483</b>	<b>11,297,682</b>	<b>11,297,682</b>	<b>14,937,626</b>	<b>18,577,564</b>	<b>18,577,564</b>	<b>18,577,564</b>
Pagesat e Interesit	2,361,212	2,374,225	2,374,225	2,374,225	2,374,225	2,374,225	2,374,225
Pagesat e Principalit	-	0	0	0	0	0	0
<b>Totali i Pagesave per Kredine Italiane 99/010</b>	<b>2,361,212</b>	<b>2,374,225</b>	<b>2,374,225</b>	<b>2,374,225</b>	<b>2,374,225</b>	<b>2,374,225</b>	<b>2,374,225</b>
Pagesat e Interesit	5,254,587	560,199	516,262	472,325	428,388	384,451	340,513
Pagesat e Principalit	19,771,740	4,393,720	4,393,720	4,393,720	4,393,720	4,393,720	4,393,720
<b>Totali i Pagesave per Kredine Italiane 98/001</b>	<b>25,026,328</b>	<b>4,953,919</b>	<b>4,909,982</b>	<b>4,866,045</b>	<b>4,822,108</b>	<b>4,778,171</b>	<b>4,734,233</b>
Pagesat e Interesit	-	51,374,129	42,213,076	33,980,651	25,573,067	17,165,484	8,757,901
Pagesat e Principalit	-	193,277,772	177,171,291	193,277,772	193,277,772	193,277,772	193,277,772
<b>Totali i Pagesave per Kredine e HEC Lana Bregas</b>	<b>0</b>	<b>244,651,901</b>	<b>219,384,367</b>	<b>227,258,423</b>	<b>218,850,839</b>	<b>210,443,256</b>	<b>202,035,673</b>
Pagesat e Interesit	-	10,305,157	36,704,043	40,060,291	34,789,675	29,260,190	23,730,705
Pagesat e Principalit	-	1,504,173	33,761,178	106,711,160	127,114,591	127,114,591	127,114,591
<b>Totali i Pagesave per Kredine e Shen Merise</b>	<b>0</b>	<b>11,809,331</b>	<b>70,465,221</b>	<b>146,771,451</b>	<b>161,904,265</b>	<b>156,374,781</b>	<b>150,845,296</b>
Kredite te Ardhshme							
Pagesat e Interesit	-	0	0	67,474,898	65,226,780	62,978,838	60,730,896
Pagesat e Principalit	-	0	0	382,945,500	382,851,000	382,851,000	382,851,000
<b>Totali i Pagesave per Kredine Japoneze (JAICA)</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>450,420,398</b>	<b>448,077,780</b>	<b>445,829,838</b>	<b>443,581,896</b>
Pagesat e Interesit	-	0	0	58,725,000	228,375,000	396,663,086	502,637,053
Pagesat e Principalit	-	0	0	0	0	585,835,204	1,025,130,902
<b>Totali i Pagesave per Kredine e Ardhshme Tregtare</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>58,725,000</b>	<b>228,375,000</b>	<b>982,498,290</b>	<b>1,527,767,955</b>
<b>Totali i Kredive</b>							
Totali i Pagesave te Interesit	30,019,731	89,830,987	105,666,874	229,228,595	385,190,270	535,891,401	624,278,414
Totali i Pagesave te Principalit	995,598,249	334,976,422	351,126,946	823,128,909	843,437,840	1,432,425,566	1,871,216,860

**Flota e Punës – Nevoja për të Ardhura**

Pershkrimi	Detyrime nga periudha te mepareshme (Lek)	Viti Baze 2016 (Lek)	Viti 2017 (Lek)	Viti 2018 (Lek)	Viti 2019 (Lek)	Viti 2020 (Lek)	Viti 2021 (Lek)
<b>Shpenzime Totale per Mirrembajtje e Operim (1)</b>	<b>950,638,000</b>	<b>1,760,827,974</b>	<b>2,268,996,401</b>	<b>2,229,135,766</b>	<b>2,110,375,484</b>	<b>2,128,549,105</b>	<b>2,106,468,547</b>
<b>Pagesa per Bashkine e Tiranes (2)</b>	<b>439,526,000</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
<b>Pagesa e Kredise</b>							
Pagesa Interesi	30,019,731	89,830,987	105,666,874	229,228,595	385,190,270	535,891,401	624,278,414
Pagesa Principali	995,598,249	334,976,422	351,126,946	823,128,909	843,437,840	1,432,425,566	1,871,216,860
<b>    Nettotal (3)</b>	<b>1,025,617,980</b>	<b>424,807,409</b>	<b>456,793,820</b>	<b>1,052,357,504</b>	<b>1,228,628,110</b>	<b>1,968,316,967</b>	<b>2,495,495,274</b>
<b>Shpenzime Kapitale</b>							
Shpenzime per Rinovime Kapitale		565,712,000	252,596,630	100,000,000	100,000,000	1,000,000,000	1,100,000,000
Fondi per Riparim e Zevendesim Kapitale		50,102,000	11,892,793	93,215,787	212,624,115	257,297,561	326,796,905
Fondi per Investime te Reja Kapitale	601,264,000	65,626,000	589,864,535	688,954,674	1,077,832,969	874,679,900	639,517,633
<b>    Nettotal (4)</b>	<b>601,264,000</b>	<b>681,440,000</b>	<b>854,353,957</b>	<b>882,170,461</b>	<b>1,390,457,083</b>	<b>2,131,977,460</b>	<b>2,066,314,538</b>
<b>Nevoja per Financim</b>							
Nevoja per Financim (Operim+Shpenzime Kapitale)		0	0	0	0	0	0
Marreshje me Qeverine per te Shuar Detyrimet e Prapambetura te Kredise Italiane	995,598,249	140,194,477	140,194,477	140,194,477	140,194,477	143,346,999	142,842,595
<b>    Nettotal (5)</b>	<b>995,598,249</b>	<b>140,194,477</b>	<b>140,194,477</b>	<b>140,194,477</b>	<b>140,194,477</b>	<b>143,346,999</b>	<b>142,842,595</b>
<b>Nevojat Totale per te Ardhura (1+2+3+4-5)</b>	<b>2,021,447,731</b>	<b>2,726,880,906</b>	<b>3,439,949,702</b>	<b>4,023,469,253</b>	<b>4,589,266,200</b>	<b>6,085,496,533</b>	<b>6,525,435,763</b>

Nr 12628 Prot

16.06.17

Ujësjetës Kanalizime Tiranë sh.a  
Pasqyrat financiare të konsoliduara më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016  
Së bashku me Raportin e Audituesit të pavarur

## PËRMBAJTJA

	FAQE
PASQYRAT FINANCIARE :	
RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR	1
PASQYRA E KONSOLIDUAR POZICIONIT FINANCIAR	5
PASQYRA E KONSOLIDUAR E FITIMIT OSE HUMBJES DHE TË TË ARDHURAVE GJITHPËRFSHIRËSE	6
PASQYRA E KONSOLIDUAR E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	7
PASQYRA E KONSOLIDUAR E FLUKSEVE TË MJETEVE MONETARE	8
SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE TË KONSOLIDUARA	9-43

## RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për Aksionarët dhe Drejtuesit e Shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Tiranë Sh.a.

## Opinion me Rezervë

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të konsoliduara të Shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Tiranë Sh.a. (më poshtë "Shoqëria"), të cilat përfshijnë pasqyrën e konsoliduar të pozicionit financiar më datën 31 Dhjetor 2016, pasqyrën e konsoliduar të performancës dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e konsoliduar të fluksit të mjeteve monetare dhe pasqyrën e konsoliduar të ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur në këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat e konsoliduara financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, me përjashtim të efekteve të çështjes të përshkruara në paragrafin e bazës për opinionin me rezervë, pasqyrat e konsoliduara financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më datën 31 Dhjetor 2016, performancën e saj financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit.

## Bazat për Opinion me Rezervë

Arsyet e mëposhtëme janë bazat për dhënien e opinionit me rezervë:

1. Sikurse është paraqitur në shënimin 7, 'aktive afatgjata jomateriale', pasqyra e konsoliduar e pozicionit financiar të Grupit përfshin emrin e mirë për vlerën neto prej 717,064 mijë lekë, të njohur nga përthithja e njësisë HEC Lanabregas Sh.a. Ashtu sikurse përshkruhet në shënimet shpjeguese, shënimi 4.4, Grupi njej humbje nga rënia në vlerë e emrit të mirë mbi baza të llogaritjeve fiskale. Një njësi e cila ka njohur emër të mirë në një kombinim biznesi, duhet ta testojë emrin e mirë për zhvlerësim çdo vit, për të mbështetur masën e rënies në vlerë të regjistruar për emrin e mirë, ashtu sic parashikohet në SNK 36. Rrjedhimisht, në mungesë të një testi të zhvlerësimit të emrit të mirë, ne nuk jemi në gjendje të përcaktojmë nëse rregullime për emrin e mirë janë të nevojshme më 31 dhjetor 2016 dhe më 31 Dhjetor 2015 dhe efektet që mund të shkaktohen në pasqyrën e konsoliduar të të ardhurave gjithëpërfshirëse dhe pasqyrën e konsoliduar të ndryshimit të kapitalit.
2. Sikurse është paraqitur në shënimin 6, 'aktive afatgjata materiale', pasqyra e konsoliduar e pozicionit financiar të Grupit përfshin, aktive në proces me vlerë 1,026,003 mijë lekë të mbartura nga periudhat e mëparshme për punime të kryera nga nënkontraktorë të Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjetllës Kanalizime (DPUK). Pavarësisht dokumentacionit të vendosur në dispozicion nga Shoqëria për gjendjen e aktiveve në proces më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 ky informacion është i pamjaftueshëm për të siguruar një evidencë në lidhje me balancat e aktiveve në proces në pasqyrat financiare të konsoliduara. Si rrjedhojë, ne nuk jemi në gjendje të përcaktojmë nëse rregullime për aktivet në proces janë të nevojshme më 31 dhjetor 2016.
3. Sikurse është paraqitur në shënimin 6, 'aktivet afatgjata materiale', pasqyra e konsoliduar e pozicionit financiar të Grupit, përfshin, aktivin 'toka' në vlerë 2,155,486 mijë lekë, të mbartura nga periudhat e mëparshme bazuar në raportin e vlerësimit me datë 27 mars 2014, të kryer nga vlerësues të jashtëm. Raporti i vlerësimit nuk referon dhe nuk qartëson metoden e aplikuar për vlerësimin e aktivit 'toka'. Ne nuk mund të përcaktojmë nëse një rregullim i mundshëm në lidhje me vlerësimin e aktivit tokë sic parashikohet në SNK 16 mund të ketë efekt në pasqyrën e konsoliduar të pozicionit financiar të Grupit më 31 dhjetor 2016 dhe 2015.

4. Ne nuk ishim kontraktuar si auditues të Grupit në datën 31 dhjetor 2016 dhe si rrjedhojë nuk morëm pjesë në numërimin e inventarit fizik të realizuar nga shoqëria në mbyllje të vitit ushtrimor. Me gjithë procedurat e tjera alternative të kryera për të verifikuar ekzistencën dhe saktësinë e këtij inventari, ne nuk ishim në gjendje të krijojmë siguri të arsyeshme për vlerën e paraqitur në pasqyrën e konsoliduar të pozicionit financiar të Grupit për shumat 472,874 mijë lekë në datën 31 dhjetor 2016 dhe 378,142 mijë lekë në datën 31 dhjetor 2015. Gjithashtu, ne nuk mundëm të siguroheshim nëpërmjet evidencës së duhur dhe të mjaftueshme në lidhje me gjendjen e inventarit dhe zhvlerësimin e tij. Për këtë arsye, ne nuk mund të përcaktojmë nëse ndonjë rregullim mund të ketë qenë i nevojshëm në lidhje me gjendjen e inventarit dhe efektet që mund të shkaktohen në pasqyrën e konsoliduar të të ardhurave gjithëpërfshirëse dhe pasqyrën e konsoliduar të ndryshimit të kapitalit.
5. Pasqyra e konsoliduar e pozicionit financiar të Grupit përmban llogari të arkëtueshme në vlerë neto 2,905,018 mijë lekë. Sikurse paraqitet në shënimin 9 të pasqyrave financiare të konsoliduara, Shoqëria mëmë UKT Sh.a. ka kryer një cmuarje për zhvlerësimin për llogaritë e arkëtueshme bazuar mbi përqindje të paracaktuara mbi 4 klasa të riskut në bazë të numrit të faturave të papaguara për cdo kategori klientësh. Metodologjia e përdorur nuk përfshin ndonjë analizë mbështetëse për të justifikuar masën e përqindjeve të përdorura për provigjionimin e llogarive të arkëtueshme.
- Për më tepër, metodologjia e aplikuar nuk është në përputhje me kërkesat e Standardit Ndërkombëtar të Kontabilitetit 39, i cili kërkon vlerësim individual për balancat e arkëtueshme individualisht të rëndësishme dhe vlerësim kolektiv për balancat e tjera bazuar në analizë të plotë mbështetëse mbi të dhëna historike. Si rrjedhojë, në mungesë të prodhimit të një metodologjia e cila është në përputhje me kërkesat e Standardit Ndërkombëtar të Kontabilitetit 39, Instrumentat Financiar; njohja dhe matja' nuk jemi në gjendje të përcaktojmë nëse janë të nevojshme rregullime për gjendjet e llogarive të arkëtueshme më 31 dhjetor 2016 dhe 2015.
6. Sikurse është pasqyruar në shënimin shpjegues 14 "Huamarrje afatshkurtra" të pasqyrave financiare të konsoliduara të Grupit më 31 dhjetor 2016 dhe 2015, gjëndja e detyrimeve të Grupit ndaj Ministrisë së Financave është respektivisht 1,553,605 mijë lekë dhe 1,408,797 mijë lekë. Grupi nuk ka kryer vlerësimin e detyrimit ndaj Ministrisë së Financave duke përdorur kursin e fundvitit sipas kërkesave të Standardit Ndërkombëtarë të Kontabilitetit 21 "Efektet e ndryshimit në kurset e këmbimit". Për më tepër, Grupi nuk ka kryer njohjen me vlerën e drejtë në ditën e parë të marrjes së huave si dhe nuk ka aplikuar më pas metodën e kostos së amortizuar mbi huatë e marra. Si rrjedhojë, ne nuk mund të përcaktojmë nëse ndonjë rregullim është i nevojshëm në lidhje me detyrimet e huave dhe elementët që përbëjnë pasqyrën e konsoliduar të të ardhurave përmbledhëse, pasqyrën e konsoliduar të ndryshimeve në capital dhe pasqyrën e konsoliduar të flukseve të parasë më 31 dhjetor 2016 dhe 2015.
7. Sikurse është pasqyruar në shënimin shpjegues 15 të pasqyrave financiare të konsoliduara të Grupit më 31 dhjetor 2016 dhe 2015, gjëndja e granteve qeveritare të shoqërisë është respektivisht 479,651 mijë lekë dhe 494,102 mijë lekë. Pavarësisht dokumentacionit të vendosur në dispozicion nga Shoqëria për gjendjen e granteve qeveritare më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 ky informacion është i pamjaftueshëm për të siguruar një evidencë në lidhje me balancat e granteve qeveritare në pasqyrat financiare të konsoliduara. Si rrjedhojë, ne nuk mund të marrim siguri lidhur me vlefshmërinë dhe plotësinë e gjëndjes së granteve qeveritare më 31 dhjetor 2016 dhe 2015.

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.



### Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, shënimet shpjeguese, si edhe për çështjet që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të shoqërisë, duke përdorur parimet bazë të vazhdimësisë, përveç rastit kur drejtimi ka për qëllim të likuidojë aktivitetin, ose të ndërpresë aktivitetin operacional, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale përveçse më lart.

Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

### Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomali mund të vijë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë periudhës së auditimit. Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, planifikojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse për zbutjen e këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të atyre kontroleve të brendshme relevante për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit në përputhje me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontroleve të brendshme.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen në shënimet shpjeguese përkatëse të bëra nga Drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, mbi ekzistencën e një pasigurie materiale mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi aktivitetin e saj. Nëse një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vëmendjen në shënimin shpjegues përkatës, nëpërmjet raportit tonë të auditimit, ose nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërprerje të aftësisë së Shoqërisë për vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare dhe të shënimeve shpjeguese dhe në rast se ato përfaqësojnë drejt transaksionet dhe ngjarjet.

DIANA YLLI (GOLEMI)

RR. EMIN DURAKU PALL. BINJAKËT, NO.5 TIRANË

IRENA HOXHA (PULO)

RR. EMIN DURAKU PALL BINJAKËT, NO.5 TIRANË

SOKOL TOSKA

RR. TISH DASHA, KOMPLEKSI KIRA 2, KULLA 2, TIRANË


Ne komunikojmë me personat të ngarkuar për qeverisjen e Shoqërisë, përveçse çështjeve të tjera, edhe objektin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi relevante në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.

Tiranë, 16 qershor 2017

Diana Ylli (Golemi)  
Auditues Ligjor

Irena Pulò (Hoxha)  
Auditues Ligjor

Sokol Toska  
Auditues Ligjor

 MAZARS

Rr. Emin Duraku Palli "Binjaket",  
No.5, 1000, Tirana, Albania  
phone : +355 42 27 80 15  
www.mazars.al , info@mazars.al



Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sh.a

(Vlerat janë në mijë Lek)

Pasqyra e konsoliduar e Pozicionit Financiar  
Më 31 dhjetor 2016

	Shënime	31 dhjetor 2016 mijë lek	31 dhjetor 2015 mijë lek
<b>AKTIVE</b>			
<b>Aktivët afatgjatë</b>			
Aktivët afatgjatë material	6	13,735,775	12,702,649
Aktivët afatgjatë jomateriale	7	717,064	956,084
<b>Totali i aktiveve afatgjatë</b>		<b>14,452,839</b>	<b>13,658,733</b>
<b>Aktivët afatshkurtra</b>			
Inventarë	8	472,874	378,142
Llogari të arkëtueshme tregtare	9	2,905,018	2,716,829
Aktive tatimore të shtyra		1,251	-
Llogari të tjera të arkëtueshme		9,094	8,697
Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra	10	99,089	-
Mjetet monetare në arkë e në bankë	11	290,959	396,917
<b>Totali i aktiveve afatshkurtra</b>		<b>3,778,285</b>	<b>3,500,585</b>
<b>Totali i aktiveve</b>		<b>18,231,124</b>	<b>17,159,318</b>
<b>KAPITALI</b>			
Kapitali themeltar	12	2,544,398	2,544,398
Rezerva nga rivlerësimi		3,219,601	3,219,601
Rezerva ligjore		81,098	79,746
Rezerva statutore		3,681	3,681
Rezerve të tjera		729	729
Fitime të mbartura		1,315,400	809,399
<b>Fitimi i ushtrimit</b>		<b>639,625</b>	<b>533,045</b>
<b>Totali i kapitalit</b>		<b>7,804,532</b>	<b>7,190,599</b>
<b>DETYRIMET</b>			
<b>Detyrime afatgjatë</b>			
Hua afatgjatë	13	5,436,854	5,188,890
Detyrime të tjera (Tatim i shtyrë)		-	671
Grante, të ardhura të shtyra e të tjera detyrime	15	479,651	494,102
<b>Totali i detyrimeve afatgjatë</b>		<b>5,916,505</b>	<b>5,683,663</b>
<b>Detyrime afatshkurtra</b>			
Hua afatshkurtra	14	1,553,605	1,408,797
Llogari të pagueshme tregtare	16	2,717,582	2,599,551
Detyrime ndaj personelit	17	52,945	86,594
Detyrime tatimore/ Detyrime ndaj Shtetit dhe ISSH	18	41,471	189,850
Të tjera të pagueshme	19	119	264
Provizione	20	144,364	-
<b>Totali i detyrimeve afatshkurtra</b>		<b>4,510,087</b>	<b>4,285,056</b>
<b>Totali i detyrimeve</b>		<b>10,426,592</b>	<b>9,968,719</b>
<b>Totali i kapitalit dhe detyrimeve</b>		<b>18,231,124</b>	<b>17,159,318</b>

Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sh.a

(Vlerat janë në mijë Lek)

Pasqyra e konsoliduar e Fitim ose Humbjes dhe të të ardhurave gjithpërfshirëse  
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

	Shënime	31 dhjetor 2016 mijë lek	31 dhjetor 2015 mijë lek
<b>Të ardhurat</b>			
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	21	3,108,845	2,798,357
Të ardhura të tjera	22	99,731	143,161
<b>Total të ardhura</b>		<b>3,208,576</b>	<b>2,941,518</b>
<b>Shpenzimet operative</b>			
Shpenzimet e prodhimit	23	(780,430)	(924,153)
Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi	6	(279,285)	(269,562)
Renia ne vlere e Emrit te mire	7	(239,021)	(260,753)
Rimarrje/(Shpenzime) provizione llogari te arketushme	9	56,439	170,678
Rimarrje (Shpenzime ) provizione te tjera		1,498	3,178
Shpenzimet e pergjithshme dhe administrative	24	(230,081)	(139,286)
Shpenzime personeli	25	(805,529)	(869,097)
<b>Total shpenzime Operative</b>		<b>(2,276,409)</b>	<b>(2,288,995)</b>
<b>Te ardhurat /shpenzime financiare</b>			
Te Ardhurat financiare	26	1,259	275
Shpenzimet financiare	26	(88,423)	(114,876)
Provizioni	20	(140,417)	-
Fitim (humbje) nga kembimit valutore	27	61,063	88,180
<b>Të ardhura / Shpenzime te tejra Financiare</b>		<b>(166,518)</b>	<b>(26,421)</b>
<b>Fitimi/humbja para tatimit</b>		<b>765,649</b>	<b>626,102</b>
Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin	28	(126,024)	(93,057)
<b>Fitimi/humbja e vitit</b>		<b>639,625.27</b>	<b>533,045.00</b>
<b>Të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për vitin</b>		<b>-</b>	<b>-</b>
<b>Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin</b>		<b>639,625</b>	<b>533,045</b>

Pasqyrat financiare të konsoliduara duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese të faqeve 9 - 43, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara.

**Ujësjetillës Kanalizime Tiranë sh.a**

(Vlerat janë në mijë Lek)

**Pasqyra e konsoliduar ndryshimeve në Kapital  
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016**

	Kapitali Aksioner	Rezerva Ligjore	Rezerva te tjera	Rezerva Statutore	Rezerva te Rivleresimit te Aktiveve	Fitimi i Pashperndare	Rezultati i vitit	TOTALI
Gjendja me 1 janar 2015	2,544,398	79,746	729	3,681	3,219,601	809,399		6,656,825
Shtesa nga HEC Rezultati i vitit							533,045	729 533,045
<b>Gjendja me 31 dhjetor 2015</b>	<b>2,544,398</b>	<b>79,746</b>	<b>729</b>	<b>3,681</b>	<b>3,219,601</b>	<b>809,399</b>	<b>533,045</b>	<b>7,190,599</b>
Gjendja me 1 janar 2016	2,544,398	79,746	729	3,681	3,219,601	809,399		7,190,599
Shtesa nga HEC								
Rezultati mbartur nga 2015		1,352				506,001	(507,353)	-
Divident							(25,692)	(25,692)
Rezultati i vitit							639,625	639,625
<b>Gjendja me 31 dhjetor 2016</b>	<b>2,544,398</b>	<b>81,098</b>	<b>729</b>	<b>3,681</b>	<b>3,219,601</b>	<b>1,315,400</b>	<b>639,625</b>	<b>7,804,532</b>

Pasqyrat financiare të konsoliduara duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese të faqeve 9 – 43, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara.

Pasqyrat financiare së bashku me shënimet shpjeguese për vitin ushtrimor të mbyllur më 31 dhjetor 2016 u aprovuan nga Menaxhimi i shoqërisë më \_\_\_\_\_ dhe u nënshkruan si më poshtë:



Z. Redi Molla  
Drejtor i Përgjithshëm

Znj. Ajda Suta  
Drejtor Ekonomik

Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sh.a  
(Vlerat janë në mijë Lek)

Pasqyra e konsoliduar Fluksit të Mjeteve Monetare  
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

Shënime	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
	mijë lek	mijë lek
<b>Fitimi( Humbja)</b>	<b>765,649</b>	<b>626,102</b>
<b>Rregullime te Fitimi(Humbjes)</b>		
Amortizimi	277,267	269,562
Rimarje /renie ne vlere e llogarive te arketushme	91,352	(170,677)
Renie ne vlere e emrit te mire	239,021	260,753
<b>Flukset monetare neto të përdorura në aktivitetet operative</b>	<b>1,373,289</b>	<b>985,740</b>
Pakesim /(Rritje) Llogarite e Arketueshme	(446,135)	(663,248)
Pakesim /(Rritje) Inventaret	(94,732)	16,536
Rritje /(Pakesim) i Furnitoreve	302,179	1,124,871
Rritje /(Pakesim) i detyrimeve te tjera	(155,405)	(31,144)
Rritje /(Pakesim) i personelit dhe detyrimet ndaj shtetit	(36,674)	49,747
Tatim fitimi i Paguar	(103,246)	(209,397)
Nxjerrje jashtë përdorimi Aktiveve Afatgjata Materiale	45	-
Rrimarje/(shpenzime) provizione te tjera	-	(3,178)
Rritje /(Pakesim) i aktiveve tatimore te shtyra	(1,922)	-
<b>Kapitali Qarkullues</b>	<b>(535,890)</b>	<b>281,187</b>
<b>Mjetet Monetare qe rrjedhin nga Aktiviteti Operativ</b>	<b>837,354</b>	<b>1,273,105</b>
Blerje Aktiveve Afatgjata Materiale	(1,310,438)	(598,789)
<b>Mjetet Monetare qe rrjedhin nga Aktiviteti Investues</b>	<b>(1,310,438)</b>	<b>(598,789)</b>
Rritje ( Pakesim) i Huave nga Insitucione te Tjera	392,773	(285,811)
Pagesa nga pjesemarrje	(25,692)	-
<b>Mjetet Monetare qe rrjedhin nga Aktiviteti Financues</b>	<b>367,081</b>	<b>(285,811)</b>
<b>Rritje/(Pakesim) i Mjeteve Monetare gjate periudhes</b>	<b>(105,958)</b>	<b>385,327</b>
Ndryshimi neto ne mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre	(105,958)	385,327
Mjete Monetare ne Fillim te periudhes	396,917	11,590
<b>Mjete Monetare ne Fund te Periudhes</b>	<b>290,959</b>	<b>396,917</b>

Pasqyrat financiare të konsoliduara duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese të faqeve 9 – 43, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara.

**1. Informacion i përgjithshëm****1.1 Informacion Ligjor**

Ujësjetllës Kanalizime Tiranë Sha ("Kompania") është krijuar me vendimin e Gjykatës Tiranë nr. 24875 date 28.12.2000 në vijim të vendimit të Gjykatës së Rrethit Tiranë, bazuar në vendimin e aksionerit të vetëm, Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit për krijimin e Ndërmarrjes Ujësjetllës Kanalizime Qytet Sha. , me kapital aksioner prej lekë 2,008,900,000, Aksione 2,008,900 me vlerë nominale Lek 1000/aksion, tërësisht i paguar me kontribute në natyrë.

Kompania operon në aktivitetin e furnizimit me ujë të pijshëm të konsumatorëve dhe shitja e tij. Mirembajtje e sistemit (edhe) të furnizimit me ujë të pijshëm, prodhimi dhe/ose blerja e ujit për plotësimin e kërkesës së konsumatorëve, shërbimi i grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura dhe shitja e tij, mirëmbajtja e sistemeve të ujërave të ndotura, si dhe impiantëve të pastrimit të tyre.

Krijimi i saj është realizuar në bazë të urdhërit nr .46 ,datë 05.12.2000 të Ministrisë të Ekonomisë dhe Privatizimit, vendim i marrë në vijim të nenit 2, të ligjit nr 8237 date 01.09.1997 " Për disa ndryshime" të ligjit nr 7926 datë 20.04.1995 " Për Transformimin e Ndërmarrjeve Shtetërore në Shoqëri Tregëtare , i ndryshuar me dekretin nr .1195 datë 14.08.1995, ligin nr 8099 datë 28.03.1996, dekretin 1631 datë 01.11.1996 dhe ligjin 8158 datë 7.11.1996, ligjin nr 8158 date 7.11.1996", dhe VKM nr 58 datë 24.2.2000 " Për kriteret e vlerësimit të kapitalit themeltar të shoqërive shtetërore që do të krijohen nga shndërrimi i ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregëtare".

Me vendim nr 228 datë 04.06.2003 Aksioneri i vetëm "Ministria e Ekonomisë " vendosi bashkimin me përthithje të Ndërmarrjes Ujësjetllës Kanalizime Qytet, me Ndërmarrjen e Ujësjetllës Fshat, krijuar me vendim Gjykate nr. 27377 datë 12.03.2002, vendim i rregjistruar në Gjykatën e Tiranës nr 24875/2 datë 17.07.2003 , pas këtij bashkimi kapitali i shoqërisë u bë Lek 2,561,571, 000 , nr i aksioneve 2,561,571 vlerën nominale Lek 1,000/ aksion.

Në 24 janar 2007 me numrin e çështjes: CN-109845-12-07 . Kuota që mbahej nga aksioneri i vetëm Ministria e Ekonomisë te Shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Tiranë, u transferua në pronësi të njërive vendore të zonës së shërbimit që përbëhet nga 3 bashki dhe 16 komuna. Me datë 14/01/2010, numri i çështjes: CN-334160-01-10, Kapitali i Shoqërisë, u zvogëluar nga 2.561.571.000,00 Lek u bë 2.544.398.050,00, ndërkaq që numri i Aksioneve ishte "2.561.571,00" u bë "2.544.398,00" . Diferenca përfaqëson shtesë vlere të Kapitalit të paguar. Me numër çështjeje CN-715092-03-12 për depozitimin e ekstraktit të QRA datë 27/2/2012.

Aksionerët në UKT sha ishin si vijon:

Me datë 04/09/2015, numri i çështjes: CN-243826-09-15, kanë ndodhur ndryshimet e mëposhtme tek ortakët juridik dhe aksionerët në UKT janë si vijon:

Aksioneri	Nr Aksioneve	%	Kontributi
Bashkia Tiranë	2,099,108	82,50	2,099,108,000
Bashkia Kamëz	371,486	14,60	371,486,000
Bashkia Vorë	73,804	2,90	73,804,000
<b>TOTALI</b>	<b>2,544,398</b>	<b>100</b>	<b>2,544,398,000</b>

Më pas në datën 26/02/2016 kompania në bazë të numrit të çështjes: CN-570538-02-16, ka rregjistruar pranë QKR administrator ligjor, Z. Redi Molla, i cili ka zëvendësuar Z. Neritan Gjojdeshi i liruar nga detyra, sipas vendimit të asamblesë nr. 1 Datë 26.02.2016.

Më datë 18/7/2014 është rregjistruar shoqëria HEC LANABREGAS sha pranë QKR-së me NIPT L41918001E dhe aksioner 100% UKT sha me një kapital prej 10.000.000 lekë sipas vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve nr 13 date 13/9/2013, me adresë Komuna Dajt Hec Lanabregas me objekt të aktivitetit prodhim i energjisë elektrike, shitja e energjisë elektrike. Shoqëria mundet të realizojë çdo lloj operacioni financiar apo tregtar që lidhet direkt apo indirekt me objektin e saj, brenda limiteve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

Shoqëria do të kryejë çdo veprim me qëllim marrjen e lejeve, autorizimeve, liçensave dhe miratimeve të nevojshme për realizimin e veprimtarive të saj.

Adresa ligjore UKT sha është në : Rruga 5 Maji, pranë Medresesë, Tiranë. Shoqëria është subjekti i rregjistruar në TVSH dhe është pajisur me NIPT J62005002O. Më 31 dhjetor 2016 shoqëria ka 1168 punonjës kundrejt 870 punonjës më 31 dhjetor 2015.

## 1.2 Informacion mbi veprimtarinë

Në vitin 1939, me përfundimin e qendrës së Tiranës (ndërtimin e Ministrive dhe shëtitores "Dëshmorët e Kombit"), u vu në punë Impianti i Pastrimit të ujit në Brar, i cili merrte ujë në lumin e Tiranës pranë kataraktit me prurje Q=40 l/sek së bashku me rrjetin që furnizon objektet e ndërtuara.

Për administrimin e Impiantit dhe rrjetit shpërndarës, u krijua Shoqëria e Ujësjellësit Tiranë me vartësi nga Ministria e Punëve Botërore. Ky administrim ka vazhduar edhe pas çlirimit të vendit, të cilën e vërtetojnë lejet nga Shoqëria për ndërtimin e çezmave publike në qytetin e Tiranës. Në vitin 1951 qytetit të Tiranës, përveç Impiantit Brar, iu shtuan edhe Burimet e Selitës, të cilat, pasi përpunohen në Hidrocentralin Lana-Bregas, shpërndahen në depot e Tiranës. Me rritjen e numrit të konsumatorëve shtohen kërkesat për ujë. Në vitin 1964, Tiranës i janë shtuar burime të tjera: Burimi i Bovillës me prurje Q=140-420 l/sek dhe Burimet e Shën Mërisë me prurje Q=600 l/sek.

Në vitin 1988 Tiranës i shtohen burime të reja me ngritje mekanike Bërxull dhe Pishinat. Me rritjen e kërkesave, po në vitin 1988, me fonde të përbashkëta nga Ministria e Bujqësisë dhe Komunale, u krye studimi për ndërtimin e Digës së Bovillës me kapacitet 80 milion m<sup>3</sup>/ujë dhe aftësi përpunuese 40 milion m<sup>3</sup>/ujë. Diga e Bovillës përfundoi në vitin 1999, e në funksion të saj u ndërtua Impianti i Pastrimit të Ujit, me kapacitet përpunues prej 1800 l/sek. Impianti i Pastrimit të Ujit është vënë në punë në vitin 2000.

### a. Informacion mbi produktet kryesore dhe shërbimet e UKT sha

Liçensa e shoqërisë është rinovuar nga Komisioni Kombëtar Rregullator i Ujit me numer 21 me vendim nr.28 date 01.07.2013, pas një procesi monitorimi dhe vlerësimi të përmbyshjes së të gjitha kërkesave për këtë liçencë nga Enti Rregullator i Ujit në bazë të Ligjit Nr. 8102 datë 28.03.1996 "Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik, largimin dhe përpunimin e ujrave të ndotura"

Veprimtaritë përkatëse të kualifikuar në kategoritë janë:

- Kategorija A, Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik.
- Kategorija B, Për përpunimin e ujit për konsum publik.
- Kategorija C, Për largimin e ujrave të ndotura.

Në zonat e shërbimit të këtij operatori është: Bashkitë Tiranë, Kamëz, Vorë; Komunat Prezë, Farkë, Petrelë, Krrabë, Dajt, Bërxull, Baldushk, Vaqar, Zall – Herr, Peze, Kashar Ndroq, Paskuqan.

Përsa bazuar në liçensë UKT ofron shërbimet e mëposhtme:

- i) shpërndarjen e ujit të pijshëm
- ii) instalimin e matësve
- iii) instalimin e pikëlidhjeve me rrjetin
- iv) azhornimin e rrjetit
- v) largimin e ujrave të ndotura
- vi) shitjen e ujit me botë
- vii) furnizimin me ujë të HEC Lanabregas etj

## 1.3 Informacion mbi përthithjen e Shoqërisë HEC Lanabregas Sha në Ujësjellës Kanalizime Sha

Shoqëria "HEC LANABREGAS" sh.a është krijuar si shoqëri anonime shtetërore në 31/08/2011 dhe është rregjistruar në Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit Tiranë në 07/09/2011 si rezultat i një operacioni spin-off të aktiveve të prodhimit të energjisë elektrike të Korporatës Elektroenergjitike Shqiptare Sha të përdorura prej saj, në vendndodhjen Lanabregas, Komuna Dajt Tiranë.



Themelues i shoqërisë është aksioneri i vetëm Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës. Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave përkatëse të Ligjit 9901, datë 14.04.2010, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregëtare" si dhe nga statuti dhe legjislacioni shqiptar në fuqi.

*Objekti i veprimtarisë: Prodhimi dhe shitja e energjisë elektrike.*

Në vijim të kontratës nr 1588 rep-nr 320 kol datë 08/05/2012 " Për Blerjen e Aksioneve të HEC Lanabregas sha", Ligjit 9901 date 14/04/2008 "Për Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare" Ujësjetllës Kanalizime sha është shndërruar në zotëruesin në masën 100% të kapitalit të Shoqërisë Hec Lanabregas Sha.

Në datë 15.10.2012 u diskutua nga Këshilli Mbikqyrës i shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime sh.a Tiranë dhe u vendos të miratojë Projektin e Marrveshjes së Bashkimit me përthithje të shoqërive Ujësjetllës Kanalizime sha Tiranë dhe HEC Lanabregas sha ku shoqëria Ujësjetllës Kanalizime sha Tiranë është shoqëria përthithëse dhe shoqëria HEC Lanabregas sha është shoqëria e perthithur.

Asambleja e Aksionarëve të UKT sha në datë 16.01.2013 pasi shqyrtoi transaksionin vendosi të aprovojë Marrveshjen e Bashkimit me përthithje të shoqërive Ujësjetllës Kanalizime sha Tiranë dhe HEC Lanabregas sha ku shoqëria Ujësjetllës Kanalizime sha Tiranë është shoqëria përthithëse dhe shoqëria HEC Lanabregas sha është shoqëria e përthithur. Ky operacion sipas Marrëveshjes është realizuar mbi të dhënat e datës 30 shtator 2012.

Si rezultat i këtij operacioni Pasqyrat Financiare të UKT sha për periudhën që u mbyll më 31 dhjetor 2012 paraqesin dhe rezultatin e bashkimit me përthithje të HEC sha për periudhën 1 tetor 2012- 31 dhjetor 2012.

Në Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit përthithja e rezultateve të HEC Sh.a nga UKT u përfundua më datë 07/02/2013 me numër çështje CN-998395-01-13 me numër 1 të vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerëve datë 16/01/2013. Janë paraqitur për efekt fiskal vetëm rezultatet e HEC Lanabregas Sh.a deri në këtë datë të cilat reflektojnë rezultatin fiskal të tij.

#### **1.4 Informacion mbi krijimin dhe transferimin e Shoqërisë HEC LANABREGAS sha .**

Më datë 18/7/2014 është rregjistruar shoqëria HEC LANABREGAS sha pranë QKR-së me NIPT L41918001 dhe aksioner 100% UKT sha me një kapital prej 10.000.000 lekë sipas vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve nr 13 datë 13/9/2013, me adresë Komuna Dajt Hec Lanabregas me objekt të aktivitetit prodhim i energjisë elektrike, shitja e energjisë elektrike. Shoqëria mundet të realizojë çdo lloj operacioni financiar apo tregtar që lidhet direkt apo indirekt me objektin e saj, brenda limiteve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi. Shoqëria do të kryejë çdo veprim me qëllim marrjen e lejeve, autorizimeve, licensave dhe miratimeve të nevojshme për realizimin e veprimtarive të saj, për të cilat kërkohen këto dokumente administrative. Administratori i shoqërisë është zoti Arben Ibroja.

Shoqëria HEC LANABREGAS sha me NIPT L41918001E deri në marrjen e licensës së shitjes së energjisë elektrike në emër të saj ka nënshkruar një kontratë porosie me UKT sha me nr prot 11658 datë 21/7/2014 në të cilën ajo ka të drejtë të shfrytëzojë, përdorë dhe të mirëmbajë asetet e UKT –së me qëllim prodhimin e energjisë elektrike. Gjithashtu është nënshkruar kontrata e huapërdories midis dy shoqërive me nr prot 19322 dt 10/12/2014 që i shërben të njëjtit qëllim.

## 2. Aplikimi i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar të reja dhe të rishikuara (SNRF)

### 2.1 Standardet dhe interpretimet efektive në periudhën aktuale

Standardet dhe interpretimet e mëposhtme janë efektive për periudhat e raportimit financiar që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2016.

- Ndryshimet në SNRF 10 "Pasqyrat financiare të konsoliduara", SNRF 12 "Dhënia e informacioneve shpjeguese në lidhje me interesat në njësitë e tjera ekonomike" dhe SNK 28 "Investimet në pjesëmarrje dhe sipërmarrjet e përbashkëta" - Njësitë investuese: Aplikimi i përjashtimit të konsolidimit - miratuar nga BE-ja më 22 shtator 2016 ( në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas 1 janarit 2016)
- Ndryshimet në SNRF 11 "Marrëveshje të përbashkëta" Kontabiliteti për Blerjet e interesave në operacione të përbashkëta - të miratuar nga BE-ja më 24 nëntor 2015 (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2016)
- Ndryshimet në SNK 1 "Paraqitja e pasqyrave financiare" Paraqitja Fillestare - miratuar nga BE-ja më 18 dhjetor 2015 (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2016)
- Ndryshimet në SNK 16 "Aktivet Afatgjata Materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje"- Sqarimi i Metodave të pranueshme të Zhvlerësimit dhe Amortizimit - të miratuara nga BE-ja më 2 dhjetor 2015 (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2016).
- Ndryshimet në SNK 27 "Pasqyrat financiare individuale"- Metoda e kapitalit neto në pasqyrat financiare të veçanta - e miratuar nga BE-ja më 18 dhjetor 2015 (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2016)
- Ndryshimet në standardet e ndryshme "Përmirësimet në SNRF-të (cikël 2012-2014)" që rezultojnë nga projekti për përmirësimin vjetor të SNRF (SNRF 5, SNRF 7, SNK 19 dhe SNK 34) kryesisht me qëllim që të shmangin mospërputhjet dhe të qartësojnë formulimin - miratuar nga BE-ja më 15 dhjetor 2015 (ndryshimet duhet të zbatohen për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2016).

Miratimi i këtyre ndryshimeve në standardet ekzistuese nuk ka çuar në ndonjë ndryshim material në pasqyrat financiare të kompanisë.

### 2.2 Standardet dhe interpretimet e emetuara por ende të pa përvetësuar

Në datën e aprovimit të këtyre pasqyrave financiare, standardet e mëposhtme, interpretimet dhe rishikimet janë emtuar por nuk janë ende efektive:

- SNRF 9 "Instrumentat Financiar" (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2018)
- SNRF 15 " Të ardhurat nga Kontratat me Klientet" dhe amemdime të mëtejshme(efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2018)
- SNRF 16 " Qirate" (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2019)
- Ndryshimet në SNRF 2 "Pagesat e bazuara në aksione" (Klasifikimi dhe matja e pagesës të bazuar në aksione (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2018).
- Ndryshimet në SNRF 4 " Kontratat e Sigurimit"- Aplikimi i SNRF 9 "Instrumentat Financiar" me SNRF 4 "Kontratat e Sigurimit" (efektive për periudhat vjetore që fillojnë nga 1 Janari 2018 ose kur SNRF 9 "Instrumentat Financiare aplikohet për herë të pare).
- Ndryshimet në SNRF 10 "Pasqyrat Financiare të Konsoliduara" dhe SNK 28 "Investimet në pjesëmarrjet dhe në sipërmarrjet e përbashkëta"- Shitja ose Kontributi asetëve ndermjet një investitori dhe ortakut ose sipërmarrjet e përbashkëta dhe ndryshime të mëtejshme (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2018)

- *Ndryshimet në SNK 7 "Pasqyra e Flukseve Monetare"- Paraqitja fillestare(efektive për periudhat vjetore që fillojnë nga 1 Janari 2017)*
- *Ndryshimet në SNK 12 "Tatimi mbi të ardhurat"- Njohja e detyrimeve tatimore të shtyrë për humbjet e perealizuara(efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2017)*
- *Ndryshimet në SNK 40 "Aktivet Afatgjata Materiale të Investuara"- Transferimet e aktiveve afatgjata materiale të investuara(efektive per periudhat vjetore që fillojne më ose pas 1 Janarit 2018)*
- *Ndryshime të standarteve të ndryshme " Permirësime të SNRF-ve(cikli 2014-2016)" që rrjedhin nga projekti vjetor I permirësimit të SNRF-ve( SNRF 1, SNRF 12, IAS 28) kryesisht me qëllim që të shmangin mospërputhjet dhe të qartësojnë formulimin (Ndryshimet në SNRF 12 duhet të zbatohen për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2017 dhe ndryshimet në SNRF 1 dhe SNK 28 duhet të zbatohen për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018)*

Kompania ka zgjedhur të mos i përvetësojë këto standarde, rishikime dhe interpretime para datës që ato do të bëhen efektive. Kompania parashikon se përvetësimi i këtyre standardeve, rishikimeve dhe interpretimeve nuk do të ketë ndikim material në pasqyrat financiare të kompanisë në periudhën e aplikimit fillestar të tyre.

### 3. Bazat e përgatitjes

#### 3.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare të konsoliduara të Grupit UKT Sh.a. janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të miratuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK). Kuadri kontabël i aplikuar është i bazuar në politikat kontabël të listuara më poshtë. Më poshtë paraqiten parimet kryesore kontabël të aplikuara në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara.

Shoqëria mëmë UKT Sh.a.përgatit pasqyrat financiare të konsoliduara në përputhje me SNRF për Grupin UKT Sh.a. i cili përfshin UKT Sh.a. dhe HEC Lanbregas Sh.a. Në pasqyrat financiare të konsoliduara, Shoqëritë e Kontrolluara, në të cilat Grupi kontrollon në mënyrë direkte ose jodirekte më shumë se gjysmën e të drejtave të votës, ose zotëron të drejtën për të ushtruar kontroll mbi aktivitetet e tyre, konsolidohen plotësisht.

#### 3.2. Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombetare të Raportimit Financiar (SNRF) të lëshuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ("BSNK") dhe interpretimet e nxjerra nga Komiteti për Interpretimet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("KIRFN") të BSNK-se.

Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të parimit të vijimësisë.

#### 3.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Grupi do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

#### 3.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek Shqiptar ("Lek"), e cila është monedha funksionale e Grupit.

### 3.5. Bazat e konsolidimit

Pasqyrat financiare të Grupit konsolidojnë ato që shoqëria mëmë dhe të shoqërise se kontrolluar të saj me 31 dhjetor 2016. Shoqëria e Kontrolluar ka nje datë raportimi më 3 dhjetor 2016.

Të gjitha trasaksionet dhe balancat ndërmjet të shoqërive të Grupit janë eliminuar në konsolidum, duke përfshirë fitimet e parealizuara dhe humbjet nga transaksionet në ndërmjet shoqërive të Grupit.

Në rastet kur humbjet e parealizuara në shitjet e asetëve brenda grupit janë stornuar në konsolidim, aktivi është testuar edhe për zhvlerësim nga prespektiva e grupit. Shumat e raportuara në pasqyrat financiare të Shoqërive të Kontrolluara janë përshtatur aty ku është e nevojshme për të siguruar përputhshmërinë me politikat kontabël të miratuara nga Grupi.

### 3.6. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

#### 3.6.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuar të cilat rezultojnë nga pa mundësia e klientëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të klientëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së klientëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

#### 3.6.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

#### 3.6.3 Zhvlerësimi i inventarëve

Shoqëria vlerëson gjendjen e inventarit në qarkullim të ulët dhe inventarin i cili ka humbur vlerën e përdorimit për shkak të zhvillimeve teknologjike apo arsyeve të tjera , me synim për të përcaktuar masën e zhvlerësimit të inventarit , bazuar në përdorimin e ardhshëm të tij dhe në llogaritjen e vlerës neto të realizueshme . Në rast se vlera neto e realizueshme e inventarit është më e ulët se vlera kontabël neto , ekziston një tregues që inventari është i zhvlerësuar . Shoqëria përdor gjykimin e saj për të përcaktuar masën e zhvlerësimit.

#### 4. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

##### 4.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmben në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
EUR/LEK	135.23	137.28
USD/LEK	128.17	125.79
CHF/LEK	126.05	126.74
GBP/LEK	157.55	186.59

##### 4.2. Instrumentat financiare

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivitet financiarë çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

##### Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

##### Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionin për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

*(Vlerat janë në mijë Lek)*

#### *Llogari të pagueshme*

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Per llogarite e pagueshme ,te pa paguara dhe te pa kërkuara per me shume se pese vjet per te cilat shoqeria bazuar ne te dhënat dhe komunikimin me palën tjetër nuk ka ndonjë pritshmëri per shlyerjen e këtyre detyrimeve, gjykon se detyrimet e me sipërme nuk duhen njohur si te tilla por i njeh si të ardhura te vitit qe vijne nga fshirja e tyre.

#### *Hua të marra*

Huatë e marra njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

#### *Vlera e drejtë*

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

#### *Të tjera*

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

#### *Kapitali aksionar*

Kapitali aksionar njihet me vlerën nominale.

#### *Zhvlerësimi i aktiveve financiare*

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

#### 4.3. Aktive afatgjata materiale

##### i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitetit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitetit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivitetit. Programi i blerë që është pjesë përbërëse në funksionimin e një pajisjeje është kapitalizuar si pjesë e pajisjes.

Në rastet kur pjesë të një aktiviteti afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

##### ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

##### iii. Amortizimi

Amortizimi njihet në të ardhura ose shpenzime me metodën lineare mbi jetën e dobishme të aktivitetit për ndërtesat, kompjuterat, furniturat dhe pajisje dhe mjetet e transportit. Aktivitetet e marra me qera amortizohen përgjatë periudhës më të shkurtër midis periudhës së qiramarrjes dhe jetës së tyre të dobishme. Toka nuk amortizohet.

Ndërtesat, makineritë dhe pajisjet e lidhura me aktivitetin e Ujësjiellës Kanalizime amortizohen bazuar në jetëgjatësinë e aktivitetit, në këto raste për amortizimin e tyre përdoret metoda lineare. Baza e përlllogaritjes përfshin shumën fillestare të makinerive dhe pajisjeve dhe duke zbritur vlerën e rikuperueshme të aktivitetit.

Ndërtesa, makineri dhe pajisje të tjera zakonisht janë amortizuar me metodën lineare në bazë të jetës të dobishme të tyre që zakonisht përlllogaritet mbi jetëgjatësinë e supozuar të aktivitetit.

Vlerësimi i jetës së aktiveve është bërë duke parë nivelin e lartë të konsumimit dhe dëmtimet në asetet e UKT Sh.a.

##### iv. Rënia në vlerë

Vlera e mbartur e ndërtesave, makinave dhe pajisjeve kryesore të Grupit janë testuar çdo vit për rënie e mundeshme në vlerë, atëherë kur ngjarjet apo kushtet e gjëndjes financiare tregojnë që shuma e mbartur e këtyre aktiveve nuk mund të rikuperohet.

Në rast se për aktivet identifikohet fakti që mbartin një rënie të vlerës së tyre, atëherë shuma e mbartur në kontabilitet zvoglohet deri në shumën e rikuperueshme. Shuma e rikuperueshme përfaqësohet nga shuma më e madhe midis vlerës së drejtë minus kostot e shitjes dhe vlerës në përdorim, ku kjo e fundit është llogaritur si vlera e skontuara e flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë, të rregulluara nga faktorët e riskut që mbartin.

Për këto arsye grupohen sipas aftësisë së tyre për të gjeneruar flukse hyrëse të parasë bazuar në faktin që këto aktive janë të identifikueshme dhe që gjenerojnë flukse të rëndësishme të mjeteve monetare.

Vlerësimet e flukseve të ardhshme të parasë të përdorur, me vlerën e rënë të aktiveve të lidhura me prodhimin dhe shpërndarjen e produkteve të Grupit, kryhen duke përdorur vlerësimin e riskut në lidhje me prodhimin dhe performancën e tyre.

Zbritja në vlerë e aktiveve, përveç emrit të mirë, aplikohet sa herë që ngjarjet të cilat kanë ecur në këtë rënie të vlerës ndryshojnë. Shtimet apo pakësimet e rënies në vlerë, raportohen së bashku me zhvlerë

v. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëhere kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

4.4. Aktivitet Afatgjata Jomateriale (Emri i Mirë)

Emri i mirë rezulton nga transaksionet e blerjes së shoqërisë dhe përfaqëson tepricën midis shumës së paguar dhe vlerës së drejtë të kapitalit të shoqërisë që blihet.

Për qëllime të testit të vlerës së Emrit të Mirë, ai alokohet në Njësinë Gjeneruese të Fitimeve të identifikuar dhe që pritet të përftojë nga sinergjitë e kombinimit të bizneseve. Njësia e Gjenerimit të Fitimeve për të cilën është alokuar Emri i Mirë përfaqëson nivelin më të ulët brenda kompanisë mbi të cilën monitorohet Emri i Mirë. Emri i i Mirë monitorohet në nivel të raporteve segmentare.

Testimi për zhvlerësimin e Emrit të Mirë realizohet çdo vit nga kompania. Vlera e mbartur në kontabilitet krahasohet me vlerën e rikuperueshme. Në rast se diferenca midis vlerës së rikuperueshme dhe vlerës së mbartur në kontabilitet është negative atëhere humbja kalohet në të ardhura dhe shpenzime. Kjo shumë njihet menjëherë dhe nuk rimerret sërish.

4.5. Aktive jo financiare

Vlerat kontabël të aktiveve jofinanciare të Shoqërisë janë rishikuar në datën e raportimit për të përcaktuar në qoftë se ka ndonjë tregues zhvlerësimi. Në qoftë se ndonjë tregues i tillë ekziston, atëherë llogaritet vlera e rikuperueshme e aktivitetit. Shuma e rikuperueshme është vlera më e lartë midis vlerës së drejtë minus kostot e shitjes dhe vlerës në përdorim. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset e vlerësuarat monetare të ardhshme janë zbritur për vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para taksave që reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe risqet specifike për aktivin për të cilat vlerësimet e flukseve monetare të ardhshme nuk janë rregulluar.

Humbjet nga zhvlerësimi njihen në qoftë se vlera e mbartur e aktivitetit apo pjesa e burimit të parave e kalon vlerën e rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi janë njohur në të ardhura ose shpenzime.

4.6. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

Të ardhurat përfshijnë të ardhurat nga shitjet neto dhe të ardhurat nga shërbimet të realizuara nga aktivitetet kryesore të Degës, duke mos përfshirë tatimin mbi vlerën e shtuar (TVSH). Pjesa më e madhe të shitjeve të Degës gjenerohen nga shitja e shërbimeve të instalimit dhe mirëmbajtjes.

*i) Të ardhurat nga shitja e shërbimeve dhe produkteve*

Në marrëveshjet për shitjen vetëm të shërbimeve, të ardhurat nga shërbimet e furnizimit me uje të pijshëm dhe shërbimet e kanalizimit njihen në momentin e kryerjes së shërbimit, bazuar në matjen që realizohet të konsumit. Të ardhurat nga shërbimet e mirëmbajtjes dhe azhurnimit, si dhe të shitjes së produkteve : të matësive, librezave të ujit etj, njihen në momentin e realizimit të tyre.

Përgjithësisht, të ardhurat vlerësohen me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose që do të arkëtohet. Në rastin kur një pagesë e shtyrë ka një ndikim të rëndësishëm në llogaritjen e vlerës së drejtë, do të llogaritet duke skontuar pagesat e ardhshme. Vlerësimi i arkëtimit të llogarive të arkëtueshme është i rëndësishëm për të përcaktuar nëse do të njihen ose jo të ardhurat ose shpenzimet. Si pjesë e procesit të njohjes së të ardhurave, vlerëson nëse do të rrjedhin përfitime ekonomike të lidhura me transaksionin. Nëse Dega ka pasiguri nëse do të hyjnë apo jo përfitime ekonomike, njohja e të ardhurave shtyhet dhe njihen mbi baza monetare. Megjithatë,



nëse ka pasiguri rreth mbledhjes së një shume tashmë të përfshirë në të ardhurat, shuma në lidhje me të cilën është e pamundur që të arkëtohet ajo njihet si shpenzim në zërin e kostos së mallrave të shitura.

Sipas vendimit numër 24 të Komisionit Kombëtar Rregullator të Ujit , datë 26.02.2013 “ Për një shfuqizim në vendimin e KKR” dhe nr. 29, datë 28.09.2011 “ për përcaktimin e llogaritjes së sasisë së ujrave të ndotura “, vendosi që sasisë e ujrave të ndotura për çdo klient do të llogariten me 100% të sasisë së ujit të konsumuar.

#### **SNRF 15 “Të ardhurat nga Kontratat me Klientët “**

SNRF 15 paraqet kërkesat e reja për njohjen e të ardhurave , duke zëvendësuar SNK 18 “ Të ardhurat “,SNK11”Kontratat e ndërtimit “, dhe disa Interpretimet të tjera në lidhje me të ardhurat .Standarti i ri krijon një model për njohjen e të ardhurave të bazuar në kontroll dhe jep udhëzime shtesë në shumë fusha që nuk mbulohen në detaje nga SNRF-të ekzistuese , duke përfshirë se si të trajtohen marrëveshjet me detyrimet e shumta të performancës , çmimet ndryshueshme , të drejtat e rimbursimit të klientëve ,opsionin për riblerje nga furnizuesi dhe të tjera kompleksitete të zakonshme.

#### **ii) Të ardhurat nga interesi**

Të ardhurat nga interesi njihen në proporcion me kohën duke u bazuar në metodën e interesit efektiv. Kur një llogari e arkëtushme është vështirë për t'u arkëtuar, Dega zvogëlon vlerën e mbartur deri në vlerën e rikuperueshme, duke konsideruar që flukset e ardhshëm të parashikuara të skontuar me normën origjinale të interesit efektiv të instrumentit, dhe vazhdon të pakësojë zbritjen duke njohur të ardhurat nga interesi. Të ardhurat nga interesi në rastin e huave të cilat kanë rënie të vlerës njihen duke përdorur normën efektive origjinale të interesit.

#### **iii) Të ardhurat nga Grantet**

Qeveria e Shqipërisë ose/dhe Organizma Ndërkombëtare ofrojnë Grante shoqërisë në lidhje me realizimin e investimeve në infrastrukturën e rrjeteve. Fillimisht Granti njihet si detyrim në Pozicionin Financiar ndërkaq që shuma e Grantit ,njihet në të ardhurat me realizimin e investimit ose shpenzimeve për realizimin e tyre. Gjithashtu Bashkitë dhe Komunat mund të japin grante për kompensimin e çmimit të ujit apo shërbimeve të rregulluara , në këto raste të ardhurat njihen në proporcion me sasinë e ujit apo shërbimeve të rregulluara që konsumohen. Në rastin kur ofrohen grante për mbulimin e shpenzimeve të UKTsha ato njihen në të ardhura , në masën e shpenzimit të realizuar.

#### **4.7. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit**

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate dhe te ardhura nga veprimtari te tjera jooperative.

#### **4.8. Qiratë**

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve. Pagesat e bëra për qiratë operative njihen në të ardhura ose shpenzime në mënyrë lineare gjatë afatit të qirasë. Shoqëria ka vetem qira operative.

#### **4.9. Grantet**

Grantet që lidhen me aktivitet, përfshirë grantet jo monetare me vlerë të drejtë, paraqiten ne pasqyren e pozicionit financiar duke e njohur grantin si të ardhur të shtyrë, e cila njihet si e ardhur ne Pasqyren e fitimit ose humbjes dhe te ardhurave te tjera te pergjithshme në mënyrë sistematike dhe proporcionale pergjat jetës së dobishme të aktivitetit.

#### 4.10. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

#### 4.11. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2016 është 15% (2015: 15%).

#### 4.12. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

#### 4.13. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhur.

#### 4.14. Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

#### 4.15. Aktivitetet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

#### 4.16. Krahasueshmeria e informacionit kontabel

Kur është e nevojshme, shifrat krahasuese axhustohen (rregullohen) në konform me ndryshimet në paraqitje në periudhën aktuale raportuese. Ndryshimet janë kryer për të paraqitur më mirë natyrën e biznesit të Shoqërisë. Ato aplikohen retrospektivisht.

## 5. Çmuarje dhe gjykime kritike të kontabilitetit

Kompania kryen supozime dhe bën vlerësime të cilat kanë ndikim në shumat e raportuara të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar. Çmuarjet dhe gjykimet vlerësohen vazhdimisht dhe bazuar në eksperiencën e kaluar dhe faktorë të tjerë, duke përfshirë edhe parashikimet e ngjarjeve të ardhshme të cilat besohet që janë të arësyeshme sipas rrethanave.

### 5.1 Monedha Funktionale dhe raportuese

Monedha funksionale e Kompanisë është LEK. Vendosja e LEK si monedhë funksionale të Kompanisë kërkon gjykime të rëndësishme. Në marrjen e këtij gjykimi, merret në konsideratë monedha e mjedisit kryesor ekonomik në të cilin operon. Kompania gjithashtu merr në konsideratë faktorët e mëposhtëm në përcaktimin e monedhës funksionale:

a) monedha që influencojnë kryesisht në çmimin e shitjes për të mirat dhe shërbimet (kjo është monedha në të cilën çmimet e shitjes së të mirave dhe shërbimeve të saj janë përcaktuar), dhe ku faktorë ekonomik përcaktojnë çmimet e shitjes së të mirave dhe shërbimeve.

b) monedhat që influencojnë kryesisht fuqinë puntore, materialet, dhe kosto të tjera të furnizimit të mallrave dhe shërbimeve (kjo është monedha me të cilën kosto të tilla janë përcaktuar).

### 5.2 Njohja e të Ardhurave

#### (i) Të Ardhurat nga shitja e produkteve të rregulluar

Njohja e të ardhurave për klientët të cilët janë objekt matjeje përfshin një vlerësim të vlerës së ujit të konsumuar dhe të tjera shërbime të lidhura midis datës së fundit të matjes dhe datës së fundit të periudhës ushtrimore. Në datën e bilancit kjo shumë është për tu faturuar në datën tjetër të matjes. Drejtimi mendon që perlllogaritja e konsumit për periudhën afërsisht 15 ditore për klientët paraqet besueshëm vëllimin e të ardhurave që realizohen gjatë kësaj periudhe. Megjithatë ndryshimi në këto supozime nuk do të ketë efekte materiale në raportimin e të ardhurave.

#### (ii) Grantet

Një numër i caktuar grantesh janë përfshirë në librat, të përfituara nga transaksione të ndryshme me donator të ndryshëm. Drejtimi analizoi destinacionin dhe dokumentacionin e këtyre granteve. Një shumë e caktuar grantesh kanë qenë dhuruar si kontribut në materiale dhe aktive. Grantet njihen si të ardhura për pjesën e amortizimit të aktiveve për të cilat janë përfutur.

### 5.3 Rënia në vlerë e aktiveve

#### i) Aktivet afatgjata, materiale dhe jomateriale dhe emri i mire

Shoqëria analizon nëse në çdo datë të raportimit financiar ka indikatore të rënies në vlerë të Aktiveve Afatgjata, materiale dhe jomateriale sipas kërkesave të SKK 36 Rënia në vlerë e aseteve. Si rrjedhojë e kësaj politike Aktivet Afatgjata Materiale dhe jo Materiale janë testuar për vlerën e tyre më 31 Dhjetor 2016. Ky testim u krye në kuadër të vlerësimit me vlerën e drejtë të Aktiveve Afatgjata Materiale dhe si rezultat u vu re një rënie në vlerë e emrit të mirë të krijuar në momentin e blerjes së Hec Lanabregas sipas pasqyrimit në tabelën e mëposhtme :

Shumat Ne ' 000 Leke

Pershkrimi i Llogarive	Shënime	UKTsha 16	UKTsha 15
Aktive te tjera afatgjata		717,064	956,084
Tituj te pjesmarrjes-HEC		956,084	1,216,836
Zhvleresim tituj te pjesmarrjes-HEC		-239,020	-260,752
<b>Total</b>		<b>717,064</b>	<b>956,084</b>

**ii) Inventarët**

Inventarët janë matur me më të voglën midis Kostos Historike dhe Vlerës Neto së Realizueshme. Vlera Neto e Realizueshme është çmimi i vlerësuar i shitjes gjatë aktivitetit normal të biznesit, minus kostot e çmuara të përfundimit dhe kostot e çmuara që duhen për realizimin e shitjes. Inventari dhe Prodhimi në Proçes vlerësohen me më të voglën midis kostos (duke përfshirë shpenzimet indirekte të prodhimit nëse është rasti) dhe Vlerës Neto të Realizueshme. Vlera Neto e Realizueshme është e ardhura e parashikuar nga shitja në një periudhë normale të aktivitetit minus kostot e parashikuara të shitjes.

**5.4 Rënia në vlerë e Llogarive të arkëtueshme**

Shoqëria llogarit zhvlerësimin për Llogaritë e Arkëtueshme dhe të arkëtueshmeve të tjera bazuar në humbjet e vlerësuar që rezultojnë nga paaftësia e klientëve për të bërë pagesat e detyrimeve të tyre. Vlerësimi është bazuar në analizën e vjetërsisë të Llogarive të Arkëtueshme dhe eksperiencën historike të nxjerrjes jashtë librave kontabël, cilësinë e klientit dhe ndryshimet në termat e pagesës së klientit kur vlerësohet saktësia e humbjes nga zhvlerësimi për Llogaritë e dyshimta. Kjo përfshin supozimet për sjelljen e ardhshme të klientit dhe mbledhjet e ardhshme të parave. Në qoftë se kushtet financiare të klientit përkeqësohen, çregjistrimet aktuale të Llogarive të Arkëtueshme ekzistuese mund të jenë më të larta sesa priten dhe mund të kalojnë nivelin e humbjeve nga zhvlerësimi të njohura deri tani. Kompania testoi Llogaritë e Arkëtueshme të saj nëse ato kanë një rënie në vlerë në përputhje me politikat e brendshme të Kompanisë të përshkruara në Shën.3.9 pghr. 3). Nga testimi i bërë rezultoi që balanca e rezervës për renien në vlerë të Llogarive të arkëtueshme janë bërë ndryshimet si më poshtë.

Levizjet e humbjes se vleres paraqiten ne vijim:

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
<b>Gjendje ne Fillim</b>	<b>932,527</b>	<b>1,103,205</b>
Shtesa		
Pakesimet	(64,625)	(170,678)
<b>Gjendja ne Fund</b>	<b>867,902</b>	<b>932,527</b>

**Metoda e Vlerësimit**

Bazuar në politikën kontabël UKT evidenton Llogaritë e Arkëtueshme për efekte të vlerësimit të vlerës së drejtë si vijon:

**Vlerësuar Individualisht**

UKT fillimisht vlerëson nëse ka evidencë të humbjes së vlerës në rang individual dhe që kjo evidencë është materiale në grupin e aktivitetit financiar.

Nëse UKT identifikon sa më sipër që nuk ka evidencë për humbje vlere atëhere ajo e përfshin aktivin në një klasë të aktiveve financiare me karakteristika të ngjashme të riskut të kreditit dhe i vlerëson ata kolektivisht për rënien në vlerë. Aktivitet që janë vlerësuar individualisht për rënien në vlerë dhe për të cilët humbja nga rënia në vlerë është ose vazhdon të njihet nuk janë përfshirë në një vlerësim kolektiv për rënien në vlerë.

**Vlerësuar Kolektivisht**

Flukset e ardhshme monetare në një grup të aktiveve financiare që janë vlerësuar kolektivisht për rënien në vlerë parashikohen në bazë të eksperiencës së humbjes historike për aktivitet me karakteristika të ngjashme të riskut të kreditit me ato në grup.

Në rastet kur UKT nuk ka një eksperiencë humbjeje specifike ose ka një eksperiencë të pamjaftueshme, atëherë përdor eksperiencën e shoqërive që operojnë në të njëjtin treg.

Humbjet janë rregulluar në bazë të të dhënave aktuale të vëzhguara për të reflektuar efektet e kushteve aktuale të cilat nuk kanë ndikuar periudhën në të cilën është bazuar eksperiencia e humbjes historike dhe të mënjanojë efektet e kushteve në periudhën historike që nuk ekzistojnë aktualisht.

Vlerësimet e ndryshimeve në flukset e ardhshme monetare të parashikuara reflektojnë dhe janë lidhur në mënyrë konsistente me ndryshimet e të dhënave të lidhura nga periudha në periudhë ( të tilla si normat papunësisë, çmimet e pronës, çmimet e produkteve, fuqia paguese ose faktorë të tjerë që janë tregues të humbjeve të shkaktuara në grup dhe magnitudës së tyre).

Metodologjia dhe supozimet e përdorura për flukset e ardhshme të parashikuara janë rishikuar rregullisht për të zvogëluar ndonjë diferencë midis humbjes së parashikuar dhe eksperiencës së humbjes aktuale.

#### Vlerësimi i Lloqarive të Arkëtueshme

Bazuar në specifikën e aktivitetit të Kompanisë si duke marrë në konsideratë politikat e UKT sh.a.për vjeljen e detyrimeve të prapambetura me vështirësi arkëtimi, Sektori i Menaxhimit të Riskut, në varësi të mënyrës së matjes së konsumit të ujit dhe moshës së debisë, ka klasifikuar portofolin e debisë sipas kategorive të abonentëve në 4 klasa Risku sipas kriterëve të shpjeguara më poshtë:

#### **Klasa 1 (rrezikshmëria 22.5 %)**

- a) "Me Matje" përfshin të gjithë abonentët të cilët kanë pa shlyer deri në 12 fatura.
- b) "Pa Matje" përfshin të gjithë abonentët të cilët kanë pa shlyer deri në 6 fatura.

#### **Klasa 2 (rrezikshmëria 42.5 %)**

- c) "Me matje" përfshin të gjithë abonentët të cilët kanë pa shlyer deri në 12-18 fatura.
- d) "Pa matje" përfshin të gjithë abonentët të cilët kanë pa shlyer 6-12 fatura.

#### **Klasa 3 (rrezikshmëria 62.5 %)**

- e) "Me Matje" përfshin të gjithë abonentët të cilët kanë pa shlyer deri në 18-30 fatura.
- f) "Pa Matje" përfshin të gjithë abonentët të cilët kanë pa shlyer deri në 12-24 fatura.

#### **Klasa 4 (rrezikshmëria 87.5 %)**

- g) "Me Matje" përfshin të gjithë abonentët të cilët kanë pa shlyer mbi 30 fatura.
- h) "Pa Matje" përfshin të gjithë abonentët të cilët kanë pa shlyer mbi 24 fatura.

Sipas mënyrës së matjes për çdo kategori abonenti dhe moshës së debisë, është klasifikuar debia deri më datë 31.12.2016 sipas klasave të riskut të përcaktuara më sipër dhe në bazë të kësaj është përlogaritur vlera e provigjonimit duke marrë në konsideratë edhe vlerën e provigjonuar ne vitin 2015. Konkretisht, vlera e provigjonimit sipas klasave është specifikuar si më poshtë:

#### Klasa I

Kategori abonenti	Debia më datë 31.12.2016	Perqindja e provigjonimit deri 31.12.2015	Perqindja e provigjonimit sipas klasave te riskut	Shuma e provigjonit më 31.12.2016
<b>Klasa 1 Total</b>	<b>228,919,042</b>			<b>11,318,098</b>
Buxhetorë	41,168,813	3.7%	22.50%	342,730
Familjare	85,206,708	41.6%	22.50%	7,975,348
Familjare pa kanal.	11,861,458	63.7%	22.50%	1,700,043
Jo-Buxhetore	25,064,010	5.0%	22.50%	281,970
Privat	58,259,666	5.0%	22.50%	655,421
Privat pa kanal.	7,358,386	21.9%	22.50%	362,584

**Klasa II**

Kategori abonenti	Debi më datë 31.12.2016	Perqindja e provigjonimit deri 31.12.2015	Perqindja e provigjonimit sipas klasave te riskut	Shuma e provigjonit më 31.12.2016
<b>Klasa 2 Total</b>	<b>59,345,301</b>			<b>5,716,021</b>
Buxhetorë	3,655,382	3.7%	42.50%	57,481
Familjare	21,747,124	41.6%	42.50%	3,844,892
Familjare pa kanal.	4,388,135	63.7%	42.50%	1,187,978
Jo-Buxhutore	15,977,090	5.0%	42.50%	339,513
Privat	12,810,220	5.0%	42.50%	272,217
Privat pa kanal.	767,350	21.9%	42.50%	71,421

**Klasa III**

Kategori abonenti	Debia më datë 31.12.2016	Perqindja e provigjonimit deri 31.12.2015	Perqindja e provigjonimit sipas klasave te riskut	Shuma e provigjonit më 31.12.2016
<b>Klasa 3 Total</b>	<b>90,048,000</b>			<b>16,008,970</b>
Buxhetorë	6,571,000	3.7%	62.50%	151,954
Familjare	41,387,257	41.6%	62.50%	10,760,687
Familjare pa kanal.	9,901,161	63.7%	62.50%	3,941,900
Jo-Buxhutore	10,959,090	5.0%	62.50%	342,472
Privat	19,823,236	5.0%	62.50%	619,476
Privat pa kanal.	1,406,256	21.9%	62.50%	192,481

**Klasa IV**

Kategori abonenti	Debia më datë 31.12.2016	Perqindja e provigjonimit deri 31.12.2015	Perqindja e provigjonimit sipas klasave te riskut	Shuma e provigjonit më 31.12.2016
<b>Klasa 4 Total</b>	<b>2,285,532,869</b>			<b>818,305,319</b>
Buxhetorë	23,319,374	3.7%	87.50%	754,965
Familjare	1,503,269,452	41.6%	87.50%	547,190,080
Familjare pa kanal.	455,638,619	63.7%	87.50%	253,961,575
Jo-Buxhutore	10,908,550	5.0%	87.50%	477,249
Privat	266,131,104	5.0%	87.50%	11,643,236
Privat pa kanal.	26,265,771	21.9%	87.50%	5,033,178

(Vlerat janë në mijë Lek)

Sa më sipër, vlera totale e provigjonimit sipas kategorive të abonenteve referuar vlerës së debisë deri më 31.12.2016, është:

Kategori abonenti	Debia 31.12.2016	Shuma e provigjonit deri 31.12.2016	% Provigjoni
Buxhetorë	74,714,568.70	1,307,130.35	1.75%
Familjare	1,651,610,540.64	569,771,006.52	34.50%
Familjare pa kanal.	481,789,372.61	260,791,496.22	54.13%
Jo-Buxhutore	62,908,740	1,441,203.90	2.29%
Privat	357,024,226.01	13,190,350.34	3.69%
Privat pa kanal.	35,797,763.25	5,659,665.24	15.81%
<b>Grand TOTAL</b>	<b>2,663,845,211.21</b>	<b>852,160,852.57</b>	<b>31.99%</b>

Ulja e vlerës së provigjonimit krahasuar më atë të një viti më parë, reflekton masat administrative dhe ligjore që janë ndërmarrë nga Shoqëria, si dhe të funksionimit më efikas të strukturave të saj gjatë vitit 2016.

#### 5.5 Tatimi mbi të ardhurat

Kompania është subjekt i tatimit mbi të ardhurat. Në përcaktimin e provizioneve të tatimit mbi të ardhurat janë të nevojshme çmuarjet. Ekzistojnë shumë transaksione dhe llogaritje për të cilat përcaktimi përfundimtar i tatimit është i pasigurtë gjatë veprimtarisë normale të biznesit. Kompania njuh detyrimet për vlerësimet e organeve tatimore bazuar në vlerësimet nëse tatime të tjera shtesë do të lindin si detyrime. Nëse më pas ka diferencë midis detyrimit faktik dhe atij të regjistruar atëherë këto diferenca do të ndikojnë në tatimin mbi të ardhurat dhe provizionet për tatime në periudhën në të cilën është kryer ky krahasim.

Ujësjellës Kanalizime Tiranë sh.a

Shënime mbi pasqyrat financiare të konsoliduara më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(Vlerat janë në mijë Lek)

6. Aktivet afatgjata materiale dhe jomateriale

	Toka	Ndertesa	Rrjeti Kanalizim	Rrjeti Ujesjelles	Makinëri dhe Pajisje Pune	Mjete Transporti	Pajisje zyre dhe te ngjashme	Punime ne proces	Asete ne magazine	Total
Vlera kontabel me 01 Janar 2016	2,155,486	4,529,514	562,526	3,008,939	193,562	163,839	75,352	2,509,925	76,378	13,275,521
Blerjet gjatë viti ushtrimor	-	-	2,675	-	8,907	-	1,441	1,263,140	34,280	1,310,442
Nga inventaret afatshkurter ne inventar afatgjate	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Rimarrje nga nxjerrje jashte perdorimit	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Transferime & Sisteme UKT	-	18,370	128,685	269,646	9,191	(255)	25,841	(416,702)	(34,781)	(4)
Pakesime gjate vitit ushtrimor	-	-	-	-	(60)	-	-	-	-	(60)
Vlera kontabel me 31 Dhjetor 2016	2,155,486	4,547,884	693,887	3,278,585	211,600	163,584	102,633	3,356,363	75,877	14,585,899

Amortizimi i akumuluar 01 Janar 2016	-	167,224	37,556	227,154	32,247	44,920	37,076	-	21,794	567,972
Amortizimi 2016	-	83,958	20,752	119,738	16,024	23,874	12,923	-	-	277,267
Shtese Amortizimi nga magazina ne perdorim	-	-	-	-	(1,689)	(128)	(669)	-	2,485	(0)
Pakesim Amortizimi	-	-	-	-	(15)	-	-	-	-	(15)
Amortizimi i akumuluar 31 Dhjetor 2016 UKT	-	251,182	58,308	346,892	46,566	68,667	49,331	-	24,279	845,225

Zhvleresimi 31Dhjetor 2015	-	-	-	-	4,762	-	-	-	138	4,900
Zhvleresime	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Zhvleresimi 31Dhjetor 2016	-	-	-	-	4,762	-	-	-	138	4,900

Vlera Neto Kontabel 31 Dhjetor 2015 TOTAL	2,155,486	4,362,290	524,970	2,781,785	156,553	118,919	38,275	2,509,925	54,447	12,702,649
Vlera Neto Kontabel 31 Dhjetor 2016 TOTAL	2,155,486	4,296,703	635,579	2,931,693	160,271	94,917	53,303	3,356,363	51,461	13,735,775



(Vlerat janë në mijë Lek)

**7. Aktivët afatgjatë jomateriale**

Balanca e aktiveve afatgjatë jomateriale të Grupit më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 paraqitet si më poshte:

	<u>Emri i mirë</u>	<u>Totali</u>
<b>Kosto</b>		
Më 1 janar 2015	1,216,836	1,216,836
Rënia në vlerë	(260,752)	(260,752)
<b>Me 31 dhjetor 2015</b>	<u>956,084</u>	<u>956,084</u>
Më 1 janar 2016	956,084	956,084
Rënia në vlerë	(239,020)	(239,020)
<b>Me 31 dhjetor 2016</b>	<u>717,064</u>	<u>717,064</u>

**8. Inventarë**

Balanca e inventareve të Grupit më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 paraqitet si më poshte:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Materiale-rrjetet	369,469	269,674
Pjese kembimi	32,516	30,361
Materiale konsumi	53,094	44,053
Kimikate	12,337	1,099
Inventari i imet	24,310	23,569
Te tjera	10,675	15,346
Inventari i pamberritur	-	22,456
Materiale jashte perdorimit	29,786	29,785
Humbje vlere e aktivitet afatshkurtet	(59,313)	(57,296)
<b>Totali</b>	<u>472,874</u>	<u>378,142</u>

**9. Llogari të arkëtueshme tregtare**

Balanca e llogarive të arkëtueshme të Grupit më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 paraqitet si më poshte:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Konsumatore familjare	2,359,184	2,008,452
Subjekte private	602,265	540,099
Ente buxhetore	115,639	107,652
Komuna	126,904	134,403
Tjere	571,632	81,958
Kliente per taksa bashkie	(2,706)	540,424
KESH sha	2	236,368
Zhvleresimi i llogarive te arketueshme	(867,902)	(932,527)
<b>Totali</b>	<u>2,905,018</u>	<u>2,716,829</u>

Balanca e provizionit të Grupit më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 paraqitet si më poshte:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Gjëndja ne fillim	932,527	1,103,205
Shtesat	-	-
Pakësimet	(64,625)	(170,678)
<b>Gjendja në fund</b>	<b><u>867,902</u></b>	<b><u>932,527</u></b>

#### 10. Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra

Balanca e parapagimeve dhe shpenzimet e shtyra të Grupit më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 paraqitet si më poshte:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Paradhenie te paguara nenkontraktoreve Rrjetet	-	2,727
Paradhenie per shtetin te tjera	62,596	-
Paradhenie te tjera	(125)	-
Te tjere debitore	12,402	13,899
Zbritje vlere llogari te tjera	(12,402)	(16,626)
Te tjera kerkesa te arketuara	36,618	-
<b>Totali</b>	<b><u>99,089</u></b>	<b><u>-</u></b>

#### 11. Mjetet monetare në arkë e në bankë

Balanca e mjetet monetare në arkë e në bankë të shoqërisë më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 paraqitet si më poshte:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Banka Kombetare Tregtare	262,718	330,144
Intesa San Paolo	-	27
Banka Emporiki	58	-
Union Bank Albania	858	52
Banka Pro Credit	17	39
Banka UBA	559	279
Banka Credins	17,592	65,029
NBG	38	40
Alpha Bank	1,111	585
Tirana Bank	231	42
Societe Generale Albania	210	-
Ne tranzit	6,607	-
Raiffeisen Bank	960	95
Eaysypay	-	585
<b>Totali</b>	<b><u>290,959</u></b>	<b><u>396,917</u></b>

**12. Kapitali**

Kapitali i shoqërisë më 31 dhjetor 2016 është në vlerën 2,544,398 Lekë, i cili zotërohet nga aksionerët e shoqërisë.

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Numri aksioneve	2,544,398	2,544,398
Vlera nominale	1,000	1,000
	<u><b>2,544,398</b></u>	<u><b>2,544,398</b></u>

Rezervat nga rivleresimi të Grupit më 31 dhjetor 2016 janë në vlerën 3,219,601 Lekë.

Rezervat ligjore të Grupit më 31 dhjetor 2016 janë në vlerën 81,098 Lekë.

Rezervat statutore të Grupit më 31 dhjetor 2016 janë në vlerën 3,681 Lekë.

Rezervat të tjera te Grupit më 31 dhjetor 2016 janë në vlerën 729 Lekë.

**13. Hua afatgjata**

Balanca e huave afatgjata të Grupit më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 paraqitet si më poshte:

	<u>31 dhjetor 2016</u>		<u>31 dhjetor 2015</u>	
	Euro	Leke	Euro	Lek
Bovilla - Konventa Financiare 22 Mld Lit - F.ROT/AID-95/007/00	5,365,408	725,564	5,996,634	823,218
Konventa Financiare 13 Mld Lit - F.ROT/AID-94/006/00	2,797,472	378,302	3,170,468	435,242
Konventa Financiare 53.2 Mld Lit - F.ROT/AID-99/004/00	16,708,851	2,259,538	16,708,851	2,293,791
Konventa Financiare 6.8 Mld Lit - F.ROT/AID-99/010/00	3,511,394	474,846	3,511,394	482,044
Projekti COMM'98-Konventa Financiare 22 Mld Lit - F.ROT/AID-98/001/00	357,398	48,331	389,889	53,524
Kredia e Shen Merise nga BKT	-	696,629	-	54,150
Kredia per HEC Lanabregas nga BKT	-	853,644	-	1,046,921
<b>Totali</b>	<u><b>28,740,523</b></u>	<u><b>5,436,854</b></u>	<u><b>29,777,236</b></u>	<u><b>5,188,890</b></u>

Gjatë periudhës 1993-2001, Qeveria e Shqipërisë, në vijim të planit të përbashkët të bashkëpunimit me Qeverinë e Republikës Italiane, nëpërmjet Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, ka firmosur me Zyrën e Bashkëpunimit Italian, një sërë kontratash. Bazuar në këto kontrata, është e përzgjedhur Banka Kombëtare Tregëtare (BKT) si bankë bazë për financimin e objektit të këtyre kontratave .

Në vijim të asaj më sipër, BKT dhe Njësia e Menaxhimit të Projekteve të Huaja dhe /ose Ministria e Financave, janë palë e kontratave të kredisë së akorduar me UKT për zhvillimin e rrjetit të saj dhe asistencën teknike .

Përdorimi i kredive kryhet nga kredimarrësi kryesor , UKT-ja por edhe nga Ministria përkatëse që ka firmosur kontratën. Si rrjedhojë, UKT detajon veçmas tërheqjet që janë realizuar prej saj, si dhe ato që kryhen prej Ministrive.

Informacioni për secilën kredi detajohet si më poshtë :

**Bovilla –Konventa Financiare 22 Mld Lit-F.ROT/AID-95/007/00**

E nënshkruar më 20.06.1996 midis Bankës Kombëtare Tregtare të Shqipërisë dhe Njesisë së Drejtimit të Projektit pranë Ministrisë në Ndërtimit dhe Turizmit dhe Ndërmarrjes së Ujësjetellësit Tiranë , përshumën prej 22.000.000.000 Lireta italiane . Afati i kthimit të huasë është 30 vjet nga data e bërjes efektive të huasë.

Kushtet e huasë :

1. Ndërmarrja e Ujësjetellësit Tiranë do ti paguajë huadhënësit një normë vjetore interesi prej 1% , e pagueshme 2 herë në vit me këste 6 mujore .
2. Ndërmarrja e Ujësjetellësit Tiranë do të fillojë të shlyejë pjesën e principalit pas 12 viteve të bërjes efektive të huasë, i pagueshëm 2 herë në vit me këste 6 mujore.
3. Ndërmarrja e Ujësjetellësit Tiranë do ti paguajë huadhënësit një komision prej 0.75% të huasë së përdorur, i pagueshëm në momentin e përdorimit të huasë.
4. Të gjitha detyrimet e ndërmarrjes së Ujësjetellësit Tiranë do të paguhen në monedhën në të cilën është dhënë huaja, ose në lekë e konvertuar me kursin e ditës në të cilën do të bëhet shlyerja.
5. Në rast se ndërmarrja e Ujësjetellësit Tiranë nuk mund të përmbush detyrimin e sa për të bërë pagesat në lidhje me principalin dhe interesin ,atëherë huadhënësi në bazë të marrëveshjes me Ministrinë e Financave do ti kërkoj buxhetit të shtetit të paguajë shumat përkatëse.

**Konventa Financiare 13Mld Lit-F.ROD/AID-94/006/00**

E lidhur më datën 05.04.1995 midis Bankës Kombëtare Tregëtare të Shqipësisë (BKTSH) që do të veprojë si bankë agjente në emër dhe për llogari të qeverisë dhe ndërmarrjes Ujësjetellësit Tiranë, për shumën prej 13.000.000.000 lireta.

Kushtet e huasë:

1. Afati maksimal i kthimit brenda 30 viteve. Ky afat do të jetë i negociueshëm mbi bazën e gjykimit që do të bëjë BKTSH sipas gjendjes ekonomiko-financiare të ndërmarrjes në të ardhmen.
2. Ndërmarrja e Ujësjetellësit Tiranë do të fillojë të shlyejë pjesën e principalit pas 10 viteve. Për këtë periudhë interesi do të paguhet.
  - Norma vjetore të Bankës Italiane 1%
  - Kthimi i kredisë dhe interesave do të bëhet me këste 6 mujore
  - Kthimi i kredisë do të bëhet në të njëjtën valutë me të cilën është dhënë kredia pse në lekë e konvertuar me kursin e ditës në të cilën bëhet shlyerja
  - Ndërmarrja e Ujësjetellësit Tiranë do ti paguajë huadhënësit një komision prej 0.75 % të huasë së përdorur i pagueshëm në momentin e përdorimit të huasë

**Konventa Financiare 6.8 Mld Lit-F.ROT/AID-99/010/00**

E lidhur më datën 18.09.2000 midis Bankës Kombëtare Tregëtare Shqipëtare dhe Ujësjetellësit Tiranë, për shumën prej 6.800.000.000 litera Italiane. Afati i kthimit të huasë është 35 vjet nga data e bërjes efektive të huasë sipas Konventës Financiare të lidhur midis qeverisë Italiane përfaqësuar nga Mediocredito Centrale dhe qeverisë Shqiptare përfaqësuar nga Banka Kombëtare Tregëtare.

Kushtet e huasë :

1. Norma vjetore e interesit prej 0.5% ,do të jetë e pagueshme 2 herë në vit me këste 6 mujore të llogaritur mbi tepricën e kredisë.
2. Huamarrësi do të fillojë shlyerjen e pjesës principale të huasë pas 294 muajve të bërjes efektive të saj ,i pagueshëm 2 herë në vit me këste 6 mujore.
3. Të gjitha detyrimet e huamarrësit do të paguhen në monedhën në të cilën është dhënë huaja ose në lekë e konvertuar me kursin e ditës në të cilën do të bëhet shlyerja.

**Konventa Financiare 53.2 Mld Lit-F.ROT/AID-99/004/00**

Lidhur në bazë të ligjit Italian nr 49, datë 26 shkurt 1987 midis qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Mediocredito Centrale-Istituto Centrale per il Credito a Medio Termine S.P.A për shumën prej 53.200.000.000 lireta.

Kushtet e huasë:

1. Kthimi në 22 kështe 6 mujore të barabarta dhe të njëpasnjëshëm ku afati i pagimit të këstit të parë mbaron 294 muaj pas datës së hyrjes në fuqi të kësaj Konvente Financiare.
2. Përqindja e interesit 0.5 % interes nominal vjetor i cili do të paguhet në fund të 6 mujorit i cili fillon nga data e cdo përdorimi
3. Destinacioni : Realizimi i një projekti rehabilitimi i rrjetit uhor të Tiranës dhe asistencë teknike në administrimin e ndërrmarjes së ujrave për përmirësimin e administrimit financiar dhe investimet që lidhen me këtë fushë.
4. Valuta e lëvrimit të kredisë: Kredia do të lëvrohet në lireta italiane me kursin e këmbimit të Bankës Italiane.

**Projekti COMM'98-Konventa Financiare 22 Mld Lit-F.ROT/AID/98/001/00**

E lidhur më datën 25.08.1998 midis Bankës Kombëtare Tregëtare dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjetllësve për shumën 974.042.799 lireta Italiane dhe ka për objekt përdorimin e huasë për elektropompa dhe materiale për ndërrmarjet e ujësjetllësve. Afati i kthimit të huasë është 18 vjet nga data e bërjes efektive të huasë.

Kushtet e huasë:

1. Norma vjetore e interesit prej 1% , do të jetë e pagueshme 2 herë në vit me këste 6 mujore të llogaritur mbi tepricën e kredisë.
2. Shlyerja e principalit të huasë do të filloj pas 150 muajve të bërjes efektive të huasë ,principal ky i pagueshëm 2 herë në vit me këste 6 mujore.
3. Huamarrësi do ti paguajë huadhënësit një komision prej 0.75% të huasë së përdorur ,i pagueshëm në momentin e përdorimit të huasë.
4. Të gjitha detyrimet e huamarrësit do të paguhet në monedhën në të cilën është dhënë huaja ,ose në lekë e konvertuar me kursin e ditës në të cilën do të bëhet shlyerja.

**Kredia nga BKT për shfrytëzimin e burimeve të Shën Mërisë**

E lidhur më datën 31.07.2015 mes palëve: Banka Kombëtare Tregtare Sh.a dhe Ujësjetllës Kanalizim Tiranë Sh.a për shumën 1.000.000.000 lekë e cila do të përdoret për rikonceptimin e skemës së shfrytëzimit të burimeve të Shën Mërisë

Dorëzues: Shoqëria "HEC LANABREGAS"

Kushtet e huasë:

1. Si kusht paraprakë kredimarrësi ka rënë dakord të paguajë shumën e kredisë dhe interesin mbi të.Disbursimi do të bëhet në cdo rast ,vetëm pas paraqitjes së kopjes së faturës dhe të situacionit të punimeve të kryera.
2. Kredimarrësi do të hap një ose më shumë llogari pranë Bankës Kombëtare Tregëtare , në të cilën banka do të bëjë disbursimin e shumave përkatëse të kredisë dhe nëpërmjet së cilës do të bëhet ripagimi i tyre.
3. Kredimarrësi do të paguajë një komision angazhimi prej 0.4% ,mbi vlerën totale të kredisëe e pagueshme para ditës së disbursimit. Në rast se rezultojnë pjesë të papërdorura të kredisë pas një muaji një komision prej 2% ,mbi bazë vjetore ,e përlllogaritur mbi masën e papërdorur të kredisë deri në përfundim të kësaj periudhe.
4. Në rast të mospagimit të komisioneve dhe interesit, Banka ka të drejtë të aplikoj një penalitet prej 4% në muaj, mbi shumën e papaguar të komisionit dhe interesit.

5. Në rast se kredimarrësi është në pamundësi për të ripaguar në kohë këstin e maturuar, Banka përveç normës së interesit normal ka të drejtë të aplikoj penalitet në masën 4% në muaj, i llogaritur mbi detyrimin e këstit të rradhës së papaguar.
6. Gjendja e fundit financiare e kredimarrësit tregon që raporti: Detyrime/Kapitale të veta është më i madh se 2:1.

#### Kredia për blerjen e HEC Lanabregas nga BKT

E lidhur më datën 30.05.2012 midis palëve Banka Kombëtare Tregëtare dhe Ujësjetllës Kanalizime Sh.a për shumën prej 2.130.000.000 me anë të së cilës do të financojë blerjen e "HEC LANABREGAS".

Kushtet e Huasë:

1. Kredimarrësi do të hapë një ose më shumë llogari pranë Bankës Kombëtare Tregëtare në të cilën banka do të bëjë disbursimin e shumave përkatëse të kredisë dhe nëpërmjet së cilës do të bëhet ripagimi i tyre.
2. Kredimarrësi garanton që kredia do të përdoret për qëllimin e marrjes së huasë, në të kundërt banka ka të drejtë të kerkojë menjëherë rikthimin e kredisë dhe interesave të akumuluar, ose mund të aplikojë 1% penalitetin mbi shumën fillestare të kredisë.

#### 14. Hua afatshkurtra

Balanca e huave afatshkurtra të Grupit më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 paraqitet si më poshte:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Hua - pjesa afatshkurtet e detyrimit afatgjate	140,195	142,320
Hua - keste te papaguara	-	-
Hua-keste te paguar Ministria	1,174,067	1,031,747
Hua -pjesa e papaguar e interesit	31,010	31,010
Huaja -interesa te perlllogaritur	9,039	10,442
Huamarje afat shkurter Shen Meri	6,017	-
Hua afatshkuarter HEC	193,278	193,278
<b>Totali</b>	<u><u>1,553,605</u></u>	<u><u>1,408,797</u></u>

#### 15. Grante, të ardhura të shtyra e të tjera detyrime

Balanca e granteve, të ardhurave të shtyra e të tjera detyrime të Grupit më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 paraqitet si më poshte:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Grante afatgjatë	492,212	507,434
Grante afatgjatë Kanalizim	1,890	1,949
Grante dhurata paisje informatike	374	-
Kalim ne te ardhura nga Granti	(14,825)	(15,281)
<b>Totali</b>	<u><u>479,651</u></u>	<u><u>494,102</u></u>

**16. Llogari të pagueshme tregtare**

Balanca e llogarive te pagueshme tregtare të Grupit më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 paraqitet si më poshte:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Investime afatgjata	554,950	479,609
Sherbime dhe mallra	964,475	1,416,707
Fatura te pamberrtitura	24,883	61,605
Furnitore garanzi punimesh	168,309	121,655
Debitore/kreditore te tjere	470	4,496
Detyrime te perlogaritura Bashkia Tirane	659,045	515,479
Takse pastrimi Bashkia Tirane	265,185	-
Takse ndertese Bashkia Tirane	37,811	-
Takse e ndikimit ne infrastrukture	40,560	-
Taks pastrimi Komuna Paskuqan	1,894	-
<b>Totali</b>	<b><u>2,717,582</u></b>	<b><u>2,599,551</u></b>

**17. Detyrime ndaj personelit**

Balanca e detyrimeve ndaj personelit të Grupit më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 paraqitet si më poshte:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Per rrogat dhe te tjera	52,401	86,594
Per sigurimet shoqerore dhe shendetesore	544	-
<b>Totali</b>	<b><u>52,945</u></b>	<b><u>86,594</u></b>

**18. Detyrime tatimore/ Detyrime ndaj Shtetit dhe ISSH**

Balanca e detyrime tatimore/ detyrime ndaj shtetit dhe ISSH të Grupit më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 paraqitet si më poshte:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Sigurimet shoqerore e shendetesore	15,627	14,810
Tatim mbi të ardhurat personale	4,019	14,271
TVSH	1,665	56,284
Të tjera tatim taksa	2,331	6,524
Tatim fitimi korrent	17,829	92,031
Tatim fitimi i mbartur	-	5,930
<b>Totali</b>	<b><u>41,471</u></b>	<b><u>189,850</u></b>

**19. Të tjera të pagueshme**

Balanca e te tjera llogari te pagueshme të Grupit më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 paraqitet si më poshte:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Kreditorë të tjerë, Këshilli Mbikqyres	108	264
Kreditorë të tjerë, qeradhënësi	11	-
<b>Totali</b>	<b><u>119</u></b>	<b><u>264</u></b>

**20. Provizione**

Balanca e provizioneve të Grupit më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 paraqitet si më poshte:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Provizione per ceshtje gjyqesore	144,364	-
<b>Totali</b>	<b><u>144,364</u></b>	<b><u>-</u></b>

**21. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit**

Balanca e të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit të Grupit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 paraqitet si më poshte:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Te ardhura nga konsumatore familjare	1,348,663	1,398,302
Te ardhura nga subjekte private	579,339	519,508
Te ardhura nga institucione buxhetore	323,953	328,027
Te ardhura nga institucione jo-buxhetore	62,655	61,793
Te ardhura shitja uji HEC + KESH	269,774	166,338
Te ardhura shitje uji me shumice	38,391	-
Te ardhura nga tarifa fikse e sherbimit	265,553	237,256
Te ardhura nga kliente te vecante	57,948	-
Te ardhura shitje uje me bote dhe shitje uji	7,113	-
Te ardhura nga pikelihdjet	10,602	11,845
Te ardhura vendosje matesash	18,753	31,416
Te ardhura azhornime rrjeti	1,423	638
Te ardhura te tjera	44,973	43,234
Te ardhura nga prodhimi i aktiveve	56,325	-
Te ardhura nga tarifa e pastrimit	23,380	-
<b>Totali</b>	<b><u>3,108,845</u></b>	<b><u>2,798,357</u></b>

**22. Të ardhura të tjera**

Balanca e të ardhura te tjera të Grupit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 paraqitet si më poshte:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Të ardhura nga kamatvonesa, gjoba e penalitete	59,109	54,202
Të ardhura nga provizionet, te tjera	-	73,677
Të ardhura nga grantet afat gjate	14,825	15,282
Te ardhura nga pjesemarrja	25,692	-
Te tjera te ardhura nga inventaret	105	-
<b>Totali</b>	<b><u>99,731</u></b>	<b><u>143,161</u></b>



## 23. Shpenzimet e prodhimit

Balanca e shpenzimeve te prodhimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
<b>Shpenzime pergjithshme per Aktivitete -Cmimi i Rregulluar nga ERRU</b>		
Shpenzime materiale te para - mirembajtje rrjeti	124,527	70,225
Shpenzime materiale – kimikate	58,858	71,673
Shpenzime te tjera - karbon	28,605	46,263
Shpenzime kancelerie	15,411	13,045
Shpenzime materiale te tjera - mirembajtje	42,955	3,642
Shpenzime sherbimesh dhe materiale mirembajtje rrjeti - asflatim etj	18,573	6,828
Shpenzime energjie elektrike -prodhimi	326,641	368,243
Shpenzime per uje dhe energji HEC	-	55,016
Shpenzime per puntori HEC	-	15,344
<b>Shpenzime pergjithshme per Aktivitete -Te Parregulluar nga ERRU</b>		
Shpenzime materiale - matesat	31,718	43,312
Shpenzime karburanti	46,769	50,340
Shpenzime materiale- mirembajtje, makineri e pajisje	8,176	23,541
Shpenzime te pergjithshme	6,783	95,085
Shpenzime sherbimesh -mirembajtje e pergjithshme	27,129	34,016
Shpenzime energjie elektrike	428	1,064
Qera	21,014	18,211
Lende e pare e materiale konsumushme Hec	22,844	8,306
<b>Totali</b>	<b><u>780,430</u></b>	<b><u>924,153</u></b>

## 24. Shpenzimet e pergjithshme dhe administrative

Balanca e shpenzimeve te pergjitheshme dhe administrative për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Taksa tatime te ngjashme dhe tarifa te tjera	2,306	7,724
Sherbime Keshill Mbikqyres dhe te nagjshme	3,539	1,325
Shpenzime auditimi	2,460	3,820
Marketing dhe te ngjashme	23,649	1,946
Transferta, udhetime	6,426	723
Shpenzime te kontraktuara me te trete	162,763	1,993
Shpenzime administrative pergjithshme	2,299	33,100
Penalitete, gjoba	17,424	86,395
Komisione sherbime bankare	4,713	2,260
Shpenzime telefonike ,postare ,internet	2,229	-
Te tjera	2,273	-
<b>Total</b>	<b><u>230,081</u></b>	<b><u>139,286</u></b>

Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sh.a  
 Shënime mbi pasqyrat financiare të konsoliduara më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016  
 (Vlerat janë në mijë Lek)

25. Shpenzime personeli

Balanca e shpenzimeve te personelit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Pagat	610,742	607,425
Shpenzimet e sigurimeve shoqerore	111,200	113,189
Kompensim ushqimor	61,125	67,737
Shperblime dhe te ngjashme	22,462	80,746
<b>Totali</b>	<u><u>805,529</u></u>	<u><u>869,097</u></u>

26. Te Ardhurat dhe Shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Të ardhura të tjera financiare	1,259	275
<b>Totali</b>	<u><u>1,259</u></u>	<u><u>275</u></u>

Shpenzimet financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Shpenzime interesa -Kredite22 MLD FROT/AID-95/007/00	8,784	10,818
Shpenzime interesa -kredia 13 mld F.ROT/AID-94/006/00	4,545	11,563
Shpenzime interesa -Kredia 53.2 F.ROT/AID-99/004/00	11,464	5,241
Shpenzime interesa -Kredi 6.8 F.ROT/AID-99/010/00	2,111	2,260
Shpenzime për interesa -HEC	50,368	80,824
Shpenzime për interesa -Administrata overdrafti	-	3,956
Shpenzime interesa-Kredia comm 98 22mld FROT/AID-98/001/00	846	214
Shpenzime interesi per rikoncep. e burimeve te Shen Merise	10,305	-
<b>Totali</b>	<u><u>88,423</u></u>	<u><u>114,876</u></u>

27. Fitim (humbje) nga kembimit valutore

Fitim (humbje) nga kembimit valutore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Fitim nga këmbimet valutore	61,063	88,180
<b>Total</b>	<u><u>61,063</u></u>	<u><u>88,180</u></u>

28. Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin

Shpenzimet për tatimin mbi fitimin për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Fitimi kontabel	765,649	626,102
<b>E Ardhura e patatueshme (B)</b>	83,628	-
Zhvlerësime tej normave fiskale	12,815	13,422
Gjoha, penalitete e te ngjashme	17,650	86,608
Provizjone per risqe e Shpenzime	140,417	-
Shpenzime te cilat jane me dokumenta jo te rregullt	69	-
Shpenzime te panjohura (C)	170,952	100,030
Diferenca e panjohur per efekte tatim fitimi (C-B)	87,324	100,030
Fitimi (humbja) e tatueshme	852,973	726,132
<b>Norma e tatim fitimit</b>	<b>15%</b>	<b>15%</b>
<b>Shpenzimi (perfitimi) tatimor</b>	<b>127,946</b>	<b>108,920</b>
Te ardhura tatimore te shtyra	1,922	15,863
<b>Shpenzimi (perfitimi) tatimor</b>	<b><u>126,024</u></b>	<b><u>93,057</u></b>

29. Manaxhimi i riskut financiar

Detyrimet financiare kryesore të Shoqërisë përbëhen nga llogaritë e pagueshme dhe të tjera detyrime. Qëllimi kryesor i këtyre detyrimeve financiare është të financojnë operacionet e Shoqërisë dhe të sigurojnë garanci për mbështetjen e operacioneve. Shoqëria ka hua dhe llogari të arkëtueshme, mjete monetare dhe depozita afatshkurtra që sigurohen drejtpërdrejtë nga operacionet e saj. Shoqëria është e ekspozuar ndaj riskut të tregut, riskut të kreditit dhe riskut të likuiditetit.

Manaxhimi i lartë i Shoqërisë mbikqyr manaxhimin e këtyre risqeve.

**Risku i tregut**

Risku i tregut është risku që vlera e drejtë e flukseve monetare të ardhshme të një instrumenti financiar do të variojë për shkak të ndryshimeve në çmimet e tregut. Çmimet e tregut përfshijnë katër lloje risqesh: risku i normës së interesit, risku i kursit të këmbimit, risku i çmimit të mallrave dhe risqe të tjera të çmimeve, të tilla si risku i çmimit të kapitalit. Instrumentat financiar të prekur nga risku i tregut përfshijnë huatë, kreditë dhe depozitat.

**Risku i normave te interesit**

Risku i normës së interesit përbëhet nga risku që vlera e flukseve monetare të ardhshme të një instrumenti financiar do të variojë për shkak të ndryshimeve në normat e interesit në treg dhe riskut që maturitetet e aktiveve që mbartin interes të ndryshojnë nga maturitetet e detyrimeve që mbartin interes të përdorura për të financuar ato aktive. Zgjatja kohore përgjatë të cilës norma e interesit e një instrumenti financiar është fikse, përcakton se në çfarë mase është e ekspozuar ndaj riskut të normës së interesit.

(Vlerat janë në mijë Lek)

2016	Nuk mbartin interes	Totali	Mbartin interes
<b>Aktivët financiarë</b>			
Mjetet Monetare dhe te Ngjashme	290,959	290,959	-
Llogarite e arketueshme	2,905,019	2,905,019	-
<b>Totali aktive financiare</b>	<b>3,195,978</b>	<b>3,195,978</b>	<b>-</b>
Llogarite e pagueshem dhe detyrime te perllogaritura	2,717,583	2,717,583	-
Detyrime ndaj personelit	43,852	43,852	-
Detyrime ndaj Shtetit dhe ISSH	41,471	41,471	-
Huamarrje afatshkurter	-	1,553,605	1,553,605
Huamarrje afatgjata	-	5,436,854	5,436,854
<b>Grante</b>	<b>479,652</b>	<b>479,652</b>	<b>-</b>
<b>Totali detyrime financiare</b>	<b>3,282,557</b>	<b>10,273,016</b>	<b>6,990,459</b>
<b>Hendeku i normës së interesit</b>	<b>(86,579)</b>	<b>(7,077,038)</b>	<b>(6,990,459)</b>
2015	Nuk mbartin interes	Totali	Mbartin interes
<b>Aktivët financiarë</b>			
Mjetet monetare dhe te ngjashme	396,917	345,322	-
Llogarite e arketueshme	2,716,829	2,661,809	-
<b>Totali aktive financiare</b>	<b>3,007,131</b>	<b>3,007,131</b>	<b>-</b>
Llogarite e pagueshem dhe detyrime te perllogaritura	2,599,551	2,548,858	-
Detyrime ndaj personelit	77,897	75,937	-
Detyrime ndaj shtetit dhe ISSH	189,850	174,962	-
Huamarrje afatshkurter	-	1,409,061	1,408,796
Huamarrje afatgjata	-	5,188,890	5,188,890
<b>Grante</b>	<b>494,102</b>	<b>494,102</b>	<b>-</b>
<b>Totali detyrime financiare</b>	<b>3,293,859</b>	<b>9,891,545</b>	<b>6,597,686</b>
<b>Hendeku i normës së interesit</b>	<b>(286,728)</b>	<b>(6,884,414)</b>	<b>(6,597,686)</b>

(Vlerat janë në mijë Lek)

#### Risku i kreditit

Risku i kreditit është risku që një palë tjetër nuk do të jetë në gjendje të paguajë detyrimet e saj që rrjedhin nga një instrument financiar ose marrëveshje klienti, duke çuar kështu në një humbje financiare. Shoqëria është e ekspozuar ndaj riskut të kreditit për shkak të aktiviteteve operacionale të saj (pikë së pari prej llogarive të arkëtueshme) dhe prej aktiviteteve të saj financuese, që përfshijnë depozitat me bankat dhe institucionet financiare, transaksionet në monedha të huaja dhe instrumenta të tjerë financiare.

Risku i kreditit është i kufizuar në vlerën kontabël të aktiveve financiare në datën e raportimit.

Provizionet për kërkesat tregtare të vonuara njihen duke u bazuar në vlerësimet e shumave të parikuperueshme në bazë të eksperiencës së mëparshme në mosarëtim nga klientët dhe një analize të pozicionit financiar të palës tjetër. Shoqëria vlerëson rrezikun e cilësisë së kreditit të klientit dhe vlerëson limitet e kreditit sipas klientëve.

Llogaritë e arkëtueshme të mësipërme përfshijnë 285.199.112 Lek llogari të arkëtueshme që janë të vonuara me shumë se 360 ditë në fund të vitit për të cilat nuk është njohur ndonjë zhvlerësim. Nuk ka pasur ndryshime në vlerësimin e cilësisë së kreditit për këta klientë dhe nuk ka përqendrim të gjendjes së tyre financiar. Si rrjedhim, shoqëria beson se nuk është i nevojshëm ndonjë shtesë tjetër për provizion për zhvlerësim në lidhje me kërkesat tregtare për arkëtim të cilat janë të vonuara.

#### Risku i Likuiditetit

Risku i likuiditetit është risku që Shoqëria mund të mos jetë në gjendje të paguajë detyrimet e saj të lidhura me detyrimet financiare në momentin e pagesës. Risku i likuiditetit është risk i qenësishëm në biznesin e Shoqërisë pasi disa aktive specifike të blera apo detyrime të shitura mund të kenë karakteristika likuiditeti që janë specifike. Nëse Shoqërisë do ti duhet të ketë shuma të mëdha në një afat të shkurtër kohor që tejkalon kërkesat normale për mjete monetare mundet që të ndeshet me vështirësi për të siguruar çmime konkurruese. Shoqëria monitoron riskun e likuiditetit duke monitoruar në mënyrë të vazhdueshme parashikimet dhe flukset monetare aktuale dhe duke u munduar të përputhë profilet e maturitetit të aktiveve dhe detyrime.

Ujësjetillës Kanalizime Tiranë sh.a

Shtëmime mbi pasqyrrat financiare të konsoliduara më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(Vlerat janë në mijë Lek)

2016	0 - 12 muaj	2 - 5 vjet	Më tepër se 5 vjet	Totali
<b>Aktive financiare</b>				
Mjetet monetare dhe te ngjashme	290,959	-	-	290,959
Llogarite e arketueshme	2,905,019	-	-	2,905,019
<b>Aktive financiare gjithsej</b>	<b>3,195,978</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>3,195,978</b>
<b>Detyrime financiare</b>				
Llogarite e pagueshem dhe detyrime te perllogaritura	2,717,583	-	-	2,717,583
Detyrime ndaj personelit	43,852	-	-	43,852
Detyrime ndaj shtetit dhe ISSH	41,471	-	-	41,471
Provizione	72,182	72,182	-	144,364
Te tjera te pagushme	119	-	-	119
Huamarrje afatshkurter	1,553,605	-	-	1,553,605
Huamarrje afatgjata	-	1,262,516	4,174,338	5,436,854
Grante	-	-	479,652	479,652
<b>Detyrime financiare gjithsej</b>	<b>4,428,811</b>	<b>1,334,698</b>	<b>4,653,990</b>	<b>10,417,380</b>
<b>Hendeku i maturitetit</b>	<b>(1,232,834)</b>	<b>(1,334,698)</b>	<b>(4,653,990)</b>	<b>(7,221,403)</b>

2015	0 - 12 muaj	2 - 5 vjet	Më tepër se 5 vjet	Totali
<b>Aktive financiare</b>				
Mjetet monetare dhe te ngjashme	345,322	-	-	345,322
Llogarite e arketueshme	2,661,809	-	-	2,661,809
<b>Aktive financiare gjithsej</b>	<b>3,007,131</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>3,007,131</b>
<b>Detyrime financiare</b>				
Llogarite e pagueshem dhe detyrime te perllogaritura	2,548,858	-	-	2,548,858
Detyrime ndaj personelit	75,937	-	-	75,937
Detyrime ndaj shtetit dhe ISSH	174,962	-	-	174,962
Huamarrje afatshkurter	1,408,796	-	-	1,408,796
Huamarrje afatgjata	-	1,262,516	3,926,374	5,188,890
Grante	-	-	494,102	494,102
<b>Detyrime financiare gjithsej</b>	<b>4,208,553</b>	<b>1,262,516</b>	<b>4,420,476</b>	<b>9,891,545</b>
<b>Hendeku i maturitetit</b>	<b>(1,201,422)</b>	<b>(1,262,516)</b>	<b>(4,420,476)</b>	<b>(6,884,414)</b>

Ujësjetillës Kanalizime Tiranë sh.a

Shënime mbi pasqyrat financiare të konsoliduara më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(Vlerat janë në mijë Lek)

**Risku i monedhës**

Shoqëria ndërmer transaksione në monedhë të huaj si pasojë e ekspozimit ndaj luhatjeve të kurseve të këmbimit. Ekspozimi ndaj kurseve të këmbimit manaxhohet duke përcaktuar një politikë midis të arketueshme dhe të pagueshme. Vlera kontabël neto e aktiveve dhe detyrimeve monetare të shoqërisë sipas monedhave për vitin që u mbyll janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

2016	LEK	EUR	USD	Total
<i>Aktivitet financiare</i>				
Mjetet Monetare dhe te Ngjashme	290,437	3	519	290,959
Llogarite e arketueshme	-	-	-	-
<b>Totali aktive financiare</b>	<b>290,437</b>	<b>3</b>	<b>519</b>	<b>290,959</b>
<i>Detyrime financiare</i>				
Llogarite e pagueshem dhe detyrime te perlogaritura	2,717,583	-	-	2,717,583
Detyrime ndaj personelit	43,852	-	-	43,852
Detyrime ndaj Shtetit dhe ISSH	41,471	-	-	41,471
Te tjera llogari te pagushme	119	-	-	-
Huamarrje afatshkurter	1,553,605	-	-	1,553,605
Huamarrje afatgjata	-	5,436,854	-	5,436,854
Grante	-	-	-	-
<b>Totali detyrime financiare</b>	<b>4,356,629</b>	<b>5,436,854</b>	<b>-</b>	<b>9,793,364</b>
<b>Pozicioni valutor neto</b>	<b>(4,066,192)</b>	<b>(5,436,850)</b>	<b>519</b>	<b>(9,502,405)</b>
Ndjeshmëria nëse kursi i këmbimit rritet me 5 %		(271,843)		
Ndjeshmëria nëse kursi i këmbimit zvogëlohet me 5 %		271,843		

Ujështellës Kanalizime Tiranë sh.a

Shënime mbi pasqyrat financiare të konsoliduara më dhe për vitin e mbylltur më 31 dhjetor 2016

(Vlerat janë në mijë Lek)

2015	LEK	EUR	USD	Total
<i>Aktivitet financiar</i>				
Mjetet Monetare dhe te Ngjashme	344,810	3	509	345,322
Llogarite e arketueshme	2,661,809	-	-	2,661,809
<b>Totali aktive financiare</b>	<b>3,006,619</b>	<b>3</b>	<b>509</b>	<b>3,007,131</b>
<b>Detyrime financiare</b>				
Llogarite e pagueshem dhe detyrime te perilogaritura	2,548,858	-	-	2,548,858
Detyrime ndaj personelit	75,937	-	-	75,937
Detyrime ndaj Shtetit dhe ISSH	174,962	-	-	174,962
Huamarrje afatshkurter	1,408,796	-	-	1,408,796
Huamarrje afatgjata	-	5,188,890	-	5,188,890
Grante	494,102	-	-	494,102
<b>Totali detyrime financiare</b>	<b>4,702,655</b>	<b>5,188,890</b>	<b>-</b>	<b>9,891,545</b>
<b>Pozicioni valutor neto</b>	<b>(1,696,036)</b>	<b>(5,188,887)</b>	<b>509</b>	<b>(6,884,414)</b>

Ndjeshmëria nëse kursi i këmbimit rritet me 5 %

(259,444)

Ndjeshmëria nëse kursi i këmbimit këmbimit zvogëlohet me 5 %

259,444



*Analiza e ndjeshmërisë së monedhës së huaj*

Analiza e ndjeshmërisë përfshin vetëm zërat monetare të shprehura në monedhë të huaj në fund të vitit. dhe një korigjim i vlerave të tyre i bërë për një 10% ndryshim në kurset e këmbimit. Vlera pozitive/negative tregojnë rritje/ulje në fitim ose në kapital që ndodh kur leku dobësohet/forcohet në vlerën e tij kundrejt monedhave të huaja me +/- 10%.

**30. Vlera e drejtë e instrumentave financiare**

Instrumentat financiare përfshijnë aktivet dhe detyrimet financiare.

Aktivët financiarë përbëhen nga gjendja e llogarive në bankë dhe të arkëtueshmet. Detyrimet financiare përbëhen nga të pagueshmet.

Vlera e drejtë e aktiveve dhe detyrimeve financiare përfshihet në shumën në të cilën instrumenti mund të shkëmbëhet në një transaksion mes palëve të gatshme, dhe jo të detyrueshme të në një proces likuidimi ose shitje. Vlerat e drejta të të gjitha aktiveve financiare të shoqërisë përafrojnë vlerat e tyre kontabël kryesisht për shkak të maturimit afatshkurtër të këtyre instrumentave.

**31. Burimet kryesore në vlerësimin e pasigurisë**

*Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme*

Një vlerësim i shumës së mbledhshme të llogarive të arkëtueshme tregtare kryhet kur arkëtimi i shumës së plotë nuk është më e mundur. Për shumat individuale të rëndësishme, ky vlerësim është kryer në baza individuale. Shumat të cilat nuk janë të rëndësishme individualisht, por që janë të vonuara, vlerësohen në mënyrë specifik dhe aplikohet një provizion në përputhje me gjatësinë e kohës së vonuar, bazuar në normat historike të rikuperimit.

**32. Angazhime dhe pasiguri**

*Çështje gjyqësore*

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Më 31 dhjetor 2016 Shoqëria ka çështje gjyqësore të hapur kundrejt saj por që nuk mund të kerkojë rregullime të këtyre pasqyrave financiare.

*Detyrimet tatimore*

Librat e Shoqërisë nuk janë audituar nga organet tatimore për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2016. Si rrjedhojë detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen përfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një auditim i organeve tatimore nuk mund të maten në menyrë të besueshme.

**33. Ngjarje pas datës së raportimit financiar**

Nuk ka ngjarje të rëndësishme pas datës së raportimit të cilat do të kërkonin korigjim ose shënime në pasqyrat financiare.

---

**PROJEKTMARRËVESHJE NDARJE**

---

**DATE \_\_\_\_\_ SHKURT 2017**

**ndërmjet**

Shoqërisë Ujësjetlësi-Kanalizime Tiranë sh.a. (“UKT” sh.a.)

*si* Shoqëri që ndahet

në

Shoqërinë Ujësjetlësi-Kanalizime Bashkia Tiranë sh.a. (“UKBT sh.a.”)

dhe

Shoqëria Ujësjetlësi-Kanalizime Bashkia Kamëz sh.a. (“UKBK sh.a.”)

dhe

Shoqëria Ujësjetlësi-Kanalizime Bashkia Vorë sh.a. (“UKBV sh.a.”)

*si* Shoqëri Pritëse

## **DEKLARATA PARAPRAKE :**

1. Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Tiranë sh.a. ( këtej e tutje shoqëria “UKT” sha), një shoqëri aksionare me kapital shtetëror, e krijuar me vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. 2475, datë 28.12.2000, bazuar në vendimin e aksionerit të vetëm Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit për krijimin e Ndërmarrjes Ujësjellës Kanalizime Qytet sh.a. me kapital aksioner prej 2,008,900,000 lekë, aksione 2,008,9000 me vlerë nominale 1000 lekë/për aksion , tërësisht i paguar më kontribute në natyrë.

2. Me vendim nr.228, datë 4.6.2003 aksioneri i vetëm Ministria e Ekonomisë, vendosi bashkimin me përthithje të Ndërmarrjes Ujësjellës Kanalizime Qytet me Ndërmarrjen e Ujësjellësit Kanalizime Fshat regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendim nr. 24875/2, datë 17.7.2003. Pas bashkimit, kapitali i shoqërisë u bë 2,561,571,000 lek, dhe numri i aksioneve 2,561,571 me vlerë nominale 1,000 lekë për aksion.

3. Me 24 janar 2007, aksionet që mbaheshin nga aksioneri i vetëm Ministria e Ekonomisë të shoqëria Ujësjellës Kanalizime Tiranë sh.a. u transferuan në pronësi të njësive vendore të zonës së shërbimit, e cila përbëhet nga 3 bashki dhe 16 komuna.

4. Me hyrjen ne fuqi të ligjit nr.115/2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë” aksionet e shoqërisë “UKT” sh.a., u rikonfiguruan sipas ndarjes së re administrativo-territoriale, duke u shpërndarë si më poshtë:

- Bashkia Tiranë: 2.099.108,00 aksione ose 82,50 % të totalit të aksioneve;
- Bashkia Kamëz: 371.486,00 aksione ose 14,60 % të totalit të aksioneve;
- Bashkia Vorë: 73.804,00 aksione ose 2,90% të totalit të aksioneve;

5. Në zbatim të vendimit nr. 63, datë 27.1.2016 të Këshillit të Ministrave “Për riorganizimin e operatoreve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”, Asambleja e Aksionarëve të shoqërisë “UKT” sh.a. me vendim nr. 9, datë 04.04.2016, vendosi:

1. Vendimmarrja për ndarjen e aksionarëve Bashkia Kamëz dhe Bashkia Vorë nga shoqëria Ujësjellës Kanalizime Tiranë sha, të paraprihet nga një Raport i Ekspertëve Kontabël dhe Vlerësues, që do të njohë aksionarët dhe këshillat bashkiakë përkatës, me mënyrën e riorganizimit të shoqërisë pas ndarjes, efektet në kapital dhe ndarjen e aseteve;

2. Ngritjen e një grupi pune në nivel ekspertësh, me përfaqësues nga tre Bashkitë Aksionare dhe shoqëria Ujësjellës Kanalizime Tiranë sh.a, për të mbikqyrur dhe asistuar të gjithë procesin e ndarjes.

3. Ngarkohet Drejtori i Përgjithshëm i Ujësjellës Kanalizime Tiranë Sh.a, të propozojë në mbledhjen e radhës emrat e ekspertëve dhe për zbatimin e këtij vendimi.

6. Në përputhje me parashikimet e neneve 216 -225 dhe 227 te ligjit nr. 9901/2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, dhe bazuar në raportin e ekspertëve të pavarur të zgjedhur sipas procedurave konkurruese është hartuar kjo projekt marrëveshje ndarje, e cila duhet t'i paraqitet për miratim Asamblesë se Aksionareve te shoqërisë “UKT” sha .

## **PALËT BIEN DAKORT MBI SA MË POSHTË:**

### **PËRKUFIZIME**

Në këtë Projekt Marrëveshje (duke përfshire shtojcat bashkëlidhur), përveç rasteve kur kërkohet ndryshe nga konteksti ose përcaktohet ndryshe në vazhdim, fjalët e renditura me poshtë kanë këto kuptime:

- “Projektmarrëveshja” do të thotë kjo Projektmarrëveshje Ndarje - duke përfshire si pjese integrale të saj deklaratat paraprake, raportin shpjegues dhe shtojcat bashkëlidhur kësaj projektmarrëveshje;
- “Ligji Tregtar” do të thotë Ligji nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar;
- Aset do të thotë objektet, burimet dhe rrjeti i ujësjellësit dhe kanalizimit (sistemit të furnizimit) të regjistruar ose jo në emër dhe për llogarë të shoqërisë “UKT” sh.a. ose që janë në administrim të saj;
- “KKRRU” do të thotë organi vendimmarrësi ERRU-s, i përbërë nga pesë anëtarë të emëruar sipas procedurave të parashikuara nga ligji nr. 8102, datë 28.03.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura” , të ndryshuar;
- “Licencë” do të thotë leja profesionale që i jepet një personi fizik apo juridik në përputhje me ligjin nr. 8102, datë 28.03.1996, të ndryshuar si dhe VKM nr. 958, datë 06.05.2009 për ushtrimin e aktivitetit në sektorin e furnizimit me ujë, largimit të ujërave të ndotura dhe përpunimit të tyre.
- “Kodi i Punës” do të thotë Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;

## **1.NDARJA**

### **1.1 Shoqëria që do të ndahet**

Shoqëria “UKT” sh.a. është një shoqëri shqiptare aksionare e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit me NIPT (NUIS) J62005002O me seli në Rruga “5 Maji”, pranë Medresesë, Tiranë, Shqipëri.

Shoqëria “UKT” sh.a. vepron si njësi shërbimi e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura në zonën e juridiksionit të Bashkisë Tiranë, Vorë dhe Kamëz, të Qarkut Tiranë.

### **1.2 Shoqëritë Pritëse do të krijohen rishtazi si më poshtë:**

- a. Shoqëria Ujësjiellësi-Kanalizime Bashkia Tiranë sh.a.
- b. Shoqëria Ujësjiellësi-Kanalizime Bashkia Kamëz sh.a.
- c. Shoqëria Ujësjiellësi-Kanalizime Bashkia Vorë sh.a.

### **1.3 Gjendja financiare e shoqërisë që do të ndahet:**

Në përputhje me parashikimet e nenit 216 të Ligjit Tregtar, pasqyrat financiare vjetore dhe raportet vjetore të ecurisë të shoqërisë “UKT” sh.a., për vitet financiare 2013, 2014 dhe 2015 i bashkëlidhen kësaj Projekt marrëveshje.

### **1.4 Emërtimi dhe personaliteti juridik i shoqërive pritëse të themeluara rishtazi**

Ne datën e hyrjes në fuqi të ndarjes, si përkufizohet më poshtë, shoqëria “UKT” sh.a., do të ndahet në 3 shoqëri pritëse të themeluara rishtazi Shoqëria Ujësjiellësi-Kanalizime Bashkia Tiranë sh.a.; Shoqëria-Ujësjiellësi Kanalizime Bashkia Kamëz sh.a. dhe Shoqëria Ujësjiellësi-Kanalizime Bashkia Vorë sh.a.;

Shoqëria që ndahet, UKT sh.a. do të kalojë në çregjistrim pa likuidim sipas parashikimeve të nenit 227/c të Ligjit Tregtar.

Ndarja e shoqërisë UKT sh.a. do të prodhojë pasojat e përcaktuara në nenin 227 të Ligjit Tregtar, dhe rrjedhimisht, duke filluar nga dhe pas datës së hyrjes në fuqi të marrëveshjes së ndarjes, shoqëritë pritëse do të zotërojnë të gjitha pasuritë, të drejtat, privilegjet dhe kompetencat dhe do t'i nënshtrohen të njëjtave detyrimeve dhe përgjegjësisë si shoqëria që ndahet. Të gjitha të drejtat dhe detyrimet e shoqërisë që ndahet do të merren përsipër nga shoqëritë pritëse sipas zonës së juridiksionit të bashkive respektive dhe me të njëjtat kushte sikur zbatoheshin ende nga Shoqëria që ndahet.

### **1.5 Kushtet Paraprake të Ndarjes**

a. Në përputhje me parashikimet ligjore të zbatueshme, ndarja e UKT sh.a. sipas kësaj Projekt marrëveshje, i nënshtrohet përmbushjes së kushteve të mëposhtme:

- i. Miratimin e kësaj Projekt Marrëveshjeje nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionareve të Shoqërisë UKT sh.a. që do të ndahet në përputhje me nenin 218 të Ligjit Tregtar;
- ii. Depozitimin e kësaj projekt marrëveshjeje dhe të gjithë dokumenteve shoqëruese pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit në përputhje me nenin 216 e vijues të Ligjit Tregtar;
- iii. Asambleja e Përgjithshme e Aksionareve të shoqërisë UKT sh.a. që ndahet duhet të mbledhet një muaj pas publikimit të kësaj projekt marrëveshjeje në Qendrën Kombëtare të

Regjistrimit në përputhje me nenin 216 paragrafi 3 të Ligjit Tregtar për të vendosur mbi marrëveshjen finale të ndarjes së UKT sh.a.;

iv. Regjistrimi i ndarjes së UKT sh.a. pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit në përputhje me nenet 220, 227 të Ligjit Tregtar.

### **1.6 Data e hyrjes në fuqi e ndarjes**

a.Data e hyrjes në fuqi e ndarjes do të konsiderohet data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit të marrëveshjes së ndarjes në përputhje me parashikimet e neneve 220, 227 të Ligjit Tregtar.

b.Duke filluar nga dhe pas datës së hyrjes në fuqi, në përputhje me parashikimet e nenit 220, 227 të Ligjit Tregtar:

i. Të gjitha asetet dhe detyrimet e shoqërisë që ndahet do t'i transferohen shoqërive pritëse të themeluara rishtazi sipas projektit të ekspertëve, dhe ky transferim do të hyjë në fuqi dhe do të ketë efekte si përkundrejt shoqërive pritëse ashtu edhe përkundrejt të gjitha palëve të treta.

ii. Aksionarët e shoqërisë UKT sh.a. që do të ndahet do të bëhen aksionarë të shoqërive pritëse të themeluara rishtazi sipas pjesëmarrjes së përcaktuar me poshtë në këtë akt.

iii. Shoqëria UKT sh.a. që ndahet do të konsiderohet si e prishur dhe do të çregjistrohet pa likuidim nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit.

### **1.7 Të dhënat tregtare të shoqërive pritëse të themeluara rishtazi**

a. Statutet e Shoqërive pritëse të themeluara rishtazi janë statutet sipas modelit që i bashkëngjitet kësaj projekt marrëveshjeje si Shtojcë;

b. Statutet e shoqërive pritëse të themeluara rishtazi do të hyjnë në fuqi dhe do të kenë efekte në datën e hyrjes në fuqi sipas parashikimeve në pikën 1.6 të kësaj projekt marrëveshjeje.

c. Administratorët e Përgjithshëm të shoqërive pritëse të themeluara rishtazi do të jenë si më poshtë:

Shoqëria Pritëse “UKBT” sh.a. – Z/Znj. \_\_\_\_\_, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë, më datë \_\_\_\_\_, mbajtës i letërnjoftimit me nr. \_\_\_\_\_;

Shoqëria Pritëse “UKBK” sh.a. – Z/Znj. \_\_\_\_\_, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë, më datë \_\_\_\_\_, mbajtës i letërnjoftimit me nr. \_\_\_\_\_;

Shoqëria Pritëse “UKBV” sha. – Z/Znj. \_\_\_\_\_, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë, më datë \_\_\_\_\_, mbajtës i letërnjoftimit me nr. \_\_\_\_\_;

d. Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës të Shoqërive pritëse të themeluara rishtazi, do të jenë personat e mëposhtëm:

Për “UKBT” sh.a -

Për “UKBV” sh.a –

Për “UKBK” sh.a –

## **2.PASOJA TË TJERA TË NDARJES**

### **2.1 Pasojat e ndarjes mbi aksionet e shoqërisë që ndahet**

a. Që nga data e hyrjes në fuqi si pasoje e realizimit të ndarjes dhe pa qenë nevoja për veprime të tjera, aksionet e shoqërisë UKT sh.a. që ndahet do pushojnë së ekzistuari pa kundërpagese.

b. Që nga data e hyrjes në fuqi si pasoje e realizimit të ndarjes dhe pa qenë nevoja për veprime të tjera, aksionet e shoqërisë UKT sh.a. që do të ndahet do të këmbehen automatikisht me aksione të shoqërive pritëse të themeluara rishtazi në të njëjtën vlerë;

c. Që nga data e hyrjes në fuqi, kapitali aksionarë të shoqërive pritëse të themeluara rishtazi do të jenë:

Shoqëria Pritëse “UKBT” sh.a.

Aksioneri	Nr. i aksioneve të zotëruara	% në kapital	Vlera e Aksioneve të zotëruara në lekë
UKBT	18,095,475	100%	18,095,475,000

Shoqëria Pritëse “UKBK” sh.a.

Aksioneri	Nr. i aksioneve të zotëruara	% në kapital	Vlera e Aksioneve të zotëruara në lekë
UKBK	289,024	100%	289,024,000

Shoqëria Pritëse “UKBV” sh.a.

Aksioneri	Nr. i aksioneve të zotëruara	% në kapital	Vlera e Aksioneve të zotëruara në lekë
UKBV	81,041	100%	81,041,000

d. Aksionerët e shoqërisë UKT sh.a. që ndahet pranojnë transferimin e aseteve të saj tek shoqëritë pritëse të themeluara rishtazi në këmbim të aksioneve të shoqërive pritëse të përcaktuara më lart.

e. Te drejtat lidhur me cilësinë e aksionarit të shoqërisë pritëse dhe aksionet e shoqërisë pritëse do të jenë ato që janë përcaktuar në statutet e shoqërive pritëse të themeluara rishtazi dhe që i bashkëlidhen kësaj projekt marrëveshjeje.

f. Aksionaret e shoqërive pritëse të themeluara rishtazi do të kenë të drejta pjesëmarrjeje në fitimet e pashpërndara (nëse ka) të shoqërisë UKT sh.a. që ndahet për periudhat përpara datës së hyrjes në fuqi të projekt marrëveshjes në përputhje me pjesëmarrjen e tyre në kapitalin e UKT sh.a. përpara datës së hyrjes në fuqi.

## **2.2 Pasojat e ndarjes mbi punonjësit e shoqërisë që do të ndahet**

Nuk do të ketë shkurtime të asnjë punonjësi për shkak të ndarjes dhe procesi i ndarjes së UKT sh.a. nuk do të ketë asnjë efekt mbi punonjësit e UKT sh.a. Kontratat e punës me punonjësit do të rihidhen me të njëjtat kushte nga shoqëritë pritëse sipas parashikimeve të Kodit të Punës.

## **2.3 Pasojat e ndarjes mbi kreditorët e shoqërisë që ndahet**

a. Duke filluar nga data e hyrjes në fuqi, të gjitha detyrimet e shoqërisë që ndahet do t'i kalojnë shoqërive pritëse të themeluara rishtazi. Për shkak të ligjit, detyrimet që i përkasin zonës së juridiksionit të Bashkisë Tiranë, do t'i kalojnë shoqërisë Pritëse Ujësjellësi-Kanalizimi Bashkia Tiranë; detyrimet që i përkasin zonës së juridiksionit të Bashkisë Kamëz do t'i kalojnë shoqërisë Pritëse Ujësjellësi-Kanalizimi Bashkia Kamëz sh.a, ndërsa detyrimet që i përkasin zonës së juridiksionit të Bashkisë Vorë do t'i kalojnë shoqërisë Pritëse Ujësjellësi Kanalizimi Bashkia Vorë sh.a.

b. Pa cënuar sa më sipër, shoqëria UKT sh.a. që do të ndahet dhe përfaqësuesit e saj marrin përsipër dhe i garantojnë çdo kreditori eventual që paraqet një pretendim kundrejt shoqërisë UKT sh.a. që do të ndahet, brenda afateve të përcaktuara nga neni 221 i Ligjit Tregtar çdo dhe të gjitha të drejtat e parashikuara në këtë nen. Të gjitha detyrimet kreditore do të kalojnë në datën e hyrjes në fuqi të projekt marrëveshjes në shoqëritë pritëse sipas projektit të ndarjes bashkëngjitur kësaj projekt marrëveshje si Shtojcë.

#### **2.4 Privilegje të caktuara për administratorët, Këshillin Mbikëqyrës ose ekspertët kontabël**

Administratorët dhe Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës si edhe ekspertët kontabël të Shoqërisë UKT sh.a. që do të ndahet nuk do të përftojnë privilegje të veçanta si rrjedhojë e ndarjes.

### **3. DEKLARATA DHE GARANCI**

**a. Kompetencat dhe zbatueshmëria.** Përfaqësuesit e shoqërisë UKT sh.a. që ndahet dhe aksionerët e saj kanë kompetencat dhe autoritetin e duhur për të nënshkruar këtë Projekt marrëveshje. Shoqëritë Pritëse do themelohen dhe ekzistojnë në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë.

**b. Jo-cënueshmëria.** Nënshkrimi dhe lëshimi i çdo dokumenti dhe zbatimi i çdo detyrimi sipas kësaj Projekt marrëveshje nuk do të rezultojë në shkeljen e ndonjë prej (i) parashikimeve të Statuteve të Shoqërive pritëse të themeluara rishtazi ose (ii) urdhri apo vendimi të një gjykate apo autoriteti i cili ka fuqi detyruese për shoqërinë që ndahet.

**c. Miratimet.** Kjo projekt marrëveshje dhe transaksionet që parashikohen në të do të hyjnë në fuqi pas miratimit nga ana e Asamblesë së Aksionareve të Shoqërisë UKT sh.a. që ndahet dhe pas regjistrimit të ndarjes pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit së bashku me dokumentacionin e kërkuar.

### **4.EFEKTET MBI KLIENTËT**

a. Njoftimi i klientëve të shoqërisë UKT sh.a. që ndahet: Kjo marrëveshje do të publikohet në faqen elektronike të shoqërisë. Secili prej klientëve do të njoftohet me shkresë dhe/ose me postë elektronike ose nëpërmjet faqes online të UKT sh.a. për ndarjen. Asnjë prej klientëve nuk do të ketë nevojë të ndryshojë kopjet e kontratave që ka në fuqi me shoqërinë UKT sh.a. që do të ndahet. Shoqëritë pritëse do të konsiderojnë të vlefshme secilën prej këtyre kontratave dhe do të ekzekutojnë gjithë detyrimet që rrjedhin prej tyre sipas kushteve kontraktore.

### **5. TË NDRYSHME**

a. Garanci të tjera. Shoqëria UKT sh.a. që ndahet do të kryejë ato akte dhe do të lëshojë ato dokumente që do të jenë të nevojshme për të plotësuar dhe për të bërë të vlefshme parashikimet e kësaj Projekt marrëveshjeje.

b. Kopjet. Kjo Projekt marrëveshje do të nënshkruhet në 6 kopje dhe secila prej tyre do të konsiderohet një kopje origjinale dhe të gjitha së bashku do të përbejnë një instrument të vetëm.

c. Kjo projekt marrëveshje rregullohet nga legjislacioni i Republikës së Shqipërisë. Asnjëra prej palëve nuk mund të ngrejë pretendime për sa parashikohet nga kjo projekt marrëveshje miratuar nga aksionerët e UKT sh.a. Çdo mosmarrëveshje në lidhje me zbatimin e kësaj



projekt marrëveshjeje do të zgjidhet miqësisht nga palët, në rast të kundërt kompetente për zgjidhjen është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

d. Gjuha. Kjo Projekt Marrëveshje nënshkruhet në gjuhën shqipe.

e. Kushtet paraprake, deklaratimet paraprake dhe shtojcat janë pjesë integrale e kësaj projekt marrëveshjeje dhe kanë të njëjtën fuqi ligjore me të.

Lista e Shtojcave.

Shtojca 1: Listë e aseteve të shoqërisë UKT sh.a.

Shtojca 2 : Licencat dhe të drejta të ngjashme.

Shtojca 3: Listë e marrëveshjeve të shoqërisë UKT sh.a.

Shtojca 4 Listë e çështjeve gjyqësore në proces.

Shtojca 5: Listë e kontratave të punës.

Shtojca 6: Raporti shpjegues i ekspertëve të pavarur për ndarjen e shoqërisë; raporti i ndarjes dhe dokumentacioni përkatës.

Shtojca 7: Pasqyrat Financiare Vjetore dhe Raportet Vjetore për vitet financiare 2013, 2014 dhe 2015.

Shtojca 8: Listë e kreditorëve dhe debitorëve të shoqërisë.

Shtojca 9: Lista e klientëve/abonentëve të shoqërisë.

Shoqëria “UKT” sh.a. që ndahet

Drejtor i Përgjithshëm

Miraturar pa vërejtje

Administratoret e shoqërive pritëse të themeluara rishtazi



Adresa: Rruga 5 Maji, Tiranë, Shqipëri  
Tel: 00 355 42240978  
[info@ukt.al](mailto:info@ukt.al)  
NIPT J620050020

Nr. 12689/7 Prot

datë 16/06/2017

Lënda: Propozim për marrje Vendimi

Drejtuar: Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve të  
Shoqërisë Ujësjetës Kanalizime Tiranë Sh.A.

Të nderuar Zotërinj

Në zbatim të neneve 12 dhe 21 të Statutit të Shoqërisë, Ju paraqesim për miratim projekt vendimin si më poshtë :

### PROJEKT – VENDIM

Nr..... datë ...../..... /2017

Për

**Emërimin e anëtarit të Këshillit Mbikqyrës të UKT sh.a**

Asambleja e Aksionarëve e shoqërisë Ujësjetës Kanalizime Tiranë sh.a në zbatim të Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008, "Për shoqëritë tregtare" të nenit 16 të Statutit të shoqërisë, si dhe me propozim të Bashkisë Tiranë, në mbledhjen e datës 07.07.2017,

### VENDOSI:

- 1.Lirimin e Zj.Itena Ndroqi nga detyra e Zv.Kryetares dhe anëtares së Këshillit Mbikqyrës të UKT sh.a.
- 2.Emërimin e Z.Alban Dokushi në detyrën e anëtarit të Këshillit Mbikqyrës të UKT sh.a.
- 3.Ngarkohet Drejtori i Përgjithshëm i UKT sha me zbatimin e këtij vendimi dhe regjistrimin e tij në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**





Adresa: Rruga 5 Maji, Tiranë, Shqipëri

Tel: 00 355 42240978

info@ukt.al

NIPT J620050020

Nr. 12689/8 Prot

datë 16/106 /2017

Lënda: Propozim për marrje Vendimi

Drejtuar: Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve të Shoqërisë Ujësjetës Kanalizime Tiranë Sh.A.

Të nderuar Zotërinj

Në zbatim të neneve 12 dhe 21 të Statutit të Shoqërisë, Ju paraqesim për miratim projekt vendimin si më poshtë :

### PROJEKT – VENDIM

Nr..... datë ...../..... /2017

Për

#### **Miratimin e pasqyrave financiare të konsoliduara të të ardhurave totale të shoqërisë UKT sh.a për periudhën kontabël që u mbyll më 31.12.2016 dhe Raportit të Ekspertëve Kontabël**

Në mbështetje të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, të Statutit të shoqërisë dhe pas shqyrtimit të pasqyrave financiare të konsoliduara të të ardhurave totale të shoqërisë UKT sh.a për periudhën kontabël që u mbyll më 31.12.2016 dhe të Raportit të Audituesit të Pavarur “Mazars” shpk dhe person fizik Sokol Toska, në mbledhjen e datës 06.07.2017, Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve të Ujësjetës Kanalizime Tiranë sh.a, në mbledhjen e datës 07/07/2017,

#### **VENDOSI:**

- 1.Të miratojë Pasqyrat financiare të konsoliduara të UKT sh.a të vitit 2016 dhe në zbatim të rekomandimeve të lëna të autorizojë Drejtorin e Përgjithshëm të UKT sh.a të miratojë planin e punës 2017-2018, sipas dokumentacionit bashkëlidhur.
- 2.Miratimin e Raportit të Audituesit të Pavarur “Mazars” shpk dhe person fizik Sokol Toska, të emëruar me Vendimin Nr.16, datë 14.12.2016 të Asamblesë së Aksionarëve të UKT sh.a për auditimin e pasqyrave financiare dhe bilancit kontabël të shoqërisë për vitin ushtrimor kontabël 2016.
- 3.Fitimi neto i krijuar nga aktiviteti i shoqërisë UKT sh.a për vitin ushtrimor që u mbyll me datë 31.12.2016, të kalohet në investime për vitin ushtrimor që mbyllet me datë 31.12.2017.
- 4.Ngarkohet Drejtori i Përgjithshëm i Shoqërisë me zbatimin e këtij vendimi dhe depozitimim e tij në QKB dhe organet tatimore.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

**REDI MOLLA**





Nr. 12689/Prot  
9

datë 16/06/2017

Lënda: Propozim për marrje Vendimi

Drejtuar: Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve të  
Shoqërisë Ujësjetellës Kanalizime Tiranë Sh.A.

Të nderuar Zotërinj

Në zbatim të neneve 12 dhe 21 të Statutit të Shoqërisë, Ju paraqesim për miratim projekt vendimin si më poshtë :

### PROJEKT – VENDIM

Nr..... datë ...../..... /2017

Për

**Miratimin e Planit të Biznesit të shoqërisë Ujësjetellës Kanalizime Tiranë sh.a, për vitet 2017-2021**

Në mbështetje të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, të VKM nr.1304, datë 11.12.2009 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e modelit të rregullores "për furnizimin me ujë dhe për kanalizimet në zonën e shërbimit të ujesjetellës-kanalizimeve sh.a.", të Statutit të UKT sh.a, Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve të Ujësjetellës Kanalizime Tiranë sh.a, në mbledhjen e datës 07/07/2017,

### VENDOSI:

1.Miratimin e Planit të Biznesit të shoqërisë Ujësjetellës Kanalizime Tiranë sh.a, për vitet 2017-2021, sipas dokumentit bashkëlidhur.

2.Ngarkohet me zbatimin e këtij vendimi Drejtori i Përgjithshëm i shoqërisë Ujësjetellës Kanalizime Tiranë Sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**DREJTORI PËRGJITHSHËM**  
**REDIMOLLA**



Adresa: Rruga 5 Maji, Tiranë, Shqipëri  
Tel: 00 355 42240978  
info@ukt.al  
NIPT J620050020

Nr. 12689 / Prot  
110

datë 16/06 2017

Lënda: Propozim për marrje Vendimi

Drejtuar: Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve të  
Shoqërisë Ujësjetelës Kanalizime Tiranë Sh.A.

Të nderuar Zotërinj

Në zbatim të neneve 12 dhe 21 të Statutit të Shoqërisë, Ju paraqesim për miratim projekt vendimin si më poshtë :

### PROJEKT – VENDIM

Nr..... datë ...../..... /2017

Për

**Miratimin e projekt marrëveshjes së ndarjes së aksionarëve Bashkia Vorë dhe Bashkia Kamëz nga shoqëria Ujësjetelës Kanalizime Tiranë sh.a**

Në mbështetje të neneve 135, 136, 137, 138, 139, 216-225, 227 të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, neni 25 i Statutit të Shoqërisë, Asambleja e Përgjithshme e Aksionerëve të Ujësjetelës Kanalizime Tiranë sh.a, në mbledhjen e datës 07.07.2017,

### VENDOSI:

- 1.Miratimin e Projekt-Marrëveshjes së Ndarjes së aksionarëve Bashkia Vorë dhe Bashkia Kamëz nga shoqëria Ujësjetelës Kanalizime Tiranë sh.a dhe raportin shpjegues të saj, hartuar nga eksperti kontabël dhe ligjor, bashkëlidhur.
- 2.Miratimin e Planit të veprimit të përgjithshëm për procedurat e ndarjes së shoqërisë aksionare.
- 3.Autorizimin e Drejtorit të Përgjithshëm të shoqërisë Ujësjetelës Kanalizime Tiranë sh.a për ndjekjen e procedurave të ndarjes së shoqërisë UKT sh.a në përputhje me nenet 216-225, 227 të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar dhe planin e veprimit të përgjithshëm.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

REDI MOLLA





Adresa: Rruga 5 Maji, Tiranë, Shqipëri  
Tel: 00 355 42240978  
info@ukt.al  
NIPT J620050020

Nr. 12689 Prot  
11

datë 16/06 /2017

Lënda: Propozim për marrje Vendimi

Drejtuar: Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve të  
Shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Tiranë Sh.A.

Të nderuar Zotërinj

Në zbatim të neneve 12 dhe 21 të Statutit të Shoqërisë, Ju paraqesim për miratim projekt vendimin si më poshtë :

### PROJEKT – VENDIM

Nr..... datë ...../..... /2017

Për

#### Miratimin e tarifave të furnizimit me ujë dhe dhe kanalizimeve për vitin 2017-2019

Asambleja e Aksionarëve e shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sh.a në zbatim të Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008, "Për shoqëritë tregtare", të VKM nr.1304, date 11.12.2009 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e modelit të rregullorës "për furnizimin me ujë dhe për kanalizimet në zonën e shërbimit të ujesjetllës-kanalizimeve sh.a.", në mbështetje të Statutit, Plan Biznesit të Shoqërisë si dhe me kërkesë të Drejtorit të Përgjithshëm të Shoqërisë,

#### VENDOSI:

1.Të konfirmojë dhe miratojë tarifat e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve për vitin 2017-2019, sipas tabelës, bashkëlidhur.

2.Në vijim të këtij miratimi, ngarkohet Drejtori i Përgjithshëm i shoqërisë të ndjekë të gjitha procedurat e parashikuara ligjore për realizimin e seancës dëgjimore me publikun, marrjen e mendimit të Këshillit Bashkiak dhe paraqitjen e aplikimit për miratimin e tarifave pranë ERRU.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

REDI MQELLA



Nr 12689 / Prot  
1

Datë 16 / 06 2017

**Drejtuar : ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME TË AKSIONERËVE TË  
UJËSJELLËS KANALIZIME TIRANË SH.A**

**Lënda : Relacion për Auditimin e Pasqyrave Financiare të Konsoliduara për vitin 2016**

Shoqëria Ujësjiellës Kanalizime Tiranë sha me Vendimin e Asamblesë së Aksionerëve nr. 16, datë 14/12/2016 ka përzgjedhur kompaninë audituese Mazars shpk për të audituar pasqyrat financiare të vitit ushtrimor 2016. Draft raporti u përgatit në muajin Qershor dhe pasi u shqyrtua me UKT-në u dorëzua në datën 16.06.2017.

Në vijim ju paraqesim të dhënat e bilancit sipas zërave :

1. Aktivet në vitin 2016 janë rritur me 6.2 % krahasuar me vitin 2015 duke kapur vlerën 18,231,124 mijë lekë. Ajo që ka ndikuar në këtë rritje vjen kryesisht nga shtimi i llogarive të arkëtueshme në rritje (nga 2,716,829 mijë lekë në 2,905,018 mijë lekë). Gjithashtu janë rritur dhe aktivet afat-gjata materiale (rrjet ujësjiellës kanalizime, rrjet shpërndarës, pajisje informatike) me 8%.
2. Pasivet në vitin 2016 janë rritur me 6.2% krahasuar me vitin 2015 duke kapur vlerën 18,231,124 mijë lekë. Zërat që kanë pësuar ndryshim janë:
  - detyrimet afat-shkurtra (detyrimet ndaj të tretëve për blerje mallrash dhe shërbimesh janë rritur me 4.5% në krahasim me vitin 2015)
  - janë ulur detyrimet ndaj personelit me 39% sepse gjatë vitit 2016 është ulur numri i punonjësve
  - janë ulur detyrimet ndaj shtetit me 78% sepse janë kryer rakordimet me tatimet duke sistemuar balancat.
  - janë rritur detyrimet provizione prej 144,364 mijë lekë për çështje gjyqësore, dëmshpërblim page dhe për pavlevshmëri titulli ekzekutiv që i takojnë vendimit për ristrukturimin e punonjësve të fund vitit 2015.
3. Fitimi neto është rritur me 20% ( nga 533,045 mijë lekë në 639,625 mijë lekë).

Në vijim po paraqesim rezultatet më kryesore të auditimit :

- I.** Emri i mire ka lindur kur UKT sh.a ka përthithur Hec Lanabregas. Ky emër lind kur vlera e paguar është më e madhe se vlera e drejtë e aktiveve neto. Klasifikohet si një aktiv jo-material , i cili në bazë standarteve IFRS nuk amortizohet , por vlera duhet të testohet çdo vit për çvlerësim.

Sipas audituesve UKT sh.a duhej të testonte emrin e mire për zhvlerësim, për të mbështetur masën e rënies në vlerë të regjistruar. Për këtë çështje gjatë vitit 2016 është marë vendim nga Këshilli Mbikqyrës me nr. 20 datë 12.12.2016 ku ka vendosur miratimin e vleresimit me eksperte të jashtëm të Emrit te Mirë , të regjistruar në pasqyrat financiare të UKT sh.a si aset nga blerja e HEC Lanabregas dhe pezullimin e zhvlerësimit deri në kryerjen e vlerësimit.

Në momentin e përthithjes vlera e emrit të mire të HEC-Lanabregas është 717,064 mijë lekë. UKT sh.a në buxhetin e vitit 2017 ka parashikuar në buxhetin e vitit 2017 fond për vlerësimin e aseteve të shoqërisë ku përfshihet dhe vlerësimi i Emrit të Mirë.

**II.** Në zërin aktive afatgjata material vazhdon të jetë e mbartur në zërin aktive në proces vlera prej 1,026,003 mijë lekë (Impjantin e Bovillës dhe Stacionin e Pompimit të Qafë Mollës në bashkëpunim me AKUK) për mungesë dokumentacioni të mjaftueshëm për të dhënë opinion. Nga UKT eshte ngritur grupi i punës i cili po perfundon Fazen I te shqyrtimit te vleres 1 026 003 mijë leke ne bashkepunim me AKUK.

**III.** Në zërin e aktiveve afatgjata materiale “ Toka” vlerësohet prej 2,155,486 mijë lekë bazuar në raport/vlerësimin e datës 27 Mars 2014 të kryer nga vlerësues të jashtëm .

Audituesi është shprehur se raporti i vlerësimit nuk referon dhe nuk qartëson metodën e aplikuar për vlerësimin e aktivit “ toka”.

UKT sh.a do ta mbajë parasysh këtë rregullim kur të kryhet vlerësimi i rradhës i aseteve të shoqërisë dhe kjo është pasqyruar në buxhetin e vitit 2017.

**IV.** Zëri “inventare” ka pësuar rritje nga 378,142 mijë lekë në datën 31 dhjetor 2015 në 472,874 mijë lekë në datën 31 dhjetor 2016. Audituesit nuk ishin në gjendje të krijojnë siguri të arsyshme për vlerën e paraqitur pasi nuk morën pjesë në numërimin e inventarit fizik të realizuar nga shoqëria në mbyllje të vitit ushtrimor .



V. Në lidhje me “Ilogaritë e arkëtueshme “me vlerë 2,905,018 mijë lekë të cilat janë detyrimet e abonentëve kundrejt UKT-së në vite, audituesi është shprehur se kërkohet një vlerësim individual për balancat e arkëtueshme individualisht të rëndësishme dhe vlerësim kolektiv për balancat e tjera bazuar në analizë të plotë mbështetëse mbi të dhënat historike.

Nga vetë specifika e aktivitetit të shoqërisë UKT sh.a nuk kryen analiza individuale për abonentët duke qënë se uji është e drejtë kushtetuese dhe është një detyrim moral që çdo qytetar apo subjekt të furnizohet me ujë. E vetmja politikë diferencuese shprehet në politikat e cmimit që lehtësojnë aftësitë paguese, politika të cilat janë miratuar nga ERRU.

UKT sh.a ka kryer vlerësim kolektiv (kategori ,mënyra e faturimit dhe mosha e borxhit ) mbi bazë historike që nga viti 2008. Ky vlerësim është marrë për bazë në klasifikimin e klasave të riskut.

VI. Në lidhje me zërin “Huamarje afatshkurtra“ me vlerë 1,553,605 mijë lekë të cilat janë detyrimet për huatë ndaj Ministrisë së Financave, UKTsh.a çdo vit vlerëson detyrimet e saj në monedhë të huaj duke përdorur kursin e fundvitit. Sipas audituesve UKT sh.a nuk ka kryer njohjen me vlerën e drejtë në ditën e pare të marjes së huave si dhe nuk ka aplikuar më pas metodën e kostos së amortizuar mbi huatë e marra.

Për më sipër UKT sh.a e konsideron të drejtë këtë konstatim i cili bëhet me ekspertë të jashtëm dhe do rishikohet në vazhdimësi .

VII. Lidhur me grantet qeveritare të cilat janë dhënë ndër vite për vlerën 494,102 mijë lekë audituesi shprehet se nuk ka patur dokumenta justifikues të plotë .

UKTsh.a gjatë vitit 2016 ka patur bashkpunim me Ministrinë e Financave por ka hasur vështirësi pasi grantet e UKT sh.a janë krijuar që nga viti 2002 dhe nuk gjenden pranë Degës Thesarit Tiranë pasi nuk dihet kodi i projektit dhe kodi i Ministrisë së linjës ku ka mundësuar çeljen e vlerës së projektit nëpërmjet Degës së Thesarit .

UKT sh.a do mundohet të sigurojë dokumentacionin e plotë dhe të bëjë konfirmimin zyrtar të balancave dhe kushtëzimet për grantet qeveritare .

Në përfundim për të gjitha çështjet e lëna nga audituesi Mazars shpk i kërkojmë Këshillit Mbikqyrës si më poshtë vijon:

1.Të miratojë Pasqyrat Financiare të Konsoliduara të UKT sh.a të vitit 2016 dhe në zbatim të rekomandimeve të lëna të autorizojë Drejtorin e Përgjithshëm të UKT sh.a të miratojë planin e punës 2017-2018.



Adresa: Rruga 5 Maji, Tiranë, Shqipëri  
Tel: 00 355 42240978  
[info@ukt.al](mailto:info@ukt.al)  
NIPT J620050020

---

2. Fitimi neto i krijuar nga aktiviteti i shoqërisë UKT sh.a për vitin ushtrimor që u mbyll në datën 31.12.2016, të kalohet në investime për vitin ushtrimor që mbyllet më datë 31.12.2017.

Duke ju falenderuar,

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

**REDI MOLLA**



**UJËSJELLËS KANALIZIME TIRANË SH.A.  
DREJTORIA EKONOMIKE**

Nr 12690/3 Prot

Data 16/06/2017

**Drejtuar: KËSHILLIT MBIKQYRËS**

**Lënda: Provizionimi i çështjeve gjyqësore**

Një ndër parimet ekonomike themelore të administrimit të një shoqërie është ai i marrjes së masave paraprake për ngjarje të ndodhura në të kaluarën të cilat parashikohet të kenë efekte ekonomike negative në financat e shoqërisë në të ardhmen .

Ky koncept ka gjetur një rregullim ligjor dhe administrativ nëpërmjet instrumentit të provigjioneve të parashikuar nga pika 37 e Standarteve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të miratuara nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit .

Në bazë dhe për zbatim të këtyre standarteve administrata e shoqërisë ka kryer veprimet e nevojshme administrative për përllogaritjen e sasisë së provigjioneve .

Departamenti ekonomik , bazuar mbi të dhënat e depozituara nga Departamenti i Shërbimeve Mbështetëse ka bërë një përllogaritje për krijimin e provigjioneve të cilat i ka pasqyruar në pasqyrat financiare të vitit ushtrimor 2016 .

Drejtoria Juridike gjatë vitit 2016 ka patur në proces një numër te konsiderueshëm procese gjyqësore në të treja shkallët e gjykimit me kërkesë padi të cilat përgjithësisht kanë për objekt dëshpërblimin e pagës dhe kundërshtimin e veprimeve përmbarimore.

Këto gjyqe parashikohet të kenë efekt financiar për shoqërinë, i cili për shkak të autonomisë vendimarrëse të trupave gjyqësore nuk është e mundur të llogaritet.

Gjithësesi nga ana e Drejtorisë Juridike është bërë një parashikim i përafërt i vlerës së shpenzimeve gjyqësore që parashikohet të kalojnë për tu mbuluar nga shoqëria në zbatim të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, bazuar kjo mbi pritshmëritë e mundshme të vendimeve gjyqësore.


Nisur nga sa më sipër kërkojmë që të provigjionohen për llogari të **Drejtorisë Juridike vlera prej 140.416.916** lekë të ndara 87,186,966 lekë provizione për çështje gjyqësore dëmshpërblim page dhe 53,229,950 lekë provizione për çështje gjyqësore për pavlevshmëri titulli ekzekutiv si vlerë që mund të jetë e nevojshme të përballohet nga shoqëria në përfundim të proceseve gjyqësore të lartpërmendura.

*Tabele përmbledhese për provizionet 2016*

Nr	Përshkrimi	Vlera për provizionim Në lek
1.	Provizione per ceshtje gjyqsore dëmshpërblim page	87,186,966
2.	Provizione per ceshtje gjyqsore për pavlevshmëri titulli ekzekutiv	53,229,950
	<b>Totali</b>	<b>140,416,916</b>

Ju faleminderit ,

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**





Adresa: Rruga 5 Maji, Tiranë, Shqipëri  
Tel: 00 355 42240978  
[info@ukt.al](mailto:info@ukt.al)  
NIPT J620050020

Nr 12689/14 Prot

Datë 16/06 /2017

**Drejtuar: ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË AKSIONERËVE TË UKT sha  
KËSHILLIT MBIKQYRËS TË UKT SH.A**

**Lënda:** Relacion mbi zëvendësimin e anëtarit të Këshillit Mbikqyrës të Shoqërisë Ujësjetillës Kanalizime Tiranë sha

Të nderuar Zotërinj,

Në zbatim të detyrimeve ligjore të përcaktuara në Ligjin Nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” nenet 154-167, 155 pika 2 si dhe në Statutin e shoqërisë nenet 16-19, kërkojmë zëvendësimin e Zj.Itena Ndroqi, si anëtare e Këshillit Mbikqyrës të Shoqërisë Ujësjetillës Kanalizime Tiranë sha, përfaqësuese e Bashkisë Tiranë.

Zj.Ndroqi është emëruar në detyrën e anëtares së Këshillit Mbikqyrës të UKT sha me propozimin e Bashkisë Tiranë dhe miratuar me Vendimin e Asamblesë së Aksionarëve të UKT sha Nr.18, datë 14.09.2015. Meqenëse aktualisht nuk ushtron më funksionet e saj në Bashkinë Tiranë, kërkojmë nga ana Juaj zëvendësimin e saj për të mos krijuar vakancë në përbërjen e Këshillit Mbikqyrës, që ndikon në mirëfunksionimin e këtij organi drejtues si dhe në marrjen e vendimeve e menaxhimin e shoqërisë.

Për këto raste, në nenin 16, pika 16.4 të Statutit të UKT sha, përcaktohet se:

*Neni 16*

***Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës***

***16.1 Shoqëria mbikëqyret nga Këshilli Mbikqyrës i cili përbëhet nga 6 anëtarë.***

***16.2 Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës emërohen në detyrë për një afat jo më të gjatë se 3 (tre) vjet dhe janë të rizgjedhshim.***

***16.3 Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës zgjidhen si më poshtë:***

- a) Aksionari që zotëron më shumë se ½ e aksioneve të shoqërisë, zgjedh 50+1 të anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës.***
- b) Anëtarët e tjerë të Këshillit Mbikqyrës zgjidhen nga aksionarët e tjerë.***
- c) Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës nuk mund të jenë të punësuar në këtë shoqëri***

***16.4 Në rast se vendi i njërit prej anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës mbetet vakant, ai zëvendësohet me vendim të Këshillit Mbikqyrës. Anëtari i Këshillit Mbikqyrës, i emëruar për të zëvendësuar një***



Adresa: Rruga 5 Maji, Tiranë, Shqipëri  
Tel: 00 355 42240978  
[info@ukt.al](mailto:info@ukt.al)  
NIPT J620050020

*anëtar tjetër, do të qëndrojë në detyrë deri në mbledhjen e ardhshme të Asamblesë së Përgjithshme dhe, nëse ai rizgjidhet nga kjo e fundit, qëndrimi i tij në detyrë do të përkojë me qëndrimin në detyrë të anëtarëve të tjerë të Këshillit Mbikqyrës siç përcaktohet në aktin e tyre emërimit.*

Bazuar në këtë akt kërkojmë nga ana Juaj zëvendësimin e Zj.Itena Ndroqi, me një tjetër anëtar, përfaqësues të Bashkisë Tiranë, në mënyrë që të jemi korrekt në zbatimin e nenit 16 të Statutit të UKT sha.

Zëvendësimi i anëtarit të Këshillit Mbikqyrës mund të bëhet nga Këshilli Mbikqyrës dhe të miratohet nga Asambleja e Aksionarëve. Emerimi i anëtarit të ri duhet t'i nënshtrohet rregullave të përcaktuara në nenin 16, pika 16.3, gërma a të Statutit, në bazë të të cilit anëtari i ri që do të zëvendësojë Zj.Ndroqi duhet të propozohet nga Bashkia Tiranë, si aksionari që zotëron më shumë se ½ e aksioneve të shoqërisë.

Për sa relatuar më lart, me qëllim drejtimin e manaxhimit e shoqërisë brenda kuadrit ligjor, i kërkojmë Aksionarit Bashkia Tiranë, të paraqesë në mbledhjen e radhës, emrin e anëtarit të ri të Këshillit Mbikqyrës.

Duke Ju falenderuar për mirëkuptimin.

**DREJTORI I PËRGJITHSHËM**

**REDI MOLLA**





Adresa: Rruga 5 Maji, Tiranë, Shqipëri  
Tel: 00 355 42240978  
[info@ukt.al](mailto:info@ukt.al)  
NIPT J620050020

16.06.17

12 689/5 Prer

**Drejtuar : Asamblesë së Aksionarëve të Shoqërisë së Ujësjetellës Kanalizime Tiranë**

**Këshillit Mbikqyrës të Shoqërisë Ujësjetellës Kanalizime Tiranë**

**Lënda: Relacion për Planin e Biznesit 2017-2021**

Plani i Biznesit 2017-2021 i Shoqërisë Ujësjetellës-Kanalizime Tirane (UKT) është një instrument i rëndësishëm për Këshillin Mbikqyrës dhe drejtuesit e shoqërisë për marrjen e vendimeve racionale dhe të koordinuara në lidhje me nivelin dhe llojet e shërbimeve, ku kapacitetet e kompanisë shfrytëzohen në mënyrë efektive me anë të lidhjeve të qarta me planifikimin financiar. Plani i biznesit është hartuar që të jetë i kuptueshëm dhe i dobishëm jo vetëm për ekipin drejtues të shoqërisë, por edhe për Këshillin Mbikqyrës të saj, donatorët dhe kreditorët dhe një sërë aktorësh të tjerë të interesuar.

Gjithashtu, hartimi i Planit të Biznesit 5-Vjeçar është në përputhje me Rregulloren e Entit Rregullator të Ujit ku saktësohet që çdo shoqëri ujësjetellës kanalizime që kërkon të aplikojë për ndryshim tarifash të shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve duhet të paraqesë pranë këtij Enti së bashku me dokumentet e aplikimit edhe një Plan Biznesi 5-vjeçar të përditësuar.

Në të kaluarën, Shoqëria Ujësjetellës Kanalizime Tiranë nuk ka patur një plan biznesi 5-vjeçar të detajuar dhe të shoqëruar me një Program Veprimi për Përmirësimin e Performancës. Kjo ishte dhe arsyeja që UKT me ndihmën e Bashkisë Tiranë, kërkoi asistencë pranë USAID për të financuar zhvillimin e një Plani Biznesi pesë vjeçar 2017-2021. Në përgjigje të kërkesës së UKT, USAID mundësoi asistencën duke vënë në dispozicion konsulencën e specializuar të Kompanisë Valu Add Management Services.

Në planin e biznesit analizohen në mënyrë shumë të detajuar treguesit aktualë kryesorë të operimit të shoqërisë, duke identifikuar objektivat strategjike që duhet të arrihen në fund të periudhës së planit të biznesit përmes planeve të veprimit për përmirësimin e performancës, investimeve kapitale dhe shpenzimeve që lidhen me këto plane veprimi dhe buxhetin total të shpenzimeve për secilin nga vitet e parashikuara në Planin e Biznesit.

Ky Plan Biznesi është fokusuar kryesisht në këto çështje prioritare të identifikuara si objektiva strategjike:

- Rritja e mbulimit me shërbimin e furnizimit me ujë të popullsisë në Tiranë nga 85% në 95.3% (qyteti i Tiranës 100% dhe komunat 72%) dhe mbulimin me shërbim kanalizimesh nga 78.1% në 83.5%.
- Arritja e shërbimit të pandërprerë, të vazhdueshëm dhe me presion të furnizimit me ujë (24/7) në pjesën më të madhe të zonës së shërbimit të furnizimit me ujë të Tiranës.
- Reduktimi i ujit pa të ardhura nga 66% në 40% deri në vitin 2021. Shoqëria e ka marrë shumë seriozisht këtë çështje, sepse një pjesë e ujit nuk humbet por faktikisht "vidhet" me anë të lidhjeve të paligjshme dhe të paregjistruara në sistem.



Adresa: Rruga 5 Maji, Tiranë, Shqipëri  
Tel: 00 355 42240978  
[info@ukt.al](mailto:info@ukt.al)  
NIPT J620050020

- Rritja e normës së arkëtimit të faturave nga 79.9% në 92%.
- Vazhdimi i përmirësimit të qëndrueshmërisë financiare të Shoqërisë në mënyrë që kontributi total i saj të arrijë nivelin 6.3 miliardë lekë gjatë periudhës së planit të biznesit.

Plani i Biznesit i UKT mbështetet nga një Model Financiar, i krijuar me Microsoft Excel, që i mundëson shoqërisë të regjistrojë dhe llogarisë rezultatet sipas të dhënave dhe supozimeve të regjistruara nga stafi drejtues.

Ky Model Financiar përbëhet nga gjashtë (6) fletë pune kryesore të ndërlidhura me njëra tjetrën dhe janë si më poshtë:

- Të dhënat e stafit, analiza dhe parashikimet
- Analiza e kërkesës për ujë dhe parashikimi i shitjeve të ujit
- Parashikimi i buxhetit të operimit dhe mirëmbajtjes
- Parashikimi i investimeve kapitale dhe i shpenzimeve kapitale
- Nevoja për të ardhurat
- Struktura e tarifave dhe Cmimeve

Treguesit kryesorë të performancës për vitin bazë për UKT dhe objektivat e synuar për t'u arritur në fund të vitit të pestë të planit të biznesit paraqiten në tabelën e mëposhtme:

<b>Treguesi kryesor i performancës</b>	<b>Viti bazë 2016</b>	<b>Synimi 2021</b>
Mbulimi me shërbimin e furnizimit me ujë (% e popullsisë)	85%	95.3%
Mbulimi me shërbimin e kanalizimeve (% e popullsisë)	78.1%	83.5%
Lidhje me matës (% e totalit të lidhjeve)	75%	97%
Uji Pa të Ardhura (% e prodhimit)	67.6%	40%
Norma e arkëtimit (% e totalit të faturave)	79.9%	92%
Stafi për 1,000 lidhje ujësjellës-kanalizime	2.62	2.45
Numri mesatar i orëve të furnizimit me ujë nga sistemi	14.7	24

Plani i Biznesit 2017-2021 trajton çështjet kryesore të listuara si vijon:

## **I. Analiza dhe parashikimi i kërkesës për ujë**

Menaxhimi i kërkesës për ujë nga UK Tiranë ka qenë gjithmonë një çështje prioritare, duke qenë se sistemi i ujësjellësit është më i madhi në vend dhe ka kompleksitetin më të madh teknik të çdo sistemi që përfshin të gjithë komponentët që mund të gjenden në një sistem ujësjellës-kanalizime. Analiza e hollësishme e kërkesës aktuale dhe të parashikuar të ujit, si dhe reduktimi i parashikuar i ujit të pa të ardhurave trajtojnë elementët e mëposhtëm:

- Popullsinë në Zonën e Shërbimit dhe Popullsinë e Shërbyer
- Analizën e detajuar të 5 Kategorive të Konsumatorëve (Familjare, Ente Private,





Adresa: Rruga 5 Maji, Tiranë, Shqipëri  
Tel: 00 355 42240978  
[info@ukt.al](mailto:info@ukt.al)  
NIPT J620050020

- Institucionet Buxhetore, Furra Buke, Klientë Specialë)
- Kërkesen Aktuale për Ujë për Frymë (1/f/d)
- Normen e Projektuar te Kërkesës për Ujë (1/f/d)
- Uji pa të Ardhura - Humbjet e Ujit

Elementi i rëndësishëm i kësaj analize është studimi i statistikave mbi popullsinë. Bazuar në të dhënat e INSTAT dhe rregjistrin civil në ish NJQV (Bashkia Tiranë) popullsia totale është 832,302 brenda kufijve administrativë të Bashkisë. Mbulimi është 85% ose 707,800 banorë dhe objektivi është arritja e mbulimit mesatar prej 95.3% UKT.

UKT parashikon të rrisë mbulimin me shërbimin e furnizimit me ujë duke rritur numrin e lidhjeve të reja kryesisht nga: (i) formalizimi i lidhjeve aktuale të parregjistruara (paligjshme) dhe (ii) lidhjet e reja (nga zgjerimi i rjetit).

Analiza e kërkesës për ujë ka parashikuar ndryshimin në nivelin e prodhimit të ujit deri në vitin 2021. Prodhimi aktual është 106 milionë m<sup>3</sup> dhe deri në vitin 2021 parashikohet të shkojë në 62 milionë m<sup>3</sup> që ndryshe përkthehet ulje prej 42 %. Ky reduktim vjen si rezultat i zbatimit të aksioneve për uljen e nivelit të Ujit pa të Ardhura si dhe një manaxhimi më efikas të kërkesës për ujë nëpërmjet zbatimit të një programi tërësor të matjes nga burimi tek konsumatori.

Shoqëria është e angazhuar për të bërë investimet e nevojshme për rritjen e përqindjes së lidhjeve me ujëmatës në pesë vitet e Planit të Biznesit, në mënyrë që të rrisë lidhjet me ujëmatës në zonën e re të shërbimit të UK Tiranës nga 75% në 2016 në 97% për konsumatorët familjarë në fund të vitit 2021 dhe në 100% lidhje me ujëmatës për entet private dhe institucionet buxhetore deri në fund të vitit 2018.

Tabela në vijim jep treguesit për tu arritur sipas kategorive.

**Lidhjet me Ujëmatës sipas Kategorisë së Konsumatorëve**

Kategoria e klientit	Totali i lidhjeve	Lidhjet me ujëmatës	% e lidhjeve me ujëmatës 2016	Treguesi për tu arritur në 2021
Familjare	196,611	147,626	75%	97%
Ente private	30,614	29,336	96%	100%
Institucione buxhetore	634	577	91%	100%
Klientë të veçantë	27	27	100%	-
Furrat e bukës	204	204	100%	-

Element tjetër i analizës është parashikimi për shitjet e ujit. Tabela në vijim pasqyron në periudhën e analizës të dhënat mbi prodhimin, shitjen dhe ujin pa të ardhura.



Adresa: Rruga 5 Maji, Tiranë, Shqipëri  
Tel: 00 355 42240978  
[info@ukt.al](mailto:info@ukt.al)  
NIPT J620050020

#### Ujin e Parashikuar në Ujin e Prodhuar dhe Ujin Pa të Ardhura (në m<sup>3</sup>/d)

Përshkrimi	2016	2017	2018	2019	2020	2021
Shitje me pakicë	86,082	88,753	90,661	89,952	88,774	88,515
Shitje me shumicë	8,765	10,244	13,584	13,584	13,584	13,584
<b>Totali i shitjes së ujit</b>	<b>94,847</b>	<b>98,997</b>	<b>104,245</b>	<b>103,536</b>	<b>102,358</b>	<b>102,099</b>
Prodhimi i ujit	292,739	265,348	243,112	212,581	187,216	153,632
Uji i blerë	0	17,500	17,500	17,500	17,500	16,533
<b>Totali i ujit që hyn në sistem</b>	<b>292,739</b>	<b>282,848</b>	<b>260,612</b>	<b>230,081</b>	<b>204,716</b>	<b>170,165</b>
Uji pa të ardhura	197,892	183,851	156,367	126,544	102,358	68,066
<b>% e ujit pa të ardhura</b>	<b>67.6%</b>	<b>65.0%</b>	<b>60.0%</b>	<b>55.0%</b>	<b>50.0%</b>	<b>40.0%</b>

Siç e shohim nga tabela shitja e ujit do të rritet deri në 2021 si rrjedhojë e rritjes së mbulimit me shërbim të popullsisë. Nga ana tjetër ulet mbiprodhimi gjë që con në uljen e humbjeve nga 67.6 % në 40%. Kjo tregon eficiencën në menaxhimin e shërbimeve të ofruara nga UKT.

## II. Investimet e parashikuara

Nevojat për investime kapitale, në sistemet urbane dhe rurale të ujësjellësit të menaxhuara nga UK Tiranë, janë vlerësuar bazuar në kushtet ekzistuese të këtyre sistemeve ujësjellës-kanalizime dhe investimeve në vazhdim që janë bërë nga të ardhurat e Shoqërisë, apo me fondet e siguruara nga huaja tregtare që Shoqëria ka me Bankën Kombëtare Tregtare (BKT). Pjesa më e madhe e investimeve të realizuara në këto vitet e fundit, nga fondet e Shoqërisë, lidhen me rehabilitimin e rrjetit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve.

Në lidhje me përmirësimin e cilësisë së shërbimit dhe performancës së matshme të shërbimeve, për sa më sipër do të nevojiten investime kapitale për përmbushjen e objektivave strategjike të mëposhtme, në mënyrë të veçantë:

- Reduktimi i ujit pa të ardhura
- Rritja e mbulimit me shërbim ujësjellësi
- Rritja e mbulimit me shërbim kanalizimesh
- Arritja e shërbimit të furnizimit të pandërprerë me ujë (24/7) në ish UK Tiranë
- Përmirësimi i performancës financiare të Shoqërisë

Në shifra të përafërta, investimet e parashikuara për pesë vitet e planit të biznesit klasifikohen në dy grupe kryesore.

### A. Investime kapitale nga fondet e Shoqërisë që arrijnë në total 6.3 miliardë lekë nga të cilat:

- 2.8 miliardë lekë për shpenzime për rinovime kapitale të rrjetit
- 0.78 miliardë lekë për riparime dhe zëvendësime kapitale
- 2.78 miliardë lekë për investime të reja kapitale.



Adresa: Rruga 5 Maji, Tiranë, Shqipëri  
Tel: 00 355 42240978  
[info@ukt.al](mailto:info@ukt.al)  
NIPT J620050020

- B. Investime kapitale nga huaja tregtare që arrin në total rreth 16.26 miliardë lekë nga të cilat:
- 10.3 miliardë lekë për shpenzime për rinovime kapitale të rrjetit
  - 5.9 miliardë lekë për investime të reja kapitale.

Këto investime në total kapin vlerën prej 22.6 miliardë ku vlen të përmenden disa prej projekteve më të rëndësishme si:

- Matësat e rinj mekanikë dhe SMART për entet private
- Dixhitalizimi me GIS dhe Master Plani
- Shtimi i impjantit të Bovillës
- Rikualifikim i linjave të transmetimit të Shën Mërisë
- Ndërtimi i By-Paseve të linjave të transmisionit të Impjantit të Bovillës, Burimit të Shën Mërisë dhe Burimit të Selitës
- Shfrytëzim i vendburimit të Gurit të Bardhë etj.

### III. Parashikimi i Buxhetit për Operimin dhe Mirëmbajtjen

Parashikimi i buxhetit për O&M është përgatitur bazuar në të dhënat e Vitit Bazë 2016, ku përfshihen të dhënat për Shoqërinë UK Tiranë ekzistuese dhe për ish komunat, që i janë shtuar Bashkisë Tiranë pas Reformës Territoriale. UK Tiranë ka aplikuar norma kostosh që lidhen me variablat në modelin financiar si dhe normat në rritje/rënie që përfaqësojnë tendencat e pritshme gjatë pesë viteve të periudhës së planifikimit.

Parashikimet janë bërë për të pasqyruar të gjitha kostot e operimit dhe të mirëmbajtjes, si dhe efektet që lidhen me Objektivat Strategjike të përcaktuara në Planin e Biznesit. Edhe pse struktura e kostos për ish komunat përbëhet kryesisht nga pagat e personelit, mirëmbajtja dhe materialet, kimikatet dhe energjia elektrike, kostot e operimit dhe mirëmbajtjes janë bashkuar me strukturën e kostos së Shoqërisë ekzistuese UK Tiranë. Në parashikimet e të gjitha shpenzimeve që lidhen me aktivitetet e UK Tiranë të ri-organizuar përfshihen: kostot e punës, shpenzimet e mirëmbajtjes rutinë, kostot e energjisë, kostot e transportit, programi i marrëdhënieve me publikun, etj. Tabela e mëposhtme paraqet një përmbledhje të parashikimit 5-vjeçar të buxhetit për operimin dhe mirëmbajtjen e UK Tiranë.

#### Buxheti i parashikuar i operimit dhe mirëmbajtjes (Lekë)

Zëri në buxhet	2017	2018	2019	2020	2021
Pagat e punonjësve	806,511,834	807,395,814	850,990,606	867,970,238	867,970,238
Kosto të tjera të punonjësve	126,659,279	131,904,878	139,044,759	141,825,654	141,825,654
Shërbime të kontraktuara	378,720,000	379,694,400	380,688,288	381,702,054	382,736,095
Shpenzime të konsumueshme	957,105,288	910,140,673	739,651,831	737,051,159	713,936,560
<b>Kosto Totale O&amp;M</b>	<b>2,268,996,401</b>	<b>2,229,135,766</b>	<b>2,110,375,484</b>	<b>2,128,549,105</b>	<b>2,106,468,547</b>



Adresa: Rruga 5 Maji, Tiranë, Shqipëri  
Tel: 00 355 42240978  
[info@ukt.al](mailto:info@ukt.al)  
NIPT J620050020

#### IV. Parashikimi i Nevojes për të Ardhura dhe Startegjia e Tarifave dhe Cmimeve

Nevoja për të ardhura është llogaritur për të mbuluar kostot rutinë të operimit dhe mirëmbajtjes, si dhe nevojën për të financuar rezervat kapitale për rinovim kapitali të infrastrukturës nëntokësore, riparim e zëvendësim kapitali, dhe investime të reja kapitale që duhet të përmbushen nga të ardhurat e Shoqërisë. Së fundi, në të merren parasysh pagesat për huatë e prapambetura që Shoqëria duhet të paguajë për sa i përket pagesave të principalit dhe interesave.

Një përmbledhje e Nevojës për të Ardhura e ndarë sipas zërave kryesore paraqitet në tabelën e mëposhtme:

##### Nevojat Totale për të Ardhura (Lekë)

Përshkrimi	2017	2018	2019	2020	2021
<b>Operimet dhe Mirëmbajtja</b>	<b>2,268,996,401</b>	<b>2,229,135,766</b>	<b>2,110,375,484</b>	<b>2,128,549,105</b>	<b>2,106,468,547</b>
<b>Pagesa e Borxhit</b>					
Pagesa Interesi	105,666,874	229,228,595	385,190,270	535,891,401	624,278,414
Pagesa Principali	351,126,946	823,128,909	843,437,840	1,432,425,566	1,871,216,860
<b>Nëntotal</b>	<b>456,793,820</b>	<b>1,052,357,504</b>	<b>1,228,628,110</b>	<b>1,968,316,967</b>	<b>2,495,495,274</b>
<b>Shpenzime për fondin rezervë për kapitalin</b>					
Rinovim Kapitali	252,596,630	100,000,000	420,000,000	1,100,000,000	950,000,000
Riparim e Zëvendësim të Kapitalit	11,892,793	93,215,737	212,017,122	233,254,835	231,983,461
Investime të Reja Kapitale	589,864,535	438,954,674	557,832,969	556,679,900	639,517,633
<b>Nëntotal</b>	<b>854,353,957</b>	<b>632,170,461</b>	<b>1,189,850,091</b>	<b>1,889,934,734</b>	<b>1,821,501,094</b>
<b>Nevoja për financime</b>					
Marrëveshje me QQ për të shlyer huan italiane	140,194,477	140,194,477	140,194,477	143,346,999	142,842,595
<b>Nëntotal</b>	<b>140,194,477</b>	<b>140,194,477</b>	<b>140,194,477</b>	<b>143,346,999</b>	<b>142,842,595</b>
<b>Nevojat Totale për të Ardhura</b>	<b>3,439,949,702</b>	<b>3,773,469,253</b>	<b>4,388,659,208</b>	<b>5,843,453,807</b>	<b>6,280,622,319</b>

Bazuar tek Nevoja Totale për të Ardhura UKT ka zhvilluar një Strategji të Tarifave dhe Cmimeve për periudhën 5-vjecare. Tarifat propozohen të ndryshojnë në të gjithë komponentët e secilës kategori konsumatori duke u bazuar në shitjet e ujit dhe normat e arkëtimit të cilat rriten nga 90% në vitin 2017 në 92% në vitin 2021. Konkretisht, projektimi i ndryshimit të tarifave dhe cmimeve paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Përshkrimi	2017	2018	2019	2020	2021
<b>Tarifa Mujore Fikse (Lekë/Lidhje/Muaj)</b>					
Familjarë	100	200	200	300	300
Ente Private	100	200	200	300	300
Institucione buxhetore	100	200	200	300	300
Klientë të veçantë	100	200	200	300	300
Furra Buke	100	200	200	300	300
HEC Lanabregas	100	200	200	300	300
<b>Tarifa e furnizimit me ujë (Lekë/m<sup>3</sup>)</b>					



Adresa: Rruga 5 Maji, Tiranë, Shqipëri  
Tel: 00 355 42240978  
[info@ukt.al](mailto:info@ukt.al)  
NIPT J620050020

Familjarë	45	65	65	85	85
Ente private	135	150	150	165	165
Institucione buxhetore	120	135	135	150	150
Klientë të veçantë	170	190	190	210	210
Furra Buke	95	110	110	125	125
HEC Lanabregas	5	6	6	7	7
<b>Tarifa e Kanalizimeve (Lekë/m<sup>3</sup>)</b>					
Familjarë	11	11	35	35	35
Ente private	35	35	55	55	55
Institucione buxhetore	30	30	55	55	55
Klientë të veçantë	40	40	55	55	55
Furra Buke	13	13	55	55	55
HEC Lanabregas	0	0	0	0	0
<b>Tarifë specifike për shlyerjen e matësve</b>					
Ente private/klientë të veçantë/furrat e bukës	450	450	450	450	450
Tarifa e furnizimit me ujë me shumicë (Lekë/m <sup>3</sup> )	12	15	15	15	15

Duke përmbledhur të gjithë komponentët e studiuar në këtë relacion, rezulton që duke nisur nga viti 2017 totali i nevojave për të ardhura është 3.44 miliardë lekë, ndërsa totali i të ardhurave të përftuara nga arkëtimi nga shitjet dhe shërbimet e tjera është 3.5 miliardë lekë. Pra gjenerohet një rezultat pozitiv prej 60 milionë lekë.

Gjatë periudhës 2018-2021 është parashikuar që rezultati pozitiv i Shoqërisë do të vazhdojë të rritet ndjeshëm duke i dhënë mundësi UKT:

- Të mbulojë 100% Kostot e Operimit dhe Mirëmbajtjes
- Të shlyejë të gjitha detyrimet e prapambetura nga vitet e kaluara, të cilat në fund të vitit 2016 vlerësohen të jenë rreth 1.9 miliardë lekë,
- Të kryejë shpenzime kapitale me fondet e Shoqërisë në vlerën 5.5 miliardë lekë për periudhën 2018-2021.
- Të shlyejë të gjitha detyrimet kontraktuale të huave ekzistuese dhe atyre të ardhshme.

Përsa më sipër kërkojmë miratimin e Plan Biznesit 2017-2021 nga Këshilli Mbikqyrës dhe Asambleja e Aksionarëve të UKT sh.a.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

REDI MOLLA





Adresa: Rruga 5 Maji, Tiranë, Shqipëri  
Tel: 00 355 42240978  
info@ukt.al  
NIPT J620050020

1

Nr/2689/prot  
13

Tiranë, më 16/06/2017

Drejtuar: ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË AKSIONARËVE TË UKT SH.A

Lënda: Relacion mbi Projekt-Marrëveshjen e ndarjes së aksionarëve Bashkia Vorë dhe Bashkia Kamëz nga shoqëria Ujësjetës Kanalizime Tiranë sh.a

Të nderuar Zotërinj,

Shoqëria Ujësjetës Kanalizime në zbatim të Vendimit të Asamblesë së Aksionarëve Nr.1, datë 18.04.2017 "Për rishikimin e kushteve të Projektmarrëveshjes dhe Raportit të Ekspertëve për ndarjen e aksionarëve Bashkia Vorë dhe Bashkia Kamëz nga shoqëria Ujësjetës Kanalizime Tiranë sh.a bazuar në kriteret e VKM Nr.660, datë 12.09.2007", i është drejtuar shoqërisë që hartoi aktet e ndarjes UHY Elite Auditing, Tax & Consulting dhe "Silvana Abazi", me shkresën nr.10508 prot, date 13.05.2017.

Nëpërmjet kësaj shkrese është kërkuar rishikimi i Raportit të ndarjes dhe Marrëveshjes së ndarjes të aksionarëve të UKT sh.a, Bashkia Kamëz dhe Bashkia Vorë duke përdorur si kriter numrin e popullsisë, sipas përcaktimeve të VKM Nr.660, datë 12.09.2007 "Për transferimin e aksioneve të shoqërive të ujësjetësve dhe kanalizimeve njësive të qeverisjes vendore" pika 2.

Ekspertëve i është vënë në dispozicion Protokollit i mbledhjes dhe Vendimi i Asamblesë së Aksionarëve Nr.1, datë 18.04.2017 "Për rishikimin e kushteve të Projektmarrëveshjes dhe Raportit të Ekspertëve për ndarjen e aksionarëve Bashkia Vorë dhe Bashkia Kamëz nga shoqëria Ujësjetës Kanalizime Tiranë sh.a bazuar në kriteret e VKM Nr.660, datë 12.09.2007".

Shoqëria UHY Elite Auditing, Tax & Consulting dhe "Silvana Abazi" ka kthyer përgjigje me shkresën nr.10508/1 prot, datë 16.06.2017 nëpërmjet të cilës jep argumentat si vijon:

UHY-Elite sh.p.k, ka marre përsipër misionin për vlerësimin e procesit të ndarjes të aksionarëve Bashkia Vorë dhe Bashkia Kamëz nga shoqëria Ujësjetësi Kanalizime Tiranë sha në përputhje me kushtet dhe termat e referencës sipas kontratës nr. 22519/7 prot. datë 16.12.2016 të lidhur midis UKT sh.a dhe UHY Elite sh.p.k.

Misioni i kësaj shoqërie konsiston në vlerësimin e kushteve të projekt-marrëveshjes së ndarjes, verifikimin nëse vlerat përkatëse që u jepen aksionerëve të shoqërisë UKT sh.a. të cilët marrin pjesë në këtë operacion janë të drejta dhe raporti i këmbimit është i drejtë dhe i arsyeshëm në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

Për kryerjen e këtij misioni UHY Elite sh.p.k është bazuar ne ligjin nr.9901 date 14.04.2008 "Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare" më konkretisht, nenet 216 deri në 225, duke qene se aktiviteti i shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizime, (UKT) përta i takon aspekteve financiare, konsiderohet



Adresa: Rruga 5 Maji, Tiranë, Shqipëri  
Tel: 00 355 42240978  
[info@ukt.al](mailto:info@ukt.al)  
NIPT J620050020

si një shoqëri tregtare publike e llojit të veçantë dhe aktiviteti i tyre bazohet në ligjin e mësipërm si dhe te akteve nënligjore në zbatim të tij.

Nga ana tjetër vlerësimi dhe analizimi i vlerës së aksioneve, është bere në përputhje të plotë me ligjin Nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të Audituesit Ligjor dhe të Kontabilistit të Miratuar” i ndryshuar me Ligjin nr.10297 datë 08.07.2010 dhe me ligjin 47/2016.

Në analizë të sa më sipër, UHY Elite sh.p.k arriti në përfundimin se kriteri i ndarjes së shoqërisë UKT sha **bazuar në vlerën neto të aktiveve** që i kalojnë në administrim shoqërive të reja të krijuara nga ndarja e UKT sha në njësitë administrative përkatëse, Tirane, Vore dhe Kamez, jo vetëm përben kriterin më të drejtë, real dhe të arsyetueshme, por ky kriter është në përputhje me kuadrin ligjor të sipërpërmendur si dhe me praktikatat me të mira tregtare që aplikohen në operacione të ngjashme financiare dhe ekonomike.


Në këto kushte, kërkojmë vendimmarrjen Tuaj që të miratoni Projekt-marrëveshjen e ndarjes, Raportin e Ekspertëve për ndarjen e shtojcat, si akte të hartuara bazuar në legjislacionin shqiptar në fuqi dhe bazuar në modalitetet e përcaktuara në Relacionin e Grupit të përbashkët të punës Nr.17170 Prot, datë 09.08.2016, të përbërë nga përfaqësues të Bashkisë Tiranë, Bashkisë Kamëz dhe Bashkisë Vorë.

Bashkëlidhur gjeni:

1. Shkresën nr.10508/1 prot, datë 16.06.2017 të UHY Elite sh.p.k;
2. Relacionin e Grupit të përbashkët të punës Nr.17170 Prot, datë 09.08.2016;
3. Projekt-marrëveshjen e ndarjes;
4. Raportin e Ekspertëve për ndarjen dhe shtojcat;
5. Pasqyrat financiare vjetore, raportet e ecurisë së veprimtarisë, në mënyrë të detyrueshme për tre vitet e fundit;
6. Projekt-vendimin e miratimit të Projekt-marrëveshjes së ndarjes dhe Raportit të Ekspertëve.
7. Plani i Veprimeve.

Faleminderit për mirëkuptimin.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM





Adresa: Rruga 5 Maji, Tiranë, Shqipëri

Tel: 00 355 42240978

info@ukt.al

NIPT J620050020

Nr. 17170 Prot  
18

datë 09/08/2016

Drejtuar: **ASAMBLEË SË PËRGJITHSHME TË AKSIONARËVE TË UKT SHA**

Për dijeni: **KËSHILLIT MBIKQYRËS TË UKT SHA**

Lënda: **Raport i Grupit të Punës mbi modalitetet e ndarjes së Bashkive si aksionarë të UKT sha**

Të nderuar Zotërinj,

Me Vendimin nr.9, datë 04.04.2016 të Asamblesë së Aksionerëve të UKT Sh.a, "Mbi fillimin e procesit paraprak të ndarjes së Bashkisë Vorë dhe Bashkisë Kamëz nga shoqëria Ujësjetillës Kanalizime Tiranë sh.a", aksionarët vendosën:

- 1. Vendimmarrja për ndarjen e aksionarëve Bashkia Kamëz dhe Bashkia Vorë nga shoqëria Ujësjetillës Kanalizime Tiranë sha, të paraprihet nga një Raport i Ekspertëve Kontabël dhe Vlerësues, që do të njohë aksionarët dhe këshillat bashkiakë përkatës, me mënyrën e riorganizimit të shoqërisë pas ndarjes, efektet në kapital dhe ndarjen e asetëve .*
- 2. Ngritjen e një grupi pune në nivel ekspertësh, me përfaqësues nga tre Bashkitë Aksionare dhe shoqëria Ujësjetillës Kanalizime Tiranë sh.a, për të mbikqyrur dhe asistuar të gjithë procesin e ndarjes.*
- 3. Ngarkohet Drejtori i Përgjithshëm i Ujësjetillës Kanalizime Tiranë Sh.a, të propozojë në mbledhjen e rradhës emrat e ekspertëve dhe për zbatimin e këtij vendimi.*

Në zbatim të këtij vendimi shoqëria Ujësjetillës Kanalizime Tiranë sh.a i është drejtuar aksionarëve të saj Bashkia Tiranë, Bashkia Kamëz dhe Bashkia Vorë me shkresën nr.10172 prot, datë 04.05.2016, për të kërkuar emrat e përfaqësuesve të tyre për ngritjen e grupit të punës sipas pikës 2 të vendimit.

Në përgjigje të shkresës nga bashkitë aksionare janë dërguar emrat e përfaqësuesve në grupin e punës me shkresat:

1- Nr Prot 13599/1, datë 30.06.2016, Përfaqësues të Bashkisë Tiranë, në këtë Grup konfirmohen:

- Zj.Itena Ndroqi, Drejtor i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme Juridike, e Aseteve dhe Licensimit
- Zj.Alda Mile, Përgjegjës Sektori në Drejtorinë e Rrjeteve, Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike

2- Nr Prot 2828, datë 21.06.2016, Përfaqësues të Bashkisë Kamëz, në këtë Grup janë:

Ujësjetillës Kanalizime sh.a. Tiranë NIPT J620050020 Adresa: Rruga 5 Maji, Tiranë, Shqipëri,

Tel: 00 355 42240978, info@ukt.al.0





Adresa: Rruga 5 Maji, Tiranë, Shqipëri

Tel: 00 355 42240978

info@ukt.al

NIPT J62005002O

- Zj.Vera Lala, Eksperte kontabël pranë shoqërisë “VENIS-Audit & Financë”
- Z. Ndriçim Halilaj, Përgjegjës i Zyrës Juridike

3- Nr Prot 1653/1, datë 06.05.2016, Përfaqësues të Bashkisë Vorë, në këtë Grup janë:

- Z.Behar Ciku, Përgjegjës i Sektorit Juridik
- Zj.Aida Dedja, Përgjegjës i Sektorit Financës

Pas këtij konfirmimi UKT sh.a ka formalizuar ngritjen e grupit të punës me Urdhërin të Brëndshëm Nr.492, datë 07.07.2016 “Mbi fillimin e procesit paraprak të ndarjes së Bashkisë Vorë dhe Bashkisë Kamëz nga shoqëria Ujësjellës Kanalizime Tiranë sh.a” duke vendosur dhe përfaqësues nga administrata e UKT sh.a.

Grupi i Punës me qëllim përmbushjen e detyrave të vendosura nga asambleja e aksionarëve dhe bashkitë aksionare, ka zhvilluar më datë 08.07.2016 ora 12:00 mbledhjen për të diskutuar mbi modalitetet e ndarjes nëpërmjet largimit të Aksionarëve Bashkia Kamëz dhe Bashkia Vorë, referuar legjislacionit shqiptar në fuqi dhe specifikisht ligjit për shoqëritë tregtare.

Në këtë mbledhje morën pjesë përfaqësuesit e të gjithë palëve të cilët dhanë opinionet e tyre dhe diskutuan mbi çështjet:

1. Ndarja e objekteve, burimeve dhe sistemeve të furnizimit me ujë sipas kompetencës territoriale të Bashkive aksionare të UKT sh.a;
2. Detyrat që do të ndjekë grupi i punës sipas përcaktimeve të Vendimit nr.9, datë 04.04.2016 të Asamblesë së Aksionerëve të UKT Sh.a;
3. Përgatitja e akteve për ndarjen e aksionarëve Bashkia Kamëz dhe Bashkia Vorë si aksionarë të shoqërisë UKT sh.a, bazuar në përcaktimet e Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” nenet 216-225;
4. Vënia në dispozicion e dokumentacionit ligjor e financiar për realizimin e procesit të ndarjes.

Për çështjen nr.1: Ndarja e objekteve, burimeve dhe sistemeve të furnizimit me ujë sipas kompetencës territoriale të Bashkive aksionare të UKT sh.a. Lidhur me këtë çështje nga Grupi i Punës është konkluduar se referuar përcaktimeve të nenit 5 të ligjit Nr.111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, objektet, burimet dhe sistemet që i shërbejnë furnizimit me ujë, pavarësisht territorit të bashkisë ku ndodhen, janë pronë e shtetit shqiptar dhe në administrim të organeve shtetërore (si psh një pjesë e Bovillës dhe stacioni e puset e Laknasit ndodhen në territorin e Bashkisë Kamëz por i shërbejnë furnizimit me ujë popullatës së Tiranës dhe një pjesë Bashkisë Kamëz që furnizohet me shumicë nga UKT sh.a; Depo e ujit që po ndërtohet nga KFË për furnizimin me ujë të Bashkisë Kamëz në zonën e Zall-Herrit, ndodhet në territorin e Bashkisë Tiranë por ka si qëllim furnizimin e zonës së Kamzës). Në këto kushte ndarja e këtyre objekteve nuk do të ketë si bazë kompetencën territoriale të bashkisë përkatëse, por propozohet që ndarja e administrimit të tyre të bëhet në bazë të kriterëve:

- Qëllimit dhe destinacionit për të cilin janë ndërtuar këto objekte;

Ujësjellës Kanalizime sh.a. Tiranë NIPT J62005002O Adresa: Rruga 5 Maji, Tiranë, Shqipëri,  
Tel: 00 355 42240978, info@ukt.al.0



Adresa: Rruga 5 Maji, Tiranë, Shqipëri

Tel: 00 355 42240978

info@ukt.al

NIPT J620050020

- Nevojave për furnizim me ujë të bashkive përkatëse;
- Subjektit apo Institucionit që ka investuar për ndërtimin e tyre apo përfituesit të këtij investimi;

Për çështjen nr.2: Mbi detyrat që do të ndjekë grupi i punës sipas përcaktimeve të Vendimit nr.9, datë 04.04.2016 të Asamblesë së Aksionerëve të UKT Sh.a.

Për këtë çështje është vendosur që sipas vendimit dhe vullnetit të shprehur nga Asambleja e Aksionarëve, Grupi i punës do të asistojë studion e ekspertëve që do të përzgjidhen në bazë të ligjit të prokurimit për hartimin e akteve të ndarjes, me dokumentacion financiar, teknik e ligjor dhe do të mbikqyrin procesin e do të përgatisë opinion mbi projekt marrëveshjen dhe raportin e ndarjes për llogari të Aksionarit që përfaqëson.

Për çështjen nr.3 Përgatitja e akteve për ndarjen e aksionarëve Bashkia Kamëz dhe Bashkia Vorë si aksionarë të shoqërisë UKT sh.a, bazuar në përcaktimet e Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” nenet 216-225;

Lidhur me këtë çështje Grupi i Punës vendosi që t'i propozojë asamblesë së aksionarëve që Aktet e ndarjes së aksionarëve të hartohen nga Studio me Ekspertë të pavarur të licencuar (ekspertë kontabël, ligjorë, fiskalë) që do të përzgjidhen nga UKT sh.a me procedurë prokurimi.

Ekspertët do të hartojnë kushtet e Marrëveshjes së ndarjes nëpërmjet largimit të aksionarëve Bashkia Vorë dhe Bashkia Kamëz, Raportin shpjegues dhe Raportin e vlerësimit të kushteve të projekt-marrëveshjes. I gjithë procesi dhe dokumentacioni përkatës do të vihet në dispozicion të ekspertëve dhe përfaqësuesve të aksionarëve që janë pjesë e këtij grupi pune.

Procedura e ndarjes duhet të kryhet bazuar në përcaktimet e Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” nenet 216-225 duke ndjekur planin e veprimeve si vijon:

1-Caktimin e ekspertëve të jashtëm të licencuar (studio me ekspertë kontabël, ligjor, fiskalë) që do të përzgjidhen në bazë të ligjit për prokurimin publik dhe do të hartojnë aktet përkatëse sipas përcaktimeve të ligjit për shoqëritë tregtare duke ndjekur procedurat si vijon:

- Në bazë të nenit 216 të Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” do të hartohet Projekt-Marrëveshja e ndarjes së aksionarëve Bashkia Kamëz dhe Bashkia Vorë ku minimalisht do të përcaktojnë: a) emrin e regjistruar dhe selinë e shoqërive, që ndahet (UKT sh.a) dhe aksionarët që largohen për të krijuar shoqëritë e tyre; b) pranimi i palëve për kalimin e pasurive të secilës shoqëri (aksionar) që ndahet, në këmbim të aksioneve të shoqërisë UKT sh.a; c) raporti i këmbimit të aksioneve dhe çdo shumë e pagueshme në para; ç) kushtet e ndarjes së aksioneve në shoqërinë që ndahet; d) të drejtat, që rrjedhin nga aksionet e shoqërisë që ndahet; dh) të drejtat, që shoqëria që ndan aksionet u njeh zotëruesve të aksioneve, apo çdo mase tjetër në favor të tyre; e) përparësitë e veçanta, që u jepen administratorëve, anëtarëve të këshillit mbikëqyrës apo ekspertëve kontabël të autorizuar; ë) pasojat që ndarja do të ketë ndaj punëmarrësve e përfaqësuesve të tyre, si dhe masat e propozuara për to.



Adresa: Rruga 5 Maji, Tiranë, Shqipëri  
Tel: 00 355 42240978  
[info@ukt.al](mailto:info@ukt.al)  
NIPT J620050020

- Projekt-marrëveshja do të shoqërohet me Raport të hollësishëm ku do të përshkruhen bazat ligjore dhe ekonomike për të e, në veçanti, raporti i këmbimit të aksioneve apo të drejtave të veçanta. Në raport përshkruhen edhe vështirësitë e veçanta të vlerësimit, të cilat janë hasur. Raporti duhet të përshkruajë edhe pasojat e kësaj ndarje mbi punëmarrësit e shoqërive pjesëmarrëse.
- Kushtet e Projekt-Marrëveshjes vlerësohen nga ekspertë të pavarur të licencuar të fushave të ndryshme që caktohen me procedurë prokurimi nga UKT sh.a.
- Projekt-Marrëveshja depozitohet bashke me raportin e ndarjes një muaj para datës së mbledhjes së asamblesë së aksionarëve në QKR. Së bashku me të depozitohen edhe pasqyrat financiare dhe raportet e ecurisë së veprimtarisë për tre vitet e fundit.

2-Hartohet Projekt-marrëveshja dhe Raporti shpjegues;

3-Hartohet nga Ekspertë të licencuar (studio) Raporti Vlerësues i Marrëveshjes

4-Projekt- Marrëveshja dhe Raportet e ekspertëve (sipas rastit dhe zvogëlimi i kapitalit nëse ka) bashkë me pasqyrat financiare të tre viteve të fundit të UKT sh.a, depozitohen në QKR.

5-Thirret asambleja pas një muaji të depozitimit të Akteve të ndarjes së aksionarëve në QKR dhe miratohet nga Asambleja marrëveshja e ndarjes dhe raporti vlerësues.

6-Vendimi i Asamblesë për miratimin e marrëveshjes së ndarjes së aksionarëve nëpërmjet largimit të tyre si aksionarë të UKT sh.a depozitohet në QRA, QKR dhe organet tatimore.

Për çështjen nr.4: Vënia në dispozicion e dokumentacionit ligjor e financiar për realizimin e procesit të ndarjes.

Lidhur me këtë çështje Grupi i Punës vendosi që Administrata e shoqërisë UKT sh.a të vendosë në dispozicion të ekspertëve që do të caktohen nga Asambleja e Aksionarëve dhe grupit të punës të gjithë dokumentacionin tekniko-financiar e ligjor që i shërben procesit.

#### **Për Grupin e Punës**

Përfaqësues të Bashkisë Tiranë

Itena Ndroqi

Alda Mile

Përfaqësues të Bashkisë Kamëz

Vera Lala

Ndriçim Halilaj

Përfaqësues të Bashkisë Vorë

Behar Ciku

Ujësjetë Kanalizime sh.a. Tiranë NIPT J620050020 Adresa: Rruga 5 Maji, Tiranë, Shqipëri,  
Tel: 00 355 42240978, [info@ukt.al](mailto:info@ukt.al)



Adresa: Rruga 5 Maji, Tiranë, Shqipëri

Tel: 00 355 42240978

[info@ukt.al](mailto:info@ukt.al)

NIPT J620050020

Aida Dedja

Përfaqësues të UKT sh.a

Evis

Gjebrea

Aida

Sula

Gelantina

Gurakuqi

Ilda

Çelmeta

Vladimir

**NIPT K31712103L**

Rr. Deshmoret e 4 Shkurtit  
Pallati 17, Hyrja 3, Kati III, Ap. 12  
Tirana, Albania

Nr.16/06 Prot.

Tirane, 16.06.2017

10508/1  
Për :

Z. REDI MOLLA  
DREJTOR I PERGJITHSHEM  
UJESJELLES KANALIZIME TIRANE

16.06.17

**Lënda:** Kthim përgjigje

Në përgjigje të shkresës suaj nr. 10508 prot., datë 13.5.2017, me të cilën kërkohet mendim lidhur me rishikimin e raportit të ndarjes dhe projekt marrëveshjes së ndarjes të aksionareve të UKT sh.a, Bashkia Kamze dhe Bashkia Vore, ju sqarojmë si më poshtë vijon:

UHY-Elite sh.p.k, ka marrë përsipër misionin për vlerësimin e procesit të ndarjes të aksionarëve Bashkia Vorë dhe Bashkia Kamëz nga shoqëria Ujësjiellësi Kanalizime Tiranë sha në përputhje me kushtet dhe termat e referencës sipas kontratës nr. 22519/7 prot. datë 16.12.2016 të lidhur midis UKT sh.a. dhe UHY Elite sh.p.k.


Misioni ynë konsiston në vlerësimin e kushteve të projekt-marrëveshjes së ndarjes, verifikimin nëse vlerat përkatëse që u jepen aksionerëve të shoqërisë UKT sh.a. të cilët marrin pjesë në këtë operacion janë të drejta dhe raporti i këmbimit është i drejtë dhe i arsyeshëm në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

Për kryerjen e këtij misioni ne jemi bazuar në ligjin nr.9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" më konkretisht, nenet 216 deri në 225, duke qenë se aktiviteti i shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizime, (UKT) përse i takon aspekteve financiare, konsiderohet si një shoqëri tregtare publike e llojit të veçantë dhe aktiviteti i tyre bazohet në ligjin e mësipërm si dhe te akteve nënligjorë në zbatim të tij.

Nga ana tjetër vlerësimi dhe analizimi i vlerës së aksioneve, është bërë në përputhje të plotë me ligjin Nr. 10091 datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të Audituesit Ligjor dhe të Kontabilistit të Miratuar" i ndryshuar me Ligjin nr.10297 datë 08.07.2010 dhe me ligjin 47/2016.

Në analizë të sa më sipër, ne arritëm në përfundimin se kriteri i ndarjes së shoqërisë UKT sha **bazuar në vlerën neto të aktiveve** që i kalojnë në administrim shoqërive të reja të krijuara nga ndarja e UKT sha në njësitë administrative përkatëse, Tirane, Vore dhe Kamez, jo vetëm përben kriterin më të drejtë, real dhe të arsyetueshme, por ky kriter është në përputhje me kuadrin ligjor të sipërpërmendur si dhe me praktikën me të mira tregtare që aplikohen në operacione të ngjashme financiare dhe ekonomike.

Me Repekt,

  
**Mimoza SULA**  
Administrator  
UHY Elite  
Auditing, Tax & Consulting  
NIPT: K 31712103 L  
Tirana - Albania



Adresa: Rruga 5 Maji, Tiranë, Shqipëri  
Tel: 00 355 42240978  
[info@ukt.al](mailto:info@ukt.al)  
NIPT J620050020

12688/6 Prut

16.06.17

**Drejtuar : Asamblesë së Aksionerëve të Shoqërisë Ujësjetë Kanalizime Tiranë**

**Këshillit Mbikqyrës të Shoqërisë Ujësjetë Kanalizime Tiranë**

**Lënda: Relacion për Miratimin e Propozimit për ndryshimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura**

Shoqëria Ujësjetë Kanalizime Tiranë sha (UKT) ka operuar gjithmonë me buxhetim vjetor, proces i cili nuk lejon që të kryesh planifikime afat-gjata mbi investime më gjithëpërfshirëse apo analizë për zgjerimin dhe përmirësimin e aktivitetit e shërbimeve që UKT ofron.

Kjo është dhe arsyeja që UKT-së i ka munguar vizioni afat-gjatë dhe objektivat strategjikë. Me ndihmën e Bashkisë Tiranë UKT zyrtarisht kërkoi asistencë pranë USAID për të financuar Biznes Planin. Si rezultat kërkesa u miratua dhe Plani i Biznesit u përgatit nga kompania konsulente të Kompanisë Valu Add Management Services. Nga analizat kosto-përfitim që ky Plan Biznesi realizoi doli nevoja për rishikim të strukturave të tarifave për të gjitha kategoritë e konsumatorëve, me qëllim arritjen e objektivave strategjikë të cilat si qëllim final kanë përmirësimin e cilësisë së shërbimit.

## **I. Gjendja Aktuale**

Problemet që UKT ka në ofrimin e shërbimeve janë:

- Rrjeti i amortizuar i linjave të transmetimit që furnizojnë me ujë Qytetin e Tiranës është investuar nga vitet 1950 -1964-1974 dhe në vazhdim ndërsa për rrjetin e shpërndarjes që prej vitit 1964.
- Ndërhyrje emergjente te fragmentuara në rrjet pa një projekt afat-gjatë dhe gjithëpërfshirës.
- Mungesë e furnizimit me ujë 24 orë dhe krijimi i situatave të emergjencës gjatë sezonit veror.
- Nivel i lartë i ujit pa të ardhura prej 67.6 %.
- Lidhje të paligjshme që kryesisht vijnë nga zonat informale që në total të hapësirës ku operon UKT sh.a përbën 26.4%.
- Mungesë e azhurnimit të hartave të sistemit
- Mos trajtimi i ujërave të ndotura sipas udhëzimeve të Komunitetit Europian
- Zgjerimi i zonës së shërbimit me ish komunat.
- Performancë financiare e dobët për shkak të detyrimeve të prapambetura të pashlyera apo rrezikut ligjor nga vendimet gjyqësore/përmbarrimore.
- Nivel i matjes prej 75%
- Performancë e dobët arkëtimi e mbartur nga vitet e mëparshme (vlera e madhe e llogarive të arkëtueshme).



Adresa: Rruga 5 Maji, Tiranë, Shqipëri  
Tel: 00 355 42240978  
[info@ukt.al](mailto:info@ukt.al)  
NIPT J620050020

## II. Objektivat Strategjike 2017-2021

Ky biznes plan ka vënë fokusin 5 vjeçar në këto çështje të përmirësimit të performancës:

- Rritja e mbulimit me shërbimin e furnizimit me ujë të popullsisë në Tiranë nga 85% në 95.3% (qyteti i Tiranës 100% dhe komunat 72%) dhe mbulimin me shërbim kanalizimesh nga 78.1% në 83.5%.
- Arritja e shërbimit të pandërprerë, të vazhdueshëm dhe me presion të furnizimit me ujë (24/7) në pjesën më të madhe të zonës së shërbimit të furnizimit me ujë të Tiranës.
- Reduktimi i ujit pa të ardhura nga 67.6 % në 40% deri në vitin 2021. Shoqëria e ka marrë shumë seriozisht këtë çështje, sepse një pjesë e ujit nuk humbet por faktikisht “vidhet” me anë të lidhjeve të paligjshme dhe të paregjistruara në sistem.
- Rritja e normës së arkëtimit të faturave nga 79.9% në 92%.
- Vazhdimi i përmirësimit të qëndrueshmërisë financiare të Shoqërisë në mënyrë që kontributi total i saj të arrijë nivelin 7.3 miliardë lekë gjatë periudhës së planit të biznesit.

Në mbështetje të Objektiveve Strategjike seksioni në vijim paraqet në mënyrë më të detajuar planin konkret të veprimit.

## III. Programi i Përmirësimit të Performancës

Hartimi i Biznes Planit është mbështetur në këto parametra si më poshtë:

### 3.1 Analiza dhe parashikimi i kërkesës për ujë

Analiza e hollësishme e kërkesës aktuale dhe të parashikuar të ujit, si dhe reduktimi i parashikuar i ujit të pa të ardhurave trajtojnë elementët e mëposhtëm:

- Popullsinë në Zonën e Shërbimit dhe Popullsinë e Shërbyer
- Analizën e detajuar të 5 Kategorive të Konsumatorëve (Familjare, Ente Private, Institucionet Buxhetore, Furra Buke, Klientë Specialë)
- Kërkesën Aktuale për Ujë për Frymë (l/f/d)
- Normen e Projektuar të Kërkesës për Ujë (l/f/d)
- Uji pa të Ardhura - Humbjet e Ujit

Elementi i rëndësishëm i kësaj analize është studimi i statistikave mbi popullsinë. Bazuar në të dhënat e INSTAT dhe rregjistrin civil në ish NJQV (Bashkia Tiranë) popullsia totale është 832,302 brenda kufijve administrativë të Bashkisë. Mbulimi është 85% ose 707,800 banorë dhe objektivi është arritja e mbulimit mesatar prej 95.3% UKT.

UKT parashikon të rrisë mbulimin me shërbimin e furnizimit me ujë duke rritur numrin e lidhjeve të reja kryesisht nga: (i) formalizimi i lidhjeve aktuale të parregjistruara (paligjshme) dhe (ii) lidhjet e reja (nga zgjerimi i rjetit).



Adresa: Rruga 5 Maji, Tiranë, Shqipëri

Tel: 00 355 42240978

[info@ukt.al](mailto:info@ukt.al)

NIPT J620050020

Analiza e kërkesës për ujë ka parashikuar ndryshimin në nivelin e prodhimit të ujit deri në vitin 2021. Prodhimi aktual është 106 milionë m<sup>3</sup> dhe deri në vitin 2021 parashikohet të shkojë në 62 milionë m<sup>3</sup> që ndryshe përkthehet ulje prej 42 %. Ky reduktim vjen si rezultat i zbatimit të aksioneve për uljen e nivelit të Ujit pa të Ardhura si dhe një manaxhimi më efikas të kërkesës për ujë nëpërmjet zbatimit të një programi tërësor të matjes nga burimi tek konsumatori.

Shoqëria është e angazhuar për të bërë investimet e nevojshme për rritjen e përqindjes së lidhjeve me ujëmatës në pesë vitet e Planit të Biznesit, në mënyrë që të rrisë lidhjet me ujëmatës në zonën e re të shërbimit të UK Tiranës nga 75% në 2016 në 97% për konsumatorët familjarë në fund të vitit 2021 dhe në 100% lidhje me ujëmatës për entet private dhe institucionet buxhetore deri në fund të vitit 2018.

Tabela në vijim jep treguesit për tu arritur sipas kategorive.

#### Lidhjet me Ujëmatës sipas Kategorisë së Konsumatorëve

Viti Bazë 2016 -2021

Kategoria e klientit	Totali i lidhjeve	Lidhjet me ujëmatës	% e lidhjeve me ujëmatës	Totali i lidhjeve 2021	Lidhjet me ujëmatës	Treguesi për tu arritur në 2021
Familjare	196,611	147,626	75%	227,051	220,239	97%
Ente private	30,614	29,336	96%	34,838	34,838	100%
Institucione buxhetore	634	577	91%	665	665	100%
Klientë të veçantë	27	27	100%	27	27	100%
Furrat e bukës	204	204	100%	204	204	100%

Element tjetër i analizës është parashikimi për shitjet e ujit. Tabela në vijim pasqyron në periudhën e analizës të dhënat mbi prodhimin, shitjen dhe ujin pa të ardhura.

#### Ulja e Parashikuar në Ujin e Prodhuar dhe Ujin Pa të Ardhura (në m<sup>3</sup>/d)

Përshkrimi	2016	2017	2018	2019	2020	2021
Shitje me pakicë	86,082	88,753	90,661	89,952	88,774	88,515
Shitje me shumicë	8,765	10,244	13,584	13,584	13,584	13,584
<b>Totali i shitjes së ujit</b>	<b>94,847</b>	<b>98,997</b>	<b>104,245</b>	<b>103,536</b>	<b>102,358</b>	<b>102,099</b>
Prodhimi i ujit	292,739	265,348	243,112	212,581	187,216	153,632
Uji i blerë	0	17,500	17,500	17,500	17,500	16,533
<b>Totali i ujit që hyn në sistem</b>	<b>292,739</b>	<b>282,848</b>	<b>260,612</b>	<b>230,081</b>	<b>204,716</b>	<b>170,165</b>
Uji pa të ardhura	197,892	183,851	156,367	126,544	102,358	68,066
<b>% e ujit pa të ardhura</b>	<b>67.6%</b>	<b>65.0%</b>	<b>60.0%</b>	<b>55.0%</b>	<b>50.0%</b>	<b>40.0%</b>





Adresa: Rruga 5 Maji, Tiranë, Shqipëri  
Tel: 00 355 42240978  
[info@ukt.al](mailto:info@ukt.al)  
NIPT J620050020

Siç e shohim nga tabela shitja e ujit do të rritet deri në 2021 sepse rritet niveli i matjes dhe mbulimi i popullsisë (arsyet e përmendura më sipër). Nga ana tjetër ulet mbiprodhimi gjë që con në uljen e humbjeve nga 67.6 % në 40%. Kjo tregon eficiencën në menaxhimin e shërbimeve të ofruara nga UKT. Gjithashtu edhe kanalizimet do të rritet mbulimi nga 78% në 83% që kryesisht vjen nga rritja e lidhjeve të rregjistruara. Vlen të përmendet që është në përfundim projekti i JICA për fazën e parë të trajtimit të ujërave të zeza (Kashar) që parashikohet të përfundojë në vitin 2018.

### 3.2 Investimet e parashikuara

Nevojat për investime kapitale, në sistemet urbane dhe rurale të ujësjellësit të menaxhuara nga UK Tiranë, janë vlerësuar bazuar në kushtet ekzistuese të këtyre sistemeve ujësjellës-kanalizime dhe investimeve në vazhdim që janë bërë nga të ardhurat e Shoqërisë, apo me fondet e siguruar nga huaja tregtare që Shoqëria ka me Bankën Kombëtare Tregtare (BKT). Pjesa më e madhe e investimeve të realizuara në këto vitet e fundit, nga fondet e Shoqërisë, lidhen me rehabilitimin e rrjetit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve.

Në shifra të përafërta, investimet e parashikuara për pesë vitet e planit të biznesit klasifikohen në dy grupe kryesore.

- A. Investime kapitale nga fondet e Shoqërisë që arrijnë në total 7.3 miliardë lekë nga të cilat:
- 2.5 miliardë lekë për shpenzime për rinovime kapitale të rrjetit
  - 0.9 miliardë lekë për riparime dhe zëvendësime kapitale
  - 3.9 miliardë lekë për investime të reja kapitale.
- B. Investime kapitale nga huaja tregtare që arrijnë në total rreth 16.26 miliardë lekë nga të cilat:
- 10.3 miliardë lekë për shpenzime për rinovime kapitale të rrjetit
  - 5.9 miliardë lekë për investime të reja kapitale.

Këto investime në total kapin vlerën prej 23.56 miliardë ku vlen të përmenden disa prej projekteve më të rëndësishme si:

- Matësat e rinj mekanikë dhe SMART për entet private
- Dixhitalizimi me GIS dhe Master Plani.
- Shtimi i impjantit të Bovillës
- Ndërtimi i Linjës së re të Transmisionit nga ITU Bovillë deri në Yzberisht-KMY
- Rikualifikim i linjave të transmetimit të Shën Mërisë
- Ndërtimi i By-Paseve të linjave të transmisionit të Impjantit të Bovillës, Burimit të Shen Merise dhe Burimit të Selites.
- Shfrytëzim i vendburimit të Gurit të Bardhë etj.

## IV. Parashikimi i Buxhetit për Operimin dhe Mirëmbajtjen

Parashikimet për buxhetin O&M janë bërë për të pasqyruar të gjitha kostot e operimit dhe të mirëmbajtjes, si dhe efektet që lidhen me Objektivat Strategjike të përcaktuara në Planin e



Adresa: Rruga 5 Maji, Tiranë, Shqipëri  
Tel: 00 355 42240978  
info@ukt.al  
NIPT J620050020

Biznesit. Edhe pse struktura e kostos për ish komunat përbëhej kryesisht nga pagat e personelit, mirëmbajtja dhe materialet, kimikatet dhe energjia elektrike, kostot e operimit dhe mirëmbajtjes janë bashkuar me strukturën e kostos së Shoqërisë ekzistuese UK Tiranë. Në parashikimet e të gjitha shpenzimeve që lidhen me aktivitetet e UK Tiranë të ri-organizuar përfshihen: kostot e punës, shpenzimet e mirëmbajtjes rutinë, kostot e energjisë, kostot e transportit, programi i marrëdhënieve me publikun, etj.

Tabela e mëposhtme paraqet një përmbledhje të parashikimit 5-vjeçar të buxhetit për operimin dhe mirëmbajtjen e UK Tiranë.

#### Buxheti i parashikuar i operimit dhe mirëmbajtjes (Lekë)

Zëri në buxhet	2017	2018	2019	2020	2021
Pagat e punonjësve	806,511,834	807,395,814	850,990,606	867,970,238	867,970,238
Kosto të tjera të punonjësve	126,659,279	131,904,878	139,044,759	141,825,654	141,825,654
Shërbime të kontraktuara	378,720,000	379,694,400	380,688,288	381,702,054	382,736,095
Shpenzime të konsumueshme	957,105,288	910,140,673	739,651,831	737,051,159	713,936,560
<b>Kosto Totale O&amp;M</b>	<b>2,268,996,401</b>	<b>2,229,135,766</b>	<b>2,110,375,484</b>	<b>2,128,549,105</b>	<b>2,106,468,547</b>

#### V. Propozimi për rritjen e tarifave

Nevoja për të ardhura është llogaritur për të mbuluar kostot rutinë të operimit dhe mirëmbajtjes, si dhe nevojën për të financuar rezervat kapitale për rinovim kapitali të infrastrukturës nëntokësore, riparim e zëvendësim kapitali, dhe investime të reja kapitale që duhet të përmbushen nga të ardhurat e Shoqërisë. Së fundi, në të merren parasysh pagesat për huatë e prapambetura që Shoqëria duhet të paguajë për sa i përket pagesave të principalit dhe interesave.

Një përmbledhje e Nevojës për të Ardhura e ndarë sipas zërave kryesore paraqitet në tabelën e mëposhtme:

#### Nevojat Totale për të Ardhura (Lekë)

Përshkrimi	2017	2018	2019	2020	2021
<b>Operimet dhe Mirëmbajtja</b>	<b>2,268,996,401</b>	<b>2,229,135,766</b>	<b>2,110,375,484</b>	<b>2,128,549,105</b>	<b>2,106,468,547</b>
<b>Pagesa e Borxhit</b>					
Pagesa Interesi	105,666,874	229,228,595	385,190,270	535,891,401	624,278,414
Pagesa Principali	351,126,946	823,128,909	843,437,840	1,432,425,566	1,871,216,860
<b>Nëntotal</b>	<b>456,793,820</b>	<b>1,052,357,504</b>	<b>1,228,628,110</b>	<b>1,968,316,967</b>	<b>2,495,495,274</b>
Shpenzime për fondin rezervë për kapitalin					



Adresa: Rruga 5 Maji, Tiranë, Shqipëri  
 Tel: 00 355 42240978  
[info@ukt.al](mailto:info@ukt.al)  
 NIPT J620050020

Rinovim Kapitali	252,596,630	100,000,000	100,000,000	1,000,000,000	1,100,000,000
Riparim e Zëvendësim të Kapitalit	11,892,793	93,215,787	212,624,115	257,297,561	326,796,905
Investime të Reja Kapitale	589,864,535	688,954,674	1,077,832,969	874,679,900	639,517,633
<b>Nëntotal</b>	<b>854,353,957</b>	<b>882,170,461</b>	<b>1,390,457,083</b>	<b>2,131,977,460</b>	<b>2,066,314,538</b>
<b>Nevoja për financime</b>					
Marrëveshje me QQ për të shlyer huan italiane	140,194,477	140,194,477	140,194,477	143,346,999	142,842,595
<b>Nëntotal</b>	<b>140,194,477</b>	<b>140,194,477</b>	<b>140,194,477</b>	<b>143,346,999</b>	<b>142,842,595</b>
<b>Nevojat Totale për të Ardhura</b>	<b>3,439,949,702</b>	<b>4,023,469,253</b>	<b>4,589,266,200</b>	<b>6,085,496,533</b>	<b>6,525,435,763</b>

Bazuar tek Nevoja Totale për të Ardhura UKT sha. ka zhvilluar një Strategji të Tarifave dhe Cmimeve për periudhën 5-vjecare. Tarifat propozohen të ndryshojnë në të gjithë komponentët e secilës kategori konsumatori çdo dy vjet duke u bazuar në shitjet e ujit dhe normat e arkëtimit të cilat rriten nga 90% në vitin 2017 në 92% në vitin 2021. Konkretisht, projektimi i ndryshimit të tarifave dhe cmimeve paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Përshkrimi	2017	2018	2019	2020	2021
<b>Tarifa Mujore Fikse (Lekë/Lidhje/Muaj)</b>					
Familjarë	100	200	200	300	300
Ente Private	100	200	200	300	300
Institucione buxhetore	100	200	200	300	300
Klientë të veçantë	100	200	200	300	300
Furra Buke	100	200	200	300	300
HEC Lanabregas	100	200	200	300	300
<b>Tarifa e furnizimit me ujë (Lekë/m<sup>3</sup>)</b>					
Familjarë	45	65	65	85	85
Ente private	135	190	190	200	200
Institucione buxhetore	120	170	170	190	190
Klientë të veçantë	170	235	235	260	260
Furra Buke	95	130	130	150	150
HEC Lanabregas	5	6	6	7	7
<b>Tarifa e Kanalizimeve (Lekë/m<sup>3</sup>)</b>					
Familjarë	11	11	35	35	35
Ente private	35	35	55	55	55
Institucione buxhetore	30	30	55	55	55
Klientë të veçantë	40	40	55	55	55
Furra Buke	13	13	55	55	55
HEC Lanabregas	0	0	0	0	0
<b>Tarifë specifike për shlyerjen e matësve</b>					
Ente private/klientë të veçantë/furrat e bukës	450	450	450	450	450
<b>Tarifa e furnizimit me ujë me shumicë (Lekë/m<sup>3</sup>)</b>	<b>12</b>	<b>15</b>	<b>15</b>	<b>15</b>	<b>15</b>

Sa më sipër referuar tabelës propozohen rritje proporcionalisht jo të njëjta për të gjitha kategoritë. Konkretisht:



Adresa: Rruga 5 Maji, Tiranë, Shqipëri  
Tel: 00 355 42240978  
[info@ukt.al](mailto:info@ukt.al)  
NIPT J620050020

- (i) Kategoria familjare rritet me 44%, e cila krahasimisht me kategoritë e tjera duke patur efekt social ka qënë disa herë më e ulët se kategoritë, të cilat kanë kompensuar nivelin e saj të ulët.
- (ii) Kategoria ente private rritet me 40%, e cila është kategoria që mund të përballojë pa vështirësi financiare rritjen e tarifës.
- (iii) Kategoria institucione buxhetore pëson rritje prej 41%.
- (iv) Kategoria klientë të vecantë pëson rritje prej 38%.
- (v) Kategoria furra buke furra buke pëson rritje prej 36%.
- (vi) Kategoria Hec Lanabregas pëson rritje të ulët prej 20%.
- (vii) Kategoria uji me shumicë pëson rritje prej 25%.

Sikurse është shpjeguar në analizën e mësipërme për nevojën e pajisjes me matësa SMART ky investim do të fillojë me bizneset private. Për të mos rënduar koston e tyre është menduar që shlyerja e matësave (duke qënë se matësi do të jetë në pronësinë e biznesit) të realizohet një tarifë specifike mujore për entet private/klientë të vecantë dhe furrat e bukës. Kjo tarifë është 450 lekë për periudhën prej 1.5 vite.

Tarifat e kanalizimeve për cdo kategori konsumatori pëson një rritje më të ulët dhe do të fillojë të aplikohet në vitin 2019 pasi në këtë vit do të fillojë operimin Impjanti për Perpunimin e Ujërave të Ndotura në Kashar.

Si rezultat i analizës të të gjithë komponentëve në këtë relacion, rezulton që duke nisur nga viti 2017 totali i nevojave për të ardhura është 3.44 miliardë lekë, ndërsa totali i të ardhurave të përftuara nga arkëtimi nga shitjet dhe shërbimet e tjera është 3.5 miliardë lekë. Pra gjenerohet një rezultat pozitiv prej 60 milionë lekë.

Gjatë periudhës 2018-2021 duke aplikuar ndryshimin e tarifave është parashikuar që UKT do të arrijë objektivat strategjike ku ndër më kryesori është realizimi i investimeve që do të çojë në një shërbim 24 orë.

Përsa më sipër kërkojmë miratimin e Plan Biznesit 2017-2021 nga Këshilli Mbikqyrës dhe Asambleja e Aksionarëve të UKT sh.a.

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

**REDI MOLLA**



Adresa: Rruga 5 Maji, Tiranë, Shqipëri  
Tel: 00 355 42240978  
[info@ukt.al](mailto:info@ukt.al)  
NIPT J620050020

Nr 12689 Prot

Tiranë, më 16/06 /2017

Drejtuar: **ASAMBLESE SË AKSIONAREVE TË UJËSJELLËS KANALIZIME TIRANË**

**BASHKIA TIRANË  
BASHKIA KAMËZ  
BASHKIA VORË**

Lënda: Njoftim për thirrjen e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve të UKT sh.a

Të nderuar Zotërinj,

Në cilësinë e përfaqësuesve të aksionarëve të Shoqërisë UKT Sh.a dhe në zbatim të neneve 135, 136, 137, 138, 139, 154-167 të Ligjit Nr.9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe të Statutit të Shoqërisë, Ju njoftojmë se në datë **07.07.2017, ora 11:00**, në selinë e UKT-së, do të zhvillohet mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerëve të Shoqërisë Ujësjetellës Kanalizime Tiranë Sh.A, me rendin e ditës si vijon:

1. Diskutimi mbi Projekt-Marrëveshjen dhe Projekt-Raportin e Ekspertëve të Pavarur për vlerësimin e Projektit për ndarjen e Aksionarëve Bashkia Vorë dhe Bashkia Kamëz nga Shoqëria Ujësjetellës Kanalizime Tiranë;
1. Miratimi i Plan-Biznesit 5-vjeçar 2017-2021 i shoqërisë Ujësjetellës Kanalizime Tiranë sh.a;
2. Miratimi i Pasqyrave Financiare dhe Bilancit të shoqërisë Ujësjetellës Kanalizime Tiranë për vitin 2016;
3. Miratimi i provizioneve për çështjet gjyqsore të shoqërisë Ujësjetellës Kanalizime Tiranë për vitin 2016;
4. Zëvendësimi i anëtarit të Këshillit Mbikqyrës të shoqërisë Ujësjetellës Kanalizime Tiranë sh.a;
5. Miratimi i transferimit të pasurive, troje nga Ujësjetellës Kanalizime Tiranë sh.a në pronësi të HEC Lanabregas sh.a;
6. Të tjera.

Informacioni lidhur me mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerëve, do të jetë i publikuar në faqen zyrtare në internet të shoqërisë [www.ukt.al](http://www.ukt.al).

Bashkëlidhur gjeni relacionet shpjegues mbi pikat e rendit të ditës që do të jenë të publikuara në faqen zyrtare të UKT sh.a.

Për çdo paqartësi lidhur me rendin e ditës së kësaj mbledhje, si dhe për çdo shtesë, mund të kërkontë sqarim ose të dërgoni sugjerimet me shkrim para datës së mbledhjes së Asamblesë.

Faleminderit për mirëkuptimin.

**DREJTORI I PËRGJITHSHËM**  
**REBI MOLLA**

## PLAN VEPRIMI I PËRGJITHSHËM PËR PROCEDURAT E NDARJES SË SHOQËRISË AKSIONERE

Hapat e veprimeve	Dokumentacionii kërkuar	Afatet e përafërta	Autoriteti përgjegjës	Shënime
<p><b>Faza e parë:</b></p> <p>Thirrja e mbledhjes së Asamblesë së Aksionerëve për: Shqyrtimin e raportit të ekspertëve të pavarur, projekt marrëveshjes së ndarjes dhe dokumentacionit përkatës.</p>	<p>Projekt marrëveshja; Raporti i ndarjes; Pasqyrat financiare vjetore, raportet e ecurisë së veprimtarisë, në mënyrë të detyrueshme, për të paktën tri vitet e fundi.</p>	<p>Sipas afateve për njoftimin e Asamblesë</p>	<p>UKT sh.a. – Drejtori i Përgjithshëm</p>	<p>Thirrja e mbledhjes së asamblesë të kryhet sipas parashikimeve të statutit të shoqërisë.</p>
<p>Mbledhja e asamblesë për miratimin e projekt marrëveshjes së ndarjes</p>	<p>Projekt vendim asambleje; Projekt marrëveshja e ndarjes;</p>	<p>Data e caktuar për mbledhje asambleje</p>	<p>UKT sh.a. Drejtori i Përgjithshëm Drejtoria Juridike</p>	<p>Në këtë fazë nuk nënshkruhet marrëveshje midis aksionerëve, por vetëm miratohet me vendim Asambleje project marrëveshja e ndarjes.</p>
<p>Miratimi i projekt marrëveshjes së ndarjes dhe ngarkimi I kryetarëve të bashkive aksionere me vendim të këshillave bashkiakë përkatës</p>	<p>Projekt vendim asambleje; Projekt marrëveshja e ndarjes; Relacionet dhe project vendimet.</p>	<p>Sipas rregullave për njoftimet e mbledhjes së këshillit bashkiak</p>	<p>Bashkitë aksionere Sekretaritetë e këshillave bashkiakë përkatës</p>	<p>Në referim të kuadrit ligjor për ndarjen e shoqërive ujësjellës kanalizime, kompetencat për ndjekjen e procedurave I takojnë kryetarëve të bashkive</p>

				aksionere. Por për të qënë në përputhje me Ligjin 139/2015 “Për vetëqëverisjen vendore”, cmojmë të kryhet dhe kjo procedurë vendimmarrje nga ana e këshillave bashkiakë.
Rregjistrimi i vendimit të asamblesë për miratimin e projekt marrëveshjes në QKR	Vendim asambleje; Projekt marrëveshja e ndarjes; Raporti i ndarjes; Pasqyrat financiare vjetore, raportet e ecurisë së veprimtarisë, në mënyrë të detyrueshme, për të paktën tri vitet e fundit; Raporti i Ekspertëve.	Afati maksimal që parashikon ligji është një muaj nga data e aktit që depozitohet.	UKT sh.a. Drejtori i Përgjithshëm Drejtoria Juridike	Publikimi qëndron një muaj. Cdo palë e interesuar paraqet në QKR pretendimet e veta.
Modifikimet e raportit dhe projekt marrëveshjes së ndarjes	Raporti i Ekspertëve; Raporti i ndarjes; Projekt marrëveshja e ndarjes	Në varësi të volumit të punës.	Ekspertët	
<b>Faza e dytë</b>  Thirrja e mbledhjes së Asamblesë së Aksionerëve për: Shqyrtimin e raportit final të ekspertëve të pavarur, projekt	Raporti final i Ekspertëve; Raporti i ndarjes; Projekt marrëveshja e ndarjes.	Sipas afateve për thirrjen e mbledhjes së asamblesë; në cdo rast pas kalimit të afatit njëmuajor nga publikimi i project marrëveshjes në QKR;	UKT sh.a. – Drejtori i Përgjithshëm	Sipas parashikimeve të statutit të shoqërisë

marrëveshjes së ndarjes dhe dokumentacionit përkatës.				
Mbledhja e asamblesë për miratimin e projekt marrëveshjes së ndarjes dhe nënshkrimin e saj midis aksionerëve	Projekt vendim asambleje; Projekt marrëveshja e ndarjes;	Data e caktuar për mbledhje asambleje	UKT sh.a. Drejtori i Përgjithshëm Drejtoria Juridike	Në këtë fazë nënshkruhet edhe marrëveshja midis aksionerëve.
Aplikimi në QKR për regjistrimin e marrëveshjes së firmosur	Vendim I Asamblesë; Marrëveshja e nënshkruar së bashku me raportet e ekspertëve; Statuti dhe akti i themelimit dhe aktet përkatëse për themelimin e shoqërive të reja;	30 ditë	UKT sh.a. Drejtoria Juridike	Në kushtet që nga ndarja do të krijohen shoqëri të reja sipas pikës 1 të nenit 227 (shoqëri të themeluara rishtazi) të Ligji Tregtar, duhet të paraqitet dokumentacioni përkatës, për regjistrimin e shoqërive së reja (sipas formës ligjore përkatëse të tyre).
Transferimi I dokumentacionit Ngritja e grupit të punës me përfaqësues nga secila shoqëri	Procesverbale	Menjëherë	Shoqëritë e reja	Ngritja e këtij grupi pune mund të vendoset që në vendimin e asamblesë për miratimin e marrëveshjes finale të ndarjes’  Pas procesit të regjistrimit të shoqërive të reja si



				<p>pasojë e ndarjes duhet që nga shoqëria që ndahet të përgatitet dhe kalohet dokumentacioni që i takon secilës shoqëri pritëse, si libra kontabël, inventar asetesh, lista e punonjësve me të dhënat përkatëse dhe cdo dokument tjetër që i takon nga ndarja shoqërisë pritëse</p>
<p>Marrja në dorëzim e asetëve</p>	<p>Procesverbale</p>	<p>Menjëherë</p>	<p>Shoqëritë e reja</p>	<p>Transferimi i asetëve nga shoqëria që ndahet dhe kalimi i tyre fizikisht tek shoqëritë pritëse duhet të bëhet me procesverbal dorëzimi nënshkruar nga përfaqësuesit e autorizuar të shoqërisë që ndahet dhe atyre pritëse.</p>
<p>Licensimi i shoqërive të reja nga KKRRU dhe marrja e lejeve dhe autorizimeve të tjera mjedisore</p>	<p>Dokumentacioni sipas ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996 dhe kuadrit ligjor për mbrojtjen e mjedisit.</p>		<p>Shoqëritë e reja</p>	<p>Mungesa e licenses nga KRRU dhe A.K.Mjedisit janë pengesë për ushtrim aktiviteti</p>

**UJESJELLËS KANALIZIME TIRANË**  
**UKT SH.A.**

**RAPORTI I EKSPERTIT TË PAVARUR PËR VLERËSIMIN E**  
**PROJEKTIT PËR NDARJEN E AKSIONARËVE, BASHKIA VORË DHE**  
**BASHKIA KAMËZ NGA SHOQËRIA UJËSJELLËS KANALIZIME**  
**TIRANË SH.A.**

**31 DHJETOR 2016**

Tiranë, datë 16 Shkurt 2017

**Përgatitur nga Bashkimi i operatorëve:**  
**UHY Elite sh.p.k dhe “Silvana Abazi” PF**

## PËRMBAJTJA

<b>1.TË PËRGJITHSHME</b>	<b>4</b>
1.1 RRETH “UJËSJELLËS KANALIZIMI TIRANË” SH.A. (SHOQËRIA QË NDAHET)	4
1.2 QËLLIMI	4
1.3 BURIMET E INFORMACIONIT	6
1.4 PËRDORIMI I RAPORTIT	6
<b>2. VLERËSIMI JURIDIK DHE BAZA LIGJORE E PROCESIT TË NDARJES</b>	<b>7</b>
2.1 INFORMACION MBI SHOQËRINË UKT SH.A.	7
2.1.1 Organet e Shoqërisë	9
2.2 OBJEKTI I SHOQËRISË	9
2.2.1 Prishja – Ndarja – Bashkimi	10
2.3 LEJET DHE AUTORIZIMET	10
2.4 PUNËSIMI	11
2.5 GJENDJA FINANCIARE	11
2.6 PASURITË E PALUAJTSHME	11
2.7 MOSMARRËVESHJET	12
2.8 ARSYET PËR NISJEN E PROCEDURAVE TË NDARJES SË SHOQËRISË UKT SH.A.	12
2.9 PROCESI I NDARJES SIPAS LIGJIT NR. 9901, DATË 14.04.2008 “PËR TREGTARËT DHE SHOQËRITË TREGTARE”, I NDRYSHUAR (“LIGJI TREGTAR”)	13
2.10 PROCEDURAT E NDARJES	14
<b>3. RAPORTI PËR PROJEKTIN E NDARJES SË UKT SH.A I DETAJUAR SIPAS GJETJEVE FAKTIKE SIPAS TERMAVE TË REFERENCËS</b>	<b>17</b>
3.1 BAZA LIGJORE DHE VËSHTIRËSITË	17
3.2 MARRËDHËNIET DHE PRAKTIKAT FINANCIARE NDËRMJET UKT SH.A. DHE AKSIONAREVE TË SAJ DERI TANI	18
3.3 ANALIZA E PASQYRAVE FINANCIARE - (ANALIZA E TRANSAKSIONEVE DERI NË DITËN E HARTIMIT TË RAPORTIT DHE TRANSAKSIONET E PRITSHME DERI NË DITËN E NDARJES).	19
3.3.1 Informacioni i marrë	19
3.3.1 Metodologjia dhe puna e kryer	19
3.3.2 Konkluzioni	19
3.4 NDARJA E AKTIVEVE AFATGJATË	20
3.4.1 Informacioni	20
3.4.2 Metodologjia dhe puna e kryer	20
3.4.3 Konkluzioni	23
3.5 PASOJAT LIGJORE DHE EKONOMIKO-FINANCIARE QË VIJNË NGA NDARJA E AKTIVEVE AFATGJATË DHE INFRASTRUKTURËS KRYESORE TË UKT SH.A.	23
3.6 NDARJA E AKTIVEVE AFATSHKURTËR	24
3.6.1 Informacioni i marrë	24
3.6.2 Metodologjia dhe puna e kryer	24
3.6.3 Konkluzioni	27
3.7 ANALIZA E KLIENTËVE /ABONENT TË UKT SH.A.	28
3.7.1 Informacioni i marrë	28
3.7.2 Metodologjia dhe puna e kryer	28
3.7.3 Konkluzioni	29
3.8 NDARJA E KLIENTËVE AKTIVË	30

3.8.1	<i>Informacioni i marë</i>	30
3.8.2	<i>Metodologjia dhe puna e kryer</i>	30
3.8.3	<i>Konkluzioni</i>	30
3.9	VLERËSIMI DHE RAPORTI I NDARJES SË DETYRIMEVE KUNDREJT FURNITORËVE DHE DETYRIME TË TJERA AFATSHKURTËR	30
3.9.1	<i>Informacioni i marrë</i>	30
3.9.2	<i>Metodologjia dhe puna e kryer</i>	31
3.9.3	<i>Konkluzioni</i>	31
3.10	VLERËSIMI DHE NDARJA E HUAVE SIPAS KRITEREVE TË PRANUESHME NË RAPORT ME INVESTIMET DHE IMPAKTIN E TYRE NË RRJETIN SHPËRNDARËS NË PRONËSI TË SECILËS PREJ SHOQËRIVE TË REJA;	32
3.10.1	<i>Informacioni i marë</i>	32
3.10.2	<i>Metodologjia dhe puna e kryer</i>	32
3.10.3	<i>Konkluzioni</i>	33
3.11	VLERËSIMI I GRANTEVE TË MARA	33
3.11.1	<i>Informacioni i marrë</i>	33
3.11.1	<i>Metodologjia dhe puna e kryer</i>	33
3.11.2	<i>Konkluzioni</i>	34
3.12	ANALIZA DHE NDARJA E PUNONJËSVE SI PASOJË E NDARJES TË UKT SH.A. SI DHE PROVIZIONET E PRETENDIMEVE NGA PUNONJËSIT PËR ÇËSHTJET NË GJYKATË	34
3.12.1	<i>Informacioni i marrë</i>	34
3.12.2	<i>Metodologjia dhe puna e kryer</i>	35
3.12.3	<i>Konkluzioni</i>	36
3.13	VLERËSIMI I TË DREJTAVE DHE DETYRIMEVE TATIMORE NË RAPORT ME NDARJEN E AKTIVEVE	36
3.13.1	<i>Informacioni i marrë</i>	36
3.13.2	<i>Metodologjia dhe puna e kryer</i>	37
3.13.3	<i>Konkluzioni</i>	37
<b>4.</b>	<b>BILANCI I PA AUDITUAR NË DATËN 31.12.2016</b>	<b>39</b>

**Drejtuar:** Asamblese se Përgjithshme të Aksionarëve të Shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sh.a.

**Të nderuar Zotërinj,**

Në ekzekutim të Kontratës, Nr. Prot. 22519/7 më datë 16.12.2016 midis UHY Elite sh.p.k. dhe shoqërisë “Ujësjetllës Kanalizime Tiranë” sh.a. (UKT sh.a.) kemi përgatitur këtë Raport të vlerësimit të ndarjes së shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sh.a. (UKT sh.a.) në tre shoqëri për tre bashkitë, Bashkia Vorë, Bashkia Kamëz dhe Bashkia Tiranë, në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 9901, datë 14 Prill 2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore që veprojnë në këtë sektor.

Misioni ynë ka të bëjë me vlerësimin e kushteve të projekt-marrëveshjes së ndarjes, verifikimin nëse vlerat përkatëse që u jepen aksionerëve të shoqërisë UKT sh.a. që marrin pjesë në operacion janë të drejta dhe raporti i këmbimit është i drejtë dhe i arsyeshëm.

Në përputhje me vendimin e sipërpërmendur, Aksionarët kanë emëruar Ekspert të Pavarur Shoqërine “UHY Elite” sh.p.k. në bashkëpunim me personi fizik “Silva Abazi”.

Më poshtë po ju paraqesim Raportin e vlerësimit të ndarjes të shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sh.a. (UKT sh.a.) në tre shoqëri për tre bashkitë, Bashkia Vorë, Bashkia Kamëz dhe Bashkia Tiranë, të përgatitur në përputhje me kushtet e Kontratës, më datë 16.12.2016 Nr. Prot. 22519/7 (shtojca 2.4).

Raporti është konfidencial, sikundër është rënë dakord në kontratë, dhe është subjekt i kufizimeve në përdorim, specifikuar në marrëveshje.

Ne nuk mbajmë asnjë përgjegjësi kundrejt çdo pale në lidhje me përmbajtjen e Raportit. Si rezultat i kufizimeve, kohës në dispozicion, informacionit apo aksesit, ne mund të mos kemi identifikuar të gjitha faktet apo informacionin e nevojshëm për Shërbimin (sikundër përcaktohet në Kontratë) apo ato që ju mund ta konsideroni të rëndësishme.

Analizat që janë përdorur dhe supozimet mbi të cilat ato janë ndërtuar, janë bazuar mbi të dhënat e UKT sh.a. dhe të dhëna publike dhe ne nuk pranojmë asnjë përgjegjësi mbi vërtetësinë e tyre dhe saktësinë përfundimtare.

---

Firmosur nga Përfaqësuesi Ligjor  
UHY Elite sh.p.k

Datë

## 1. Të përgjithshme

### 1.1 Rreth “UJËSJELLËS KANALIZIMI TIRANË” SH.A. (Shoqëria që ndahet)

Shoqëria “Ujësjetllës Kanalizime Tiranë” SH.A. (UKT sh.a.) është një Shoqëri Aksionare, me adresë “Rruga 5 Maji”, pranë Medresesë, Tiranë, Shqipëri, e regjistruar me Vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë Nr. 24875, datë 28.12.2000, bazuar në vendimin e aksionerit të vetëm Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit për krijimin e Ndërmarrjes Ujësjetllës Kanalizime Qytet sh.a. me kapital aksioner prej Lek 2,544,398,000 dhe 2,544,398 aksione me vlerë nominale 1000lek/për aksion si më poshtë:

Aksioneri	Nr Aksioneve	%	Kontributi
Bashkia Tiranë	2,099,108	82,50	2,099,108,000
Bashkia Kamëz	371,486	14,60	371,486,000
Bashkia Vorë	73,804	2,90	73,804,000
<b>TOTALI</b>	<b>2,544,398</b>		<b>2,544,398,000</b>

Në zbatim të vendimit nr. 63 datë 27.1.2016 të Këshillit të Ministrave “Për riorganizimin e operatoreve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”, Asambleja e Aksionareve të shoqërisë UKT sh.a. me vendim Nr. 9 datë 4.4.2016 (shtojca 2.1), shpalli:

*“Vendimmarrjen që ndarja e aksionarëve Bashkia Kamëz dhe Bashkia Vorë nga shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sh.a., të paraprihet nga një Raport i Ekspertëve Kontabël dhe Vlerësues, që do të njohë aksionarët dhe këshillat bashkiakë përkatës, me mënyrën e riorganizimit të shoqërisë pas ndarjes, efektet në kapital dhe ndarjen e aseteve.”*

### 1.2 Qëllimi

Vlerësimi i procesit të ndarjes të shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sh.a. (UKT sh.a.) në tre shoqëri për tre njësitë bashkiake; Bashkia Vorë, Bashkia Kamëz dhe Bashkia Tiranë perben qëllimin e këtij Raporti. Ne kemi marrë përsipër misionin për kryerjen e këtij procesi në përputhje me kushtet dhe termat e references sipas Kontratës Nr. Prot. 22519/7 datë 16.12.2016 të lidhur midis UKT sh.a. dhe UHY Elite sh.p.k.

Objekt i këtij shërbimi është përgatitja e Raportit të Vleresimit të ndarjes së shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sh.a. (UKT sh.a.) në tre shoqëri të reja për tre njësitë bashkiake; Bashkia Vorë, Bashkia Kamëz dhe Bashkia Tiranë në përputhje me termat e Referencës si më poshtë:

- Analizë (due diligence) të të gjitha të dhënave për shoqërinë tregtare UKT sh.a. për statusin ligjor të saj; strukturën e kapitalit të shoqërisë; strukturën e aseteve të shoqërisë; marrëdhëniet me autoritetet publike; kontratat e rëndësishme; marrëdhëniet e punës; huatë dhe kreditë e mundshme që mund të ketë shoqëria; pretendimet e palëve të treta ndaj shoqërisë (gjykatat, arbitrazhet, ekzekutimet nga përmbarimi), në funksion të procesit të ndarjes së aksionarëve Bashkia Vorë dhe Bashkia Kamëz nga shoqëria UKT sh.a.;
- Paraqitja në mënyrë të qartë dhe transparente të pasojave ligjore dhe ekonomiko-financiare që vijnë nga ndarja e aktiveve afatgjatë dhe sidomos nga aktivet afatgjatë të burimeve natyrore dhe infrastrukturës kryesore të UKT sh.a..

- c. Analizë ligjore dhe ekonomike për të vlerësuar përputhshmërinë e kriterëve të propozuara për ndarjen e aktiveve afatgjatë nëse janë në përputhje me udhëzimet e këshillit mbikqyrës dhe me aktet ligjore në fuqi;
- d. Vlerësimi financiar dhe kontabël i bilancit të shoqërisë UKT sh.a., i paraqitur për ndarje në projekt-marrëveshjen e ndarjes nëse pasqyron një situatë reale të pasurisë dhe detyrimeve të shoqërisë në datën e ndarjes;
- e. Vlerësimi dhe analiza e transaksioneve të kryera deri në ditën e hartimit të Raportit shpjegues të procesit të ndarjes që përmendet më sipër, si dhe analiza financiare nëse Raporti shpjegues i ka paraqitur këto transaksione në mënyrë transparente dhe të saktë për aksionerët e shoqërisë UKT sh.a.;
- f. Verifikimi, nëse lista e aktiveve afatgjatë, është e përditësuar deri në ditën e hartimit të projekt-marrëveshjes së ndarjes. Verifikimi i cdo shtesë apo pakësimi të aktiveve afatgjatë pas datës së hartimit të projekt-marrëveshjes deri në ditën e hartimit të raportit shpjegues, dhe nëse këto shtesa apo pakësime janë analizuar dhe paraqitur në mënyrë të saktë dhe transparente në raportin shpjegues për aksionerët e shoqërisë. Nëse ka mangësi në raportin shpjegues, të paraqitet në mënyrë të saktë e të plotë lista e aktiveve afatgjatë.
- g. Analizë dhe verifikimi i bilancit të shoqërisë UKT sh.a., bashkëlidhur projekt-marrëveshjes, për pasqyrimin e situatës reale dhe të saktë të asetëve dhe detyrimeve të shoqërisë, në datën e përcaktuar për ndarjen;
- h. Vlerësimin e aktiveve afatgjatë dhe efektet e saj në ndarjen e shoqërisë dhe në raportin e aksioneve të aksionereve që largohen; ii) ndarja e aktiveve të tjera jo afatgjatë (përveç likuiditeteve) sipas kriterit të nevojës dhe domosdoshmërisë për të përmbushur detyrat dhe funksionet e cdo shoqërie të re të krijuar duke marrë në konsideratë përkatësinë fizike dhe gjeografike e tyre; iii) ndarja e klientëve aktivë sipas përkatësisë gjeografike dhe/ose pronësisë së re mbi rrjetin shpërndarës.
- i. Analizën financiare dhe ligjore për borxhet e vjetra (debitë e këqija) dhe ndarja e tyre sipas një kriteri të pranueshëm në raport me ndarjen e shoqërive të reja;
- j. Vlerësimin për ndarjen e inventareve (materialeve) në përputhje me ndarjen e shoqërive të reja dhe sipas nevojave specifike të tyre;
- k. Vlerësimi dhe raporti i ndarjes së detyrimeve kundrejt furnitorëve në përputhje me ndarjen e aktiveve për secilën pjesë të aktiveve që i përkasin secilës prej shoqërive të reja;
- l. Vlerësimin dhe ndarjen e huave sipas kriterëve të pranueshëm në raport me investimet dhe impaktin e tyre në rrjetin shpërndarës në pronësi të secilës prej shoqërive të reja;
- m. Vlerësimin e rezervave, granteve, provizioneve dhe fitimeve të pashpërndara dhe ndarjen e tyre në mënyrë të drejtë me aktivet dhe pasivet e tjera të bilancit të shoqërisë;
- n. Vlerësimin e të drejtave dhe detyrimeve tatimore në raport me ndarjen e aktiveve dhe të elementeve të tjerë përkatës të bilancit të shoqërisë;
- o. Përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve ligjore dhe ekonomiko-financiare midis shoqërive të reja që krijohen si rezultat i ndarjes së UKT sh.a. në mënyrë të drejtë dhe të qartë;
- p. Përgatitja e një raporti dhe analize të detajuar për objektin e kërkuar të kontratës duke paraqitur avantazhet dhe disavantazhet, dhe duke e vënë theksin tek pasojat ligjore dhe

ekonomike që vijnë nga procesi i ndarjes së aksionarëve Bashkia Vorë dhe Bashkia Kamëz nga shoqëria UKT sh.a.

### **1.3 Burimet e informacionit**

Raporti ynë bazohet;

- a. Në informacionin e përgatitur nga grupi i punës krijuar me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të UKT sh.a. Nr. 22 datë 19.01.2017 (stafi i UKT sh.a.) si dhe stafit të UKT sh.a.
- b. Në përgjigje të pyetjeve specifike dhe nga analizat e bëra mbi ekzaminimin e informacioneve dhe evidencave dhe dokumenteve të tjera.
- c. Ne zhvilluam gjithashtu takime të rregullta me grupe specialistësh inxhinier/teknik dhe ekonomik të UKT sh.a.

Për më shumë detaje referohuni shtojca nr.1 që përmban listën e dokumentacioneve shoqëruese të raportit.

### **1.4 Përdorimi i Raportit**

Ky raport do të përdoret vetëm për qëllimin e përmendur më lart sipas kontratës me Nr. Prot. 22519/7 datë 16.12.2016 nënshkruar mes palëve, si dhe i shërben vetëm Asamblese së Përgjithshme të Ortakëve të UKT sh.a.

---

Firmosur nga Përfaqësuesi Ligjor  
UHY Elite sh.p.k

---

Datë



## **2. Vlerësimi Juridik dhe baza ligjore e procesit të ndarjes**

Vlerësimi juridik është hartuar nga ekspertet ligjor të konsulentit me qëllim që të asistojë Shoqërinë Ujësjetllës Kanalizime Tirana sh.a., në marrjen e vendimit përkatës lidhur me ndarjen e aksionerëve Bashkia Kamëz (BK) dhe Bashkia Vorë (BV) nga UKT sh.a.

Raporti është hartuar në bazë të informacionit, dokumentacionit dhe të dhënave të vëna në dispozicion nga përfaqësuesit e “UKT” sh.a dhe nuk tenton të jetë një raport ligjor i cili të përmbajë të gjithë informacionin që Klienti mund të dëshirojë, të kërkojë apo konsiderojë si të nevojshëm me qëllim marrjen e vendimit përfundimtar lidhur me realizimin e ndarjes, por vetëm atë informacion dhe opinion bazuar në faktet, të dhënat dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion nga “UKT” sh.a. dhe në kuadrin ligjor në fuqi, që zbatohet në rastin e këtij transaksioni.

Me marrjen e këtij Raporti, UKT sh.a. konsiderohet se ka pranuar shprehimisht dhe në mënyrë të pakushtëzuar se Konsulenti (i) nuk ka qenë i ngarkuar me detyrën për të hetuar apo verifikuar informacionin, dokumentacionin dhe të dhënat e vëna në dispozicion nga përfaqësuesit shoqërisë UKT sh.a.; dhe se (ii) nuk është aspak përgjegjës për pasaktësitë që mund të reflektohen për shkak të mungesës së vërtetësisë apo saktësisë së këtyre informacioneve, dokumentacioneve dhe të dhënave.

### **2.1 Informacion mbi shoqërinë UKT sh.a.**

Emri, kohëzgjatja, kapitali themeltar dhe ortakët e Shoqërisë

Shoqëria “UKT” sh.a. është një shoqëri aksionare themeluar sipas legjislacionit shqiptar, e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit (“QKR”) me NIPT (NUIS) J62005002O, me seli në Rruga “5 Maji”, pranë Medresesë, Tirana, Shqipëri.

Shoqëria “UKT” sh.a. si një shoqëri aksionare me kapital shtetëror, është krijuar me vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tirana nr. 2475, datë 28.12.2000, bazuar në vendimin e aksionerit të vetëm Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit për krijimin e Ndërmarrjes Ujësjetllës Kanalizime Qytet sh.a. me kapital prej 2,008,900,000 lekë, aksione 2,008,900 me vlerë nominale 1000 lek/për aksion, tërësisht i paguar më kontribute në natyrë.

Me vendim nr.228, datë 4.6.2003 aksioneri i vetëm Ministria e Ekonomisë, vendosi bashkimin me përthithje të Ndërmarrjes Ujësjetllës Kanalizime Qytet me Ndërmarrjen e Ujësjetllës Kanalizime Fshat regjistruar ne Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tirana me vendim nr. 24875/2, datë 17.7.2003. Pas bashkimit, kapitali i shoqërisë u bë 2,561,571,000 lekë, dhe numri i aksioneve 2,561,571, me vlerë nominale 1,000 lek për aksion.

Në 24 dhjetor 2007, me numrin e çështjes: CN-109845-12-07, regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (“QKB”), kuota që mbahej nga aksionari i vetëm Ministria e Ekonomisë tek Shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Tirana, u transferua në pronësi të njërive vendore të zonës së shërbimit që përbëhet nga 3 bashki dhe 16 komuna. Me datë 14.01.2010, me numrin e çështjes: CN-334160-01-10, kapitali i shoqërisë ka ndryshuar nga Lekë 2.561.571.000,00 në Lekë 2.544.398.000,00, me transferimin e aksioneve njërive të qeverisjes vendore në dhjetor 2007, në zbatim të VKM Nr. 660, datë 12.09.2007, si më poshtë:

<b>Aksioneri</b>	<b>Nr. Aksioneve</b>	<b>%</b>	<b>Kontributi</b>
Komuna Prezë	10,170	0.4	10,170,000
Komuna Farkë	33,074	1.3	33,074,000
Komuna Vaqar	25,441	1	25,441,000
Komuna Petrelë	20,365	0.8	20,365,000
Komuna Shëngjergjaj	10,170	0.4	10,170,000
Bashkia Kamëz	259,540	10.2	259,540,000
Komuna Zall Herr	30,535	1.2	30,535,000
Komuna Dajt	33,074	1.3	33,074,000
Komuna Bërxullë	28,000	1.1	28,000,000
Bashkia Tiranë	1,844,697	72.5	1,844,697,000
Bashkia Vorë	35,634	1.4	35,634,000
Komuna Baldushk	15,269	0.6	15,269,000
Komuna Paskuqan	111,946	4.4	111,946,000
Komuna Kashar	58,510	2.3	58,510,000
Komuna Bërzhitë	17,803	0.7	17,803,000
Komuna Krrabë	10,170	0.4	10,170,000
<b>TOTALI</b>	<b>2,544,398</b>	<b>100</b>	<b>2,544,398,000</b>

Me hyrjen në fuqi të ligjit nr.115/2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë” aksionet e shoqërisë UKT sh.a, u rikonfiguruan sipas ndarjes së re administrativo-territoriale, duke u shpërndarë si më poshtë:

<b>Aksioneri</b>	<b>Nr Aksioneve</b>	<b>%</b>	<b>Kontributi</b>
Bashkia Tiranë	2,099,108	82,50	2,099,108,000
Bashkia Kamëz	371,486	14,60	371,486,000
Bashkia Vorë	73,804	2,90	73,804,000
<b>TOTALI</b>	<b>2,544,398</b>		<b>2,544,398,000</b>

Aksionet e Shoqërisë janë të zakonshme. Sipas nenit 3 të Statutit, kohëzgjatja e Shoqërisë “UKT” sh.a është e pakufizuar.

Në zbatim të vendimit nr. 63, datë 27.1.2016 të Këshillit të Ministrave “Për riorganizimin e operatoreve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”, Asambleja e Aksionareve të shoqërisë UKT sh.a. me vendim Nr. 9, datë 4.4.2016, vendosi:

“Vendimmarrja për ndarjen e aksionarëve Bashkia Kamëz dhe Bashkia Vorë nga shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sh.a., të paraprihet nga një Raport i Ekspertëve Kontabël dhe Vlerësues, që do të njohë aksionarët dhe këshillat bashkiakë përkatës, me mënyrën e riorganizimit të shoqërisë pas ndarjes, efektet në kapital dhe ndarjen e asetëve.”

### 2.1.1 Organet e Shoqërisë

Organet e Shoqërisë UKT sh.a janë:

- Asambleja e Përgjithshme;
- Këshilli Mbikëqyrës;
- Drejtori i Përgjithshëm.

#### Asambleja e Përgjithshme

Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë ‘UKT’ sh.a. Në përputhje me Statutin e Shoqërisë dhe legjislacionin për shoqëritë tregtare, Asambleja merr vendim për: ndryshimin apo plotësimin e Statutit të Shoqërisë; zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit themeltar; ri-investimin e fitimeve vjetore; pjesëtimin e aksioneve dhe anulimin e tyre; ndryshimet në të drejtat që lidhen me aksionet e kategorive të ndryshme; riorganizimin, shpërndarjen, transformimin, bashkimin, shkrirjen, ndarjen, prishjen apo likuidimin e Shoqërisë si edhe riorganizimin e Shoqërisë në një formë tjetër; ndërmarrjen e çdo veprimi i cili pritet në mënyrë të arsyeshme se do të çojë në likuidimin e Shoqërisë etj;

Asambleja e përgjithshme përbëhet nga Bashkia Tiranë, Bashkia Kamëz, Bashkia Vorë.

#### Këshilli Mbikëqyrës

Shoqëria mbikëqyret nga Këshilli Mbikëqyrës i cili përbëhet nga 6 anëtarë të cilët emërohen në detyrë për një afat jo më të gjatë se 3 (tre) vjet, me të drejtë rizgjedhje. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës zgjidhen si më poshtë:

- a) Aksionari që zotëron më shumë se  $\frac{1}{2}$  e aksioneve të shoqërisë, zgjedh 50+1 të anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës;
- b) Anëtarët e tjerë të Këshillit Mbikëqyrës zgjidhen nga aksionarët e tjerë;
- c) Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës nuk mund të jenë të punësuar në këtë shoqëri.

#### Drejtori i Përgjithshëm ( Administratori)

Drejtori i Përgjithshëm është person fizik i emëruar për një afat 3 (tre) vjeçar, me të drejtë rizgjedhje. Vendimet e përditshme të cilat kanë të bëjnë me administrimin e zakonshëm të Shoqërisë do të merren nga Drejtori i Përgjithshëm i shoqërisë. Drejtori i Përgjithshëm duhet t'i raportojë Këshillit Mbikëqyrës dhe Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve të shoqërisë.

Drejtori i Përgjithshëm i shoqërisë UKT sh.a është z. Redi Molla, i cili është i emëruar në detyrë me vendim nr. 01, datë 22.02.2016 të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë UKT sh.a, vendim i cili është i depozituar dhe regjistruar në QKR në datë 26.02.2016

## 2.2 Objekti i Shoqërisë

### Objekti i Shoqërisë UKT sh.a përfshin kryesisht:

“Shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm të konsumatorëve dhe shitjen e tij. Mirëmbajtjen e sistemeve të furnizimit me ujë të pijshëm. Prodhimin dhe/ose blerjen e ujit për plotësimin e kërkesave të konsumatorëve. Shërbimi i grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura dhe shitja e tij. Mirëmbajtjen e sistemeve të ujërave të ndotura si dhe të impianteve të pastrimit të tyre. Studimin, Projektimin e ndërtimin e sistemeve të furnizimit me ujë dhe

kanalizimeve. Lidhjen e kontratave të furnizimit me ujë me konsumatorët në zonën e shërbimit. Lidhja e konsumatorëve me rrjetin publik të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve të ujërave të ndotura; Projektimi, miratimi dhe zbatimi i skemave të furnizimit me ujë. Zhvillimi i rrjetit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve duke e përshtatur atë me standardet ndërkombëtare; Shërbimi ndaj konsumatorit në funksion të përmbushjes së detyrimeve kontraktuale dhe ato të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Zbatimi i rregulloreve higjieno-sanitare dhe mjedisore të miratuara për projektimin, ndërtimin dhe shfrytëzimin e objekteve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve të ujërave të ndotura”.

Shoqëria mundet të realizojë çdo lloj operacioni financiar apo tregtar, që lidhet direkt apo indirekt me objektin e saj, brenda limiteve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

### 2.2.1 Prishja – Ndarja – Bashkimi

Sipas nenit 25 të statutit, Shoqëria “UKT” sh.a mund të prishet si rrjedhojë e vërtetimit të shkaqeve të parashikuara nga ligji. Në rast prishjeje, Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë likuidues duke u caktuar kompetencat reciproke në përputhje me ligjin në fuqi. Shoqëria mund edhe të ndahet apo bashkohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme. Kjo lloj vendimmarrje sipas statutit kërkon pjesëmarrjen e  $\frac{3}{4}$  të aksioneve me të drejtë votë. Për procedurën e ndarjes nuk ka nevojë për ndonjë miratim apo autorizim nga Autoriteti përgjegjës për konkurrencën.

### 2.3 Lejet dhe autorizimet

Shoqëria UKT sh.a është e pajisur me këto licenca:

#### Numri i licencës Licencë

PN-9375-02-2015	Leje Mjedisi e tipit A
PN-9372-02-2015	Leje Mjedisi e tipit A
PN-9374-02-2015	Leje Mjedisi e tipit A
PN-8348-10-2014	Leje e integruar mjedisore
PN-8617-11-2014	Leje e integruar mjedisore
PN-0672-08-2015	Leje Mjedisi e tipit A
PN-9373-02-2015	Leje Mjedisi e tipit A

Sipas përmbajtjes së këtyre lejeve dhe licencave transferimi i të drejtave dhe detyrimi i tyre bëhet me vendim të organit që i ka lëshuar, me kusht që si titullari aktual ashtu dhe subjekti të cilit i kalohen këto të drejta dhe detyrime japin pëlqimin me shkrim për këtë kalim/transferim. Procedurat kryhen pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe QKB.

Shoqëria UKT sh.a. zotëron licencën miratuar me Vendimin nr. 21 datë 01.07.2013, lëshuar nga KKRRU për furnizimin me ujë. Sipas Rregullores së Licencimit së miratuar me vendim të KKRRU nr. 29, datë 08.12.2009 “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridikë e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe të largimit të përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar, neni 10, parashikohet se:

### **“Modifikimi i Licencës**

Në përgjigje të çdo kërkesë të të licencuarit ose me iniciativën e vet, KKRRU mund të modifikojë termat dhe kushtet e një licence, duke ndjekur procedurat e parashikuara në nenin 26 të Ligjit Nr.8102, datë 28.03.1996 “Për kuadrin rregullator të furnizimit me ujë...”

KKRRU mund të vendosë modifikimin e licencës në rastet e mëposhtme:

a) kur ka ndryshime të rrethanave të lëshimit të licencës, (kuadri ligjor, vendime të gjykatës, VKM) ose të disa ngjarjeve që ndikojnë në mënyrë të konsiderueshme në administrimin e sistemeve të furnizimit me ujë, largimit dhe trajtimit të ujerave të ndotura, etj.; b) kur ka ndryshime ligjore, teknike ose financiare që bëjnë të pamundur plotësimin e pjesshëm ose të plotë të kushteve të vendosura në licencë; c) kur ka ndryshime në strukturën e të licencuarit duke përfshirë ndarjen, bashkimin ose transformimin në një person tjetër fizik apo juridik.

Nëse KKRRU vendos të ndryshojë një licence, duhet t’i lëshojë të licencuarit një licencë me përmbajtje të ndryshuar, duke shfuqizuar pjesët e ndryshuara të licencës së mëparshme.

Në rastin e modifikimit / ndryshimit të licencës, KKRRU zbaton të njëjtat afate dhe procedura si për licencimin duke kërkuar dhe informacionin shtesë nëse është e nevojshme”.

Në rastin e ndarjes së UKT sh.a. në tre shoqëri pritëse, të tre këto të fundit do të duhet të aplikojnë në KKRRU për t’u pajisur me licencat përkatëse. UK Bashkia Tiranë mund të kërkojë transferimin e licencës ekzistuese të shoqëria pritëse me modifikimet përkatëse që I përshtaten kushteve të reja të funksionimit të veprimtarisë së saj.

### **2.4 Punësimi**

Shoqëria “UKT” sh.a. ka 1220 të punësuar. Marrëdhëniet e punës rregullohen nga Kodi i Punës. Struktura organizative jepet në shtojcat bashkëngjitur këtij raporti.

Shoqëria “UKT” sh.a. është e regjistruar pranë Inspektoratit të Punës dhe ka derdhur të gjithë detyrimet e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në institucionet përkatëse. Ndarja e shoqërisë nuk duhet të ndikojë në të drejtat e punonjësve të shoqërisë. Ky është një detyrim që kërkohet si nga Ligji Tregtar, ashtu dhe një garanci për punonjësit në kuptim të nenit 138 të Kodit të Punës, i cili parashikon se transferimi i ndërmarrjes, aktivitetit ekonomik nuk mund të përkeqësojë kushtet e marrëdhënies së punës në dëm të punëmarrësit dhe marrëdhënia e punës konsiderohet e vazhdueshme.

### **2.5 Gjendja financiare**

Për informacion të plotë mbi këtë pikë, referoju raportit të ekspertëve të pavarur kontabël. Nga të dhënat e vëna në dispozicion nga UKT sh.a. nuk rezulton që shoqëria të jetë në proces administrativ apo gjyqësor, ose në hetime nga organi i akuzës për çështje që lidhen me menaxhimin financiar, çështje fiskale apo kontabël për shoqërinë.

### **2.6 Pasuritë e paluajtshme**

Shoqëria zotëron pasuri të paluajtshme, të cilat janë vlerësuar si aktive të saj në regjistrat përkatës kontabël. Për më shumë informacion mbi pasuritë e paluajtshme dhe asetëve referoju Raportit të ekspertëve të pavarur kontabël. Një listë e të dhënave mbi pasuritë e paluajtshme dhe asetëve e shoqërisë jepet në shtojcat bashkëngjitur këtij raporti. Nga të dhënat e vëna në dispozicion nga UKT sh.a. nuk rezulton që shoqëria të jetë në proces administrativ apo

gjyqësor, ose në hetime nga organi i akuzës për çështje që lidhen me pasuritë e paluajtshme në pronësi të saj.

## 2.7 Mosmarrëveshjet

Nga të dhënat e vëna në dispozicion nga UKT sh.a. rezulton që shoqëria është palë në procese gjyqësore civile për konflikte pune me ish punonjës të saj, kontratat e punës së të cilëve janë zgjidhur në mënyrë të njëanshme nga UKT sh.a. Lista e proceseve gjyqësore jepet në shtojcat bashkëngjitur këtij raporti. Nga vlerësimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga UKT sh.a. çmujmë se pjesa më e madhe e këtyre proceseve do të rezultojnë me vendimmarrje nga ana e gjykatës kundër UKT sh.a. Kjo për efekt të procedurave të gabuara dhe në kundërshtim me ligjin për zgjidhjen e njëanshme të kontratës së punës, të ndjekur nga UKT sh.a.

Kostot përkatëse të mundshme që rezultojnë nga humbja e këtyre proceseve gjyqësore është llogaritur nga ekspertët e pavarur në mënyrë të përafërt. Për më shumë informacion mbi këto përlllogaritje referoju raportit të ekspertëve të pavarur kontabël.

Gjithashtu, nga të dhënat e vëna në dispozicion nga UKT sh.a. rezulton që shoqëria të jetë palë në 43 procese gjyqësore me objekte të ndryshme, të ndara në grupe si më poshtë:

1. Pavlefshmëri titulli ekzekutiv/gjobë;
2. Detyrim pagim shume;
3. Shpërblimi i dëmit jopasuror.

Lista e proceseve gjyqësore jepet në shtojcat bashkëngjitur këtij raporti. Nga vlerësimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga UKT sh.a. kostot përkatëse të mundshme që rezultojnë nga humbja e këtyre proceseve gjyqësore është llogaritur nga ekspertët e pavarur në mënyrë të përafërt. Për më shumë informacion mbi këto përlllogaritje referoju raportit të ekspertëve të pavarur kontabël.

## 2.8 Arsyet për nisjen e procedurave të ndarjes së shoqërisë UKT sh.a.

Arsyet për nisjen e procedurave të ndarjes burojnë nga kërkesat e ligjit nr. 115/2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”. Ky ligj ka përcaktuar një ndarje të re administrative territoriale të njësive së qeverisjes vendore duke parashikuar konkretisht se në Republikën e Shqipërisë janë 61 bashki dhe 12 qarqe. Kjo lloj ndarje e re administrative, me konstituimin e njësive të qeverisjes vendore dhe rikonfigurim e tyre, kërkonte riorganizimin e funksioneve të gjithë strukturave përkatëse që lidhen me qeverisjen vendore.

Me vendim nr. 510, datë 10.6 2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial” u përcaktuan procedurat konkrete për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial.

Më tej, me hyrjen në fuqi të vendimit nr. 63, datë 27.01 2016 të Këshillit të Ministrave “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura” u materializua mënyra se si do të

kryhej riorganizimi i shërbimeve të furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura në Republikën e Shqipërisë, sipas ndarjes së re administrative-territoriale. Sipas këtij vendimi të gjitha njësitë e shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura detyrohen të organizohen si shoqëri aksionare, sipas sistemit me një nivel administrimi dhe funksionojnë në bazë të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.”, dhe duhet të veprojnë sipas zonës së juridiksionit të bashkisë përkatëse.

Ndodhur në këto kushte, mbështetur në detyrimet ligjore e sipërcituar, Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve të shoqërisë UKT sh.a. miratoi dy vendime:

1. Vendim nr.9, datë 04.04.2016 i Asamblesë së Përgjithshme se Aksionareve të shoqërisë UKT sh.a. “Mbi fillimin e procesit paraprak të ndarjes së Bashkisë Vorë dhe Bashkisë Kamëz nga shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sh.a”;
2. Vendim nr.11, datë 31.08.2016 i Asamblesë së Përgjithshme se Aksionerëve të shoqërisë UKT sh.a. “Mbi miratimin e modaliteteve për ndarjen e aksionereve së Bashkisë Vorë dhe Bashkisë Kamëz nga shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sh.a”.

Sipas këtyre vendimeve, Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve të shoqërisë UKT sh.a. vendosi të kryhet ndarja e aksionarëve së Bashkisë Vorë dhe Bashkisë Kamëz nga shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sh.a” në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi, e në mënyrë të veçantë me ligjin për shoqëritë tregtare, duke përcaktuar se kjo ndarja do të behet sipas këtyre kriterëve:

- Nevoja për furnizim me ujë të banorëve të bashkive përkatëse;
- Qëllimi dhe destinacioni për të cilin janë ndërtuar dhe përdorën asetet/pasuritë e UKT sh.a. (funksionalitetit të aktiveve);
- Subjekti ose institucioni që ka investuar për ndërtimin e aseteve ose përfituesi i këtij investimi;
- Numri i abonentëve/klientët të shtrirë në territoret Bashkia Tiranë, Bashkia Kamëz dhe Bashkia Vorë.

## **2.9 Procesi i ndarjes sipas ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar (“ligji tregtar”)**

Drejtimi ekonomik elastik i strukturave të shoqërisë dhe krijimi i rrjeteve të shoqërive, shpesh, kërkojnë transformimin (riorganizimi) e shoqërisë nëpërmjet formave të ndryshme si bashkimin e shoqërive, shndërrimin ose ndarjen e tyre dhe “lidhjen me kontratë” të pjesëve të cilat integrohen në shoqëri të pavarura që, për shembull, mund të administrohen si “shoqëri të përbashkëta”, së bashku me shoqëritë e interesuara.

Neni 214 e vijim i Ligjit Tregtar parashikon një paketë të plotë të procedurave për riorganizimin e shoqërive (sh.p.k.-ve dhe sh.a.-ve) përmes bashkimit (nenet nga 215 deri në 226), përmes ndarjes (neni 227) ose përmes ndryshimit të formës (nenet 228 dhe 229).

Ndarja e shoqërisë ndodh kur një shoqëri tregtare ndahet duke ia kaluar pasuritë e veta dy ose më shumë shoqërive tregtare ekzistuese ose të reja (të themeluarit rishtazi), me vendim të

asamblesë së përgjithshme, rast në të cilin shoqëria që ndahet pushon së ekzistuari. Kjo forme riorganizimi, kryesisht, kërkon edhe garantimin e këtyre katër kushteve ligjore:

- Mbrojtja e të drejtave dhe interesave të ortakëve ose e aksionarëve të shoqërive të përfshira në procesin e riorganizimit;
- Mbrojtja e kreditorëve të drejtat e të cilëve kanë lindur përpara riorganizimit. Në favor të kreditorëve të shoqërisë së ndarë, shoqëritë pritëse përgjigjen në mënyrë individuale dhe solidare, së bashku me shoqërinë ndarëse, për angazhimet e kësaj të fundit;
- Mbrojtja e punëmarrësve të shoqërive në riorganizim;
- Kalimi “automatik” i aktiveve të ndërmarrjeve ekzistuese në subjektet juridike të formuara rishtazi.

Megjithatë, duke qenë se pasuritë e shoqërisë së ndarë i marrin të paktën dy shoqëri të tjera, logjika e thjeshtë kërkon disa modalitete të këmbimit të aksioneve, që duhet të zgjidhen dhe të parashikohen në aktmarrëveshjen e ndarjes.

Më konkretisht, për ndarjen e shoqërisë zbatohen dispozitat e neneve 216 deri në 225 të Ligjit Tregtar. Regjistrimi i ndarjes së shoqërisë kryhet pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit dhe ka si pasojë:

- kalimin të shoqëritë pritëse të të gjitha aktiveve e pasiveve të shoqërisë që ndahet, në përputhje me raportin e ndarjes, të përcaktuar në marrëveshjen e ndarjes. Ky kalim sjell pasojë për marrëdhëniet ndërmjet shoqërive, si dhe për palët e treta;
- bërjen e aksionarëve/ortakëve të shoqërisë që ndahet aksionarë apo ortakë të një ose më shumë shoqërive pritëse, në përputhje me raportin e ndarjes, përcaktuar në marrëveshjen e ndarjes;
- vlerësimin e shoqërisë që ndahet si e prishur dhe çregjistrimin e saj nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, sipas seksionit V të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit “pa kryerjen e likuidimit.

## 2.10 PROCEDURAT E NDARJES

Procedurat e ndarjes kryhen në dy faza.

### FAZA E PARË

- Miratimi i projekt marrëveshjes së ndarjes me Vendim Asambleje;
- Depozitimin e kësaj projekt marrëveshjeje dhe të gjithë dokumenteve shoqëruese pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit në përputhje me nenin 216 e vijues të Ligjit Tregtar; Dokumentacioni shoqërues përmban:
  - Projekt marrëveshjen;
  - Raportin e ndarjes;
- Pasqyrat financiare vjetore, raportet e ecurisë së veprimtarisë, në mënyrë të detyrueshme, për të paktën tri vitet e fundi.
- Raporti i Ekspertëve.
  - Raporti i ekspertëve depozitohet pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit dhe publikohet në faqen e internetit, nëse ka, të shoqërive që marrin pjesë në ndarje, të paktën një muaj përpara datës së caktuar për mbledhjen e



asamblesë, në lidhje me vendimin e përcaktuar në nenin 218 të Ligjit Tregtar.

- Përfshirja e ekspertëve, mund të përjashtohet nëse të gjithë aksionarët/ortakët e shoqërive që bashkohen japin miratimin.

Projekt marrëveshja qëndron e publikuar një muaj në QKR me qëllim që të bëhet e njohur nga të tretët dhe të njoftohen pretendimet e mundshme për ndonjë efekt që sjell ndarja tek interesat e të tretëve apo palëve të interesuara. Pas përfundimit të këtij afati, duhet të kryhen korrektimet dhe saktësimet përkatëse, nëse ka, dhe hartohet raporti përfundimtar në bazë të së cilit bëhen dhe modifikimet përkatëse në projekt marrëveshje.

Në referim të kuadrit ligjor për ndarjen e shoqërive ujësjetllës kanalizime, kompetencat për ndjekjen e procedurave i takojnë kryetarëve të bashkive aksionere. Por, për të qenë në përputhje me ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, çmojmë të kryhet dhe miratimi i projekt marrëveshjes dhe ngarkimi i kryetarëve të bashkive aksionere për ndjekjen e procedurave të ndarjes me vendim të këshillave bashkiakë përkatës.

## **FAZA E DYTË**

- Vendimi i Asamblesë së Përgjithshme të Aksionareve të Shoqërisë, i cili miraton projekt marrëveshjen e ndarjes. Asambleja e Përgjithshme e Aksionareve të shoqërisë që ndahet duhet të mbledhet të paktën një muaj pas publikimit të kësaj projekt marrëveshje në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit në përputhje me nenin 216 paragrafi 3 të Ligjit Tregtar;
- Nënshkrimi i Marrëveshjes së ndarjes;
- Regjistrimi i Marrëveshjes në QKR; Në kushtet që nga ndarja do të krijohen shoqëri të reja sipas pikës 1 të nenit 227 (shoqëri të themeluara rishtazi) të Ligji Tregtar, duhet të paraqitet dokumentacioni përkatës, sipas ligjit për regjistrimin e shoqërive së reja (sipas formës ligjore përkatëse të tyre). Statuti dhe akti i themelimit dhe aktet përkatëse për themelimin e shoqërive të reja, gjenden në shtojcat e këtij raporti;

### **Transferimi dokumentacionit**

Pas procesit të regjistrimit të shoqërive të reja si pasojë e ndarjes duhet që nga shoqëria që ndahet duhet të përgatitet dhe kalojë dokumentacioni që i takon secilës shoqëri pritëse, si libra kontabël, inventar asetesh, lista e punonjësve me të dhënat përkatëse si dhe çdo dokument tjetër që i takon nga ndarja shoqërisë pritëse.

### **Marrja në dorëzim e aseteve**

Transferimi i aseteve nga shoqëria që ndahet dhe kalimi i tyre fizikisht tek shoqëritë pritëse duhet të bëhet me procesverbal dorëzimi nënshkruar nga përfaqësuesit e autorizuar të shoqërisë që ndahet dhe atyre pritëse. Për këtë çmojmë se është e nevojshme të grihet një grup pune me urdhër të secilit drejtues të shoqërive të përfshira në këtë proces. Për procedurat e transferimit palët mund ti referohen për analogji VKM nr. 510, datë 10.06.2015.

### **Procedura e licencimit pranë KKRRU**

Shoqëritë pritëse duhet secila të ndjekin procedurat për licencimin nga KKRRU sipas parashikimeve të Ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996, me ndryshime, dhe akteve ligjore dalë në bazë e për zbatim të tij. Gjithashtu, këto shoqëri duhet të aplikojnë për lejet mjedisore dhe çdo leje a autorizim tjetër të nevojshëm për ushtrimin e aktivitetit të tyre.

### **2.11. PROJEKTAKTET**

Bashkangjitur këtij raporti jepet:

- Plani i hapave për t'u ndjekur për procedurën e ndarjes;
- Projekt marrëveshja e ndarjes;
- Draft i aktit të themelimit dhe statutit të shoqërisë pritëse sipas parashikimeve të VKM nr. 63, datë 27.01.2016.

### **3. RAPORTI PËR PROJEKTIN E NDARJES SË UKT SH.A I DETAJUAR SIPAS GJETJEVE FAKTIKE SIPAS TERMAVE TË REFERENCËS**

#### **3.1 Baza ligjore dhe vështirësitë**

Bazuar në Strategjinë Kombëtare Sektoriale e shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizime, persa i takon aspekteve financiare, Shoqëritë e Ujësjetllës Kanalizimeve konsiderohen si shoqëri tregtare publike të llojit të veçantë dhe aktiviteti i tyre bazohet në ligjin nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtaret dhe shoqëritë Tregtare” i ndryshuar dhe në aktet e tjera nënligjore në zbatim të tij Shoqëritë aksionare të ujësjetllës kanalizimeve, nëpërmjet veprimtarisë së tyre sigurojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm konsumatorëve dhe shitjen e tij, prodhimin, blerjen e ujit për plotësimin e kërkesës së konsumatorëve dhe mirëmbajtjen e të dy shërbimeve, të furnizimit me ujë të pijshëm dhe të kanalizimeve.

Rregullimi i sektorit të furnizimit me ujë bazohet në Ligjin Nr. 8102, datë 28.03.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar.

Këshilli i Ministrave miraton politikat dhe strategjinë kombëtare në sektorin e furnizimit me ujë dhe të largimit e të përpunimit të ujërave të ndotura.

Enti Rregullator, nëpërmjet përcaktimit të çmimit u jep mundësi shoqërive të ujësjetllës kanalizimeve të rikuperojë kostot e arsyeshme të kryerjes së një shërbimi efektiv, duke përfshirë dhe mundësinë për të siguruar një fitim mbi investimin e tij, që është i mjaftueshëm për përmirësime kapitale dhe ndërtime të reja.

Për vetë vështirësitë dhe karakteristikat e sektorit, shoqëritë e ujësjetllës kanalizimeve marrin donacione dhe financime të ndryshme nga buxheti, dhe institucionet financiare ndërkombëtare për investime.

Me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 63 datë 27.01.2016 “Për riorganizimin e operatoreve që ofrojnë shërbimin me furnizimin me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”, njësitë e shërbimit duhet të riorganizohen sipas ndarjes së re administrative territoriale, në përputhje me ligjin nr. 115/2014. Sipas statutit tip të shoqërive aksionare shtetërore të Ujësjetllës Kanalizimeve neni 3, “kapitali” pika 2, Kontributet e Aksionarit janë Kontribute në natyre.

Gjatë kryerjes së vlerësimit të kuotave të aksionerëve të UKT sh.a., konstatoam që përcaktimi i pjesëmarrjes në kapitalin e shoqërisë ka ndryshuar në vite së bashku me transferimi i aksioneve. Ndryshimi i vazhdueshëm i pronarëve në thelb ka krijuar vështirësi në vlerësimin e kuotave për dhe ndarjen e aksionarëve, sipas kriterëve orientues që ka parashikuar vendimi i asamblesë nr. 11 datë 31.08.2016.

Më konkretisht, vështirësitë e paraqitura janë pasojë e aplikimit të metodave jo tradicionale të vlerësimit të kontributeve të aksionareve në shoqërinë e krijuar nder vite. Në rastin konkret, për futjen e aksionereve të rinj (Bashkia Vorë dhe Bashkia Kamëz), konstatohet se nuk është përdorur asnjë kriter që lidhet me kontributet në natyre apo në mjete monetare por përkundrazi është konceptuar nëpërmjet një kriteri të pazakontë i cili referohet numrit të popullsisë banuese në njësinë administrative që bëhet aksioner në UKT sh.a.

Aplikimi i kriterit të sipërpërmendur, krijon një paqartësi në dukje të vlerësimit të kontributeve/aseteve me qëllim ndarjen e shoqërisë UKT sh.a, por që në të vërtetë nga

pikëpamja ekonomike, ky vlerësim duhet të bazohet vetëm me kontributet reale ekonomike dhe me asetet reale/konkrete që një shoqëri posedon apo trashëgon gjatë një riorganizimi.

Në këtë kuptim, si kontribute reale për rastin konkret, përveç aseteve, do të konsiderohen numri i klientëve abonentë (atyre që ju shitet me pakicë) me të cilët shoqëria ka kontrata, dhe jo numri i popullsisë që jeton në territorin e njësive administrative të cilës ajo i ofron shërbimin e furnizimit me ujë.

Arsyet që ne na bën të mendojmë se ky kriter është i papërshtatshëm janë si me poshtë.

- a. Në nuk arritëm të bëjmë një lidhje të qartë midis ndikimi të numrit të popullsisë së njësive të reja administrative Kamëz dhe Vorë, dhe përfitimeve të realizuara nga UKT sh.a. që nga momenti i futjes së tyre si aksioner deri në ditën e këtij raporti.
- b. Njësitë administrative kanë kaluar në pronësi të UKT sh.a. vetëm një pjesë të aseteve që i përkisnin këtij shërbimi në territoret e tyre.
- c. Edhe pse u përdor një kriter i tillë, banorët e këtyre njësive administrative nuk u mbuluan asnjëherë me shërbimin e furnizimit të ujit nga shoqëria UKT sh.a.

**Si konkluzion në çmujmë se kriteret e përdorura në atë kohë për vlerësimin e transferimit të aksioneve tek Bashkia Vorë dhe Bashkia Kamëz nuk përfaqësojnë raporte reale, të drejta dhe nuk janë zbatuar në mënyrë korrekte, rrjedhimisht këto raporte të zotërimit e aksioneve nuk mund të përdoren si kriter në rastin e ndarjes së shoqërisë.**

Në vend të kësaj ne vlerësojmë që kriteri i ndarjes së shoqërisë UKT sh.a. të bazohet në kriteret dhe parime që janë më të drejta dhe më përfaqësuese të interesave të tyre në Shoqërinë UKT sh.a. Një prej tyre mund të jetë vlera neto e aktiveve që i kalojnë në administrim shoqërive të reja të krijuara nga ndarja e UKT sh.a. sipas njësive administrative përkatëse Tiranë, Vorë, dhe Kamëz.

Përcaktimi i vlerës neto të aktiveve bazohet në vlerën neto kontabël të aktiveve afatgjatë materiale në datën 31.12.2016, dhe në vlerën neto kontabël të llogarive të arketueshme (klientë abonentë) në datën 31.12.2016 për aksionarët që largohen Bashkia Vorë dhe Bashkia Kamëz. Ndërsa për aksionarin Bashkia Tiranë aktivet e transferuar do të jenë për diferencë midis totalit të aktiveve në datën 31.12.2016 dhe pjesës përkatëse që i kalon aksionarëve të larguar Bashkia Kamëz dhe Vorë. Kjo formë transferimi do të thotë që Aksionari Bashkia Tiranë në shoqërinë e re që do krijohet, do të marrë të gjitha detyrimet e tjera që shoqëria UKT sh.a. ka ndaj të tretëve, institucioneve financiare, punonjësve, dhe institucioneve të tjera ligj-zbatuese.

Të dhënat numerike të aktiveve afatgjatë materiale dhe klientëve abonent që janë object i ndarjes, jepen në seksionin përkatëse të këtij raporti (sek. 4.6 dhe 4.7).

### **3.2 Marrëdhëniet dhe praktikat financiare ndërmjet UKT sh.a. dhe aksionareve të saj deri tani**

Nga grupi i punës krijuar me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të UKT sh.a. Nr. 22 datë 19.01.2017 (“stafi i UKT”), (shtojca 2.5) morëm informacionet e mëposhtme, në lidhje me marrëdhëniet që ekzistojnë midis shoqërisë UKT sh.a. dhe njësive administrative Bashkia Vorë dhe Bashkia Kamëz:

- a. UKT sh.a. në bazë të kontratës së furnizimit Nr.Prot 672 datë 14.07.2003 (shtojca 15), furnizon me ujë me shumicë Bashkinë Kamëz, e cila me pas ia faturon ujin klientëve të saj në territorin e Bashkisë Kamëz. Kësaj kontate i janë bërë ndryshime në vitin 2011 pas miratimit të një tjetër cmimi të shitjes së ujit me shumicë nga ERRU.
- b. Bashkia Vorë në bazë të kontratave referuar në shtojca 15, ka vendosur në datë 27.02.2015:
  - kalimin në përdorim të UKT sh.a të aktiveve dhe rrjetin e saj të kanalizimeve
  - kalimin e zonës së shërbimit të furnizimit me ujë të Bashkisë Vorë nën administrimin e UKT sh.a.
  - kalimin e përgjegjësisë për vjeljen e borxhit të keq të abonentëve për furnizimin me ujë nga Bashkia Vorë tek UKT sh.a.

### **3.3 Analiza e Pasqyrave Financiare - (Analiza e transaksioneve deri në ditën e hartimit të raportit dhe transaksionet e pritshme deri në ditën e ndarjes).**

#### **3.3.1 Informacioni i marrë**

Ne kemi marrë nga grupi i punës Pasqyrat Financiare të audituara për vitin 2015 (shtojca 3.1). Gjithashtu kemi marrë Pasqyrat Financiare të pa-audituar për vitin 2016. U vumë në dijeni që inventarizimi fizik i Aktiveve Afatgjatë Materiale dhe i inventarëve të tjera materiale në datën 31.12.2016, është në proces, pra i paperfunduar deri në momentin e dorëzimit të këtij raporti.

#### **3.3.1 Metodologjia dhe puna e kryer**

Në këto kushte ne kemi marrë nga grupi i punës së UKT sh.a., një pasqyrë të Bilancit të pa-audituar në datën 31.12.2016 për ndarje, dhe ne kemi verifikuar me metoda dhe teknika të ndryshme auditimi, saktësinë e këtij bilanci, duke u bazuar në çështjet e paraqitura në raportin e auditimit të vitit 2015 dhe në vlerësimin e rrezikut për ekzistencën e ndonjë gabimi material në Bilancin e ndarjes të pa-audituar në datën 31.12.2016 të përgatitur nga grupi i punës së UKT sh.a.

#### **3.3.2 Konkluzioni**

Duke konsideruar sa më sipër, bazuar në Pasqyrat Financiare të vitit 2015 në Bilancin e ndarjes në datën 31.12.2016 (shtojca 3.2) përgatitur nga grupi i punës së UKT sh.a., si dhe në verifikimin e informacioni nga ana jonë mbi shtesat dhe pakësimet e llogarive kontabël bazuar në vlerësimin e rrezikut gjatë vitit 2016, ne kemi arritur në konkluzionet e mëposhtme:

- a. Vërejtjet e paraqitura në raportin e auditimit të vitit 2015 qëndrojnë dhe Shoqëria UKT nuk na ka paraqitur ndonjë evidencë të posaçme që efektet e mundeshe të këtyre vërejtjet të janë ezauruar në Bilancin e ndarjes në datë 31.12.2016.
- b. Ne kemi kryer procedurat bazuar në metodat dhe në vlerësimin e rrezikut për realizimin e këtij misioni, dhe deri në ditën e paraqitjes së këtij raporti ne nuk kemi arsye të qenësishme për të besuar se Bilanci i ndarjes përmban pasaktësi materiale

- përveçse ato që janë shprehur në Raportin e auditimit të vitit 2015 dhe në ato të përmendura me poshtë në seksionin e gjetjeve faktike.
- c. Duke qenë se Bilanci në datën 31.12.2016 i paraqitur nga stafi UKT sh.a. nuk është përfundimtar, duhet të merret arsyeshëm në konsideratë se Bilanci i ndarjes në datën 31.12.2016 mund të jetë subjekt i ndryshimeve dhe azhornimeve deri në momentin e përfundimit të pasqyrave financiare përfundimtare të audituara të UKT sh.a.
  - d. Nga dita e përgatitjes së Bilancit të ndarjes (31.12.2016) deri ditën e ndarjes, shoqëria do vijojë aktivitetin e saj normal dhe të gjitha transaksionet që do të kryen gjatë kësaj periudhe tranzitore do të jenë objekt i rishikimit dhe i ndryshimit të marrëdhënieve të drejtave dhe detyrimeve midis palëve që ndahen. Transaksionet pritet të japin efekte në tepricën e klientëve, detyrimeve ndaj punonjësve, si dhe transaksionet që lindin si pasojë e kontratës Nr. Prot 672 datë 14.07.2003 të ndryshar në vitin 2011.
  - e. për furnizimin me ujë (me shumicë) të Bashkisë Kamëz nga UKT sh.a.. Të gjitha këto duhet të reflektohen në marrëdhëniet e detyrimeve dhe të drejta midis palëve nga data 1 Janar 2017 deri në ditën e ndarjes përfundimtare të aktiviteteve.
  - f. Nuk është objekt i këtij misioni që të parashikojmë me saktësi apo të verifikojmë procesin e ndarjes së transaksioneve të ndodhura gjatë periudhës tranzitore, megjithatë për me shumë informacion rreth kësaj çështje referoju seksionit 5 të këtij Raporti.

## 3.4 Ndarja e Aktiveve Afatgjatë

### 3.4.1 Informacioni

Ne kemi marrë nga stafi i UKT sh.a në formë elektronike dhe të printuara regjistrin e Aktiveve Afatgjata Materiale (AAM) më datë 31.12.2015 (shtojca 4) dhe më pas kemi verifikuar të gjitha lëvizjet shtesa dhe pakësimi deri në datë 31.12.2016 (shtojca 4).

Ne kemi marrë gjithashtu dhe raportin e rivlerësimit të fundit të aktiveve afatgjatë të kryer nga shoqëria Studio Load sh.p.k në datën 31.12.2013 efektet të cilat janë reflektuar në Bilancin e audituar datë 31.12.2014 (Ref. shtojca 3.5). Pas kësaj date nuk janë bërë rivlerësime të tjera të AAM-ve

### 3.4.2 Metodologjia dhe puna e kryer

Pas marrjes së informacionit sa më lart ne kemi kryer procedura të ndryshme bazuar në analizën e rrezikut, për të verifikuar saktësinë e këtij informacioni. Grupi ynë i punës ka analizuar në detaje regjistrin e AAM të përditësuar deri në datën 31.12.2016 i cili është përdorur si bazë për ndarjen e AAM në tre shoqëritë e reja që do krijohen. Ne kemi verifikuar nëse procesi ndarjes së tyre është kryer në përputhje me modalitetet e përcaktuara në vendimin Nr. 11 datë 31.08.2016 të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve (shtojca 3), i cili i referohet disa parimeve bazë si më poshtë:

- a. Qëllimi dhe destinacionit për të cilin janë ndërtuar këto objekte (funktionalitetit të aktivitetit)
- b. Nevoja për furnizim me ujë të banorëve të bashkive përkatëse
- c. Subjektit apo institucionit që ka investuar për ndërtimin e tyre apo përfituesit të këtij investimi

d. Numri i abonentëve/klientët të shtrire në territoret Bashkia Tiranë

e. , Bashkia Kamëz dhe Bashkia Vore.

Në bazë të vlerësimit të rrezikut dhe sipas metodave të përzgjedhjes që kemi zbatuar ne kemi kryer analiza të mjaftueshme për të patur një siguri të pranueshme se kriteret e mësipërme janë respektuar gjatë procesit të ndarjes.

Grupi i punës së UKT sh.a. bazuar në Bilancin financiar të pa-audituar në datën 31.12.2016 të Shoqërisë UKT sh.a., në përputhje me kriteret e mësipërme të përcaktuara në Vendimin Nr. 11 datë 31.08.2016 të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerëve ka paraqitur AAM në datën 31.12.2016 në mënyre analitike të ndara sipas bashkive Tiranë, Kamëz, Vorë.

Në shuma dhe kategori përmbledhëse nga procesi i ndarjes së AAM kemi këto të dhena:

Vlera Neto e Aktiveve Afatgjatë të Materiale e ndarë sipas tre shoqërive të reja që krijohen:

Aktivet Afatgjata Materiale		31 Dhjetor 15	31 Dhjetor 2016	Ndarja e propozuar në shoqëritë e reja		
				UKB Tiranë	UKB Kamëz	UKB Vorë
Aktive afatgjata materiale (bruto)	<b>a</b>	13,090,776,000	14,385,298,033	14,123,113,369	181,996,064	80,188,600
Amortizimi Aktive afatgjata materiale	<b>b</b>	(565,883,000)	(843,974,534)	(796,893,730)	(33,088,278)	(13,992,526)
Aktive afatgjata materiale (neto)	<b>(a-b)</b>	12,524,893,000	13,541,323,499	13,326,219,639	148,907,786	66,196,074
Aktive të tjera afatgjata		956,085,878	956,085,878	956,085,878		
<b>Totali</b>		<b>13,480,978,878</b>	<b>14,497,409,377</b>	<b>14,282,305,517</b>	<b>148,907,786</b>	<b>66,196,074</b>

Në mënyrë më të detajuar AAM të cilat në datën 01.01.2017 do t'u kalojnë shoqërive të reja që krijohen në Bashkitë Tiranë, Kamëz dhe Vorë paraqiten si më poshtë:

**Tiranë**

<b>Përshkrim</b>	<b>Vlera Bruto</b>	<b>Amortizimi i akumuluar</b>	<b>Vlere neto</b>
Toka/Troje	2,094,752,202	-	2,094,752,202
Ndërtesa	4,489,100,995	249,377,914	4,239,723,081
Rrjet Ujësjetllës	3,063,140,163	302,352,508	2,760,787,655
Rrjet kanalizimesh	693,886,744	58,307,980	635,578,764
Makineri Pajisje	106,109,009	40,684,480	65,424,530
Mjete Transporti	163,309,372	68,392,103	94,917,269
Mobilje dhe paisje zyre	99,062,419	49,268,409	49,794,011
AAM - Magazine	77,205,947	19,787,568	57,418,379
AA materiale në proces	3,336,546,514	-	3,336,546,514
Zhvleresime dhe amortizime te tjera		8,722,766	
<b>Totali Tiranë</b>	<b>14,123,113,366</b>	<b>796,893,727</b>	<b>13,326,219,639</b>

**Kamëz**

<b>Përshkrim</b>	<b>Vlera Bruto</b>	<b>Amortizimi i akumuluar</b>	<b>Vlere neto</b>
Toka/Troje	7,434,000	-	7,434,000
Ndërtesa	3,060,450	333,673	2,726,777
Rrjet Ujësjetllës	170,355,489	32,250,850	138,104,638
Rrjet kanalizimesh	-	-	-
Makineri Pajisje	1,146,125	503,756	642,369
Mjete Transporti	-	-	-
Mobilje dhe paisje zyre	-	-	-
AAM - Magazine	-	-	-
AA materiale në proces	-	-	-
<b>Totali Kamëz</b>	<b>181,996,064</b>	<b>33,088,279</b>	<b>148,907,785</b>

**Vorë**

<b>Përshkrim</b>	<b>Vlera Bruto</b>	<b>Amortizimi i akumuluar</b>	<b>Vlere neto</b>
Toka/Troje	27,248,600	-	27,248,600
Ndërtesa	3,905,364	498,544	3,406,820
Rrjet Ujësjetllës	45,089,409	12,288,433	32,800,976
Rrjet kanalizimesh	-	-	-
Makineri Pajisje	2,176,002	469,458	1,706,544
Mjete Transporti	275,000	274,999	1
Mobilje dhe paisje zyre	1,494,227	461,092	1,033,135
AAM - Magazine	-	-	-
AA materiale në proces	-	-	-
<b>Totali Vorë</b>	<b>80,188,602</b>	<b>13,992,526</b>	<b>66,196,076</b>

<b>Totali i AAM</b>	<b>14,385,298,032</b>	<b>843,974,532</b>	<b>13,541,323,499</b>
---------------------	-----------------------	--------------------	-----------------------



### 3.4.3 Konkluzioni

Duke u bazuar në vlerësimin e rrezikut, në metodologjinë e përshkruar më lart, në dokumentacionin e mbledhur dhe në punën e kryer nga grupi ynë i punës ne arritëm në konkluzionet tona si me poshtë:

- a. Ashtu sikurse shprehet në raportin e auditimit të Pasqyrave Financiare të Vitit 2015 në paragrafin ‘Baza për mosdhënie opinioni’ dhe në shënimin 6 të Pasqyrave Financiare të vitit 2015 Në lidhje me Aktivet Afatgjatë në proces, shoqëria ka përfshirë në Aktive Afatgjatë në proces një vlerë prej Lek 1,026,003 të trashëguar nga vitet përpara vitit 2014 për të cilën nuk ka dokumentacion të plotë në datën 31.12.2015. Grupi ynë i punës nuk ka arritur të marrë ndonjë informacion shtesë për të hequr dyshimin mbi këto paqartësi të evidentuara më herët.
- b. Ashtu sikurse shprehet në raportin e auditimit të Pasqyrave Financiare të Vitit 2015 në paragrafin ‘Baza për mosdhënie opinioni’ dhe në shënimin 6 të Pasqyrave Financiare të vitit 2015 Në lidhje me Aktivet Afatgjatë zëri Toka në vlerë 2,155,486,000 Lek, Shoqëria nuk ka dhënë informacione të detajuara në lidhje me metodën e përdorur për rivlerësimin e zërit Toka. Grupi ynë i punës nuk ka arritur të marrë ndonjë informacion shtesë në lidhje me këtë çështje të evidentuara me herët.
- c. Ashtu sikurse shprehet në raportin e auditimit të Pasqyrave financiare të Vitit 2015 në paragrafin ‘Baza për mosdhënie opinioni’ shoqëria nuk ka kryer ndonjë rregjistrim për riciklimin e fitimit nga rivlerësimi, nga Rezerva rivlerësimi në Fitime të pashpërndara në mënyrë graduale ose në momentin e transferimit të aktiveve, ashtu sikurse kërkohet nga Standardi Ndërkombëtar i Kontabilitetit 16, “Aktivet Afatgjatë Materiale”.
- d. Nga puna që ka bërë stafi i UKT sh.a. dhe grupi ynë i ekspertëve, përveç sa përmendur më sipër nuk kemi ndonjë arsye tjetër të mendojmë se Aktivet Afatgjatë Materiale nuk paraqesin vlerën e tyre reale në përputhje me vlerën e tregut, dhe se procesi i ndarjes së të jetë i pa saktë apo me gabime materiale të cilat mund të kenë ndikim material në aktivitetin, funksionin dhe në kapitalet e veta të shoqërive që ndahen.
- e. Gjatë punës sonë ne nuk kemi patur ndonjë arsye apo indikator që të na bëjë të mendojmë se ndarja e Aktiveve Afatgjatë të shoqërisë UKT sh.a. nuk është bërë në përputhje me parimet e sipërpërmendura.
- f. Së fundmi, Ne kemi kryer punën tonë, në kushtet kur UKT sh.a. nuk kishte përfunduar pasqyrat financiare finale të vitit të mbyllur në datën 31.12.2016, dhe informacioni për shtesat/pakësimet gjatë vitit 2016 është bazuar në regjistrimet e deri tanishme të bëra nga stafi i UKT sh.a. Si rrjedhojë, vlerat përfundimtare neto të AAM mund të jenë subjekt ndryshimi të pasqyrave financiare përfundimtare.

### 3.5 Pasojat ligjore dhe ekonomiko-financiare që vijnë nga ndarja e aktiveve afatgjatë dhe infrastrukturës kryesore të UKT sh.a.

Ashtu sikurse përmendet në paragrafin 4.2 të këtij raporti, shoqëria e re UKB Tiranë pas ndarjes do të vazhdojë të furnizojë me ujë me shumicë shoqërinë në Bashkinë Kamëz, si dhe do të furnizojë me ujë me shumicë shoqërinë në Bashkinë Vorë, në bazë të kontratave të reja midis tre shoqërive që krijohen. Për shoqërinë e re në Bashkinë Kamëz nuk do përbëjë ndonjë

ndryshim substancial duke qenë se ekziston një praktikë ku UKT sh.a. furnizon me ujë me shumicë Bashkinë Kamëz. Për më shume informacion rreth efekteve ligjore, referoju seksionit të Vlerësimit Juridik më lart seksioni 2. Vlerësimi Juridik.

### 3.6 Ndarja e aktiveve afatshkurtër

#### 3.6.1 Informacioni i marrë

Në bazë të dokumentacionit të analizuar dhe Pasqyrave Financiare për vitin 2015, si dhe pasqyrave financiare të pa-audituar për vitin 2016, Aktivët Afatshkurtër të UKT sh.a. paraqiten si më poshtë:

Aktivet Afatshkurtër	31 Dhjetor 15	31 Dhjetor 2016	Ndarja e propozuar në shoqëritë e reja		
			UKB Tiranë	UKB Kamëz	UKB Vorë
Mjetet Monetare dhe te Ngjashme	345,322,000	214,397,231	214,397,231		
<i>Llogaritë e arkëtueshme (Bruto)</i> <i>a</i>	3,594,336,000	3,874,298,896	3,650,927,385	203,800,805	19,570,706
<i>Zhvlerësimi Llogarive të arkëtueshme</i> <i>b</i>	(932,527,000)	(866,060,140)	(797,650,384)	(63,684,265)	(4,725,491)
Llogarite e arkëtueshme (Neto) <i>(a-b)</i>	2,661,809,000	3,008,238,756	2,853,277,001	140,116,540	14,845,215
Inventarët	374,536,000	460,430,586	460,430,586		
Aktive të tjera dhe paradhënie		92,667,366	92,667,366		
<b>Totali I Aktiveve Afatshkurtër</b>	<b>3,381,667,000</b>	<b>3,775,733,940</b>	<b>3,620,772,185</b>	<b>140,116,540</b>	<b>14,845,215</b>

#### 3.6.2 Metodologjia dhe puna e kryer

Duke u bazuar në informacionin e dhënë nga UKT dhe në vlerësimin e rrezikut ne kemi kryer ekzaminimet dhe procedurat e duhura për të verifikuar saktësinë e informacionit të dhënë dhe për vlerësuar nëse procesi i ndarjes është kryer sipas modaliteteve të përcaktuara në Vendimin e Asamblesë Nr.11 datë 31.08.2016.

Ne kemi analizuar informacionin që na ka vënë në dispozicion grupi i punës së UKT sh.a. (shtojca 3.1) duke u nisur nga Pasqyrat Financiare të vitit 2015 dhe lëvizjet e kryera gjatë vitit 2016.

- a. Likuiditeti përbëhet nga teprica e mjeteve monetare dhe të ngjashme me ato në datën 31.12.2016. Tepricat e llogarive bankare në datën 31.12.2016 paraqiten si më poshtë:

<b>Llogaritë bankare</b>	<b>Gjendja në Lek në 31.12.2016</b>
BKT Banka Konbëtare Tregtare - shpërndarje/shitje	936,462.91
Credins Banka - shpërndarje/shitje	428,583.73
Union Banka - shpërndarje/shitje	858,482.75
NBG Banka - shpërndarje/shitje	38,380.00
Procredit banka - shpërndarje/shitje	16,896.00
Intesa Sanpaolo - shpërndarje/shitje	-500.00
Emporiki Banka	58,340.00
Alpha Bank	1,111,160.30
UBA Bank	558,802.00
Tirana Bank	231,196.80
Banka Raiffeisen	-150.00
SOCIETE GENERALE ALBANIA	209,539.99
BKT- Banka Kometare Tregtare - adminitrata	184,698,392.16
Credins Bank - administrtat	17,162,882.58
BKT Kredia llogari rrjedhëse	0.41
Raiffeisen Bank	960,061.16
BKT llogari ne EURO 25.04 EUR	3,386.16
BKT llogari ne dollare 4,046.59 USD	518,651.44
<b>Totali i Bankave</b>	<b>207,790,568.39</b>
<b>Mjete te tjera te ngjashme</b>	
Unioni financiar	1,219,583.00
P&G	44,593.00
Posta	3,194,730.00
MPESA	16,580.00
AKT INVEST	338,664.50
EASY PAY	870,584.05
INTESA SANPAOLO	117,361.20
INTESA SANPAOLO	804,566.50
	<b>6,606,662.25</b>
<b>Totali i mjeteve monetare 31.12.2016</b>	<b>214,397,230.64</b>

Pas marrjes së këtij informacioni, duke u bazuar në vlerësimin e rrezikut në kemi kryer ekzaminimet dhe procedurat e duhura për të verifikuar saktësinë e informacionit të mjeteve monetare. Është e rëndësishme të përmendet se në procedura të tilla ndarje, Mjetet monetare nuk janë pjesë e procesit të ndarjes.

Për më shumë informacion rreth Mjeteve monetare referoju shtojca 9 “Mjetet Monetare”.

- b. Llogaritë e arketueshme. Puna që është bërë për analizën dhe ndarjen e Llogarive të arketueshme paraqitet në Par. 4.7 më poshtë.
- c. Inventarët, përbëhen nga vlera neto (kosto minus zhvlerësime) prej Lek 460,430,586 dhe një paraqitje më e detajuar e tyre jepet në tabelën më poshtë:

<b>Përshkrim</b>	<b>Gjendja në Lek në 31.12.2016</b>
Materiale - Ndërtim/Asfaltim	20,677,804
Materiale - Rrjet Ujësjetllës Kanalizime	17,885,809
Materiale - Hidraulike	164,686,089
Materiale - Matesa	151,887,990
Materiale - Pjesë Këmbimi	32,199,430
Materiale - Elektrike	9,073,231
Materiale - Kancelari	12,078,339
Materiale - Konsumi	27,834,319
Instrumenta/Veshje Pune	10,545,810
Materiale - Të tjera	10,594,813
Materiale - Karburant	2,635,347
Materiale - Kimikate dhe te ngjashme	1,136,163
Materiale jashtë përdorimit në magazinë	2,370,893
Inventar i imet në magazinë	10,390,944
<b>Inventar në magazinë</b>	<b>473,996,980</b>
Inventar në reparte	5,342,307
Materiale jashtë përdorimit	26,405,589
Inventar I imet në përdorim	13,919,188
Inventar i imet nga HEC	80,000
<b>Inventar në përdorim</b>	<b>45,747,084</b>
<b>Totali i Inventarit (bruto)</b>	<b>519,744,064</b>
Provizione per zhvleresimin e materialeve	(39,491,433)
Provizione per zhvleresimin e materialeve	(16,924,848)
Provizione per zhvleresimin e inv. Imet	(2,897,197)
<b>Total i provizioneve për inventarin</b>	<b>(59,313,478)</b>
<b>Totali i inventarit (neto)</b>	<b>460,430,587</b>

Grupi i punës së UKT na ka paraqitur listën e inventarit kontabël të inventarëve qarkulluese (shtojca 4.4) sepse inventarizimi fizik ishte në proces dhe deri në momentin e përgatitjes së këtij raporti, kontrolli i inventarit fizik nuk kishte mbaruar nga UKT sh.a. Sipas planit të ndarjes Aktive afat shkurtra do kalojnë të gjitha në UKB Tiranë.

- d. Aktive të tjera dhe paradhënie. Grupi i punës UKT sh.a. ka paraqitur përbërjen e këtij zëri si në tabelën e mëposhtme:

<b>Përshkrim Llogari</b>	<b>Gjendja në Lek në 31.12.2016</b>
Parapagim ndaj shtetit (TVSH)	59,379,536
Debitor të tjerë	12,453,211
Debitor të tjerë paradhënie për qeratë	1,585,000
Fatura te pa mberritura-Energji	252,500
Fatura te pamberritura	11,602,374
Personeli debitor dhe kreditor	9,387,727
Te ardhura te periudhave te ardhme	882,215
Te ardhura te anuluar nga komisioni i apelimit	7,304,205
Debitor të tjerë përmbarimi	13,748,327
<b>Totali i aktiveve të tjera dhe paradhënie</b>	<b>116,595,095</b>
<i>Zhvleresime per rreziqe te tjera</i>	<i>(23,927,729)</i>
<b>Totali i aktiveve të tjera dhe paradhënie</b>	<b>92,667,366</b>

Pas marrjes së informacionit nga grupi i punës së UKT, bazuar në rrezikun e vlerësuar ne kemi kryer ekzaminimet dhe procedurat e nevojshme për të verifikuar saktësinë e këtij informacioni si dhe kemi analizuar procesin e ndarjes së Aktiveve të tjera Afatshkurtër nga UKT sh.a. sipas modaliteteve të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionereve. Sipas këtij plani të ndarjes Aktive të tjera dhe paradhënie nuk do jenë pjesë e ndarjes tek Shoqëritë e reja UKB Vorë dhe UKB Kamëz. Ato do kalojnë të gjitha në UKB Tiranë.

### 3.6.3 Konkluzioni

Duke marrë konsideratë sa më sipër, ne NUK kemi ndonjë arsye tjetër të mendojmë se ndarja e Aktiveve Afatshkurtër nuk është bërë sipas modaliteteve të miratuara, si dhe vlera reale e tyre të jetë e ndryshme nga sa është paraqitur më sipër, përveç sa më poshtë:

- Meqenëse shoqëria UKT sh.a. është në proces inventarizimi në datën e këtij raporti, pasojat që mund të vijnë nga rezultati i inventarizimit fizik të inventarëve qarkulluese mund të kenë ndikim në vlerën e inventarit qarkullues që do ti kalojë UKB Tiranë.
- Ne kemi kryer punën tonë, në kushtet kur UKT sh.a. nuk kishte përfunduar pasqyrat financiare finale të vitit të mbyllur në datën 31.12.2016, dhe informacioni për shtesat/pakësimet gjatë vitit 2016 për zërat e Aktiveve Afatshkurtër është bazuar në regjistrimet e deritanishme të bëra nga stafi i UKT sh.a. Si rrjedhojë, vlerat përfundimtare të Aktiveve Afat Shkurtër mund të jenë subjekt ndryshimi në përfundim të pasqyrave financiare përfundimtare. Meqenëse pjesa më e madhe e këtyre Aktiveve Afat Shkurtra do kalojnë me UKB Tiranë, rrjedhimisht efektet e ndryshimeve të mundshme do jenë më të ndjeshme tek UKB Tiranë.

### 3.7 Analiza e klientëve /abonent të UKT sh.a.

#### 3.7.1 Informacioni i marrë

Grupi i punës së UKT sh.a, ka paraqitur listën e klientëve abonentë nga departamentet e shitjes dhe financës në UKT sh.a. në datën 31.12.2016 që përbëjnë vlerën e “Llogarive të arkëtueshme” në Bilancin të pa-audituar të vitit 2016, si dhe shumën e provizioneve respektive të llogaritura deri në këtë datë për ato abonentë për të cilët shoqëria ka gjykuar se arkëtimi i tyre nuk është i sigurt (Ref. shtojca 7 dhe shtojca 8). Në mënyrë të përmbledhur llogaritë e arkëtueshme për Abonentët në shuma Bruto dhe Neto jepen si më poshtë:

<b>Llogarite e arkëtueshme (nga klientë)</b>		<b>Gjendja në Lek në 31.12.2016</b>
<i>Llogaritë e arkëtueshme (Bruto)</i>		3,874,298,896
<i>Zhvlerësimi Llogarive të arkëtueshme</i>		(866,060,140)
<b>Llogarite e arkëtueshme (Neto)</b>		<b>3,008,238,756</b>

#### 3.7.2 Metodologjia dhe puna e kryer

Ne kemi marrë nga grupi i punës së UKT sh.a. informacionin e sipër cituar dhe bazuar në analizën e rrezikut ne kemi kryer procedura të ndryshme të nevojshme për të verifikuar saktësinë e këtij informacioni.

Grupi ynë i punës ka analizuar në detaje regjistrin e llogarive të arkëtueshme për vitin 2016 si dhe përlllogaritjen e provizioneve për secilën kategori të abonentëve debitor.

Gjithashtu, analizuam ndarjen e klientëve/abonentëve debitor të UKT sh.a. sipas tre bashkive në përputhje me kriteret e përcaktuara nga Asambleja e Përgjithshme e UKT sh.a.

Ne kemi analizuar tepricat e debitorëve të këqij si pjesë e llogarive të arkëtueshme si dhe kemi analizuar nëse provizioni i krijuar për këta debitorë të këqij është i përshtatshëm në datën e këtij raporti. Në lidhje me këto provizione, ne verifikuam metodologjinë e përlllogaritjes së provizioneve, duke marrë në konsideratë edhe vrejtitjen e paraqitur në paragrafin 5 të raportit të audituesit për pasqyrat financiare 2015, ku theksohet se metodologjia e aplikuar nuk është në përputhje me kërkesat e standardit ndërkombëtar të kontabilitetit 39.

Tabela e mëposhtme paraqet një përmbledhje të Llogarive të arkëtueshme dhe provizioneve për Llogaritë e arkëtueshme Klient Abonentë dhe Debitorë të tjerë të UKT sh.a. në 31 dhjetor 2016, si dhe ndarjen e tyre në tre shoqëritë e reja:

		<b>Ndarja e propozuar në shoqëritë e reja</b>			
<b>Llogaritë e arkëtueshme</b>		<b>31 Dhjetor 2016</b>	<b>UKB Tiranë</b>	<b>UKB Kamëz</b>	<b>UKB Vorë</b>
<b>Llogaritë e arkëtueshme (Bruto)</b>	<b>a + d</b>	3,874,298,896	3,650,927,385	203,800,805	19,570,706
<i>Klient/Abonent</i>	<i>a</i>	2,937,620,155	2,714,248,643	203,800,805	19,570,706
<i>Provizion</i>	<i>b</i>	(866,060,140)	(797,650,384)	(63,684,265)	(4,725,491)
<b>Te arkëtueshme Klient Net</b>	<b>C = a - b</b>	2,071,560,015	1,916,598,260	140,116,540	14,845,215
<b>Debitor të tjerë net</b>	<b>d</b>	936,678,741	936,678,741	-	-
<b>Llogari te arkëtueshme net</b>	<b>C + d</b>	<b>3,008,238,756</b>	<b>2,853,277,001</b>	<b>140,116,540</b>	<b>14,845,215</b>

Duke qenë se Shoqëritë e reja Ujësjetlles Kanalizime Bashkia (UKB) Kamëz dhe Ujësjetlles Kanalizime Bashkia(UKB) Vorë do marrin pjesë vetëm në ndarjen e Klientëve Abonentë, shuma prej 936,678,741 Lek “Debitorë të tjerë”, i mbetet shoqërisë së re Ujësjetlles Kanalizime Bashkia(UKB) Tiranë, për shkak të lidhjes së ngushtë të tyre me aktivitetin i cili mbetet në juridiksionin e UKB Tiranë.

Gjatë punës sonë për verifikimin e saktësisë së informacioneve të paraqitura nga grupi i punës UKT sh.a, u konstatua se kishte gjithmonë një mos-përputhje midis vlerës totale të tepricës së Klientëve abonentë sipas regjistrimit kontabël në Programin Financa 5 dhe sistemit kompjuterik të faturimeve në departamentin e shitjes, e cila në datën 31.12.2016 nuk ishte një shifër materiale.

### 3.7.3 Konkluzioni

Duke marrë në konsideratë sa më sipër, të bazuar dhe në analizën e rrezikut kemi kryer procedurat tona të verifikimit të saktësisë së informacionit të paraqitur nga grupi i punës UKT sh.a. ne nuk kemi ndonjë arsye tjetër të mendojmë se paraqitja dhe ndarja e Klientëve Abonentë dhe Debitorëve të tjerë nuk është bërë sipas modaliteteve të miratuara, si dhe vlera reale e tyre të jetë e ndryshme nga sa është paraqitur më sipër, përveçse:

- a. Për sa i përket vërejtjes së përmendur në Raportin e Auditimit të vitit 2015, ne kemi konstatuar se edhe pse UKT sh.a. nuk ka ndryshuar politikën e saj për përlogaritjen e provizioneve për klientët Abonent debitor gjatë vitit 2016, provizioni i krijuar është i përshtatshëm në datën 31.12.2016, pavarësisht vërejtjes në raportin e audituesit për pasqyrat financiare për vitin 2015. Kjo e bazuar dhe e provuar me eksperiencën e pasur të UKT sh.a. e cila ka aplikuar këtë politikë ndër vite, dhe ne mendojmë se kjo politikë ka qenë konsistent dhe e përshtatshme për natyrën e biznesit të UKT sh.a. dhe të qëllimit të saj në shërbim të popullatës.
- b. Në lidhje me debitorët e tjerë natyra e të cilëve është shumë e ndryshme ne mendojmë se paraqitja dhe masa e provizionit për zhvlerësimin e tyre është i përshtatshëm në datën 31.12.2016.
- c. Ne kemi kryer punën tonë, në kushtet kur UKT sh.a. nuk kishte përfunduar Pasqyrat Financiare finale të vitit të mbyllur në datën 31.12.2016, dhe informacioni për shtesat/pakësimet gjatë vitit 2016 për zërin e Llogarive të arkëtueshme është bazuar në regjistrimet e deritanishme të bëra nga stafi i UKT sh.a. Si rrjedhojë, vlerat përfundimtare të Llogarive të arkëtueshme mund të jenë subjekt ndryshimi në përfundim të pasqyrave financiare për vitin 2016. Në opinionin tonë, efektet e pritshme (nëse do të ketë), me shumë gjasa do të kenë impakt në zvogëlimin e shumës neto të Llogarive të arkëtueshme Klientë Abonentë.

### 3.8 Ndarja e klientëve aktivë

#### 3.8.1 Informacioni i marrë

Nga stafi i UKT sh.a. ne kemi marrë të printuar listën e klientëve aktivë të UKT sh.a., për njësitë bashkiake Vorë dhe Kamëz dhe në formë elektronike në CD “Anekset elektronike”, dosja “Lista e klientëve” për Bashkinë Tiranë që janë shoqëruese të këtij raporti. Sipas informacionit, numri total i klientëve aktivë të UKT sh.a. është 228,158 Abonentë i paraqitur si më poshtë për çdo njësi Bashkiake:

<b>Bashkia</b>	<b>Numri i Klienteve aktiv</b>	<b>%</b>
Tiranë	220,018	96.4%
Kamëz	4,492	2.0%
Vorë	3,648	1.6%
<b>Klientet Total</b>	<b>228,158</b>	<b>100%</b>

#### 3.8.2 Metodologjia dhe puna e kryer

Duke u bazuar në informacionin e dhënë nga UKT sh.a. ne kemi kryer ekzaminimet dhe procedurat e duhura për të verifikuar nëse procesi i ndarjes është kryer sipas modaliteteve të përcaktuara në Vendimin e Asamblesë Nr.11 datë 31.08.2016. Ndarja e klientëve është bërë sipas kriterit të vendndodhjes gjeografike së klientëve, pra sipas ndarjes së re administrative. Një ndarje e tillë, përveç zbatimit të kriterit të përcaktuar nga Asambleja e Përgjithshme e UKT sh.a bëhet edhe për arsye të përputhshmërisë me pagesën e taksave lokale për çdo Bashki nëpërmjet faturimit të shoqërive të reja që krijohen. Rrjedhimisht numri i klientëve të cilët i kalojnë shoqërive të reja që krijohen është paraqitur në mënyrë përmbledhëse më poshtë duke u bazuar në listat e detajuara të përfshira në CD-në (file: “Ndarja e klientëve”) pjesë shoqëruese të këtij raporti.

#### 3.8.3 Konkluzioni

Duke konsideruar sa më sipër ne konkludojmë se NUK kemi ndonjë arsye të mendojmë që ndarja e klientëve të UKT sh.a sipas ndarjes administrative nuk është bërë në mënyrë të saktë, duke qenë se të dhënat për vendndodhjen e klientëve sipas sistemit kompjuterik të faturimit, janë të sakta.

### 3.9 Vlerësimi dhe raporti i ndarjes së detyrimeve kundrejt furnitorëve dhe detyrime të tjera afatshkurtër

#### 3.9.1 Informacioni i marrë

Ne kemi marrë nga grupi i punës së UKT sh.a. regjistrat kontabël dhe Bilancin e pa-audituar në datën 31.12.2016 (shtojca 3.2) ku vlera totale e “Llogarive të pagueshme“ është Lek 2,819,777,511, e cila përbëhet nga Llogari të pagueshme tregtarë (Furnitorë) dhe nga Llogari të tjera të pagueshme. Tabelat më poshtë paraqesin përbërjen e këtyre dy zërave kryesorë, ndërkohë një informacion më i zgjeruar për këtë zë të Bilancit jepet në shtojcën 6:



<b>Furnitorë UKT sh.a.</b>	<b>Gjëndja në Lek në 31.12.2016</b>
Furnitorë për mallra dhe shërbime	952,034,421
Furnitorë për shërbime përmbarimi	1,622,723
Furnitorë për aktive afatgjata	679,054,974
Garanci furnitore	168,294,068
Furnitorë për ambiente me qera	701,690
<b>Detyrimet totale ndaj furnitorëve</b>	<b>1,801,707,876</b>

<b>Llogari të tjera të pagueshme</b>	<b>Gjëndja në Lek në 31.12.2016</b>
Personeli për sindikatën	1,599
Taksa pastrimit Bashkia Tiranë të përllogaritura	622,341,128
Taksa e pastrimit Bashkia Tiranë	265,184,596
Taksa e pastrimit Komuna Pakuqan	1,893,643
Taksa ndertese Bashkia Tiranë	37,810,850
Taks infrastrukture/arsimore Bashkia Tiranë	40,559,550
Kreditore të tjerë	15,824,629
Shpenzime të periudhave të ardhëshme	12,482
Të ardhura të llogaritura	31,107,606
Të ardhura të periudhave të ardhëshme	3,333,553
<b>Totali i llogarive të tjera të pagueshme</b>	<b>1,018,069,636</b>

### 3.9.2 Metodologjia dhe puna e kryer

Ne kemi marrë nga grupi i punës së UKT sh.a. informacionin Llogarive të pagueshme dhe kemi kryer ekzaminimet dhe procedurat e duhura sipas analizës së rrezikut, për të verifikuar saktësinë e informacionit të dhënë dhe nëse procesi i ndarjes është kryer sipas modaliteteve të përcaktuara në Vendimin e Asamblesë Nr.11 datë 31.08.2016.

Grupi i punës i UKT sh.a. ka propozuar që “Llogaritë e pagueshme” në shumën Lek 2,819,777,511 do ti kaloje 100% shoqërisë së re Ujësjetës Kanalizime Bashkia Tiranë, si rezultat i lidhjes së ngushtë të këtyre elementeve dhe operacioneve të tyre me aktivitetin e UKT sh.a. brenda juridiksionit të Bashkisë Tiranë, dhe për qëllime të aktivitetit të UKT sh.a. në këtë territor.

### 3.9.3 Konkluzioni

Duke konsideruar sa më sipër, nga analiza e të dhënave se nga çfarë aktiviteti rezultojnë këto detyrime si dhe argumentimin e dhënë nga stafi për propozimin për kalimin e të gjithë shumës së “Llogarive të pagueshme” në shoqërinë e re Ujësjetës Kanalizime Bashkia Tiranë, ne konkludojmë që kalimi i të gjitha detyrimeve të përfshira në zërin e bilancit “Llogari të pagueshme” në 31.12.2016 tek shoqëria e re që krijohet Ujësjetës Kanalizime Bashkia Tiranë është i drejtë dhe është bërë sipas modaliteteve të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme

Ne kemi kryer punën tonë, në kushtet kur UKT sh.a. nuk kishte përfunduar pasqyrat financiare finale të vitit të mbyllur në datën 31.12.2016, dhe informacioni për shtesat/pakësimet gjatë vitit 2016 për zërin e Llogarive të pagueshme është bazuar në

regjistrimet e deritanishme të bëra nga stafi i UKT sh.a. Si rrjedhojë, vlerat përfundimtare të Llogarive të pagueshme mund të jenë subjekt ndryshimi në përfundim të Pasqyrave Financiare përfundimtare.

### 3.10 Vlerësimi dhe ndarja e huave sipas kriterëve të pranueshme në raport me investimet dhe impaktin e tyre në rrjetin shpërndarës në pronësi të secilës prej shoqërive të reja;

#### 3.10.1 Informacioni i marë

Ne kemi marrë nga grupi i punës së UKT sh.a. evidencën e Huave afatgjatë dhe afat shkurtër në datën 31.12.2016 dhe regjistrimet kontabël deri në datën 31.12.2016. (shtojca 13).

Tabela e mëposhtme paraqet në mënyrë të përmbledhur huatë afatgjata dhe tepricat e tyre përkatëse në datë 31.12.2016:

Emërtimi i Huasë Afatgjatë	Monedha	Vlera e akorduar e kredisë	Gjëndja e mbetur e kredisë në EUR në 31.12.2016	Konvertimi në monedhën Lek me kursin 1 EUR = 135.23 Lek	Gjëndja e mbetur e kredisë në Lek në 31.12.2016
Bovilla - Konventa 22 Mld Lit. - F.ROT/AID-95/007/00	EUR	11,362,052	5,365,408	725,564,182	725,564,182
Konventa Financiare 13 Mld Lit - F.ROT/AID-94/006/00	EUR	6,713,940	2,797,472	378,302,084	378,302,084
Konventa Financiare 53.2 Mld Lit - F.ROT/AID-99/004/00	EUR	27,475,507	16,708,851	2,259,537,910	2,259,537,910
Konventa Financiare 6.8 Mld Lit - F.ROT/AID-99/010/00	EUR	3,511,395	3,511,394	474,845,803	474,845,803
Projekti COMM 98 - Konventa Financiare 22 Mld Lit - F.ROT/AID-98/001/00	EUR	584,833	357,398	48,330,950	48,330,950
<b>Totali i huave afatgjata në monedhën EUR</b>		<b>49,647,726</b>	<b>28,740,523</b>	<b>3,886,580,929</b>	<b>3,886,580,929</b>
Huamarrje afatgjatë HEC	LEK	2,130,000,000			1,046,921,317
Kredia Shën-Mërisë	LEK	704,150,255			702,646,082
Interesa të përlogaritura	LEK				9,038,553
<b>Totali i Huamarrjeve Afatgjata</b>		<b>2,883,797,982</b>	<b>28,740,523</b>	<b>3,886,580,929</b>	<b>5,645,186,881</b>

Huatë afatshkurtër konsistojnë kryesisht në detyrime afatshkurtër ndaj Ministrisë së Financave, për të cilat UKT sh.a. nuk paguan me interes. Sipas informacioneve të mara nga regjistri kontabël gjendja e huamarrjeve afatshkurtra në mënyrë të përmbledhur është si paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Huatë afatshkurtër	Gjëndja në Lek në 31.12.201
Huamarrje afatshkurtër Ministria e Financave (Principale)	1,174,066,826
Huamarrje afatshkurtër Ministria e Financave (Interesa)	31,010,411
Huamarrje afatshkurtër të tjera (principale)	140,194,626
<b>Totali i huave afatshkurtër</b>	<b>1,345,271,863</b>

#### 3.10.2 Metodologjia dhe puna e kryer

Ne kemi marrë informacionin e mësipërm nga grupi i punës i UKT sh.a. Kemi kryer procedurat e nevojshme për të verifikuar saktësinë e informacionit bazuar në analizën e rrezikut, si dhe kemi analizuar në detaje elementet e çdo huaje. Më pas kemi kontrolluar të gjitha transaksionet dhe regjistrimet e bëra në regjistrin kontabël gjatë vitit 2016.

Gjithashtu, ne kemi verifikuar qëllimin e çdo huaje të marrë nga UKT sh.a. në raport me aktivin për të cilën ajo është përdorur respektivisht. Në vazhdim, ne kemi bërë verifikimin e qëllimit dhe funksionit të aktiveve përkatëse (për të cilat është marrë hua) sikurse është

përcaktuar në modalitetet e miratuara nga Asambleja e Përgjithshme e UKT sh.a. Së fundmi, kemi vlerësuar ndarjen e huave afatshkurtra dhe afatgjata që ka bërë stafi i UKT sh.a., duke ia kaluar të dyja tepricat prej Lek 1,345,271,863 dhe Lek 5,645,186,881 respektivisht shoqërisë së re Ujësjetllës Kanalizime Bashkia Tiranë.

### 3.10.3 Konkluzioni

Duke u bazuar në informacionin e marrë nga stafi i UKT sh.a. dhe punën e bërë nga grupi ynë i punës ne arritëm në konkluzionin se:

- a. Huatë afatgjata dhe afatshkurtra janë vlerësuar drejt dhe paraqesin një pamje të plotë të Huave që ka Shoqëria UKT sh.a. ndaj Institucioneve financiare dhe jo financiare në datën 31.12.2016.
- b. Ndarja e huave nga stafi i UKT sh.a. është bërë në bazë të modaliteteve të vendosura në Asambleshën e Përgjithshme, dhe duke qenë se këto hua janë ekskluzivisht të lidhura me aktivet afatgjatë të cilat i kalojnë dhe janë nën juridiksionin shoqërisë së re UKB Tiranë sipas paragrafit 4.4 të këtij raporti, këto do ti kalojnë 100% shoqërisë së re UKB Tiranë.

## 3.11 Vlerësimi i granteve të mara

### 3.11.1 Informacioni i marrë

Ne kemi marrë nga grupi i punës së UKT sh.a. informacione për “Grantet e mara” që konsistojnë në Pasqyrat Financiare të vitit 2015 dhe Bilancin e UKT sh.a. në datën 31.12.2006 (i pa audituar), si dhe informacione në lidhje me grantet që UKT sh.a. ka marrë nga Qeveria e Shqipërisë dhe Organizma të tjerë në lidhje me realizimin e investimeve në infrastrukturën e rrjetit shpërndarës të ujit të pijshëm dhe të kanalizimeve. Grantet e mara fillimisht njihen si detyrime në Pasqyrat e Pozicionin Financiar, ri-marrja e tyre në të ardhura bëhet në përputhje me jetëgjatësinë e aktivitetit të përfutur nga granti përkatës.

Shuma totale e granteve e pasqyruar në Bilancin e pa-audituar në datë 31.12.2016 është Lek 479,651,937. Gjatë vitit 2016 Teprica e granteve është pakësuar me një shumë prej Lek 14,449,956, e cila përfaqëson shumën e rimarrë në të ardhura gjatë këtij viti.

<b>Grantet UKT sh.a.</b>	<b>Në Lek</b>
Grante afatgjatë në 31.12.2015	494,101,893
Rimarrje në të ardhura për vitin 2016	14,449,956
<b>Gjendja e granteve afatgjata në 31.12.2016</b>	<b>479,651,937</b>

### 3.11.1 Metodologjia dhe puna e kryer

Ne kemi analizuar informacionin e dhënë nga stafi i UKT sh.a. për grantet dhe kemi aplikuar procedurat e nevojshme për të verifikuar saktësinë e shumave të raportuar dhe për të vlerësuar nëse ndarja e granteve është bërë në përputhje me modalitete të përcaktuara në Vendimin e Asamblesë Nr.11 datë 31.08.2016.

- a. Ne kemi marrë në konsideratë gjithashtu dhe vërejtjet e audituesit për pasqyrat financiare për vitin 2015 (shtojca 3.1), rishikuar dokumentacionit mbështetës rreth granteve.
- b. Grupi i punës së UKT sh.a. ka parashikuar se shuma e mbetur e granteve të mara duhet të kalojë 100% në shoqërinë e re që krijohet Ujësjetllës Kanalizime Bashkia Tiranë, duke qenë se këto grante janë përdorur për investime në aktive të cilat janë në shërbim të aktivitetit në territorin e Bashkisë Tiranë, si dhe janë të lidhura ekskluzivisht me aktive të cilat i kalojnë shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Bashkia Tiranë të përmendura në paragrafin 4.4 të këtij raporti.

### 3.11.2 Konkluzioni

Duke u bazuar në informacioni e mbledhur dhe në analizën e kryer të të dhënave më sipër ne konkludojme se:

- a. Ashtu sikurse është përmendur në Raportin e auditimit në paragrafin “Bazat për mos dhënie opinionin” dhe në shënimin Nr. 17 të Pasqyrave Financiare të vitit 2015, shoqëria UKT sh.a. nuk disponon dokumentacion të mjaftueshëm për të vërtetuar tepricën e këtyre Granteve në datën 31.12.2015. Gjatë punës së kryer nga grupi i punës së UKT sh.a. nuk na ka paraqitur ndonjë informacion shtesë për të mbështetur shumën e raportuar në zërin Grante të mara në datën 31.12.2016. Për këtë arsye konstatimi i bërë në raportin e auditimit të vitit 2015 është ende i pa zgjidhur.
- b. Ne vlerësojmë se vendimi i stafit të UKT sh.a. për të kaluar të gjithë vlerën e mbetur të detyrimit afatgjatë – grante në 31.12.2016 tek shoqëria e re UKB Tiranë është i drejtë dhe në përputhje me modalitetet e miratuara nga Asambleja e Përgjithshme në Vendimin e Asamblesë Nr.11 datë 31.08.2016.

Përveç sa më sipër, ne NUK kemi ndonjë arsye apo indikator tjetër që të na bëjë të mendojmë se ndarja e zërit Grante të mara nuk është bërë në përputhje me modalitetet e përcaktuara në Vendimin e Asamblesë Nr.11 datë 31.08.2016.

## 3.12 Analiza dhe ndarja e punonjësve si pasojë e ndarjes të UKT sh.a. si dhe provizionet e pretendimeve nga punonjësit për çështjet në gjykatë

### 3.12.1 Informacioni i marrë

Nga stafi i UKT sh.a kemi marrë listën e punonjësve aktual të UKT sh.a. të ndarë sipas njësive administrative ku ata punojnë (shtojca 10), ku dallohet se UKT sh.a. nuk ka punonjës të saj që punojnë në territorin e Bashkisë së Kamzës. Kjo bashki ka personelin e saj i cili kujdeset për të ofruar shërbimet tek klientët e saj.

Struktura aktuale e punonjësve është e ndarë sipas këtyre nën-ndarjeve:

<b>Kategorit e punonjësve</b>	<b>Numri i punonjësve</b>
Drejtues	23
Specialiste dhe inxhinieri	217
Punonjës në terren	751
Administratë	229
<b>Numri total i punonjësve UKT sh.a.</b>	<b>1,220</b>

Kjo strukturë ka garantuar funksionimin e plotë të shoqërisë UKT sh.a. në të gjitha segmentet dhe divizionet e saj, dhe nuk priten ndryshime të mëdha si pasoje e ndarjes.

Gjatë viteve të fundit shoqëria ka pasur lëvizje të shpeshta në personelin e saj, dhe këto lëvizje janë diktuar nga nevoja për personel me cilësi dhe kualifikime të veçanta si dhe nga nevoja për të mbuluar më mirë shërbimin në një territor në rritje e zmadhim të vazhdueshëm.

Gupi i punës së UKT sh.a., na ka paraqitur një listë me ish-punonjës që janë larguar nga UKT sh.a. të cilët kanë ngritur kanë pretendime për ndërprerje të marrëdhënieve të punësimit në mënyrë të pa ligjshme nga ana e UKT sh.a. dhe për këtë kanë hapur procese gjyqësore ndaj UKT sh.a. Një pjesë e këtyre çështjeve janë fituar nga ish të punësuarit dhe e një pjesë janë ende në proces gjyqësor ndaj UKT sh.a. Një trajtim më i hollësishëm i tyre nga pikëpamja ligjore jepet në paragrafin 2 të këtij raporti. Më poshtë jepen shumat përkatëse të pretenduara nga këta punonjës të cilat janë provizionuar në datën e Bilancit të pa audituar në datën 31.12.2016 (shtojca 3.2).

### 3.12.2 Metodologjia dhe puna e kryer

Duke u bazuar në informacionin e marrë prej UKT sh.a. dhe në vlerësimin e rrezikut ne kemi kryer ekzaminime dhe procedura të tjera sipas rastit për të verifikuar nëse ndarja e punonjësve të UKT në tre shoqëritë e reja të krijuara është në përputhje me modalitetet e përcaktuara nga Asamblesë e Përgjithshme nëse kjo ndarje garanton vazhdimin e aktivitetit për shoqëritë që ndahen.

- Pas analizës së detajuar të të dhënave marrë nga UKT-ja dhe procedurave të ndjekura për vlerësimin e saktësisë së informacionit, vlerësuam se ndarja e punonjësve sipas njësive administrative ku ata punojnë nga stafi i UKT sh.a është si më poshtë:

<b>Numri total i punonjësve UKT sh.a.</b>	<b>1,220</b>
Numri i punonjësve që vazhdojnë në Tiranë	1,177
Numri i punonjësve që kalojnë në shoqërinë e re në Vorë	43
<b>Numri i punonjësve që kalojnë në shoqërinë e re në Kamëz</b>	<b>-</b>

Sikurse thuhet më sipër Bashkia Kamëz e ka administruar vetë aktivitetin e shpërndarjes së ujit tek banorët e saj, dhe si rrjedhojë UKT sh.a nuk ka ndonjë pjesë të personelit të saj që i shërben kësaj njësie administrative dhe nuk do ketë kalim të personelit në këtë njësi administrative.

Persa i përket Bashkisë Vorë, ajo do të marrë në formën e transferimit 43 punonjës, të cilët mbulojnë më së shumti procesin operacional në terren, prandaj kjo njësi administrative duhet të vlerësojë nevojat e saj për staf drejtues dhe specialitë në momentin që behet kalimi i aktivitetit tek kjo njësi administrative.

- b. Sa i përket pretendimeve të ish-punonjësve ndaj UKT sh.a, ne kemi kryer ekzaminimet e duhura në vlerësimin e rrezikut, dhe kontrolluam provizionimin që stafi i UKT sh.a kishte bërë për shumat e pretenduara në proceset gjyqësore në vazhdim, paraqitur në mënyrë të përmbledhur në tabelën e mëposhtme:

<b>Provizionet</b>	<b>Në 31.12.2016 (në Lek)</b>
Për personelin	89,055,246
Pavlefshmëri e titujve ekzekutiv	53,900,797
<b>Provizionet totale për çështjet gjyqësore</b>	<b>142,956,043</b>

### 3.12.3 Konkluzioni

Duke u bazuar në informacionin e paraqitur nga UKT sh.a. dhe në punën tonë mbi këto informacione sipas metodave të gjykuara të nevojshme nga ana jonë, ne konkludojmë se:

- a. NUK ka ndonjë arsye të mendojmë që ndarja e punonjësve nuk është bërë sipas modaliteteve të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme, pasi të gjithë punonjësit që punojnë në njësinë nr. 6 (Bashkia Vorë) do i kalojnë shoqërisë së re që krijohet UKB Vorë.
- b. Sa i përket çështjeve gjyqësore të përfunduara apo në proces ne mendojmë se provizioni i krijuar për to në masën 100% është i saktë siç është paraqitur në Bilancin e pa-audituar në datë 31.12.2016, bazuar dhe në komentin përkatës në paragrafin 2, dhe ky provizion kalon 100% me shoqërinë e re UKB Tiranë.

## 3.13 Vlerësimi i të drejtave dhe detyrimeve tatimore në raport me ndarjen e aktiveve

### 3.13.1 Informacioni i marrë

Ne kemi marrë nga grupi i punës së UKT sh.a. listën e detyrimeve tatimore, e përbëra nga deklarata tatimore për vitin 2016 (shtojca 12), si dhe regjistrimeve kontabël për këto detyrime. Në datën e Bilancit të pa-audituar (31.12.2016) këto detyrime tatimore rezultojnë si më poshtë:

<b>Detyrime tatimore për tu paguar</b>	<b>Gjendja në Lek në 31.12.2016</b>
Sigurime shoqërore dhe shëndetësore - administratë	15,626,856
Detyrim mbi të ardhurat personale - administratë	3,676,472
Tatim në burim - këshilli mbikqyrës	50,520
Tatim në burim - ambjente me qera	516,239
Tatim fitimi për vitin 2016	44,946,033
<b>Totali</b>	<b>64,816,120</b>

### 3.13.2 Metodologjia dhe puna e kryer

Ne kemi analizuar informacionin e mësipërm dhe duke bazuar në vlerësimin e rrezikut ne kemi kryer ekzaminime dhe procedura të tjera të nevojshme për tu siguruar që detyrimet fiskale të paraqitura në Bilancin e pa-audituar ne datën 31.12.2016 janë vlerësuar drejt dhe se ndarja e tyre midis shoqërive të reja është bërë në përputhje me modalitet e ndarjes siç përcaktohet në vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të UKT sh.a.

Grupi i punës së UKT sh.a. ka propozuar që në procesin e ndarjes së këtyre detyrimeve midis shoqërive të reja që do krijohen, ato ti kalojnë 100% shoqërisë së re Ujësjetllës Kanalizime Bashkia Tirana.

Ne kemi zhvilluar bisedime dhe kemi ngritur disa çështje për diskutim me grupin e punës së UKT sh.a. për detyrimet tatimore, dhe në mënyrë më specifike kemi kërkuar se çfarë analize është bërë nga UKT sh.a. për të vlerësuar rrezikun e ndonjë detyrimi tatimor që mund të rezultojë nga ndonjë kontroll tatimor prej organeve tatimore përkatëse. Kontrolli i fundit tatimor në UKT sh.a. është bërë gjatë vitit 2013, me objekt periudhën tatimore 2011-2013 i cili ka nxjerrë detyrime tatimore dhe penalitete në shumën prej Lek 7,127,473. Drejtuesit e UKT sh.a. nuk kanë parashikuar ndonjë provizion në lidhje me detyrime që mund të lindin potencialisht në të ardhmen nga ndonjë kontroll tatimor.

### 3.13.3 Konkluzioni

Pas analizës së informacionit të marrë dhe punës së kryer nga grupi ynë në bazë të rrezikut të vlerësuar, ne konkludojmë se:

- Përveç faktit të përmendur më lart të mungesës së provizionit për detyrime tatimore në të ardhmen, ne konkludojmë se NUK ndonjë arsye apo faktorë tjetër që të na bëjë të mendojmë se Detyrimet tatimore të pasqyruara në Bilancin e pa-audituar të UKT sh.a. në datën 31.12.2016, të përmbajnë ndonjë pasaktësi materiale.
- Ne, aprovojmë vendimin e grupit të punës UKT sh.a. që këto detyrimet tatimore të UKT sh.a. deri në 31.12.2016 i takojnë shoqërisë së re që krijohet në Bashkinë Tiranë, duke qenë se ato janë më së shumti të lidhura me aktivitetin e kryer në periudhën para ndarjes.
- Ne kemi kryer punën tonë, në kushtet kur UKT sh.a. nuk kishte përfunduar pasqyrat financiare finale të vitit të mbyllur në datën 31.12.2016, dhe informacioni për

detyrimet tatimore është bazuar në regjistrimet e deritanishme të bëra nga stafi i UKT sh.a. Si rrjedhojë, vlerat përfundimtare të detyrimeve tatimore mund të jenë objekt ndryshimi në përfundim të pasqyrave financiare përfundimtare. Meqenëse këto detyrime do ti kalojnë totalisht shoqërisë së re UKB Tiranë, rrjedhimisht dhe efektet e ndryshimeve të mundshme do jenë më të ndjeshme tek shoqëria e re UKB Tiranë.

- d. Me transferimin e Aktiveve afatgjatë materiale nga UKT sh.a. tek tre shoqëritë e reja që do krijohen, pritet që të ketë efekte në shumën e taksave që shoqëria UKT sh.a duhet të paguajë në datën e transferimit të aktiveve tek shoqëritë e reja. Shuma e këtyre taksave do te jetë e barabartë me 15% të tepicës së Rezervës së Rivlerësimit të Aktiveve, minus shumën e transferuar gjatë viteve në fitimet e mbartura pa kaluar nga pasqyra e të ardhurave deri në datën e ndarjes në përputhje me Standardin Ndërkombëtar të Kontabiliteti 16, Toka, Ndërtesa, Makineri e Pajisje.



## 4. Bilanci i pa audituar në datën 31.12.2016

Grupi i punës së UKT sh.a. ka paraqitur si më poshtë, Bilancin e pa-audituar të shoqërisë në datën 31.12.2016 mbi të cilin është bazuar puna jonë dhe konkluzionet tona të paraqitura në këtë raport.

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR 31 DHJETOR 2016					
Shumat ne leke					
					31 Dhjetor 16
	UKT sh.a 31.12.2016	UKB Tirane	UKB Kamez	UKB Vore	
<b>Aktivet Afatshkurter</b>					
Mjetet Monetare dhe te Ngjashme	214,397,231	214,397,231			
Llogarite e arketueshme	3,008,238,756	2,853,277,001	140,116,540		14,845,215
<i>Llogarite e arketueshme</i>	<i>3,874,298,896</i>	<i>3,650,927,385</i>	<i>203,800,805</i>		<i>19,570,706</i>
<i>Zhvleresimi Llogarive te arketueshme</i>	<i>(866,060,140)</i>	<i>(797,650,384)</i>	<i>(63,684,265)</i>		<i>(4,725,491)</i>
Inventaret	460,430,586	460,430,586			
Aktive te tjera dhe paradhanie	92,667,366	92,667,366			
	<b>3,775,733,940</b>	<b>3,620,772,185</b>	<b>140,116,540</b>		<b>14,845,215</b>
<b>Aktivet AfatGjate</b>					
Aktive afatgjata materiale	13,541,323,499	13,326,219,639	148,907,786		66,196,074
<i>Aktive afatgjata materiale</i>	<i>14,385,298,033</i>	<i>14,123,113,369</i>	<i>181,996,064</i>		<i>80,188,600</i>
<i>Amortizimi Aktive afatgjata materiale</i>	<i>(843,974,534)</i>	<i>(796,893,730)</i>	<i>(33,088,278)</i>		<i>(13,992,526)</i>
Aktive te tjera afatgjata	956,085,878	956,085,878			
Tituj pjesmarrje	192,397,676	192,397,676			
Llogari konsolidimi te UKT					
	<b>14,689,807,053</b>	<b>14,474,703,193</b>	<b>148,907,786</b>		<b>66,196,074</b>
<b>Totali i Aktiveve</b>	<b>18,465,540,992</b>	<b>18,095,475,377</b>	<b>289,024,326</b>		<b>81,041,289</b>
<b>Detyrime Afatshkurter</b>					
Llogarite e pagueshem dhe detyrime te perllogaritura	2,819,777,511	2,819,777,511			
Detyrime ndaj personelit	51,865,404	51,865,404			
Detyrime ndaj Shtetit dhe ISSH	64,816,120	64,816,120			
Provizione	142,956,043	142,956,043			
Huamarrje afatshkurter	1,345,271,863	1,345,271,863			
	<b>4,424,686,941</b>	<b>4,424,686,941</b>			
<b>Detyrime AfatGjate</b>					
Huamarrje afatgjata	5,645,186,881	5,645,186,881			
Detyrime te Tjera ( Tatimi i Shtyre)	2,309,395	2,309,395			
Grante	479,651,937	479,651,937			
	<b>6,127,148,213</b>	<b>6,127,148,213</b>			
<b>Kapitali</b>	<b>7,162,825,585</b>	<b>6,792,759,970</b>	<b>289,024,326</b>		<b>81,041,289</b>
<b>Fitimi i periudhes</b>	<b>750,880,253</b>	<b>750,880,253</b>			
<b>Kapitali neto</b>	<b>7,913,705,839</b>	<b>7,543,640,224</b>	<b>289,024,326</b>		<b>81,041,289</b>
<b>Totali i Detyrimeve dhe Kapitalit Aksioner</b>	<b>18,465,540,992</b>	<b>18,095,475,377</b>	<b>289,024,326</b>		<b>81,041,289</b>

Pasqyra e Pozicionit Financiar sa më lart pasqyron ndarjen e propozuar të aktiveve neto midis shoqërive të reja që do krijohen në bazë të informacionit kontabël deri në datë 31.12.2016.

Të gjitha veprimet si rezultat i veprimtarisë ekonomike që nga data 1.1.2017 deri në ditën e ndarjes do të sjellin ndryshime në Pasqyrën e Pozicionit Financiar të UKT sh.a., të cilat do të kenë efekte në vlerën e aktiveve neto të transferuara në shoqëritë e reja. Diferencat midis Aktiveve neto të transferuara sipas këtij Bilanci të pa audituar dha vlerës së Aktiveve neto të transferuara realisht në momentin e ndarjes do të pasqyrohen si të drejta dhe detyrime midis shoqërive të reja që krijohen.